Viti XXXIII nr. 74

EDUKATA ISLAME

REVISTË SHKENCORE KULTURORE ISLAME

Prishtinë, 2004

Edukata Islame
Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXIII nr. 74 / 2004

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXXIII nr. 74 – 2004

Botues:
Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës
Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84
Tel & fax: 038 / 224-024
e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:
Mr. Qemajl Morina
qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:
Akad. Jashar Rexhepagiq, Dr.Pajazit Nushi,
Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahimi,
Hajrullah Hoxha dhe Xhabir Hamiti.

Sekretar i redaksisë: ***Hajrullah Hoxha***

Lektor: Isa Bajçinca

Korrektor: Skender Rashiti
Ballina: Shyqyri Nimani

Realizimi: **Shtëpia Botuese**
Redaktor teknik: Bashkim Mehani

Operator kompjuterik: Nuhi Simnica

Shtyp: *Koha* - Prishtinë

Tirazhi: 1000

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXIII nr. 74 / 2004

Prishtinë
2004

EDITORIALI

Mr. Qemajl Morina

ARSIMIMI

"Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi *(çdo gjë).* ***Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur. Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi*** *(njeriun)* ***të shkruaj me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte."*** *(Kurani:: el-Alak;1-5).*

Me fillimin e muajit shtator të gjitha shkollat anekënd botës i hapin dyert e tyre për nxënësit e të gjitha niveleve. Kështu veprohet edhe në Kosovë dhe në viset e tjera ku jetojnë shqiptarët. Arsimimi është ndër çështjet më të rëndësishme të individit, familjes dhe shoqërisë. Çështja e arsimit sot është njëra prej preokupimeve kryesore të botës bashkëkohore. Kjo është e arësyeshme, sepse aq sa është i arsimuar një popull aq vlen ndër popujt e tjerë. Të gjitha të arriturat shkencore dhe i tërë përparimi në të gjitha fushat e jetës, është rezultat i arritjeve të njeriut në lëmin e arsimit. Sot të gjithë popujt bëjnë gara për ngritjen e nivelit të arsimit, si mjet për të mbisunduar teknologjinë bashkëkokohore të kohës së sotme, e cila garanton një jetë më të mirë dhe më të begatshme për çdo popull. Përparimi në arsim, do të thotë përparim në të gjithë lëmenjtë e jetës si dhe prosperitet për vetë popullin.

Duke mbajtur parasysh të gjitha, më 17 maj të këtij viti, me iniciativën e Fakultetit të Shkencave Islame të Shkupit u organizua një tryezë e rrumbullakët me temën "*Gjendja dhe perspektivat e sistemit arsimor fetar në suazat e Bashkësisë Fetare Islame", ku morën* pjesë përgjegjës të arsimit fetar *nga të gjitha trojet shqiptare. Kumtesat e kësaj tryeze,* për shkak të rëndësisë që kanë, do t'i botojmë në revistën tonë që nga ky numër.

Sipas raporteve të fundit të Bankës Botërore si dhe UNICEF-it, shumë vende në zhvillim, siç janë për shembull vendet arabe, shpenzojnë shuma të konsiderueshme parash, ndoshta më shumë se vendet e zhvilluara, siç janë ShBA-ja, Kanadaja, Japonia dhe vendet evropiane. Megjithatë, në kohën kur Perëndimi shënon rezultate të theksuara dhe përparim të vazhdueshëm në lëmin e arsimit, shumë vende në zhvillim vazhdojnë të ngecin. Sa për ilustrim po përmendim se ShBA-ja në arsim shpenzon 5.5% të të hyrave kombëtare, kurse shpenzimet për arsimin në vendet arabe arrijnë 5.8% të të hyrave kombëtare. Maroku, për shembull, për arsim shpenzon një të katërtën e buxhetit dhe Algjeria shpenzon 30% të buxhetit. Ndërkaq, Egjipti për çdo 1.000 studentë shpenzon më tepër sesa shpenzon ShBA për aq.

Vendet e pasura, si Arabia Saudite, Kuvajti dhe vendet e tjera të Gjirit Arabik konsiderohen ndër shtetet që shpenzojnë më së shumti për arsimin në tërë botën. Megjithatë, në ato vende ka një ngecje të theksuar në sistemin e arsimit, kjo për sa u përket rezultateve tejet modeste në arsim, ashtu edhe numrit shumë të madh të atyre që mbeten të papunë edhe pas diplomimit. Sa për ilustrim mund të përmendim se në Egjipt, numri i të papunëve me diplomë universiteti arrin në 250.000, kurse numri i juristëve të diplomuar në Marok mund t'i plotësojë nevojat edhe për pesëdhjetë vjetët e ardhshëm. Edhe numri i atyre që janë kualifikuar për punë administrative në Algjeri, mund t'i plotësojë nevojat edhe për pesëdhjetë vjet të ardhshëm, kurse studentët që kryejnë studimet në shkencat ekzakte dhe teknologji, nëse do të kenë fat, mund të gjejnë punë vetëm në vendet perëndimore.

Hapja e shkollave të huaja

Për këtë gjendje të palakmueshme të arsimit , shumica i fajësojnë qeveritë e vendeve të botës në zhvillim, sa kohë që në ato vende për ditë e më shumë po hapen shkolla të huaja, të cilat janë bërë pothuaj bazë e arsimit të një klase të caktuar të shoqërisë. Kjo do të thotë se një pjesë e brezave të ardhshëm, të cilët do të diplomojnë në ato shkolla konsiderohen prej njerëzve të zgjedhur të shoqërisë, do të dijnë më shumë për historinë dhe kulturën e Perëndimit sesa për historinë dhe kulturën e vet kombëtare. Ata, në vend të gjuhës së tyre amtare, ndoshta edhe në familjet do të flasin gjuhën angleze. Kësaj dukurie mund t'i shtohet edhe dëshira e madhe e studentëve të vendeve në zhvillim për të studiuar në universitete perëndimore. Sa për ilustrim mund të përmendim se mbi 600.000 studentë të vendeve arabe i ndjekin studimet e tyre në Amerikë dhe në Evropë.

Megjithë investimet e mëdha në arsim në shtetet në zhvillim, si për shembull në vendet arabe, analfabetizmi është në një shkallë shumë të lartë. Numri i analfabetëve arrin në 65 milionë, që do të thotë mbi 43% të popullatës së vendeve arabe nuk dinë shkrim-lexim. Kësaj, siç thotë Tarik Suvejdan, drejtor i Qendrës Amrikane tër Inovacioneve, duhet t'i shtohet edhe anlafabetizmi tjetër, që është analfabetizmi i intelektualëve. Nëse leximi është argument i ngritjes se vetëdijes, pasurimit të njohurive dhe vetëdijes intelektuale, përqindja e atyre që lexojnë shtypin është në rënie e sipër . Sa për ilustrim, sipas Tarik Suvejdanit, nëse për një mijë banorë në vitin 1985 në Botën Arabe lexoheshin 3.2 kilogram gazeta, në vitin 1995 lexoheshin vetëm 2.7 kilogram. Ndërkohë lexueshmëria e shtypit në Evropë ishte rritur dukshëm për të njëjtën periudhë kohore nga 55.7 kilogram në 82.2 kilogram për një mijë banorë. Kjo është për t'u habitur po të mbajmë parsysh dallimin e madh sa i përket shtimit të popullsisë në Botën Arabe në krahasim me Botën Perëndimore.

Kjo gjendje kishte bërë që Ahmed Mensuri, një analist i njohur për çështjet e arsimit në një program televiziv të kanalit të njohur "el-Xhezira", të bëjë apel për të ndërmarrë diçka për t'i shpëtuar brezat e ardhshëm nga kjo krizë nëpër të cilën po kalon Bota Arabe.

Rëndësia e programeve mësimore

Nuk ka dyshim se arsimi kualitativ ka nevojë të mbështetet në programe të përgatitura mirë. Mu për këtë kohët e fundit jemi dëshmitarë të kërkesave të shpeshta për reforma në arsim (education reform). Kështu sa i përket arsimit universitar, merret për bazë Karta e Bolonjës, kurse për nivelet tjera përvojat e vendeve të tjera më të zhvilluara .

Pika më e dobët e vendeve në zhvillim është përgatitja e planprogrameve shkollore. Ato janë të të stërngarkuara me shumë lëndë dhe tekste të shumta. Nxënësi është i stërngarkuar me shumë gjëra, të cilat i duhet t'i mësojë përnjëherë. Për të arritur sukses sa më të mire, ai detyrohet që të mësojë përmendsh, duke kaluar një kohë të gjatë në përsëritjen e mësimeve. As këto programe nuk janë stabile, sepse me ndërrimin e ministrit të arsimit, ndërrohen edhe programet mësimore dhe çdo gjë nis prej fillimit. Nxënësi a studenti, pas përfundimit të shkollës së mesme ose fakultetit, e ka të vështirë të gjejë punë.

Në vendet e zhvilluara strategjia e arsimit është pjesë e strategjisë së shtetit e jo e minsitrit të arsimit, kushdo qoftë ai. Në përgatitjen e planprogrameve shkollore marrin pjesë ekspertë të të gjitha fushave. Shteti për këtë çështje shpenzon shuma të mëdha të hollash, sepse këtë e vlerëson si çështje të rëndësishme dhe investim për të ardhmen e kombit dhe shtetit. Kështu, për shembull, në ShBA, sipas Tarik Suvejdanit, për përgatitejen e planprogramit të klasës së gjashtë janë shpenzuar gjashëqind milionë dollarë, ndërsa në hartimin e tij kanë marrë pjesë 600 ekspertë të fushave të ndryshme, ndër ta edhe industrialistë, sepse ata e dinë më së miri për çfarë profilesh kanë nevojë në fabrikat e tyre .

Në një raport botuar në gazetën amerikane "Los Angeles Times", datë 23 janar 2001, thuhej: "Sasia e lëndëve që mëson nxënësi egjipti-

an është shumë më e madhe sa ajo që mëson nxënësi amerikan.” Po ashtu edhe koha që kalon nxënësi egjiptian për mësim është shumë më e gjatë se e atij amerikan. Megjithatë, rezultatet janë të kundërta. Mirëpo, kjo nuk ka të bëjë me sasinë, po me përmbajtjen e planprogramit dhe cila është filozofia ku mbështetet ai?

Në shumë vende në zhvillim, nxënësit përqendrohen në mësimin përmendsh dhe për këtë punë ata kalojnë orë të tëra duke i përsëritur mësimet. Kjo metodë nuk aplikohet në vendet e zhvilluara. Atje ekzistojnë mjetet e konkretizmit dhe çdo gjë shkon sipas planit të paraparë e të përgatitur më herët.

Në shumë vende në zhvillim, për të arritur që fëmijët e tyre t’i regjistrojnë në fakultet, prindërit shpenzojnë shuma të konsiderushme parash. Kështu për shembull, në Egjipt, sipas një shkrimi të gazetës “El-Ahram” të Kajros, egjiptianët shpenzojnë më shumë se katër miliardë funta egjiptiane për mësime private.

Cilët janë faktorët kryesorë të arsimit?

Faktor janë disa. Do të përmendim një numër të tyre.

1. Faktori i parë është mësuesi. Në Botën Perëndimore nuk i lejohet askujt ta ushtrojë profesionin e mësuesit pas kryerjes së fakultetit. Ai duhet të mësojë edhe një vit të plotë në administrimin e programeve, në administrimin e klasës, e për pedagogji, sepse ato katër a pesë vjet që ka kaluar në fakultet, nuk i mjaftojnë që të jetë në gjendje të marrë ditarin dhe të mbajë mësim para nxënësve të çfarëdo niveli qofshin ata.

2. Këshilli (bordi), i cili merret me çështje të arsimit. Ndalohet rreptësisht ushtrimi i profesionit të mësuesit pa licencë arsimi. Kjo është prej çështjeve kryesore në Perëndim. Pas skadimit të afatit të licencës, nuk lejohet ushtrimi i profesionit të mësuesisë. Kjo është çështja e dytë. Puna e mësuesit në zhvillimin e programeve të tij ndiqet vazhdimisht. Zakonisht licenca jepet për katër vjet dhe pas kalimit të kësaj periudhe, ajo nuk vlen më. Për ta vazhduar licencën për një periudhë tjetër, mësuesi duhet t'i nënshtrohet një testimi tjetër për të parë se cili

është kontributi i tij në zhvillimin e programeve shkollore. Kjo metodë e detyron atë që të ndjekë zhvillimet më të reja në sferën e arsimit, si në aspektin e planprogrameve e të metodave të zhvillimit të mësimit, ashtu edhe të arritjeve më të reja në sferën e arsimit ku punon. Kështu në Perëndim, së bashku me planprogramin, i jepet edhe programi i ushtrimit të mësuesit, të cilin ai do ta përdorë në klasë ose në kabinet gjatë mbajtjes së ligjëratave me nxënësit. Në anën tjetër, mësuesit vazhdimisht marrin pjesë në kurse dhe trajnime të ndryshme,të cilat organizohen nga ministria e arsimit.

Për fat të keq, kjo nuk ndodh në shumë vende të botës në zhvillim, edhe pse ekzistojnë dallime të mëdha në nivelet e arsimit. Kështu një mësues , i cili ka punuar në botën në zhvillim pesëmbëdhjetë vjet, ai vetëm ka përsëritur të njëjtat gjëra, dhe për të mund të thuhet se ai ka pesëmbëdhjetë vjet shërbim e jo pesëmbëdhjetë vjet përvojë pune, sepse ai të njëjtat gjëra i ka përsëritur pesëmbëdhjetë here, sepse përvoja krijohet me zhvillimin e njeriut, kurse zhvillimi vjen me risi. Për këtë Ajnshtajni ka një thënie të qëlluar:"Ne nuk do të jemi në gjendje t'i zgjidhim problemet aktuale me të cilat ballafaqohemi, me të njëjtën logjikë, e cila i ka shpikur ato." Ai thotë edhe "Është naive t'i bëjmë të njëjtat gjëra me të njejtat mënyra e pastaj të presim rezultate të ndryshme."

3. Planprogrami është faktor shumë me rëndësi dhe ndoshta kryesori në arsim. Planprogramet amerikane janë më të njohurat tash për tash. Vendin e parë në botë në arsim e zë Singapori, të dytin Koreja e Jugut, të tretin Japonia, dhe të gjitha këto mbështeten në planprogramet amerikane dhe britanike. Mirëpo, ato programet i zhvillojnë dhe i përshtatin sipas thesarit dhe identitetit të tyre, po edhe sipas nevojave vetjake.

Në përpilimin e planprogrameve në vendet në zhvillim marrin pjesë një, dy a më shumë njerëz. Por edhe mjetet financiare për këtë punë, janë pothuaj simbolike. Sa për ilustrim, një përpilues e një programi në Kuvajt paguhet 3.000 $, gjë që nuk mund të krahasohet me shumën që përmendëm më lartë 600 milionë $ dhe ku marrin pjesë një numër shumë i madh i ekspertëve të fushave të ndryshme.Mu për këtë

arsye edhe programet amerikane u imponohen shumë shteteve të tjera, natyrisht duke ruajtur secili shtet karateristikat dhe veçoritë e veta

4. Nxënësi a studenti, është ndër faktorët kryesorë dhe duhet të zërë të vehet në vendin që e meriton në këtë sferë. Para se të pranohet, duhet të vlerësohen aftësitë e tij dhe të shihen mundësitë, po edhe dëshirat e tij, se në cilin drejtim mund të ketë sukses më shumë dhe të japë kontributin e duhur, e jo t'i imponohet dëshira apo vulneti i prindërve.

Në Amerikë dhe në Perëndim në përgjithësi kanë planprograme të shkëlqyeshme; ushtrimi i arsimtarëve bëhet në mënyrë të organizuar, administrata shkollore është shumë e përparuar. Por, problemi i tyre është shoqëria dhe identiteti shoqëror; këtu hyn edhe problemi me nxënësin a studentin. Kështu atje studenti është i preokupuar me çështjet si: seksi, alkooli, droga, lojërat e ndryshme etj. dhe kjo paraqet një problem të veçantë për arsimin në shoqërinë perëndimore. Sipas disa të dhënave, në disa universitete amerikane në një amfitetar mund të gjesh nga dy-tre studentë e nga tridhjetë e më shumë studente.

Edhe për sa i përket mësimit të gjuhëve ka dallime të mëdha: sa kohë që në Perëndim përdoren 12 prograne, në vendet në zhvillim përdoret një ose dy programe. Prandaj, ploblemi më i madh është ai i programeve mësimore. Prandaj është më mirë të përkufizohemi në pesë a gjashtë lëndë e të arrijmë suksese të larta, se të mësohen njëzet lëndë me një përqendrim të dobët e me rezultate të ulëta.

Çështje me vete është stimulimi i arsimit: derisa në Japoni, për shembull, arsimtarët i kanë të ardhurat më të larta dhe janë me të respektuarit nga të gjitha profesionet e tjera, në shumë vende të botës në zhvillim arsimtarët marrin paga shumë të ulëta, që nuk mjaftojnë as për nevojat minimale të jetës së përditshme, dhe shoqëria nuk e çmon sa duhet punën dhe misionin e arsimtarit.

Ka dallime prej një vendi në tjetrin edhe sa i përket kohës që kalojnë nxënësit në bankat shkollore. Kështu, për shembull, ditët aktive të punës në shkolla në botën në zhvillim janë 150 ditë pune, në ShBA 175 dhe në Japoni 215 ditë pune gjatë një viti.

Si ta reformojmë arsimin?

Sipas shumë pedagogëve, shtyllat kryesore të arsimit janë: mësuesi, administrata, programi dhe nxënësi. Përveç këtyre, ekzistojnë edhe shtylla të tjera ndihmëse. Ato janë:

1. Potenciali njerëzor dhe zhvillimi i tij do të thotë trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve. Nëse dëshirojmë t'i zhvillojmë plaprogramet në shkollat fillore dhe të mesme, patjetër duhet t'i reformojmë planprogramet në fakultetet e mësuesisë

2. Teknologjia bashkëkohore. Sot arsimi bëhet në mënyra të ndryshme. Ai zhvillohet edhe nëpërmjet internetit dhe detyrat zgjidhen nëpërmjet rrjetit të internetit. Nxënësi hyn në internet e aty e ka ligjëratën të plotë dhe, nëse ka ndonjë problem në zgjidhjen e detyrave, ai përmes interneti kërkon shpjegim prej arsimtarit.

3. Shërbimi i veçantë: Në reformën e arsimit kërkohet të zhvillojmë shërbimin edukues, ta reformojmë shërbimin shpirtëror, ta reformojmë lidhjen me prindërit e nxënësve, në mënyrë që edhe prindërit të kenë rol të dretpërdrejtë në arsim.

4. Çështja e risive. Me kalimin e kohës duhet të mendohet për futjen e risive në plan-programet shkollore. Sa për ilustrim po përmendim se në shkollat amerikane përdoret modeli (Model Untednations) ose modeli i vogël i Kombeve të Bashkuara . Nxënësit në moshë të re njihen me modelin e punës së Kombeve të Bashkuara. Një risi tjetër është ajo që quhet Young Investors (investitorët e rinj). Mësohet një lëndë që quhet "Shkathtësitë e jetës". Nëse prej nxënësit kërkohet ta mësojë matematikën dhe t'i mësojë shkencat ekzakte si dhe njohuri të tjera, sa kohë që ai nuk di të flasë, nuk di të dëgjojë, nuk di të ndërtojë marrëdhënie brenda shoqërsië, nuk di të krijojë, - do të thotë se ne atë nuk e kemi përgatitur për t'u ballafaquar me problemet dhe sfidat e jetës. Shkathtësi e jetës, do të thotë të përgatitet nxënësi të ballafaqohet me jetën, dhe kjo është më e rëndësishme sesa ai të mësojë të llogarisë, të pjesëtojë a të shumëzojë.

Si të veprojë arsimi në kohën e globalizmit?

Ne duhet të jemi optimistë. Ne kemi rini të shkëlqyeshme. Të rinj të zgjuar. Njerëz që e duan punën dhe kryejnë me sinqeritet detyrimet e tyre. Kemi fuqi njerëzore. Kemi pasuri. Kemi historinë tonë. Kemi identitetin tonë. Ajo që na mungon, është vetëm t'i rregullojmë punët midis nesh. Kemi nevojë për një strategji afatgjatë. Kemi nevojë t'i ndjekim arritjet më të reja në lëmin e arsimit që të mos mbesim pas të tjerëve në këtë lëmë. Ne mund t'i arrijmë të tjerët, madje edhe t'ua kalojmë, nëse jemi të vendosur në punën tonë. Ne nuk duhet të lejojmë që ta ndryshojmë identitetin tone, qoftë atë fetar ose atë kombëtar. Forca jonë qëndron në ruajtjen e dientitetit tonë. Ne nuk **duhet** ta shohim globalizmin me një sy të keq. Ne mund të përfitojmë prej tij, por duke ruajtur identitetin tonë.

Cilët janë çelësat e diturisë?

Para se t'i japim nxënësit njohuri, është më mirë që atij t'i jepen disa mjete. Mjeti i parë është kultivimi dhe ruajtja e mendimit, që ai të mos shesë mendjen e tij askujt, të mos i japë as mësuesit, as ndonjë partie, as ndonjë qeverie dhe askujt tjetër. Për çdo çështje duhet ta përdorë mendjen e vetë dhe të gjykojë vetë, qoftë i drejtë apo i gabueshëm ai gjykim.. Ne dëshirojmë që djemve dhe vajzave tona t'ua mësojmë programin shkencor edhe gjatë mësimit të historisë, që ata të jenë në gjendje t'i analizojnë vetë ngjarjet historike, t'i krahasojnë ato, dhe pas këtyre analizave të dalin me rezulatet se ç'është saktë e ç'është gabim.

Pastaj vijnë disa çelësa ndihmës:

1. Gjuha amtare. Kjo është bazë e çdo njohurie të mëtutjeshme. Gjuha amtare lidh nxënësin me identitetin e vet. Sa më mirë ta njohë nxënësi gjuhën e vet amtare, aq më i aftë do të jetë edhe në fusha të tjera.

2. Gjuha angleze. Nuk ka dyshim se gjuha angleze sot është ndër gjuhët më të përhapura në botë dhe njohja e saj është e domosdoshme për të ndjekur arritjet më të reja në botë. Shumica e burimeve më të reja shkencore janë në këtë gjuhë, si dhe të gjitha mjetet e komunikimit masiv janë po në këtë gjuhë.

3. Kompjuteri: Kompjuteri sot është baza e të gjitha njohurive dhe pa të është shumë vështirë që nxënësi të jetë në gjendje të ndjekë arritjet bashkëkohore në botë.

Prandaj, nxënësi që zotëron të tri fushat e njohurive që i përmendëm më lart, të cilat konsiderohen për të gjitha njohuritë, nuk ka dyshim se është i përgatitur të hulumtojë në mënyrë të pavarur. Ta përmbyllim duke ritheksuar se, nëse në shumë vende të botës në zhvillim, në programet mësimore përdoret sistemi i mësimit përmendsh, në Perëndim sistemi i arsimit mbështetet në programet logjike dhe hulumtue dhe tek çelësat e diturive, prandaj nxënësi mund të veprojë i pavarur. Mund ta dërgosh atë në bibliotekë dhe të hulumtojë temë të caktuar, dhe ai do të ta kryejë atë punë me plot sukses. Me një plan-program të këtillë modern dhe me mjetet që u theksuan për një arsim të mirëfillt, kemi përgatitur nxënësin a studentin që në të ardhmen të bëhet një hulumtues i zellshëm dhe shkencëtar i mirë. Ky duhet të jetë misioni i arsimit.

M.Sc. Qemajl Morina

EDUCATION

(Summary)

"Read in the name of thy Lord who creates, creates man from a clot, read and thy Lord is most Generous, who taught by the pen, taught man what he knew not." (el-Alak, 1-5)

In the beginning of September schools all over the world open their doors to students of all levels who turn to schools to continue collecting knowledge. The very same happens in Kosova and other areas where Albanians live. Education is one of the most important and essential issues for each individual, family and society. The issue of education is one of the main preoccupations of the modern world and it is on the top of the agenda of all education loving people. This is completely understandable since the value of a nation among other nations is measured by its level of education. All the scientific achievements and the progress in different walks of life, to which we are a witness, is a result of the achievements in the field of education. Nowadays, every nation works to ensure a higher level of education, as a means to triumph over modern technology, which guarantees a better and more plentiful life for every nation. Thus, it is not to be surprised that in some of the most developed countries of the world education is considered an issue of national security as it determines the place of a certain state among other states. Progress in education means progress in all walks of life and prosperity for the people.

كمال مورينا

التعليم

(خلاصة البحث)

"اقرأ باسم ربك الذى خلق. خلق الانسان من علق. اقرأ وربك الاكرم. الذى علم بالقلم. علم الانسان ما لم يعلم. (سورة العلق: ١ – ٥)

مع بداية شهر سبتمبر كل المدارس فى جميع ارجاء الدنيا تقتح ابوابها لطلابها لجميع المستوايات و الذين يعودون الى مدارسهم لكى يواصلوا تحصيلهم. هذه هى العادة المتابعة فى كوسوفا والاماكن التى يعيش فيها الالبانيون. ان التعليم يعتبر من اهم الاشياء لكل انسان و كل عائلة و كل مجتمع. موضوع التعليم اليوم يعتبر من المواضيع الرئيسية لدى كل الشعوب.

و هذا شئ بديهى لان اى شعب كلما كان مستواه التعليمى احسن اكتسب احترامه بين سائر شعوب العالم.

KUR'ANI DHE SHKENCA

Prim.dr.med.sci. Ali Iljazi

KUR'ANI FAMËMADH MAHNIT SHKENCËTARËT

All-llahu i Madhërishëm në Kur'anin famëmadh thotë:

"Ai është që ju krijoi, ju dhuroi të dëgjuarit, të parët dhe mendjen, e ju po e falenderoni pak". *(El Mulk, 23)*

Teknologjia e trupit tonë është më e përsosur sesa teknologjia që ka prodhuar njerëzimi duke përdorur mbledhjen e informacioneve, eksperiencën dhe mundësitë.

Sot, duke studiuar veshin e njeriut, duke parë këtë vepër madhështore të konstruktuar, aty e shohim qartë Konstruktorin absolut.

Në shikim të pare, veshi duket i thjeshtë, por, pas laprës së veshit gjendet një strukturë fiziomorfologjike e përsosur dhe tejet delikate, e cila do të habiste edhe inxhinierin më inventiv. Duke vepruar bashkërisht, struktura e veshit të jashtëm, të mesëm dhe të brendshëm kryen operacione në largësi mahnitëse dhe virtuoze.

Shkaku pse kemi dy veshë, qëndron në faktin se ata formojnë një sistem stereo, i cili mundëson identifikimin e vendit nga vjen zëri dhe që ta dimë se a lëviz ai burim.

Veprimi i përpunimit të zërit me veshët dhe qendrën në tru, është aq i saktë saqë zëri që formohet afër njërit vesh e pastaj te veshi tjetër,

mund të njihet si dy zëra të ndryshëm kur intervali në mes tyre është i vogël, siç janë 30 mikrosekonda.

Virtuoziteti i veshit të njeriut është mahnitës dhe i pabesueshëm. Njeriu mund të dëgjojë zërin e mushkonjës jashtë dritares, edhe pse forca e zërit të saj që arrin tek veshi ynë, nuk është më e madhe se një *kuadrahonth* vat. Sikur të kombinoheshin 100 kësi zërash (100.000.000.000.000.000), duke u kthyer në energji elektrike, energjia do të mjaftonte për një llambë për lexim.

Sensiviteti i veshit është mahnitës. Lëvizja e membranës së timpanit nga ngacmimi i dëgjimit dëgjimit minimal të zërit me frekuencë 1.000 Hz, është afro e 1.000 milionta pjesë e centrimetrit, shumë më e vogël se diametri i atomit të hidrogjenit.

Lëvizjet e membranës basilare në ngacmime të njëjta janë njëqind herë më të vogla-përafërsisht sa madhësia e bërthamës së atomit. Kjo paraqet limitin e fundit të performancës.

Sikur të rritej më tepër sensitiviteti i veshit, do të ishim të vetëdijshëm për bombardimin konstant të membranës së timpanit me molekulat e ajrit.

Por edhe me limitin ekzistues, është interesante se ne nuk e dëgjojmë rrjedhjen e gjakut tonë nëpër enët e vogla të gjakut në membranën e timpanit. Kjo ndodh sepse veshi ka aftësi të injorojë sinjalet që janë të pranishme vazhdimisht.

Kështu veshi, gjithashtu njeriun e bën qenien më muzikale. Pa asnjë ushtrim muzikor jemi në gjendje të dallojmë tonin A në piano nga toni identik i violinës.

Mund të dallojmë edhe kombinimin e notave të ndryshme muzikore, karakteristike për secilin instrument që prodhon nota. Veshi është në gjendje të hedhë zhurmën duke zgjedhur njëkohësisht vetëm një zë të ngjashëm.

Bile edhe në gjumë veshi vazhdon të funksionojë me mundësi të pabesueshme, sepse truri ka mundësinë të interpretoj e të zgjedhë sinjalet që ia përcjell veshi. Kështu njeriu mund të flejë i qetë në kushte trafiku të zhurmshëm dhe në zhurmën e televizorit, dhe njëkohësisht të zgjohet nga një cingrimë e kehtë e orës.

Qeni që leh, goma e makinës që lëviz, hapat- që të gjitha mund të identifikohen. Në të vërtetë, veshi normal mund të dallojë afro 400.000 zëra.

Veshët, përpos që janë një sistem stereofonik dëgjimi me një siguri të lartë, janë po ashtu përgjegjës për mbajtjen e baraspeshës së trupit. Kjo është e siguruar me anën e dy sistemeve të vendosura në veshin e brendshëm.

Prej të gjitha organeve të trupit, pak janë ato që mund të arrijnë shumë në një hapësirë kaq të vogël, sa veshi. Sikur inxhinieri të mund të kopjonte funksionet e veshit, do t'i duhej përafërsisht një inç kub i sistemit dëgjues, i cili do të përfshinte praninë e rezistuesit me induksion, analizatorin mekanik me mundësi të gjera, reale mobile, drejtues shumëkanalësh për transmetimin e energjisë mekanike në atë elektrike, një sistem për mbajtjen e bilancit hidraulik delikat dhe një sistem komunikues dy drejtimesh.

Por edhe sikur të kishte sukses, nuk do të arrihej funksioni mahnitës i veshit.

Shumë shpezë dhe kafshë kanë mësuar që t'i përcjellin njëra-tjetrës sinjalet e tyre përmes zërave të tyre, sinjalet e njohjes dhe të kujdesit. Por, vetëm ne njerëzit kemi mësuar t'i lidhim mendimet abstrakte me zërat, duke i lidhur fjalët dhe duke i prodhuar gjuhët që mund t'i përdorim si mjet komunikimi me përvojën e kaluar të ideve dhe planet për të ardhmen.

Sot në botë kemi shumë gjuhë (afro 6000). Le ta krahasojmë cilësinë dhe teknologjinë e lartë në vesh dhe në tru, me teknologjinë e prodhuar nga njeriu. Ashtu si në rastin e imazheve, janë shpenzuar dekada në përpjekje për të gjeneruar zëra të ngjashëm me origjinalin. Rezultatet e këtyre zbulimeve janë magnetofonat, sisteme zanore me siguri të lartë, sisteme të analizimit dhe përpunimit të tingujve me anë të ndarjes së tyre sipas frekuencave. Me gjithë këtë teknologji të lartë të mijëra ekspertëve që punojnë pa pra, nuk është arritur të prodhohet një pajisje e tillë, e cila do të arrinte cilësinë e perceptimit të tingullit si veshi. Mendoni për sistemet e teknologjisë së lartë "Hi Fi", që janë prodhuar nga kompanitë më me emër në industrinë e muzikës. Edhe

në këto pajisje zëri i regjistruar humb diçka nga cilësitë e tij, sepse, kur të hapni pajisjen, do të dëgjoni gjithmonë një tingull të caktuar para se të fillojë të dëgjohet muzika.

Është e qartë se veshi dhe të gjitha pjesët e tjera të trupit të njeriut, janë produkt i krijimit madhështor.

Andaj është e qartë se përgjegjësia jonë themelore e përdorimit të veshit, syrit dhe trurit, është për të njohur ekzistencën e All-llahut, fuqinë dhe dijen e Tij të pafund. Duke shfrytëzuar begatitë e shqisave dhe aftësitë hulumtuese të universit të pafund, do të mësojmë edhe më shumë për ligjet fizike që i drejtojnë ato.

E dimë se ato ligje janë fikse dhe konsistuese, dhe që vlejnë për çdo pikë të universit. Kjo shkon në favor të faktit që është një Krijues dhe sistemi i Tij i pandryshuar, siç aludon verseti i Kur'anit fisnik:

"…Në ligjin e All-llahut nuk mund të gjesh ndryshim". *(Ahzab, 62)*

Imazhi i fituar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, saqë nuk ka arritur ta definojë as teknologjia e shekullit tonë. Shikoni për shembull në librin që lexoni, pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth.

A keni parë imazhe kaq të mprehta dhe të qarta në një vend tjetër? Edhe televizioni me ekranin më të avancuar në botë nuk mund të sigurojë imazhe kaq të mprehta.

Për më shumë se 100 vjet, mijëra inxhinierë janë munduar të prodhojnë një televizor tredimensional, i cili të mund të arrinte cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tredimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale.

Mu për këtë, All-llahu i madhërishëm në Kur'anin famëmadh thotë:

"A nuk i dhamë Ne atij dy sy?" *(El-Beled, 8)*

Tërë syri, si organ periferik i receptorit optik, mund të krahasohet me aparatin fotografik (por është afro 3.000 herë më i ndjeshëm se kamera më e saktë), ku pjesa e parme e tejdukshme i lëshon dhe i thyen rrezet e dritës, pikërisht sikurse sistemi i thjerrzave që i drejton fytyrat e objektit në film.

Rrezet e dritës, si dhunti e All-llahut të Madhërishëm, ngacmojnë kunjëzat dhe thupërzat me intensitet të mjaftueshëm. Ky ngacmim që shkaktohet nga proceset biokimike, nëpërmjet nervit optic, përcillet deri në pjesët kortikale të trurit.

Me ndihmën e kunjëzave pranohet drita e ditës (me ngjyrë), kurse me ndihmën e thupërzave drita e muzgut (bardhë e zi). Numri i atyre arrin në 130 milionë. Është vërtetuar se gjatë procesit të të parit, d.m.th. ngacmimit të thupërzave, funksioni i tyre është i lidhur për një materie speciale, e cila gjendet në to dhe quhet purpuri i të parit (rodopsinë), për krijimin e së cilës nevojitet vitamina A.

Kur drita bie në thupërza rodopsina thith energjinë e dritës dhe e transformon në lumirodopsinë. Energjia e thithur nga drita i jep lumirodopsinës sasi të madhe të energjisë së lirë. Nga kjo, në një pjesë të sekondës, lumirodopsina ndahet në metarodopsinë, që është e paqendrueshme dhe ndahet në retinën dhe skotopsinë. Skotopsina shkakton potencial elektrik local, i cili vepron drejt në membranën e thupërzave duke shkaktuar potencial receptor.

Impulset përcillen deri tek qelizat ganglionale, të cilat transmetojnë impulset nervore në çdo 5 sekonda, bile edhe kur retina ndodhet në errësirë të plotë.

Përballë të gjitha këtyre fenomeneve dhe mrekullive të panumërta të Krijuesit të përsosur, nuk na mbetet tjetër, përveçse ta lavdërojmë dhe ta falenderojmë Atë nga thellësia e zemrës, duke kujtuar ajetin e Kur'anit:

"I lartë është All-llahu, më i miri Krijues!" *(El Muminun, 14)*

Argumentet e urtisë së jashtëzakonshme janë të dukshme në çdo gjë të gjallë që vëzhgon njeriu.

Urtia, plani dhe projektimi i jashtëzakonshëm, që mbizotërojnë në gjithë natyrën, pasqyrojnë pa asnjë dyshim ekzistencën e Krijuesit që sundon gjithçka.

Ky është All-llahu Hirmadh, i Cili i ka pajisur të gjitha gjallesat me karakteristika të jashtëzakonshme, duke i treguar njeriut shenjat e qarta të ekzistencës dhe të fuqisë së Tij.

All-llahu i Madhërishëm në Kur'anin fisnik thotë:

"Ai është Zot i qiejve dhe i Tokës dhe ç'ka në mes tyre, pra adhuroje Atë, e në adhurimin ndaj Tij bëhu i qëndrueshëm. A di për Të ndonjë emnak *(adash)* ***të ngjashëm?!"*** *(Merjem, 65)*

Ja, kështu All-llahu i Madhërishëm na ka lajmëruar se shprehja – emri për Qenien e lartë hyjnore "All-llah" nuk i vihet askujt prej njerëzve, por është e posaçme vetëm për Qenien e Tij Fisnike.

Në këtë mënyrë All-llahu i Madhërishëm e provokoi mbarë njerëzimin në një çështje me mundësi zgjedhjeje, ngase emri është në kompetencën e njeriut për ta zgjedhur. Edhe pse në këtë ekzistencë jetojnë besimtarë, pabesimtarë, djaj, exhinë, njerëz e të tjerë. A mos ke dëgjuar për dikë që e ka quajtur veten me emrin All-llah, apo e ka emërtuar të birin me emrin All-llah? Jo kjo kurrë nuk ka ndodhur dhe as që do të ndodhë ndonjëherë, ngase All-llahu i Madhërishëm e ka bërë të posaçëm këtë emër vetëm për Qenien e Tij Fisnike. Askush prej njerëzve nuk mund të bëjë një gjë të tillë. Madje, as ata njerëz që pretenduan se janë zotër, si Faraoni, Nemrudi etj. nuk patën guxim dhe as që u shkoi ndër mend ta quanin veten me emrin All-llah !

Kur'ani famëmadh ka qenë dhe do të jetë mrekullia më e madhe, ngase në çdo kohë zbulohen begatitë, fshehtësitë dhe depot e pafund të tij.

Ai gjithnjë paraqet risi dhe freski për besimtarët, ilaç trupor dhe shpirtëror, siç aludon verseti i Kur'anit fisnik:

"Ne të shpallim Kur'anin që është shërim dhe mëshirë për besimtarët" *(El-Isra, 82)*

Dr Ahmed El Kadi në qytetin Panama-Siti të Floridës, vërteton ndikimin e Kur'anit fisnik në organizmin e njeriut. Eksperimentin e tij e bëri me grupe të muslimanëve, jomuslimanëve dhe të shurdhëve, duke matur pulsin, tensionin e gjakut, shkallën e djersitjes, temperaturën e lëkurës, EKG, EEG dhe EMNG.

Hulumtimet tek besimtarët vërtetuan arritjen e qetësisë gjatë leximit të Kur'anit në 97% të të ekzaminuarve.

Tek grupet e tjera qetësia u arrit në 60% të të ekzaminuarve.

Rezultatet e këtij hulumtimi përputhen me atë që All-llahu i Madhërishëm ka thënë në Kur'anin fisnik para 14 shekujve:

"All-llahu e shpalli të folmen më të mirë, librin, të ngjashëm në mrekulli, të përsëritur herë pas here *(me këshilla e dispozita),* ***që prej*** *(dëgjimit të)* ***tij rrëqethen lëkurët dhe zemrat e tyre. Ky*** *(libër)* ***është udhëzim i All-llahut, me të udhëzon atë që do. E atë që All-llahu e lë të humbur, për të nuk ka ndonjë udhëzues".*** *(Ez Zumer, 23)*

Në këtë ajet kuranor vërehet se leximi i Kur'anit vepron në lëkurën dhe zemrën e njeriut, që ka vërtetuar hulumtimi i lartpërmendur.

Ekzistojnë versete të shumta që vërtetojnë se Kur'ani vepron duke qetësuar shpirtin, zemrën dhe sistemin nervor.

All-llahu i Gjithëfuqishëm i drejtohet mbarë njerëzimit:

"O ju njerëz! Juve ju erdhi nga Zoti juaj këshilla *(Kur'ani)* ***dhe shërimi i asaj që gjendet në kraharorët tuaj*** *(në zemra),* ***edhe udhëzim e mëshirë për besimtarët".*** *(Junus, 57)*

Edhe në hadithe të shumta të Muhammedit a.s. kemi argumente për këto. Muslimi transmeton në Sahihun e tij thënien e Muhammedit s.a.v.s.:

"Nuk mblidhen njerëzit në ndonjë shtëpi të All-llahut që lexojnë Kur'an dhe studiojnë në mes tyre, e të mos lëshohet siguria (qetësia), dhe i mbulon mëshira, i rrethojnë melekët dhe All-llahu do t'i përmendë në mesin e atyre që janë tek Ai".

Pra, a ka gjë më të bukur se Kur'ani ?

A ka argument më të fuqishëm të All-llahut se Kur'ani famëmadh, i cili është dhe mbetet mrekulli përherë në duart tona, deri në Ditën e Gjykimit.

All-llahu i Madhërishëm në Kur'anin fisnik urdhëron e thotë:

"Pasha agimin kur ai shkrep *(frymon)"* *(El Tekvir, 18)*

"Fale namazin kur zbret dielli *(nga zeniti),* ***e deri në errësirën e natës dhe duke bërë lutjen*** *(namazin)* ***e agimit. Vërtet, lutja e agimit është e përcjellë".*** *(El-Isra, 78)*

Kur'ani famëmadh inkurajon të fjeturit heret dhe zgjimin që në agim. Në një hadith thuhet:

"Populli tim i është dhënë bereqet në mëngjes herët".

Ndërsa në hadithin tjetër thotë:

"Dy rekatet e namazit të sabahut kanë më shumë vlerë se dynjaja dhe ç'ka në të".

Pra në Kur'anin fisnik All-llahu i Madhërishëm betohet në agimin që frymon. Shikimi i agimit që *vërehet* me zemër të hapur, me të vërtetë frymon. Këto skena kozmike të paraqitura me bukuri, shkëlqim dhe elegancë u dhurohen ndjenjave të njerëzve. Këto paraqitje kozmike njeriu intelektual i pranon me ndjenja poetike. Në këtë mënyrë shpirti njerëzor lidhet me shpirtin kozmik nëpërmjet pamjes së bukur dhe frymëzuese, kështu shpirti kozmik rrjedh në shpirtin njerëzor, në fshehtësitë e tij duke reflektuar Fuqinë Hyjnore, e cila qëndron pas tyre, dhe e cila flet sinqerisht për të vërtetën e besimit.

Të mirat që përfiton njeriu nga të zgjuarit herët në mëngjes, janë: përqindja e ozonit në ajër është më e larta në agim. Ky gaz ndikon pozitivisht në sistemin nervor dhe gjallëron aktivitetin mendorë, duke bërë që kulmi i aktivitetit mendor dhe fizik të njeriut të arrihet heret në mëngjes; rrezet e diellit në lindjen e tyre janë përafërsisht në ngjyrë të kuqe, dhe është i njohur tashmë ndikimi stimulues për nervat, për aktivitet fiziologjik të organizmit të njeriut.

Zgjimi herët në mëngjes parapengon paraqitjen e krizave hipertensive dhe sëmundjeve *trombembolike.*

Shkencërisht është vërtetuar se sasia më e lartë e kortizonit në gjak ndodhet në mëngjes, kur arrin nivelin 72-75 mikrogramë në 100ml. plazmë. Gjendja më e vogël e tij haset në mbrëmje, kur arrin nivelin më pak se 7 mikrogramë në 100 ml. plazmë. Dihet se kortizoni është substancë "magjike" që rrit aktivitetin e organizmit.

Kortizoni vepron në qelizat e organizmit dhe në procesin e imunitetit. Kortizoni gjithashtu parandalon reaksionin inflamator në proceset alergjike.

Rol të veçantë kortizoni luan në gjendjet e stresit, kur niveli i tij rritet në gjak.

All-llahu i madhërishëm në Kur'anin famëmadh thotë:

"Ai është që nënshtroi detin, që prej tij të hani mish të freskët, e prej tij të nxirrni stoli që i mbani *(i vishni),* ***e i sheh anijet si çajnë*** *(lundrojnë)* ***në të*** *(e çajnë ujin në det me ushtimë).* ***Jua nënshtroi që të shfrytëzoni nga begatitë e Tij dhe ashtu të falënderoni*** *(Zotin)****".*** *(En-Nahl, 14)*

Peshqit, që të gjitha llojet e tij, janë një ushqim i mirë për njeriun që nga kohët e lashta.

Peshku përmban sasi të mëdha proteinash. Vaji i peshkut është burimi më i pasur i vitaminave të tretshme në yndyra, më e rëndësishmja e të cilave, vitamina A, vepron kundër dobësimit të pamjes në errësirë; vitamina D, është e domosdoshme për rritjen e eshtrave dhe kundër sëmundjes së rakitizmit tek fëmijët. Peshku është një burim i mirë i kalciumit. Sasia e zvogëluar e kalciumit shkakton spasmë muskujsh (tetonia), zgjerimin e zemrës (dilatimi) si dhe rritjen e permeabilitetit të membranës së qelizave nervore.

Peshku është burim kryesor i jodit, i cili është materie e domosdoshme për funksionimin e gjëndrës tiroide. Sasia e jodit në organizëm është 14 mg. Jodi është i rëndësishëm për formimin e tiroksinës që mban në nivel intensitetin e metabolizmit në qeliza.

Peshku përmban edhe fosfor, i cili luan rol të rëndësishëm në proceset metabolike të organizmit. Eshtrat përmbajnë sasi të mëdha të fosfatit të kalciumit.

Shkenca bashkëkohore ka zbuluar se 100gr. peshku përmbajnë 16% proteina, 9% yndyra, 20gr kalcium, 29gr hekur, 0.5gr fosfor dhe disa vitamina B.

Peshku përbën ushqimin kryesor për një numër të madh njerëzish. Për këtë arsye All-llahu, Krijuesi i Urtë, i favorizon krijesat e Tij, duke bërë që në ujërat e lumenjve e të deteve të gjendet një burim i pashtershëm ushqimi.

"Edhe kafshët Ai i krijoi dhe në saje të këtyre ju mund të mbroheni *(nga të ftohtit),* ***keni edhe dobi të tjera dhe hani prej tyre".*** *(En-Nahl, 5)*

Me siguri njeriu nuk mund të vazhdojë jetën normale, nëse i mungon ushqimit të tij mishi, që është ushqimi më i pasur me proteina.

Mishi karakterizohet nga fakti se, yndyrat që ndodhen në të, kanë fuqi kalorike të lartë, po ashtu është i pasur me hekur, fosfor, vitaminë B, dhe vitaminë A.

100 gr. mish e furnizojnë trupin me rreth 5% të nevojave të tij për proteina.

Proteinat përmbajnë 10 deri në 20% të masës qelizore. Nukleoproteinët e bërthamës dhe citoplazmës qelizore janë genet që kontrollojnë tërë funksionin e qelizës dhe transmetimin e dukurive trashëguese.

Ensimet e përbëra nga proteinat katalizojnë reaksionet kimike në qelizë, pra ato kontrollojnë funksionet metabolike në qelizë.

Roli kryesor i albuminave është mbajtja e shtypjes koloido-osmotike, që parapengon humbjen e plazmës nga kapilarët.

Mëlçia e kafshëve është një depo për shumë lëndë ushqyese dhe shumë vitamina, veçanërisht A,D,B, proteina dhe hekur. Për këtë arsye ajo përdoret për kurimin e anemisë së rëndë. Ndërsa truri i kafshëve është i pasur me fosfor, i domosdoshëm për punën dhe vitalitetin e nervave, si dhe me elemente të tjera, si bakri dhe zinku. Mungesa e bakrit shkakton anemi mikrocitare.

Zinku është pjesë përbërëse e ensimit *Karboanhidraza* që gjindet në sasi të madhe në rruazat e kuqe. Ky ensim është përgjegjës për lidhjen e shpejtë të dioksidit të karbonit me ujë në rruazat e kuqe dhe kapilarët periferikë, si dhe për lirimin e shpejtë të dioksidit të karbonit nga kapilarët e gjakut të mushkërive në *hojëza*.

Zinku është pjesë përbërëse e dehidrogenazës laktike si dhe përbërës i disa *peptidazave* që janë të rëndësishme për tretjen e proteinave në aparatin digjestiv.

Zink ka mjaft edhe në pankreas dhe ai lidhet shumë lehtë me insulinën. Mungesa e proteinave për një kohë të gjatë, shkakton sëmundje si:

- Ulja e mesatares së rritjes;
- Deshtimi dhe çrregullimi i procesit digjestiv;
- Inaktiviteti i mëlqisë;
- Anemia;
- Nefropatia;
- Ngecje mendore;
- Të ëjntura të përgjithshme.

Në Kur'anin famëmadh, kaptina "En-Neml" - ("Milingona") tërheq vëmendjen e njeriut për të logjikuar dhe medituar për madhështinë e Krijuesit të Gjithëfuqishëm, për krijimin e këtij insekti, për të cilin Kur'ani thotë:

"O ju buburreca, hyni në vendet tuaja që të mos u copëtojë Sulejmani dhe ushtria e tij duke mos ju vërejtur". *(En-Neml, 18)*

Shkenca bashkëkohore ka zbuluar se milingona i gjason njeriut nga zakonet. Ato ndërtojnë qytete, hapin rrugë nëntokësore, depozitojnë ushqimin në depo të veçanta. Fiset e milingonave i shpallin luftë njëri-tjetrit dhe fitimtari merr robër lufte. Pa dyshim që milingonat kanë një qytetërim të çuditshëm, specifik.

Ekzistojnë disa lloje milingonash që merren me mbjelljen e barërave për ushqim dhe gjuajnë lloje të caktuara krimbash e lavrash.

Ushtarët (e milingonave të bardha) janë më të mëdhenj se milingonat punëtore dhe kokat e tyre janë më të mëdha dhe më të forta. Kur qyteti sulmohet nga milingonat e tjera, ushtarët mblidhen në hyrje të tij, ngjiten sipër njëra-tjetrës, dhe formojnë një mur të gjallë.

Milingonat jetojnë në shoqëri me shumë insekte. Janë gjendur rreth 2000 lloje insektesh të ndryshme brenda vendbanimeve të milingonave.

Milingonave u pëlqen një substancë e ëmbël (vesa e mjaltit), që e marrin nga gjethet dhe trupi i pemëve.

Organizimi i mirë i punës së milingonave ka arritur deri aty sa ato të ndërtojnë dhoma të veçanta për "insektet e nektarit" që ruajnë.

Nëse lihet në fole, kokrra e grurit do të rritet e do të mbijë, gjë që do të shkatërronte folenë, prandaj milingona e ndan kokrrën e grurit në dy apo katër pjesë, dhe kështu prish embrionin e saj.

Kush e udhëzoi milingonën t'i mësonte këto gjëra?! Pa dyshim Krijuesi i Gjithëfuqishëm, siç e përshkruan verseti kur'anor:

"Madhëroje larg të metave Zotin tënd, më të lartësuarin!

I cili krijoi dhe përsosi,

Dhe i cili përcaktoi e orientoi". *(El- A'ëla, 1-3)*

Fjala e gjelbër përmendet në shumë versete të Kur'anit fisnik, veçanërisht në ato që përshkruajnë gjendjen e banorëve të Xhennetit dhe kënaqësitë që i rrethojnë ata.

Rikujtojmë versetet duke medituar:

"Aty rrinë të mbështetura në mbështetëse të gjelbra e shtroja të bukura" *(Er-Rrahman, 76)*

"Kanë të veshura petka mëndafshi të hollë e të gjelbër dhe mëndafshi të trashë". *(El-Insan, 21)*

"…ata veshin rroba të gjelbra prej mëndafshi të hollë e të trashë…" *(El-Kehf, 31)*

Psikologët kanë konstatuar se ndikimi i ngjyrës tek njeriu është tepër i madh. Janë kryer eksperimente të shumta që e bëjnë të qartë se ngjyra ndikon në reagimin apo vetëpërmbajtjen e njeriut, dhe e bëjnë atë të ndihet i gëzuar a i trishtuar, të ketë të ftohtë a të nxehtë, madje ndikon edhe në personalitetin e njeriut dhe në këndvështrimin e tij për jetën.

Muhammedi a.s. ka thënë:

"Shikimi në gjelbërim dhe ujë qetëson syrin"

Sot spitalet dekorojnë muret, gjë që ndihmon për shërimin e të sëmurëve.

Eksperimentet dhe studimet psikologjike kanë bërë të qartë se ngjyra e verdhë - gjallëron sistemin nervor; ngjyra e kuqe e mbyllët - qetëson nervat; ngjyra blu e bën njeriun të ndiejë të ftohtë; ngjyra e kuqe e bën njeriun të ndiejë ngrohtësi.

Shkencëtarët kanë arritur në përfundimin se ngjyra e vetme që ngjall gëzim në shpirt dhe në mendime si dhe që ndez tek njeriu shkëndijat e gëzimit e të dashurisë për jetën, është ngjyra e gjelbër.

Eksperimenti më interesant që argumenton ndikimin e ngjyrës së gjelbër në psikën e njeriut, është në Londër në urën "Blak Fajar", që njihej si "Ura e vetëvrasjeve", sepse pjesa më e madhe e vetëvrasjeve ndodhnin mbi të. Ndryshuan ngjyrën e zezë me të gjelbër, dhe si rezultat, numri i vetëvrasjeve ra menjëherë për 1/3.

Pra, ngado rreth nesh shihet urtia e All-llahut të Gjithëfuqishëm në krijimin e bimëve dhe pemëve me ngjyrë të gjelbër.

All-llahu i madhërishëm në Kur'anin fisnik thotë:

" …All-llahu i do ata që pastrohen" *(Et-Teube, 108)*

"…All-llahu i do ata që pendohen dhe ata që duan të pastrohen" *(El-Bekare, 222)*

Një nga veçoritë kryesore të Islamit është pastërtia, nga e cila buron forca trupore, shëndeti dhe gjallëria. Njëri prej atyre që kanë përqafuar Islamin në Perëndim, thotë: "Edhe sikur të mos kishte në Islam asgjë tjetër veç pastërtisë, ajo do të mjaftonte".

All-llahu i Gjithëdijshëm në Kur'anin e lavdueshëm thotë:

"O ju që besuat! Kur doni të ngriheni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla; fërkoni kokat tuaja, dhe lani këmbët deri tek nyjet". *(El Maide, 6)*

Nga dobitë e shumta të abdestit, të vërtetuara shkencërisht, po cekim këto:

- parandalimi i transmetimit të shumë sëmundjeve bakteriale që përcillen nëpërmjet lëkurës dhe ndotjes së duarve;
- aktivizimi i qarkullimit të gjakut duke fërkuar gjymtyrët;
- parandalimi i sëmundjes së sinusëve;
- ndjenja e freskësisë trupore e shpirtërore;
- parandalimi i sëmundjeve të lëkurës.

Dobitë e larjes së trupit, veçanërisht pas marrëdhënieve intime, janë:

- aktivizimi i trupit dhe mënjanimi i plogështisë;

- pakësimi i kongjestimit të gjakut në lëkurë dhe në organet gjenitale, që e përcjell gjakun në organet vitale të trupit, si zemra dhe truri;
- larja siguron normalizimin e funksioneve të lëkurës, më të rëndësishmet e të cilave janë: përçimi i ndjeshmërisë, rregullimi i temperaturës dhe mbrojtja e organizmit;
- larja siguron pastrimin e lëkurës nga djersa dhe sekrecionet yndyrore.

Për këtë All-llahu i Madhërishëm në Kur'anin fisnik thotë:

"…Nëse jeni xhunubë, atëherë pastrohuni (lahuni)!..." *(El-Maide, 6)*

All-llahu i Madhërishëm në Kur'anin fisnik thotë:

"Dhe rrobat tua pastroji!" *(El-Mudethir, 4)*

Pastërtia e rrobave është kusht për vlefshmërinë e namazit dhe adhurimeve të tjera. Është e njohur vlera e rrobave për mbrojtjen e njeriut nga të ftohurit dhe nga burimet e ndotjeve bakteriale.

Islami ka një pozicion të qartë në ruajtjen e mjedisit. Qëllimi i ruajtjes së mjedisit është të krijohen kushte optimale për një ndërveprim harmonik mes njeriut dhe mjedisit, si një tërësi e vetme, pasi ndotja nga individi që ka karakter lokal, herët a vonë shndërrohet në një ndotje të përgjithshme të mjedisit.

Teknologjia e sotme e shfajëson veten para botës, se po përpiqet ta zhvillojë e të krijojë mirëqenie për një jetë sa më komode, ndërsa njerëzit janë të detyruar të thithin helmin e fabrikave e të sakrifikojnë duke vënë në rrezik vetë ekzistencën e tyre, duke prishur rendin dhe ekuilibrin në Tokë.

Ruajtja e mjedisit, pra, nuk është vetëm bindje ndaj rregullave kuranore, por një çështje jetike për të gjithë banorët e planetit tonë.

Zhvillimi gjithnjë e më i madh i industrisë, pa zbatimin e masave mbrojtëse të përshtatshme, sjell ndotjen e madhe të ajrit dhe ujit, që rrezikon së tepërmi shëndetin e njeriut.

Sot, sa më shpejtë dhe me tërë diturinë dhe forcën, njerëzimi duhet të angazhohet në luftë kundër shfarosjes së llojeve biologjike dhe çdo gjëje tjetër që është e lidhur me prishjen e baraspeshës ekologjike botërore.

All-llahu i Plotfuqishëm krijoi qiejt e Tokën dhe u fali bukurinë mahnitëse. Të gjitha të gjitha këto ia nënshtroi njeriut, të cilit i dha mendjen që t'i shfrytëzojë për të mirën e tij. Njeriu tani mund të zgjedhë: ose ta kultivojë dhe ta zhvillojë bukurinë e natyrës dhe të ndihmojë prosperitetin e vet, ose ta shëmtojë bukurinë e natyrës dhe të ndihmojë kështu shkatërrimin e tij.

Është fatal fakti se sot në botë, sipas statistikave, për çdo vit hidhen në ajër 200 milionë tonë dioksid sulfuri, i cili në bashkëveprim me avullin e ujit, shndërrohet në thartira të njohura si "shi thartor". Po ashtu për çdo vit në dete dhe oqeane hidhen 1.500 kilometra kub ujë të ndotur industrial.

Radio-nukleidet që lirohen nga 417 reaktorë atomikë, gati e kanë mbuluar qiellin tonë.

Rreziku i zhdukjes së mbështjellësit të ozonit, i cili e mbron botën e gjallë në tokë nga rrezet ultravjollcë, është gjithnjë e më i madh.

Edhe mbeturinat e ndryshme industriale, gazrat e liruara nga automjetet, ndotin vazhdimisht mjedisin, ushqimin dhe ujin me plumb, zhivë, arsen, *kadmium*, fosfat, me materie të ndryshme radioaktive dhe materie të tjera helmuese.

Përveç industrisë, në ndotjen e mjedisit marrin pjesë plehrat kimike dhe mjete të tjera mbrojtëse kimike, të cilat sot përdoren shumë në bujqësi. Bota sot njeh afro 4 milionë substanca kimike, prej të cilave 60 mijë përdoren në bujqësi.

Shkenca bashkëkohore informon se 250 mijë substanca kimike janë potencialisht mutagjene (deformojnë gjenet). Këto janë substanca kimike që shkaktojnë ndryshime të pakthyeshme (ireversibile) në vetitë trashëguese-gjenetike tek njerëzit.

All-llahu i Madhërishëm për këtë tërheq vërejtjen në Kur'anin famëmadh:

"E kur atyre u thuhet: "Mos e prishni rendin në tokë"! Ata thonë: "Ne jemi vetëm përmirësues** (paqtues)**!

Vini re, ata në të vërtetë janë shkatërrues, por nuk e kuptojnë". *(El-Bekare, 11-12)*

Është një betim i vetëm në Kur'anin fisnik, për të cilin All-llahu i Madhërishëm thotë se është një betim i madh. Nga teksti kuranor vërehet zakonisht se njerëzit nuk janë të vetëdijshëm për madhështinë e këtij betimi. Vetë fakti se kemi të bëjmë me një betim madhështor, tregon se tek ai duhet përqendruar posaçërisht vëmendja për shkak të rëndësisë së tij shumë të madhe. Betimi në vete përmban diçka kolosale, sepse nga ai varet vetë ekzistimi i Gjithësisë. Pozita e yjeve tregon zakonisht rendin dhe harmoninë e kozmosit.

Tani të shohim si tingëllon ky betim i madh në gjuhën e Kur'anit famëmadh:

"Betohem në shuarjen** (perëndimin) **e yjeve.

***"E ai është betim i madh, sikur ta dinit!"** (El-Vakia, 75-76)*

Kuptimi i këtij betimi është përcaktuar me tri fjalë. Këto fjalë janë: **mevaki, nuxhum** dhe **adhim**. Të fillojmë shpjegimin e këtyre fjalive me rend të kundërt:

Adhim, d.m.th. i madh, madhështor, i fuqishëm, kolosal, i jashtëzakonshëm

Nuxhum është shumësi i fjalës nexhm, që d.m.th.*yjet*.

Mevaki është shumësi i fjalës vaki'a dhe kjo fjalë është përkthyer në shumë mënyra. Kështu Feti Mehdiu e kupton si "perëndim i yjeve", Sherif Ahmeti si "shuarje e yjeve", Hasan Nahi si "çasti i perëndimit të yjeve".

Por mevaki nuk e tregon kohën kur ka ndodhur diçka (mevakit-njësi vakti), por përkundrazi vendin ku ndodh diçka. Po t'i shfletojmë fjalorët e gjuhës arabe, do të shohim se mevaki do të thotë: vend, lokacion, pozicion, pozitë. Duke pasur parasysh këtë, përkthimi i ajetit kuranor është:

***"Por jo! Betohem në pozitat e yjeve. Dhe vërtetë, ky është betim madhështor sikur ta dinit!"** (El-Vakia, 75-76)*

Pozitën e ndonjë objekti në univers (yjet, galaktikat, mjegullnajat) i përcaktojmë me dy koordinata: rektashensionin dhe deklinacionin.

Për shikuesit nga Toka, ndryshimi i pozitës së yjeve është i pandërperë: yjet "rrëshqasin" nga lindja në perëndim, për t'u paraqitur përsëri në lindje.

Por ky është vetëm ndryshim imagjinativ i pozitës. Kjo është evidente edhe gjatë stinëve të vitit.

Po yjet kanë edhe lëvizjet e tyre, të cilat në krahasim me Diellin, janë më të shpejta për disa dhjetëra km/s. Këto lëvizje mund të vërehen vetëm në intervale të gjata kohore.

Duhet ditur se ekzistojnë yje që dalin dhe humbasin çdo ditë (cirkumpolare), por gjithashtu ekzistojnë yje që nuk dalin kurrë (anticirkumpolare).

Ekzistojnë gjithashtu yje që, për shkak të pozitës që kanë në qiell, nuk i shohim kurrë. Këto janë yjet e qiellit jugor.

Duke marrë parasysh largësinë e pabesueshme të yjeve, ato na duken të palëvizshme. Në realitet nuk është kështu. Hapësira në mes yjeve rritet për çdo sekondë, dhe Universi është në zgjerim e sipër. Yjësia e Virgjëreshës për çdo sekondë është për 1.200 km të tjerë më larg prej nesh. Yjësia e Ujorit largohet nga Toka 60 km. në një sekondë.

Pozita e yjeve, graviteti dhe baraspesha kozmike janë në lidhje të ngushtë, prandaj nuk mund të ndodhë asnjë ndryshim në pozitën e ndonjë ylli që të mos manifestohet në hapësirën përreth tij.

Mirëpo, secili ndryshim në kozmos është i sinkronizuar dhe i harmonizuar, prandaj nuk kemi pasoja në përmasa katastrofash.

Sot është e mundur që në bazë të lëvizjes së yjeve, të përcaktohet vjetërsia e tyre, paraqitja dhe zhvillimi i galaktikave në gjendjen dhe formën e tanishme.

Sot astronomët, përveç nevojës që të dinë në cilën pjesë të qiellit t'i drejtojnë teleskopët e tyre dhe të shikojnë galaktikat e zbehta të largëta dhe pozitën e vërtetë të yjeve, për mbajtjen e kursit të satelitëve artificialë, - ata kanë nevojë të dinë dhe të sigurojnë ndihmën e nevojshme për drejtimin e sondave kozmike.

Yjet lëvizin me siguri pak nga ne, pak larg nesh me shpejtësi radiale. Për shkak të lëvizjeve të tyre, yjet nuk kanë vend të njëjtë.

Astronomët e ardhshëm, ata që do të vijnë pas nesh, do ta shohin qiellin ndryshe nga ne, dhe ndoshta do t'i ndryshojnë emrat e yjeve!

Kështu, dituria e tanishme mbi lëvizjen e yjeve, mundëson të kemi njohuri për të ardhmen dhe për të kaluarën e kupës qiellore.

Kur'ani herë-herë përdor ndonjë fjalë të cilën bashkëkohësit nuk janë në gjendje ta kuptojnë apo ta shpjegojnë, por All-llahu i Madhërishëm e di që breznitë e ardhshme do ta zbulojnë dhe do ta shpjegojnë, siç e përshkruan ajeti kur'anor:

"Ne do t'ua bëjmë atyre të mundshme që t'i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre derisa t'u bëhet e qartë se ai *(Kur'ani)* ***është i vërtetë".*** *(Fussilet, 53)*

Literatura

1. Sherif Ahmet, Kur'ani-përkthim me komentim, Prishtinë, 1988.
2. Hasan Nahi, Kur'ani i madhëruar, Prishtinë, 1988.
3. Feti Mehdiu, Kurani dhe hija e tij shqip, Shkup, 1999.
4. Enes Kariq, Kur'an sa prijevodom na bosanskom jeziku, Sarajevë, 1998.
5. Ramo Atajiq, prijevod Kur'ana sa tefsirom i komentarom na bosanskom jeziku, Sarajevë, 2001.
6. Sejjid Kutub, U okrilju Kur'ana, Sarajevë, 1996.
7. Muhammed Sha'ravi, Mrekullia e Kur'anit, Prishtinë, 1996
8. Jusuf Ali, The meaning of th holy Qur'an, Maryland, USA, 1991.
9. Harun Jahja, Mrekullitë e Kur'anit, Tiranë, 2002.
10. Rasim Bejtullahu, Astronomia-tekst universitar, Prishtinë, 2003.
11. Husein Dhehebi, Komentimi shkencor i Kur'anit, Dituria Islame, nr. 42, Prishtinë, 1992.
12. Nadhim Mahmud Nesimij, Et-tibbun-nebevijj fil ilmul-hadith, 1984.
13. Orijeta Deda, Saimir Bulku; Thesare në Kur'an, Tiranë, 2002.
14. Artur Guyton; Medinska fiziologija, Beograd-Zagreb 1968.
15. Hamilton Birid Musman; Human Embryology, Baltimore, 1967.
16. Ali Iljazi, Kur'ani dhe shkenca bashkëkohore, Gjakovë, 2001
17. Ali Iljazi, Kur'ani prijatar i shkencës, Gjakovë, 2003.
18. Keith Moore, Developing Human, 1998.
19. Gary Miller, Qudesni Kur'an, 2003.
20. David Levy, Skywatching, USA, 1994.

Prim. dr. med. sci. Ali Iljazi

THE GLORIOUS QUR'AN FASCINATES SCIENTISTS

(Summary)

Allah, the Magnificent, in the Glorious Qur'an says:

"He it is Who brought you into being and made for you ears and eyes and hearts. Little thanks it is you give!" (El Mulk, 23)

The technology of our body is superior to the technology that mankind has produced.

Studying the human ear, looking at this magnificent deed, we clearly see the absolute Constructor.

At first glance, it seems a simple structure, but behind the lobe of the ear is a perfect and very delicate physio-morphological structure which would amaze the most inventive engineer.

د. علي الياسي

القرآن الكريم تحدى العلماء

(خلاصة البحث)

"قل هو الذى أنشأكم و جعل لكم السمع والابصار و الأفئدة قليلا ما تشكرون" (الملك: ٢٣) ان تكنولوجية جسم الانسان هى اكثر اتقانا من اية تكنولوجية انتجها الانسان اعتمادا على خبراته و امكانياته. و اذا امعنا النظر فى احدى حواسى الانسان كالسمع على سبيل المثال سوف نرى ان وراءه يقف الخالق سبحانه و تعالى. و فى النظرة الأولى الاذن يبدو بسيطا و لكن بداخلها يوجد تركيب دقيق جدا يمكن ان يفهمه المتخصصون فقط.

RELIGJIONI

Avni Aliu

ISLAMI ËSHTË PROGRAM JETE, JO ADET

I frymëzuar prej fjalës së Allahut (xh.sh): ***"…Ecni nëpër viset e saj (të tokës) dhe kërkoni begati…"***[1], Umeri, halifi i dytë, kalon pranë një grupi njerëzish që rrinin ulur, dhe i pyet: -"Kush jeni dhe ç'po bëni?"Ata iu përgjigjën: -"I jemi mbështetur Zotit!"Atëherë, Umeri u tha:-"Jo, ju jeni barrë e të tjerëve; i mbështetur në Zotin është ai që hedh farën në tokë dhe ia beson Zotit"! Vetëm kjo e thënë e thjeshtë, por shumë domethënëse mjafton për të paraqitur gjendjen reale të muslimanëve të sotëm.

Asnjë mësim, asnjë ideologji nuk mund t'i japë një populli aftësitë e duhura, për të cilat ai nuk është i prirur. Historia është plot me përmbytje popujsh dhe perandorish, zakonesh e ligjesh. Qytetërime të shumta janë zhdukur. Cilat janë shkaqet e këtyre shkatërrimeve të qytetërimeve të lashta? A kanë pasur ato ndonjë gabim në këtë mes? Në anën tjetër, historia tregon për ngritjen e popujve në jetë ose rënien e tyre.Cilat janë shkaqet e ngritjes, përkatësisht, të rënies së tyre? Çdo mësim dhe çdo përpjekje e shkencëtarëve, ndonjë doktrinë social-ekonomike dhe çdo zbulim shkencor, bëhen me të vetmin qëllim, që t'i shërbejnë njeriut; të jenë në përdorimin e tij; për dobinë dhe të mirën e tij. Po zbulimet teknike dhe teknologjike, kujt i shërbejnë ? Edhe ato kanë të njëjtin qëllim-t'i shërbejnë njeriut. Po feja, a mund të shërbejë për diçka tjetër përpos t'i vijë në ndihmë njeriut? Vetëm për lumturinë dhe ngritjen e njeriut Allahu (xh.sh.)përmes të dërguarve të Vet, që nga Ademi e deri tek i dërguari i fundit Muhamedi a.s. i shpalli njerëzimit fenë islame, dhe çdo arritje, mësim dhe normë e kësaj feje – që të gjitha kanë për qëllim që njeriut t'ia bëjnë jetën më të lehtë, më të lumtur dhe më të suksesshme. Të jemi më konkretë në këtë pikë. Ne e dimë që Kur'ani është Shpallja e fundit e Allahut, që ka bërë kthesën më të madhe dhe vendimtare gjatë gjithë historisë së njerëzimit. Dinamika nxitëse që ka shprehur Islami në aspektin zhvillimor të njerëzimit, është janë rezultat i fuqisë dhe forcës kreative që posedon, që, për një periudhë shumë të shkrutër kohore, popullin më primitiv arriti ta ngrinte në nivelin aq të lartë të një ymeti të qytetëruar, sa nga të gjithë studiuesit objektivë të cilësohej si popull më progresiv, i cili, i ngjeshur me shpirtin dinamik të Islamit si fe konstruktive, ka dhënë kontributet më pozitive për progresin dhe qytetërimin e jetës. Faqet më të mira dhe më të ndritshme të qytetërimit Islam paraqesin periodat më të larta të qytetërimit njerëzor në përgjithësi. As edhe armiqtë e Islamit nuk mund ta mohojnë rolin e tij historik në planin e zhvillimit dhe të përparimit, si në aspektin intelektual, ashtu edhe në aspektin moral, ekonomik, politik dhe shoqëror. Dhe një qytetërim i tillë, i paraqitur në kuadër të shpalljes hyjnore, jo vetëm që gjeti rrugën të depërtonte deri në thellësi të zemrave të njerëzve, por bëri që të ndryshonte edhe jeta e tyre. Islami shkuli rrënjët e së keqes, devijimit dhe paditurisë, duke i zëvendësuar ato me vlera të larta morale dhe etike islame.[2] Islami bëri popuj të mëdhenj gjatë historisë,thotë Muhamed Asadi[3], por ç'ndodhi me ta? Ku janë trashëgimtarët e këtij qytetërimi briliant që mahniti botën? Çka i ka kufizuar kushtet tona të sotme të

[1] Sura El-Mulk, ajeti 15:"Ai (Allahu) është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj, ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij.Vetëm tek Ai është e ardhmja"(nga përkthimi i Sherif Ahmetit).

[2] Sejjid Muxhteba Musavi Llari,"Islami dhe qytetërimi Perëndimor",Drita e jetës, Gjilan 2004, f.96-97.

[3] Muhamed Asad,"Put u Mekku",f. 173.

jetës? Cilat janë shkaqet e degradimit të kulturës, shkencës dhe rënies së ndikimit politik tek ne? Pse muslimanët, me gjithë të kaluarën e shkëlqyeshme në Lindje e Perëndim, sot ulin kokat në këtë botë moderne? - pyet analisti i njohur, Sejjid Muxhteba Musavi Llari.[4]

II. Zgjimi islam nga perspektiva e disa dijetarëve

Ne po shohim se Bota Islame tashmë një kohë të gjatë po jeton periudhën e dekadencës, e cila ka përfshirë një mori sferash të jetës. Mjerisht, është një e vërtetë e hidhur që muslimanët sot kanë ngelur shumë prapa në pikëpamje shkencore, teknologjike, industriale, politike, arsimore dhe në shumë fusha të jetës. Kjo, domosdoshmërisht, ka rezultuar me ngecje dhe prapambeturi edhe në planin fetar. Cilat janë shkaqet e dekadencës që ka përfshirë Botën Islame për disa shekuj? A mos e kanë tepruar në ndonjë ves fatal që i ka sjellë në këtë gjendje? Për se muslimanët në shekujt e parë të Islamit ishin aq të përparuar dhe progresivë? A ka mundësi që muslimanët e sotëm të dalin nga kriza në të cilën kanë rënë? Nga duhet të fillohet që të dilet nga kjo gjendje? Lidhur me këto, Profesor Asadi jep përgjigje shumë interesante.Rënia dhe ngecja e muslimanëve, thotë Asadi, s'është e metë e Islamit, sepse ajo është fe e përkryer, e përsosur, e plotësuar që me Shpalljen e fundit, por është e metë e muslimanëve pikërisht, sepse, atë moment kur muslimanët lanë pas dore Islamin dhe filluan të bëjnë jetën në kundërshtim me parimet e tij të shkëlqyeshme, që nga ai moment muslimanët filluan të ngecin, të ngelin prapa dhe të jetojnë dekadencën. Krejt ajo që konsiderohej në Islam si progres dhe lëvizje, u shndërrua në aksident të muslimanëve të sotëm, në shkujdesje, indiferentizëm, mospërfillje dhe ngecje.Që nga momenti kur muslimanëve feja e tyre iu bë adet, shprehi, dhe pushoi së funksionuari si ligj, sistem dhe program jete, që është dashur me vetëdije të plotë ta zbatonin, ndërkaq, fuqitë nxitëse dhe shtytjet novatorike që shtrihen në bazën e qytetërimit të tyre, u zhdukën dhe vendin e tyre gradualisht e

[4] Sejjid Muxhteba Musavi Llari, vep. e cit.f. 149.

zuri shterpësia, indolenca dhe degradimi kulturor. Shkaku kryesor i ngecjen dhe rënies së kulturës e shoqërisë muslimane është fakti se ata, pak nga pak, filluan të linin pas dore shpirtin e mësimeve islame. Islami ishte aty, por ai ishte si trupi pa shpirt- është i qartë Asadi.[5] Historia na demonstron në mënyrë të pagabuar se, sa herë që muslimanët kanë ndërtuar filozofinë e jetës së tyre në frymën e normave islame të shpallura nga Zoti, kanë arritur prosperitet të plotë, ndërsa, sa herë që ia kanë kthyer shpinën udhëzimit hyjnor dhe e kanë lënë pas dore, kanë dështuar dhe kanë rënë në varfëri, amulli dhe mjerim. Muslimanët themeltarë të kësaj kulture briliante e të mirëqenies shoqërore në të kaluarën, ndiqnin të gjitha parimet islame me shumë sinqeritet, devotshmëri, përkushtim, si në nivelin individual, ashtu edhe në atë shoqëror e kombëtar. Kështu, drita e dy kulturave, - shpirtërore dhe mendore, ndriçonte gjithnjë derisa aplikoheshin kriteret e shkencës, mendimit, materies dhe shpirtit. Kur muslimanët braktisën këtë qasje të mendimit e të shkencës, bajraku që u kishte prirë drejt angazhimit, përpjekjes, zellit të luftës dhe punës për të mirë, u ka rënë nga dora.[6] Ku u tret ai respekt i dikurshëm? Ajo krenari e dikurshme? Ajo kulturë kolosale që ngriti Islami? Ku është ai dinjitet, integritet, nderi dhe e vërteta muslimane që dikur kanë qenë suazat e rrugës së tyre? "Kur i tejkaluam këto vlera sublimore, konstaton Sejjid Muxhteba Musavi Llari, u gjendëm të humbur në shkretëtirën pa gjurmë, duke harruar thirrjen e lartë të Shpalljes Hyjnore si udhëzim për ne dhe për gjithë njerëzimin, që të jetojnë sipas vullnetit të Allahut. Duke e braktisur këtë fat dhe begati hyjnore, jemi zhytur në rërën e gjallë që sa shkon e ngulfat pamëshirshëm botën njerëzore përmes korrupcionit, injorancës dhe varfërisë që sot rrethon nga të gjitha anët".[7]

Duke elaboruar mbi çështjen se çfarë duhet të jetë personaliteti islam, dr. Muhamed El Mesari thotë, ndër të tjerash, se "struktura mendore dhe ajo shpirtërore e çdo njeriu, formojnë personalitetin e tij, e sa i përket personalitetit islam, ai është i veçantë nga të gjithë perso-

[5] Muhamed Asad, "Islam na raspucu", f. 8.
[6] Sejjid Muxhteba Musavi Llari, vep. e cit. f.149.
[7] Po aty, f. 149.

nalitetet e tjera në botë dhe ka kujdes që të mbetet gjithnjë i tillë, i dalluar nga të tjerët".[8] Po ashtu, muslimanët dallohen edhe ndërmjet tyre për nga kuptimi i tyre ndaj Islamit, varësisht se sa u është dhënë nga kultura islame dhe nga aftësitë mendore që Zoti i krijoi ata. Pra, vlera e personit musliman varet prej thellësisë së zhytjes së tij në kulturën islame, t, derisa ta kuptojë Islamin drejt, kur mendimi, njohuritë e tij teorike mbi Islamin të përputhen dhe të harmonizohen me veprat e tij praktike.[9] Besimi islam patjetër duhet të rezultojë me vepër të mirë. Mirëpo, kjo mund të arrihet vetëm atëherë kur është i skalitur fort në zemër të njeriut. Një besim i tillë bëhet dritë orientuese e sjelljes dhe veprimeve të njerëzve. Besimi i tillë, i skalitur fort në zemër, mëton rrënjësisht të ndryshojë gjendjen e popujve dhe të kombeve. Por, gjendja e një populli nuk mund të ndryshohet pa ndryshimin e bindjeve dhe mendimeve në kokat e njerëzve, e me këto ndryshime transformohet edhe gjendja e popullit, nga apatia dhe pasiviteti drejt aktivitetit dhe zellshmërisë, siç ka ndodhur në kohën e Muhamedit (a.s.), i cili bëri kthesën vendimtare ideore dhe ideologjike. Bindja e kundërt me këtë, jep edhe rezultate të kundërta - thotë Dr.Muhamed El Mesari.[10]

III. Për një qasje më serioze rreth kuptimit dhe zbatimit të Kur'anit

Nuk është me rëndësi vetëm leximi i Kur'anit, me rëndësi është si të kuptohet, për më tepër si të zbatohet ai, të vihet në jetë, të hedhë shtat dhe trup, të çelë lule dhe të japë fruta ajo që lexohet nga Kur'ani. Vetëm fjala "el-ilmu", që ka kuptimin: "dituri", "shkencë" dhe derivatet që dalin nga kjo fjalë, përsëriten 850 herë në Kur'an.[11] Megjithatë, Islami si një agjent aktiv dhe krijues që i dha qytetërimit dhe shoqërisë bashkëkohore një gjallëri të jetës, u shndërrua në një frymë

[8] Dr. Muhamed El Mes'ari, "Në botën e mendimit",Logos-a Shkup 1994, f. 26-27.
[9] Po aty, f.19.
[10] Po aty, f. 40.
[11] Dr. Mustafa Mahmud, "Dialog me mikun ateist" Prishtinë 1990, f.55.

abstrakte të fosilizuar brenda formave dhe kallëpeve tradicionale të aksioneve, ceremonive dhe riteve të lashta, kështu që "u bë hambar i fanatizmit dhe injorancës", siç do të thoshte Dr. Ali Sheriati.[12] Me se mund ta arsyetojnë injorancën e vet para Islamit dhe para Allahut Fuqiplotë muslimanët e sotëm?!! Me se muslimanët e sotëm mund ta arsyetojnë papunësinë e vet, duke e reduktuar Islamin vetëm në disa rite fetare dhe në leximin e verbër të Kur'anit, sa kohë që Islami duhet të shtrihet patjetër edhe në fushën ekonomike, politike, arsimore, shkencore dhe kulturore, ashtu, siç vepruan muslimanët e gjeneratave më të hershme, dhe krijuan një qytetërim dhe shkencë që në fakt ishte nëna e qytetërimit të sotëm.[13] Sepse vetëm si i tillë do të jetë i plotë besimi (imani), vetëm si i tillë do të jetë i plotë Islami, dhe ç'është më me rëndësi, me rol të rëndësishëm për gjininë njerëzore. Me se arsyetojnë vetveten muslimanët para Islamit dhe Kur'anit, kur në vend të vlerave të mirëfillta islame, ofrojnë variante deformuese, të përthara, koncepte denigruese dhe sterile, që nuk janë elemente të sistemit islam, dhe me to nuk mund të pajtohet ai koncept. A është në gjendje sot Bota Islame t'i plasojë vlerat e mirëfillta universale islame, aq të nevojshme për botën bashkëkohore,e cila, për shkak se janë produktive, qytetëruese, por edhe të moralshme, do t'i integronte në vetvete. Kjo është e nevojshme të bëhet, sa më parë aq më mirë, posaçërisht kur të kihet parasysh se "mosbesimi, imoraliteti dhe padrejtësitë janë shkaqet më kryesore të shkatërrimit dhe asgjësimit të popujve.[14] Sot bota bashkëkohore ka nevojë për t'u shëruar. Ne po shohim se qytetërimi i sotëm është një lustër. Është i sëmurë, ndien zbrazëti. Ne duhet ta ndihmojmë atë. Ne duhet t'i ofrojmë barin e shërimit. Sot, më tepër se kurdoherë, kohës sonë i nevojitet baza ideologjike për një marrëveshje të re shoqërore: Asaj i duhet feja që do t'i mundësonte të kuptojë zbrazëtinë e përparimit material, ndërkohë që kësaj jete do t'i ofronte atë pjesë që i përket. I duhet feja e cila do të mundësonte ve-

[12] Dr. Ali Sheriati, "Ç'duhet bërë"-Mendimtarët e lirë dhe rilindja Islame, Rumi-Tetovë 1997, f.161.
[13] Po aty, f.57, 158.
[14] Osman Nuri Topbash, Vargu i Profetëve 1, Stamboll 2001, f.164.

ndosjen e baraspeshës ndërmjet kërkesave shpirtërore dhe fizike, në mënyrë që ta shpëtonte njerëzimin që është vërsulur pakujdesshëm drejt katastrofës.[15] Vaclav Haveli, kur flet për qytetërimin e sotëm, thotë ndër të tjera:" Qytetërimi i sotëm është një rezultat i evolucionit të shoqërisë amerikane dhe evropiane, i mbështetur në parimet e njohjes racionale të botës së jashtme mbi idenë e progresit dhe mbi besimin në gjithëfuqinë e shoqërisë dhe të teknologjisë. Qytetërimi i sotëm është një lustër, nën të cilën fshihet një proces antagonist. Konfliktet lokale, nacionalizmi, integrizmi, janë shprehje të reaksioneve alergjike të kulturave origjinale. Intensiteti i atyre konflikteve rritet, dhe në këtë shihet një rrezik për qytetërimin. A ka rrugëdalje? Po. Rrugëdalja, pa dyshim, nuk është në konceptet standarde që propozon Perëndimi, siç janë demokracia, të drejtat e njeriut, tregu i lirë. Demokracia në vete nuk është e mjaftueshme. Ajo mbështetet në gjedhen antropologjike të lënë pa "përmasat shpirtërore".[16] Perëndimi e ka humbur spiritualizmin e vet kur e ka mënjanuar Zotin për t'ia nënshtruar gjithçka rehatisë, konsumit dhe materializmit. Shpëtimi është në kthimin tek burimet shpirtërore, në kthimin e njeriut në natyrshmërinë e tij, në të cilën natyrshmëri e krijoi Zoti. "Rilindja shpirtërore duhet të mbështetet në vlera të pranueshme në tërë botën".[17] Për këtë nevojitet edhe koka e Lindjes edhe koka e Perëndimit, siç do të thoshte Hygo. Pa bashkimin e dy kulturave-kulturës shpirtërore dhe kulturës mendore në kokat e njerëzve-njerëzimi s'mund të ketë perspektivë. "Bota lindore ka intelektin, përkatësisht shpirtëroren.Perëndimi nuk ka nevojë të mësojë nga Lindja për gjeologjinë, botanikën e shkencat e tjera, por mund të marrë shkencën shpirtërore.Bota Perëndimore ka materien, përkatësisht kulturën mendore, dhe nga Lindja mund të marrë vlera të mëdha për njerëzimin, si Islamin, kulturën shpirtërore, filozofinë e natyrës etj. Posaçërisht është e rëndësishme shtrirja e Islamit në Botën Perëndimore dhe roli i tij ndërmjetësues mes Lindjes së largët dhe Perëndimit". Bota Islame ka më shumë se kushdo tjetër të drejtë t'i re-

[15] Muhamed Asad, vep. e cit. f. 265.
[16] Vaclav Haveli "Courrier international-Paris", "Bujku, 29 mars 1998, f. 3.
[17] Po aty, f.3.

ferohet paqes dhe të vendosë paqen, sepse feja e tyre ISLAM-i, ka kuptimin "PAQE". Edhe po të donte dikush nga armiqtë më të përbetuar të tij ta përkthente ndryshe, s'do të kishte mundur përveçse të thoshte "Paqe". Mbi këto valë të qytetërimit të sotëm, ku vërshojnë gjithë mjerimet së bashku me varfërinë, si mund ta vendosin paqen në botë ata që s'e kanë paqen!. Atëherë, sa jemi ne në gjendje ta bëjmë këtë? Në ç'mënyrë mund t'i plasojmë vlerat universale islame të pranueshme për gjithë botën?. Nëse jo, e pse jo!? A nuk zbriti Kur'ani që sipas tij muslimanët të vlerësojnë dhe të gjykojnë në mbarë njerëzimin dhe jo vetëm ndër muslimanët: ***"…dhe kur të gjykoni mes njerëzve, të gjykoni me drejtësi…"*** *(Kur'an, 4:18.)* Allahu xh. sh. nuk ka thënë: "Kur të gjykoni mes muslimanëve të jeni të drejtë!, por thotë: ***"Kur të gjykoni mes njerëzve…"*** "Të gjithë ne jemi përgjegjës që Islamin ta paraqesim ashtu siç është në të vërtetë, si fe e paqes, e tolerancës, e mirëkuptimit, fe që nuk i shikon të tjerët me urrejtje, por njerëzit i konsideron për nga gjinia njerëzore, si të barabartë, e pastaj secili njeri do të përgjigjet individualisht para Krijuesit për veprat e tij në këtë botë".[18]

I goditur thellësisht nga gjendja stagnuese e muslimanëve, nga rënia e tyre prej lart-poshtë, Mesari sjell argumente të pakontestueshme se cilat janë shkaqet që sollën rënien e mendimit islam, ndërsa muslimanët u gjendën në një letargji të plotë mendore dhe shpirtërore. Islami, thotë Mesari, ndër muslimanët është shndërruar në një grumbull dukurish të çuditshme. Kështu, musliman i devotshëm konsiderohet ai që mban tesbihe në dorë, ose ai që pamjen e vet të jashtme e paraqet si islamike!? E sa u përket çështjeve të tjera të jetës së tij, atë e shohim larg nga Islami. Ndërsa, dihet se Islami dallon nga fetë e tjera mu për faktin se paraqet një mori ligjesh, normash dhe rregullash, që janë plotësisht produkt i besimit islam. Prej këtu rrjedh edhe konstatimi i drejtë se Islami është besim, mbi parimet primare të të cilit ndërtohet dhe organizohet jeta, pra Islami është program dhe sistem i jetës së

[18] Nga punimet e Konferencës së 16 "Toleranca në qytetërimin Islam", Kajro, 28.04.-1.05.2004, "Dituria Islame" Prishtinë, nr.166, f.49.

njeriut, jo adet.[19] Duke i dhënë rol të rëndësishëm mendjes, ai thotë se mendja është ajo që e dallon njeriun nga kafshët, kurse ngritjen ose rënien e tij e përcakton sjellja e tij. Se çfarë do të jetë sjellja e njeriut, varet nga ideologjia dhe mendimi i tij; nga të kuptuarit dhe vizioni i tij që ka mbi gjithësinë, njeriun dhe jetën; nga konceptimi i asaj që i prin dhe asaj që vjen pas.[20]

Ne jetojmë në botën e realiteteve, në botën e ligjeve, ku gjërat ndjekin një udhë të përcaktuar.Islami erdhi për ta pajisur njeriun me mjete të duhura, në mënyrë që ai të fitojë me nder luftën e jetës. Derisa struktura shpirtërore përcakton sjelljen e njeriut, ajo duhet të ndërtohet mbi strukturën mendore, domethënë mbi atë se çfarë është vizioni i tij mbi botën. Struktura mendore, siç po shihet, ka rëndësi të madhe në këtë mes, pasi ajo, siç thotë El Mesari, është transmetim i realitetit. Struktura shpirtërore dhe ajo mendore shërohen e marrin shëndet përmes normave të Sheriatit dhe shtrihen në bazën e besimit islam, me të vetmin dallim se tek struktura mendore besimi islam është themel i të kuptuarit dhe të menduarit.[21] Duke marrë për bazë ajetin e Kur'anit, (sure 47:22), Dr. Muhamed El Mesari shtron pyetjen:"Me se do ta arsyetojnë muslimanët braktisjen e të menduarit dhe të kuptuarit të domethënieve të Kur'anit?! Allahu ka thënë:***"A nuk e studiojnë me vëmendje Kur'anin…?*** *(Kur'ani, 47:22),* e s'ka thënë: 'si nuk e lexojnë ata Kur'anin', sepse nga të lexuarit, pa angazhimin e mendjes dhe aftësive mendore për të kuptuar- nuk ka dobi. E pikërisht muslimanët e sotëm lexojnë mjaft dhe e dëgjojnë leximin e Kur'anit dhe gjatë kësaj në fytyrat e tyre vërehet qartë pendimi, mirëpo, mjerisht, ai nuk është pendim i sinqertë, po është si një lloj gjurme që shkaktohet nga muzika në zemrat e adhuruesve të saj. Kjo mënyrë e të besuarit, fatkeqësisht, është bërë shumë e përhapur dhe e admiruar ndër njerëz - konstaton El Mesari.[22] Njerëzit me një besim të tillë, nuk mund të shënojnë asnjë hap të suksesshëm në jetën e tyre. Ata mbesin

[19] Dr. Muhamed El Mes'ari, vep. e cit. f. 44.
[20] Po aty, f.20.
[21] Po aty, f. 24-25.
[22] Po aty, f. 56, 58.

prapa si nga pikëpamja e besimit, ashtu edhe nga puna, sepse besimin e kuptojnë ashtu siç ua do qejfi, ndërsa punës i largohen. Përgjithësisht, ata ndjekin mbrapsht dy rrugë: Besimin pa jetë, dhe jetën pa punë. Mësimet islame i kuptojnë si diçka që u vyejnë për Ahiret dhe jo për jetën e kësaj bote, duke i zbritur ato në formë ceremonish e interesash, të cilat i kushtojnë pak mundim. Ja pra, ide e gabuar, ide e vdekur, që më përpara rrjedh nga dobësia e tyre ose nga mosnjohja e drejtë e natyrës thelbësore të Islamit. Kur'ani u ka ardhur muslimanëve në mënyrë që ta lexojnë, të kuptojnë çdo fjalë të tij, të veprojnë sipas tij dhe me ndihmën e tij në këtë tokë të Zotit, të ndërtojnë dhe të forcojnë "Umetin" dhe Bashkësinë e cila do të jetë në pajtim me Ligjin e Zotit. Ibn Umeri i kaloi tetë vjet të plotë në hifzin e një kaptine të vetme, të kaptinës "el-Bekare", duke e mbajtur në mend çdo ajet dhe s'kalonte në ajetin tjetër për pa e kuptuar, pa e kapur mirë e në hollësi tërë mesazhin e ajetit paraprak. Kështu vepruan edhe ashabët e tjerë. Ibn Mesudi ka thënë: "Kur ndonjëri prej nesh i mësonte dhjetë ajete, nuk i mësonte dhjetë të tjera derisa të mos e kuptonte domethënien e tyre dhe punën që duhet bërë në pajtim me to."[23]

Dallimi mes muslimanëve të parë dhe muslimanëve të sotëm është se të parët Islamin e lidhnin me jetën e kësaj bote, ata nuk e pranonin Islamin si një dogmë që kërkon verbërisht të mendohet dhe të veprohet. Ata nuk e pranonin Islamin si diçka të ndarë dhe të shkëputur nga jeta praktike e nga rrethanat konkrete. Ata nuk e pranonin Islamin të kufizuar vetëm në rite, ndjenja, emocione,në ditë jave ose kur të kremtohet ndonjë festë, në disa norma të etikës, as në përmbylljen e tij në një skutë të jetës, e të shënuar si "çështje personale" të individit.[24] Ata e mësonin Kur'anin me të menduar, duke përthithur kuptimin e çdo fjale. Çdo mendim, koncept, ide, vlerë, kriter, sistem, rrethanë, interes, ata e bazonin në kriteret që ofronte Kur'ani. Prandaj edhe zhvillimi, progresi, mirëqenia materiale e shpirtërore ishin të pashmangshme.

[23] Po aty, f. 58.
[24] Sejjid Kutub, "Islami - fe e ardhmërisë"Nr. 6. Shkup 1992, f. 13.

Mirëpo,“Sot është vështirë të gjesh një mendje që do të thoshte ’nuk ka Zot’, sikurse është vështirë të gjesh një mendje që do të punonte pikë për pikë siç thotë Zoti”-s’më kujtohet se kush e ka thënë, por e ka thënë mirë.Sot fjalët nuk mungojnë, po mungojnë veprat. Sa të rëndësishme janë veprat, këtë duhet ta ketë stoli në iman secili musliman.

IV. Rruga e ripërtëritjes

Për mendimin e Muhamed Asadit, ajo që shihet si dekadencë islame, në fakt, është vetëm zbrazëtirë dhe vdekje në zemrat e muslimanëve, të cilët janë bërë përtacë, të ngathët dhe të pandjeshëm ndaj zërit të amshueshëm të së Vërtetës.[25] Kur’ani si libër hyjnor që flet me gjuhën e shpalljes, konsideron se devotshmëria shpirtërore, pastërtia e zemrës dhe sinqeriteti i të kuptuarit paraqesin komponentet themelore në drejtim të “udhëheqjes”.[26] Kur’ani i fton ithtarët e vet që të mendojnë dhe të kundrojnë. Ai i këshillon ithtarët e vet që të vëzhgojnë, të mendojnë dhe hulumtojnë, në mënyrë që të kuptojnë sa më mirë natyrën, historinë dhe shkencat shoqërore. Ai u rekomandon ithtarëve të vet ta njohin edhe filozofinë e jetës, shkakun përfundimtar të krijimit, misterin e ekzistencës. Kur’ani e pranon këtë metodologji të punës, me qëllim që njerëzit t’i shpëtojë nga skllavëria e injorancës dhe prapambetja. Ai gjithashtu qëndron në pohimin se kjo rrugë e përcaktuar nga Zoti i shpie njerëzit nga vetëdijësimi, urtësia dhe e vërteta. Këta urdhra që i përsërit Kur’ani me qëllim të mendimit dhe të hulumtimit, papritur i ngritën muslimanët e hershëm, nga primitivizmi i tyre, në një Umet të qytetëruar dhe dinamik, të cilët themeluan qendra të ndryshme shkencore, kulturore dhe intelektuale në gjithë shoqërinë islame, që atëbotë shtrihej nga Spanja e deri në Taxhikistan.[27] Historiani anglez Veilz, në librin e tij “Studime mbi historinë njerëzore”, thotë: “Evropa i ka borxh të madh Islamit në aspektin e ligjit administrativ

[25] Dr. Ali Sheriati, vep.e cit. f.156.
[26] Muhamed Asad,”Islam na raspicu”, f.84.
[27] Dr. Ali Sheriati, vep. e cit. f.156-157.

dhe ekonomik”. Historiani francez Sidijo, pohon se ligji i Napoleon Bonapartës është kopjuar nga libri i Fikhut të Imam Malikut me titull ”Sherh derdir ala metni halil”. Gustav Lebon përcjell fjalët e profesorit nga libri, ku thotë, në mes të tjerash: “Sikur të mos ishin paraqitur arabët në arenën ndërkombëtare, renesansa evropiane do të vonohej për disa shekuj”. Lin Bol, në librin e tij “Arabët në Spanjë”, thotë: “Kur Evropa ka qenë në errësirën e injorancës dhe të prapambeturisë, pikërisht në atë kohë Spanja (Endulusi) printe në dituri dhe ishte simbol i kulturës dhe qytetërimit të botës”.[28]

Nuk ka kurrfarë shenjash të dukshme”- pohon Asadi,- “se bota njerëzore, ashtu siç është në gjendjen e vet të sotme, të ketë tejkaluar Islamin. Njerëzimi as sot e kësaj dite s’është në gjendje të krijojë një sistem etik më të mirë nga ai që ka krijuar Islami; s’është në gjendje të krijojë idenë praktike të vëllazërimit njerëzor, siç e ka bërë këtë Islami me formimin e shoqërisë mbinacionale të ashtuquajtur “Ummet”, të mbështetur në premisa të drejta; njerëzimi as sot e kësaj dite s’është në gjendje të krijojë strukturën shoqërore në të cilën konfliktet dhe fërkimet të reduktoheshin në mënyrë efikase gjer në minimum, ashtu siç e ka bërë këtë Islami me anë të sistemit të vet shoqëror; njerëzimi sot e kësaj dite s’është në gjendje t’i krijojë mundësi përparimit të dinjitetit të njeriut, ndjenjave dhe ndjesive të tij; nuk është në gjendje t’ia krijojë sigurinë, shpresën e tij shpirtërore dhe, përfundimisht, po jo me pak rëndësi, fatin, perspektivën, dhe ardhmërinë e tij. Sot, si kurrë më parë, Islami është i nevojshëm për botën njerëzore, e cila ndodhet në zgrip të humnerës”.[29]

Islami akoma është gjallë, thotë Asadi, me praninë e tij në botën e pjesëtarëve të vet dhe me praninë e normave të tij morale dhe etike, megjithëqë vetë muslimanët sikur janë bërë njerëz të paralizuar, të paaftë që besimin e tyre ta shpien përpara me aksione konkrete dhe frytdhënëse. Sistemi islam tashmë një herë është aplikuar në jetën njerëzore, dhe ka dhënë fruta, dhe ajo që ka qenë e mundur një herë,

[28] Abdullah Nasih Ulvan, “Le ta dijë rinia”, Shkup 1992, f.42.
[29] Muhamed Asad, vep. e cit. f.84.

mund të jetë e mundur prapë.[30] Ai është në gjendje jo vetëm të përmbushë nevojat jetësore, por edhe të inkurajojë dhe të udhëheqë jetën.[31] Në këtë drejtim rol të madh lozin të gjithë muslimanët, por në veçanti dijetarët dhe mendimtarët e Islamit janë ata që duhet ta bëjnë këtë detyrë. Edhe thirrësi (daiu), meqë ka të bëjë me masën, ka një detyrë të madhe, dhe kjo detyrë është "t'i vërë veshin qytetërimit dhe të përgjojë, ashtu si mjeku, se si i punojnë mushkëritë dhe zemra". Thirrësi nuk mund të kryejë detyrën e vet me sukses, vetëm me retorikën e mërzitshme dhe boshe, vetëm me improvizime të kota dhe joproduktive.Shoqëria islame dhe besimtarët presin më shumë nga ai. "Ne kemi fenë tonë origjinale, kemi burimet origjinale të fesë sonë, prandaj na nevojiten daijtë dhe edukuesit që në mënyrë të shëndoshë e të drejtë do të edukojnë gjeneratën, me qëllim që prej tyre të dalin besimtarë të plotë, të vërtetë dhe personalitete komplete" - thotë Dr. Jusuf Kardavi.[32] Thirrësi duhet të jetë me një përgatitje të lartë profesionale në shkencat islame, "me qëllim që të jetë në gjendje të diskutojë në mënyrë të kulturuar me argumente bindëse rreth të gjitha ideve të paraqitura në fushën e kundërshtive ideore, dhe atyre t'u qaset me fakte e kritikë të argumentuar. Thesari i tij intelektual dhe mendor të jetë në gjendje t'i vlerësojë të gjitha idetë e bazuara në Islam".[33] Kështu muslimani kalon nëpër disa shkallë-thotë Mesari- nga shkalla e besimit në Islam (I'tikad)-pa të cilin nuk mund të jetë musliman-në shkallën e të menduarit në bazë të Islamit-pa të cilin mentaliteti i tij nuk mund të jetë islamik, në shkallën e mendimtarit islam, që do të arrijë të jetë në gjendje t'i mposhtë të gjitha besimet dhe idetë e kundërta me Islamin"[34], por gjithnjë me fakte dhe argumente bindëse, duke treguar pjekuri, urtësi, butësi, seriozitet, mirëkuptim, kulturë dhe etikë të lartë profesionale, pa marrë parasysh qëndrimin e palës tjetër.

[30] Muhamed Asad, "Put u Mekku", f.264-265.
[31] Dr. Ali Sheriati, vep. e cit. f.159.
[32] Dr. Jusuf el-Kardavi, nga biseda e zhvilluar në emisionin televiziv El-Xhezira, shtator, 2003.
[33] Dr. Muhamed el-Mes'ari, vep. e cit. f.25.
[34] Po aty, f. 25-26.

V. Lulëzimi islam sërish është i mundshëm
(Por, ç'duhet të bëjnë muslimanët)

Duke folur mbi vlerat islame, filozofi anglez, Bernard Shou, thotë, ndër të tjera: "Feja që iu shpall Muhamedit, posedon joshje të posaçme pasi ajo ka gjallërinë e përhershme, është feja e vetme që i plotëson nevojat e kohës.Pra, jam i mendimit dhe e shoh të nevojshme që Muhamedi të shpallet shpëtimtari i njerëzimit. Po, sikur udhëheqja e botës moderne t'i besohej një njeriu si Muhamedi, do t'i zgjidhte të gjitha problemet e kohës aktuale".[35]

Ndërsa, Dr. Ali Sheriati, në librin e tij "ç'duhet bërë", ndër të tjera, thotë: "Islami ka dëshmuar se kurdoherë që është paraqitur nevoja për t'u ballafaquar me provokimet e armikut të jashtëm e të fuqishëm, ai ka dalë më i fortë dhe ngadhënjimtar. Ndërkaq, sa herë që ka pësuar disfatë, ajo ka ardhur si rezultat i hipokrizisë dhe dobësive të brendshme dhe neglizhencës së miqve të tij. A nuk qe po ky Islam i cili me një ushtri prej jo më shumë se disa qindra ushtarësh, i shkatërroi të fuqishmit dhe bashkoi frontin e fiseve arabe? A nuk qe ky po ai Islam i cili në të njëjtën kohë, me disa mijëra muslimanë varfanjakë, i shkatërroi të dy perandoritë e mëdha të botës, atë Persiane dhe Bizantine?".[36] Në ç'mënyrë mund ta kthejmë prapë mendjen e Islamit te zemra e tij? Çfarë mundësie mund të ketë që "shkencat tradicionale islamike" të dominojnë përsëri në skenën e shkencave? Në ç'mënyrë të lirohet besimi religjioz nga myku i sotëm tradicional dhe atij t'i kthehet vetëdija, drita shkencore dhe logjika racionale? Si të rikonstruktohet Islami që sot është i ndarë në dy pjesë: në traditat e trashëguara dhe në shkencat anakronike? Si të ringjallim dhe ristru-kturojmë shoqërinë, koka e së cilës është e ndarë nga trupi? Si mundemi ta ngjallim shpirtin tonë jetëdhënës, krijues, revolucionar dhe dritëdhënës; shpirtin që prodhon fuqi dhe është i kapluar nga urtësia; shpirtin i cili ithtarëve të vet u jep nder dhe pavarësi; jetë dhe dituri; besim dhe gja-

[35] Abdullah Nasih Ulvan, vep. e cit. f.42.
[36] Dr. Ali Sheriati, vep. e cit. f.159-160.

llëri; spiritualitet dhe begati; urrejtje e dashuri; luftë e paqe; fanatizëm e tolerancë; liri dhe udhëheqësi, realizim dhe idealizëm; krenari dhe modesti; vetëdije dhe njerëzi? Si është e mundur që Islami siç është sot të nxirret nga thellësitë e historisë dhe nga vendet e vjetruara e të izoluara dhe të rivendoset në kohën e sotme në vendin që meriton, në ndërgjegjen e pastër të kësaj gjenerate shpresëhumbur dhe pa cak? Si të bëhet kjo? - pyet Dr. Ali Sheriati.[37] Dhe, sa i përket përgjigjes, ai është për faktin që ajo duhet të jetë e shpejtë, e gjallë, të jetë me përgjegjësi për të gjithë, pa marrë parasysh se kush jemi, cilës klasë i përkasim dhe çfarë aftësish posedojmë dhe cilat janë ato, sepse, siç thotë ai, "për të kërkuar përgjegjësi nga dikush, mjafton që ai të jetë pjesë e racës njerëzore".[38]

"Unë besoj",- shton Sheriati,-" se ajo që ka penguar implementimin e frymës islame në kursin e kohës, dhe që pikëpamjen e kulturën islame i ka bërë anakronike, është vdekja e frymës dhe gjykimit të pavarur, domethënë, mungesa e ixhtihadit.Duke treguar të kaluarën, në të cilën mendimtarët e mirëfilltë musliman shfaqnin idetë dhe interpretimet e tyre rreth gjërave të ndryshme në pajtim me Kur'anin dhe Sunetin, Dr. Ali Sheriati thotë, ndër të tjera: "Në sferën fetare, shpirtërore dhe kulturore islame, gjykimi i pavarur ishte portë nëpër të cilën kalonte karvani i kohës, kanal për të shkuar në shtëpinë islame të diturisë dhe gjithmonë merrte frymë të freskët. Ixhtihadi paraqet një përpjekje të lirë e të pavarur që synon arritjen e kuptimit të thellë e progresiv të Islamit në të gjitha dimensionet e tij. Ai është një vegël me anën e së cilës muxhtehidi i ndërgjegjshëm përbën interpretimin e ri e të ndryshueshëm të Islamit në pajtim me pikëpamjen e tij përparimtare dhe të lartësuar. Kjo e nënkupton gjuhën shumëdimensionale të Kur'anit dhe zbulimin e kuptimit të brendshëm të tij, i cili, ashtu si natyra, ka aspekte të ndryshme kur shihet nga kënde të ndryshme. Kjo e nënkupton nxjerrjen e vazhdueshme të të vërtetave të Islamit, krahas evoluimit të mendimit të njeriut dhe të shkencës. Dhe, më në fund, kjo

[37] Po aty, f. 161, 163.
[38] Po aty, f. 162.

e nënkupton nxjerrjen e përfundimeve dhe standardeve të reja në pajtim me nevojat e ndryshueshme dhe parimet e institucioneve të sistemeve shoqërore, dhe në pajtim me lëvizjen zhvillimore e deterministe të historisë së njerëzimit. Për këtë arsye, ixhtihadi është një faktor me ndikim të madh në krijimin e lëvizjes, të jetës dhe të përtëritjes së vazhdueshme të kulturës dhe frymës islame, si dhe të rregullave praktike e legale që paraqiten krahas ndryshimit të kohës".[39]

Dr. Ali Sheriati ixhtihadin e shtrin në dy rrafshe, në atë juridik dhe intelektual:"Në Islam",- thotë ai - "ixhtihadi garanton revolucion të përhershëm. Njeriu mund të shohë se në ç'mënyrë i Dërguari i Islamit, nga njëra anë, dhe zhvillimi historik i shoqërive, nga ana tjetër, së bashku me frymën e ixhtihadit, ndihmojnë Islamin, duke i siguruar atij çlirimin nga kalbërsirat e ndonjë kohe të caktuar apo periudhe të historisë, që Islami ende të mbetet kompatibil me zhvillimet dhe ndryshimet historike të shoqërisë. Në këtë mënyrë ai e ndihmon Islamin që të shkojë me hapin e kohës. Ixhtihadi juridik u ndihmon muslimanëve që t'i zgjidhin nevojat shoqërore, ndërsa ixhtihadi intelektual i ndihmon Islamit që të përvetësojë një manifestim të ri gjatë fazave të ndryshme zhvillimore të historisë…"[40]

Çështjes së zgjimit, përparimit dhe zhvillimit të muslimanëve i kanë dhënë mjaft rëndësi sidomos Xhemaludin Afgani, Shejh Muhamed Abduhu, Reshidi Rida, Kevakibi, Shekib Arsllani, Shejh Mustafë el-Meragi, Shejh Sheltuti, por kjo çështje ngrihet sidomos në veprat e Mevdudisë, Nedevisë, Kutbit, Behaiut dhe autorëvë të tjerë bashkëkohorë si, Dr. Ali Sheriati, Dr. Jusuf Kardavi, Husein Xhozo, Dr. Muhamed el-Mes'ari etj., të cilët, rrugën e vetme për zhvillimin e shoqërisë islame; prezantimin e së vërteteës reale dhe fytyrës origjinale të Islamit; ngritjen e nivelit të njohjes dhe të vetëdijes fetare në shoqëri; afrimin e shtresës së edukuar dhe gjeneratës së re me atë Islam e shohin në rihapjen e dyerve të ixhtihadit.Sepse, Islami ka një qytetërim dhe një "qytetërim ripërtëritës, ngase hap dyert për përpjekje logjike të va-

[39] Po aty, f. 162-163. Po aty, f. 164.
[40] Dr. Ali Sheriati, vep. e cit. 164.

zhdueshme (El-Ixhtihad), sepse u mundësohet mendimtarëve të mirëfilltë muslimanë që të shfaqin idetë dhe interpretimet e tyre rreth gjërave që janë të kontestueshme e të përcaktuara në mënyrë të prerë nga ajetet dhe hadithet"[41]

VI. Çka nënkuptojmë me fjalën ixhtihad?

Zëra të mjerë janë ata që kërkojnë, gjoja në emër të Kur'anit dhe Synetit, të mos pëcaktohen për një sistem rregullash të caktuar. Zëra të mjerë janë ata që mendojnë se do të ishte më mirë të gjitha frymëzimet etike t'ia lënë në dorë intuitës dhe zërit të tyre të brendshëm. Kjo, në fakt, do të thotë të mos ekzistojë fe institucionale. Vetëm një numër i vogël njerëzish, vetëm të dërguarit e kanë pasur fatin që, me saktësi dhe me përpikëri të kuptojnë zërin e tyre të brendshëm që u fliste.Ata ishin të zgjedhurit e Zotit dhe, si të tillë, ishin të liruar nga çdo interes dhe dëshirë personale. Shumica nesh jemi të ngatërruar interesash dhe dëshirash personale,prandaj, ç'do të ndodhte sikur secili prej nesh të pasonte dhe ndiqte dëshirën e zemrës së vet, zërin e unit të tij? Do të kishim një tendosje të plotë, një kaos dhe s'do t'ia dilnim kurrnjëherë t'i harmonizonim në mënyrë të denjë e të caktuar qëndrimet dhe sjelljet tona. Po ashtu,do ishte një gabim i madh sikur të braktiset gjithë trashëgimia e fikhut, që me kujdes dhe përkushtim të madh e kanë përpunuar mendimtarët autoritativë dhe imamët e shkollave juridike."Nuk mund të pranohet e as të imagjinohet se ai që dëshiron të komentojë Kur'anin të lërë pas dore krejtësisht komentet e dijetarëve (alimëve) të mëparshëm e, nga ana tjetër, t'i përvishet asaj pune vetë. Ai do të devijojë detyrimisht, njësoj siç ka ngjarë edhe me ca dijetarë të tjerë mendjelehtë e arrogantë. Gjithashtu, sikur disa dijetarë të dëshironin të komentonin, ta zëmë, Sahihun e Buhariut, vallë, a do të mund ta bënin këtë duke mos përfillur shpjegimet dhe komentet e Imamëve të mëdhenj dhe, të mbështeteshin vetëm në forcat e veta?! Ndërkaq, favorizimi i ixhtihadit nuk nënkupton kurrsesi braktisjen e

[41] "Dituria Islame", Prishtinë, nr. 166, f. 48.

trashëgimisë së fikhut ose reduktimin e vlerës dhe efektit të saj, porse me ixhtihad nënkuptohen ca gjëra elementare, të cilat Dr. Jusuf el-Kardavi i përmbledh në tri pikat kryesore:

1. Të bëhet rishqyrtimi i trashëgimisë së pasur të fikhut (i shkollave të ndryshme juridike- i drejtimeve dhe mendimeve autoritative, veçmas i qëndrimeve dhe pikëpamjeve të ashabëve dhe tabiinëve në epoka të ndryshme në frymën e kushteve dhe pozicioneve të reja. Pastaj të bëhet seleksionimi i pikëpamjeve më autentike në to dhe i atyre më optimale për sendërtimin e intencave të Sheriatit dhe për vendosjen e mirëqenies së Umetit në kohën tonë.

2. Kthimi tek burimet, burimet autentike dhe studimi i tyre në dritën e objektivave të përgjithshme të Sheriatit.

3. Ixhtihadi në çështjet dhe situatat e reja, të cilat s'i kanë njohur juristët (fukahatë) tanë pararendës dhe as që kanë dhënë vendime për çështje të ngjashme me ato, për të cilat duhen gjetur zgjidhje përkatëse në dritën e argumenteve të Sheriatit.[42]

Duke parashtruar nevojën e ixhtihadit si të rëndësishëm dhe çështje të ndjeshme njëkohësisht, Husein Xhozo është i qartë kur thekson: "Fjala është për zgjidhjet e problemeve që janë në kompetencën dhe fushën e ixhtihadit, në realitet, për zgjidhjet nga sfera e jetës shoqërore, ekonomike dhe politike. Ndërsa zgjidhjet nga lëmi i BESIMIT dhe IBADETIT (namazi) nuk vijnë në konsideratë".[43]

Dr. Ali Sheriati zbatimin e ixhtihadit e paraqet në dy rrafshe: në rrafshin juridik dhe në rrafshin intelektual dhe shton se "për të arritur hulumtimet e ixhtihadit nivelin e lartë universitar dhe të jenë shkencore, të kenë metodologji të duhur, paraprakisht nevojitet të shfrytëzohen të gjitha resurset dhe metodologjia e shkencave shoqërore, veçanërisht e historisë, teologjisë, drejtësisë, ekonomisë, sociologjisë, orientalistikës dhe e historisë së qytetërimeve. Angazhimet, hulutmimet dhe analizat shkencore në lëmenjtë e mendimit islam, në lëmin e historisë, kulturës, shoqërisë, filozofisë, shkencës, letërsisë, artit dhe

[42] Dr. Jusuf el-Kardavi,"E drejta Islame", Shkup 1996, f.93-94.
[43] Husein Gjozo, "Islami në kohë", Shkup 1993, f.32-33.

qytetërimit në përgjithësi. Vetëm atëherë kërkimet islamike do të mund t'u bënin ballë punimeve të orientalistëve dhe islamologëve të Lindjes e të Perëndimit".[44]

Në parashikimet e veta Asadi është plotësisht i qartë kur thotë se "ajo që duhet bërë, s'është "reforma" islame, siç mendojnë, mjerisht, disa muslimanë. Islami është i përkryer dhe i plotë në vetvete."[45] Ajo që duhet reformuar patjetër, është qëndrimi ynë ndaj religjionit". Problemi qëndron tek ne, në plogështinë tonë,në shkurtpamësinë tonë, në hamendjen tonë, në përtesën tonë,në të metat dhe mangësitë tona. Po për këto nuk mund ta fajësojmë Islamin, i cili është i përkryer dhe i përsosur". Që të realizojmë rilindjen islame, nuk duhen kërkuar parime të reja të mirësjelljes nga jashtë, por vetëm duhet t'i zbatojmë ato parimet tona të lashta e të harruara. Ne gjithsesi mund të pranojmë impulse të reja nga kulturat e tjera, por nuk mund të zëvendësojmë pëlhurën e përkryer e të mrekullueshme të Islamit me ato joislame çfarëdo qofshin, pa marrë para sysh se nga vijnë, nga Lindja apo Perëndimi. Futja e ndikimeve kulturore nga jashtë, është në realitet retrogarde dhe destruktive, prandaj edhe e dhembshme. Ndryshimet duhen bërë në vetë ne dhe kjo në drejtim të Islamit, e jo në kundërshtim me të."Jemi të vetëdijshëm",- thotë Asadi,- se bota jonë, bota islame, gati-gati e ka humbur realitetin e vet si fuqi krijuese dhe e pavarur e kulturës së vet. Me zbehjen e besimit dhe të kreativitetit tonë, me ndërprerjen e organizimit të institucioneve dhe mekanizmave shoqërorë, gjendja e kaosit kulturor dhe shoqëror nëpër të cilën tash po kalojmë, tregon qartazi se forcat e baraspeshuara, të cilat një kohë të gjatë kanë qenë përgjegjëse për madhështinë e Botës Islame, sot gati kanë shteruar. Askush nuk e di drejt cilit qëllim po shkojmë. Mungon guximi intelektual, mungon vullneti që t'i rezistojmë rrebeshit të ndikimeve nga jashtë, destruktive për fenë tonë dhe shoqërinë"-është i qartë Asadi.[46]

[44] Dr. Ali Sheriati, vep. e cit. f. 164, 167.
[45] Muhamed Asadi, vep e cit. f.85-86.
[46] Muhamed Asad, vep. e cit. f. 86.

I të njëjtit mendim është edhe Dr. Muhamed el-Mes'ari, kur thotë: "Umeti islam diti të shfrytëzonte të gjithë atë që e gjeti tek popujt e tjerë, shkencën, artizanatin dhe kulturën që nuk ishte në kundërshtim me "AKIDEN"-Besimin Islam". Ai, gjithashtu, thotë se "ka dallim midis shfrytëzimit të kulturave të tjera nga ana e ashabëve dhe ndikimit të kulturave të tjera në Umetin islam, që ngjau gjatë dy shekujve të fundit. Ndikimi i njërës kulturë në tjetrën nënkupton pranimin e asaj kulture ose të një pjese të saj, pa kurrfarë analize kritike ose kundërshtimi në pikëpamjen e saj mbi jetën.Me këtë na bëhet e qartë se çfarë ka qenë fillimi dhe zhvillimi i kulturës islame në kohën e saj të parë-në kohën e ashabëve. Kultura e këtillë islame është ruajtur deri më sot, pavarësisht nga peripecitë në udhën e saj. Umeti islam, shikuar në tërësi, e ruajti veçantinë e tij të ndikimit tek të tjerët dhe jo rënien nën ndikimin e kulturave të tjera".[47]

Fet'hi Jeken lëvizjen islame dhe shkëlqimin e sërishëm të tij e sheh në përgatitjen e gjeneratave të reja, që do të jenë të gatshme dhe të vetëdijshme për madhësinë e barrës, mbi vështirësitë e asaj përgjegjësie dhe rrezikun e misionit që do të marrin përsipër. Ai thotë se gjenerata e re duhet të përgatitet në këta rrathë elementarë: 1) Përgatitja të jetë e gjithmbarshme, domethënë të përfshijë aspektet e aftësive mendore, psikologjike, shpirtërore të lëvizjes; të merren parasysh të gjitha anët e personalitetit, në mënyrë që personaliteti islam të jetë i gjithmbarshëm, i fuqishëm për rezistencë dhe ballafaqim e i dueshëm për të vazhduar realizimin e qëllimit të tij. 2) Përgatitja të jetë e baraspeshuar, domethënë përgatitja në çdo aspekt të bëhet në masë të kërkuar, pa teprime, pa mangësi, sepse çdo interesim i tepruar vetëm në një anë të posaçme, pa dyshim do ta deformojë personalitetin dhe do të prishë baraspeshën e tij. 3) Përgatitja të jetë e gjerë, domethënë të mos reduktohet vetëm në teori, por të bazohet në metodë dhe rrugën praktike gjatë punës reformuese e përgatitore, si dhe në përplotësimin e shembullit të mirë të lëvizjes. E kjo do të thotë që përgatitja të bëhet përmes lëvizjes dhe punës konkrete e jo vetëm përmes këshillës

[47] Dr. Muhamed el-Mes'ari, vep. e cit. f.18-19.

dhe mësimit. Këtë personalitet, me këto sifate, me këto tipare dhe cilësi, e do sot Islami dhe ka nevojë për të në misionin reformues.[48]

VII. Vlerat e Qytetërimit Islam

Duke u nisur nga fakti se vlerat islame janë vlera që bazohen në drejtësinë hyjnore, si të tilla, ato nuk rrezikojnë vullnetin e individit dhe të shoqërisë njerëzore në ndërtimin e jetës dhe të marrëdhënieve ndërnjerëzore në të gjitha aspektet, sepse lidhen me besimin islam, dhe aplikimi i tyre bëhet duke iu referuar autoritetit më të lartë që është Allahu, Krijuesi i gjithësisë, "i cili nuk i jep epërsi ose privilegj asnjë populli, por të gjithë besimtarët, pa dallim përkatësie kombëtare, janë të njëjtë në Islam".[49] Prandaj, bota njerëzore, si e tillë, mund të mos e përqafojë Islamin, por nuk mund të mos i pranojë vlerat islame që përbëjnë qytetërimin e vërtetë dhe sistemin më të drejtë për të gjithë njerëzimin. Sistemet shoqërore vlerat e qytetërimit islam, mund t'i quajnë me çfarëdo emri- në emër të demokracisë, humanizmit, globalizmit, në emër të të drejtave të njeriut etj., në mënyrë që të fshihet burimi i tyre, ashtu siç është vepruar edhe me të mbërrimet shkencore islame deri më tash, porse ato gjithsesi mbeten VLERA ISLAME. Cilat janë ato vlera dhe veçori që e përbëjnë qytetërimin islam dhe që e bëjnë të dalluar nga qytetërimet e tjera? Disa të dhëna po i sjellim nga materialet e Konferencës Botërore Islame, mbajtur në Kajro (2001) me titull "Një projekt për renesancë në Botën Islame":

1.Është qytetërim njerëzor global ripërtëritës. Qytetërimi islam varet sidomos nga mendimi islam i mbështetur në Kur'an dhe Synet (tradita e Muhamedit a.s.), por bën ndarje sa u përket dispozitave të bindjes dhe lutjeve, në një anë, dhe sistemeve shoqërore, në anën tjetër. Aspekti i parë u përket vetëm muslimanëve, kurse aspekti i dytë është i përgjithshëm dhe përfshin muslimanët dhe jomuslimanët. Nga ky fakt, ky e merr formën e qytetërimit njerëzor global ose botëror, larg çdo ekstremizmi dhe racizmi. Gjejmë disa ajete kuranore që i

[48] Fet'hi Jeken, "Rinia dhe reforma", Logos-a Shkup 1996, f.50-51.
[49] "Dituria Islame", Prishtinë, nr. 166, f. 48.

drejtohen njerëzimit mbarë, pa marrë parasysh fenë, gjuhën, racën e kombësinë. Si argument mund të marrim ajetin kuranor: ***"O ju njerëz, ju krijova prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëra popuj e fise që të njiheni*** *(të bashkëpunoni)* ***në mes veti. Më i miri*** *(më i ndershmi)* ***nga mesi juaj tek Allahu është ai që tregohet më i devotshmi"*** *(El-Huxhurat, 13).* Qytetërimi Islam është ngritur mbi mirëqenie dhe mishërimin ndërfetar. Thotë Allahu: ***"Nuk ka imponim me dhunë në fe"*** *(El-Bekare, 256).*

2. Ngritja e sistemit shtetëror mbi bazat e debatit, barazisë dhe mbrojtjes së lirive politike. Qytetërimi islam dallohet nga qytetërimet e tjera dhe, deri në shekullin XVIII u ka paraprirë të gjitha qytetërimeve të tjera në vendosjen e pushtetit mbi baza të debatit të hapur (Shura).Kjo do të thotë se pushteti islam për plot një mijë e dyqind vjet është ndërtuar mbi të ashtuquajturën – në kohën tonë-demokraci parlamentare… Të theksojmë vetëm disa ajete e hadithe që vendosin parimet themelore mbi të cilat bazohet ndërtimi i sistemit shtetëror në baza demokratike me debat, respektim të barazisë, drejtësisë dhe mbrojtjes së lirive politike e fetare: ajeti 58 En-Nisa, ajeti 8 El-Maide, ajeti 256 El-Bekare, pastaj hadithi i Pejgamberit a.s. se të parët, në kohën e injorancës, kanë praktikuar drejtësinë vetëm ndaj të dobëtve e jo ndaj të fuqishëmve në shoqëri:"Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, nëse Fatimja, e bija e Muhamedit, do të vidhte, do t'ia pritja dorën". Gjithashtu është një parim në Islam lidhur me zbatimin e drejtësisë në mes muslimanëve dhe jomuslimanëve, që thotë: "Ata duhet të kenë atë që kemi ne dhe ndaj tyre të veprohet sikur ndaj nesh". Gjithashtu është fjala e Umerit r.a. sa i përket mbrojtjes së të drejtave e lirive politike, që thotë:"Si i robëroni njerëzit, kur ata i kanë lindur nënat e tyre të lirë".

3.Qytetërimi islam përfshin një sistem të plotë për çështjet e fesë dhe jetës në këtë botë: Qytetërimi islam u paraprin qytetërimeve të tjera, ngase sistemon të gjitha aspektet e aktiviteteve njerëzore në këtë dynja, qofshin ato politike, shoqërore, ekonomike e ligjislative, dhe krahas kësaj, sistemon edhe çështjet fetare e morale. Dallon nga Krishterimi, i cili ka bërë klasifikime duke e ndarë fenë e duke e quajtur

kishë, dhe çështjet e kësaj dynjaje, të cilat i ka quajtur shtet, përderisa në Islam është e pamundur të bëhen ndarje të tilla. Vetë fakti flet se tentativat e tilla kanë rezultuar me prapambeturi; që nga momenti kur filluan përpjekjet për të bërë një ndarje si të krishterët, muslimanët dështuan dhe mbetën si peshku në rërë. Pra, kjo është një veçori e Islamit që të gjitha këto çështje i çon paralelisht. Islami, duke mos e ndarë fenë nga shteti, synon që njeriun ta edukojë në natyrën e pastër dhe të balancuar nga dy aspektet, ai material dhe shpirtëror, që e ilustron ajeti 77 i sures "El-Kasas". Gjithashtu, duke mos bërë këtë ndarje, Islami synon plotësimin e kësaj dynjaje të përkohshme me atë të përhershmen. Pra, sjelljet e njeriut në këtë botë janë rruga e fatbardhësisë ose dënimit në botën e amshuar. E ilustrojnë ajetet 7 e 8 të kaptinës "Ez-Zelzele".

4.Veçoria e fundit, që vlen të theksohet, është solidarizimi shoqëror. Qytetërimi islam synon ndërtimin e një shoqërie stabile dhe të ekuilibruar në mes interesit personal dhe atij shoqëror. Për këtë po theksojmë ilustrimet që na vijnë nga Kur'ani: el-Bekare,143; el-Huxhurat,10; el-Haxh,41; el-Bekare,188; dhe ajeti 34 i sures et-Teube.50)

VIII. Në vend të përfundimit

Këto veçori të qytetërimit islam jo vetëm që e dallojnë atë prej qytetërimeve të tjera, por edhe botës sonë, botës islame i kthejnë krenarinë që ka pasur dikur. Por, para së gjithash, shton Asadi,-"Ne duhet të pranojmë turpin e decadences, që ia kemi shkaktuar vetes me dorën tonë. Të pranojmë turpin e gabimit tonë dhe të durojmë idhtësinë e tij derisa të vendosim t'i mënjanojmë shkaqet e degradimit në të cilin jemi zhytur. S'ka kurrfarë dobie t'ia fshehim vetvetes sonë të vërtetën e hidhur dhe të pretendojmë se gjoja bota islame nga dita në ditë po rritet, po përparon me anë aktivitetesh islame, se misioni po punon në të katër kontinentet, se perëndimorët gjithnjë e më shumë po e kuptojnë bukurinë e Islamit etj. Nuk ka kurrfarë dobie të shfrytëzojmë argumente sofistike, në mënyrë që të bindim vetveten se si degradimi ynë nuk është i pafund, sepse ai është i pafund. Ndaj, a duhet që ky të

jetë fundi? Kjo nuk mund të bëhet! Kjo rrugë është shumë e qartë, shumë e dukshme për të gjithë ata që kanë sy për të parë.Dëshira jonë është që të jemi më të mirë se ç'jemi tash, dhe kjo na jep të drejtën të shpresojmë se ne nuk kemi marrë fund. Ekziston rruga e ripërtëritjes. Prandaj hapi ynë duhet të ishte: flakja e atij shpirti "apologjetik" për Islamin, i cili s'është asgjë tjetër veç se pretekst për skepticizmin tonë personal. Hapi tjetër duhet të jetë mendimi ynë i vetëdijshëm dhe i përgjegjshëm për pasimin e Synetit të Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s. sepse, "Synet"- s'do të thotë as më pak e as më shumë se të mësuarit e mësimit islam në praktikë. Pra, dija dhe veprimi në jetë janë të nevojshme për Botën Islame, kështu që të jemi të zotët të kuptojmë se ç'është pozitive, ç'duhet pranuar dhe ç'duhet flakur nga impulset e qytetërimit perëndimor.Dhe, në vend që me përulje t'ua nënshtrojmë Islamin normave të huaja intelektuale, duhet të mësojmë edhe një herë Islamin ta konsiderojmë NORMË dhe PROGRAM JETE, sipas të cilit duhet të vlerësohet dhe të gjykohet bota."[50]

Ç'do të ishte kjo botë me qiellin, tokën, yjet, dritën, errësirën, rrotullimin e stinëve, dëborën, shiun, ylberin, me renditjen e pakëputur të brezave njerëzorë (me fatet e me fatëkeqësitë e tyre, me lindjet,vajet, gazet, këngët, dashuritë, rrëmbimet, luftërat, mëritë, varrimet) me një sistem të tërë antitezash: kundruall lindjes - bëri vdekjen, ndanë errësirës – bëri dritë, karshi shtrëngatës – ditën e mbushulluar nga qetësia. Njeriu e kuptoi, ndonëse me vonesë, se vetëm kështu mund të mbahej baraspesha dhe të krijohej harmonia. Nën këtë shtytje të magjishme dhe misterioze, bota do t'i dukej varr, humnerë e pafund, po mos të ishte feja që njeriut t'i ofrojë dritën hyjnore, prej së cilës do të merte kuptimin e botës, kuptimin e jetës dhe qëllimin e saj.

(Për Millin: "E vërteta dhe mendimi i drejtë mund të arrihen vetëm kur pluralizmi i ideve, i opinioneve dhe liria e diskutimit janë realitet. Formula e Millit për këtë pikëpamje është e këtillë:

[50] Muhamed Asad, vep. e cit. f.86-87.

tolerimi I diversitetit shpie në lirinë e diskutimit, liria e diskutimit te gjetja e së vërtetës dhe përparimi i shkencës dhe ky i fundit, në rritjen e lumturisë së shoqërisë). Ideja se progresi i shkencës është i barabartë me progresin moral të shoqërisë, siç dihet, në shekullin XX hyri në krizë pasi që përparimi i shkencës nuk rezultoi me efektet e pritura nga iluministët, por përkundrazi rezultoi menifestimin e dispozitivit apokaliptik të dijes. Shkenca u kthye në një "teknologji të së keqes", ndërsa "emancipimi i njerëzimit" u tregua të ishte një utopi e parealizueshme.

Avni Aliu

ISLAM IS A LIFE PROGRAM, NOT A HABITUDE

(Summary)

Inspired by the words of Allah: "… walk upon its lands and search for prosperity…", Omar, the second caliph, walked by a group of people who were sitting. He asked them: "Who are you and what are you doing?" They replied: "We rely upon God!". Omar said: "You are a burden to others; only those who cultivate their lands and put their trust in God rely upon him". This meaningful saying helps present the situation of the Muslims today.

عوني علي

الاسلام نظام حياة و ليست عادة

(خلاصة البحث)

مر يوما عمر بن الخطاب الخليفة الثانى رضى الله عنه بمجموعة من المسلمين و رآهم جالسين و سألهم: من أنتم و ماذا تفعلون؟ و جاءت الاجابة منهم: "توكلنا على الله!" و رد عليهم عمر رضى الله عنه: "أنتم عبئ على المجتمع. والمتوكل على الله هو الذى يزرع الارض ثم يعتمد عليه". هذه هى احدى المقالات التى تصور الحالة الحقيقية للمسلمين اليوم.

ETIKË

Nexhat Ibrahimi

ÇËSHTJE BASHKËKOHORE TË ETIKËS ISLAME

Çdo kohë dhe çdo brezë njerëzish ka barrën e vet, me të cilën është e lidhur çelësi i fatit apo jofatit, shpresës apo dëshpërimit, haresë apo dëshpërimit, begatisë apo mjerimit, suksesit apo pasuskesit. Jeta në kohën aktuale na bën me dije se duhet të jetojmë në kohën e njeriut planetar, në të cilën kufijt fisnor, regjional, nacional, fetar e të tjera humbin kuptimin. Jemi të vetëdijshëm se jemi krijesë unikale dhe tërësi e pandashme në raport me çështjet dhe problemet tjera. Ndodhitë në botë më shumë se kurdoherë tjetër na preokupojnë individualisht dhe kolektivisht. Rasti i shpërthimit të centralit atomik në Çernobil në fund të shekullit XX, rrënimi i kullave binjake në Nju Jork më 11 shtator 2001, lufta në Kosovë dhe Bosnjë, pastaj në Afganistan, Irak, Palestinë e të tjera tregon se njeriu në fillim të shekullit XXI gjendet para një egoizmi brutal, para një qytetërimi rrënues, që di të mbytë njeriun dhe të ndotë dhe eksploatojë natyrën.[1]

[1] Mustafa Ceric, Predgovor, në: Zbornik Radova III Simpozija zagrebacke dzamije 1410 h./1990, Zagreb, 1991, fq. 6.

I përballur me këtë gjendje, etika islame fiton në rëndësi dhe duket e pakapërcyeshme në ballafaqim dhe në rrugëgjetje kundrejt problemeve të shumta dhe të rënda.

1. Morali i punës dhe afarist

Në fushën e moralit të punës hyjnë çështjet morale që kanë të bëjnë me raportin e njeriut ndaj punës: si e kupton njeriu punën, si sillet ndaj punës, si e përjeton punën, në çfarë mënyre e konsumon energjinë për punë, ç'pret nga puna, përse punon e çështje të ngjashme.

Është çështje kruciale se *si kuptohet puna* në islam. A mos është nevoja e njeriut për punë *pasojë* apo *rezultat* i mëkatit të Ademit dhe Havës apo i largimit të tyre nga xhenneti në Tokë? A mos është *mundim* puna në tokë? A duhet kuptuar punën në kontekstin historik, në lidhshmërinë e tij, *me robërinë*? Duhet pranuar se në periudha të caktuara kohore, nën ndikimin kristiano-pagan, vetëdija muslimane me konotacion të këtillë nuk ka qenë përjashtim.[2]

Nga ana tjetër, në histori, muslimanët gjatë periudhave dekadente historike kanë humbur 'vullnetin për punë' dhe se në këtë aspekt 'nuk kanë nxituar'. Kjo është çështje e gjithëpranuar. Qëndrimin e këtillë të muslimanëve ndaj punës, gjatë shekujve të kaluar, me apo pa vetëdije, edhe formalisht teoretikisht e kanë elaboruar duke përpunuar shumë tema, jo vetëm nga fusha e etikës, në shenjtë të determinizmit (xheberizmit), tërheqja nga jeta, distancimi nga shoqërorja dhe botërorja, varfëria si virtyt i besimtarit, nënshtrimi të tjerëve si vlerë e besimtarit etj. Tërë kjo është pasojë e mbylljes në vetëvete, vetëkënaqësia, shpërfillja e diturisë dhe ndjekja e imitimi i pararendësve etj.[3]

[2] Shih: Yusuf Al-Qaradawy, Introduction to Know Islam, Kairo, 1997, fq. 82. Kasim Bukvic, Moralni aspekt privredjivanja u zajednici muslimana, në: Etika u islamu, Zbornik Radova III Simpozija zagrebacke dzamije 1410/1990, Zagreb, 1991, fq. 157.

[3] Ebu'l-Hasan En-Nedevij, Ma dha hasir'el-alemu bi inhitat'il-muslimin, Bejrut, botimi VIII, 1404 h./1984; Emir Shekib Arslan, Zasto su muslimani zaostali a drugi napredovali, Novi Pazar, 1995; Alija Izetbegoviq, Deklarata islame, Prishtinë, 1999.

Së këndjemi, edhe çështja e konceptimit islam (musliman) të punës dhe raportit ndaj punës shtrohet në formën e ashpërsuar edhe në kuptimin teorik edhe praktik.

Cilat janë, pra, përcaktimet themelore të konceptimit islam të punës?

Puna në mësimin islam kuptohet si formë themelore e sjelljes së njeriut ndaj botës. Puna ka dimension krijues. Kjo do të thotë se njeriu duke punuar sendërton në jetën e tij të gjithë ata emra të Zotit në të cilët Zoti paraqitet në fuqinë dhe madhërinë e Vet krijuese, që dallon nga konceptimi evropian i religjionit, i cili shihet vetëm si raport i njeriut ndaj Zotit.[4]

Hadithi i Muhammedit a.s. në të cilin flitet për 99 emrat e bukur të Zotit, e të cilët çdo musliman duhet t'i arrijë në jetën e vet, janë baza më e fuqishme për argumentimin e punës në baza fetare. Puna është urdhëri Hyjnor për njeriun si mëkëmbës (halif) i Zotit në tokë. Të gjitha ajetet kur'anore në të cilët Zoti flet për begatitë e veta në tokë, duhet kuptuar si flesë për punë. Ato janë dhënë në formën e lëndës së parë, të cilat kërkojnë përpunim. Ofrimi i begative nga Zoti është ftesë për punë. Andaj, puna në islam duhet të ketë rangun e falënderimit të Zotit. Puna në islam është ibadet. Puna në islam është vaxhib - detyrim. [5]

Si kuptohet puna në islam tregon edhe fakti se në islam nuk ekziston *institucioni i pushimit*, (celebrimit, festës, pushimit, boshllë-kut, praznikut – serb.) analoge me të shtunën në judaizëm dhe të dielën në kristianizëm. Festa në islam nuk përbëhet në atë që mos të punohet.

[4] Domethënia e fesë në islam ka dy përmasa kryesore: të organizojë jetën personale dhe shgoqërore të njeriut në këtë botë dhe që ta përgatisë njeriun për lumturinë e përhershme në botën e amshueshme që vjen, në kuptim të fjalëve të All-llahut në Kur'an: ""O Krijuesi ynë, na jep nevenë këtë botë të mirën dhe në botën tjetër të mirtën..." (El-Bekareh, 201). Shih: Ekmeludin Ihsanoglu, Poslovna etika u multireligijskom kontekstu: imovinske transakcije u islamu, në: Grup autorësh, Zapad i Islam ka dijalogu, Sarajevë, 2001, fq. 85.

[5] Ebu'l-A'la El-Mewdudi, Nidham'ul-hajati fi'l-islam, Rijad, 1404 h./1984, fq. 63-64. Analoge me këtë parim shih trajtimin e konceptit të *fuqisë* në konceptimin islam dhe në mentalitetin musliman: N. Ibrahimi, Fuqia si vlerë dhe virtyt moral dhe domosdoshmëri e ekzistimit, në: Takvim për vitin 2004, Prishtinë, 2003, fq. 185-191.

Muslimani pushon vetëm ditën e xhuma dhe atë gjatë faljes së namazit të xhumasë. Posa të përfundojë namazi i xhumasë ***"shpërndahuni nëpër tokë dhe kërkoni begatitë e Allahut …"*** *(El-Xhumu'a, 10).*

Sipas mësimit islam, vetëm feja është pashkëputshëm e lidhur me punën. Besimi dhe puna e mirë është ndër maksimat më frekuente në Kur'an:

"Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm." (El-Asr, 1-3).

Puna është veprimtari që ka edhe perspektivë eskatologjike edhe perspektivë të siguruar shoqërore:

"Thuaj: 'Veproni, Allahu do ta shohë veprën tuaj, edhe i dërguari i Tij e besimtarët, e më vonë do të ktheheni te njohësi i të fshehtës dhe të dukshmes …". *Et-Tewbe, 105).*

Muhammedi a. s. mbi punën pohon:

"Të kërkohet fitimi hallall është detyrë sikur edhe çdo detyrë tjetër në islam." (Bejhekiu).

"Është më mirë të merret litari, të lidh me të një krah dru, t'i ngarkosh në shpinë dhe t'i shetë që Allahu të ta ruaj dinjitetin, se sa të kërkosh lëmosh nga populli, e dhanë ata apo jo." (Buhariu dhe Muslimi).

Në raportin islam ndaj punës duhet pasur parasysh se është detyrë islame që *të punohet* do të thotë *të dihet të punohet*. Në kohët moderne kjo çështje është me rëndësi edhe më të madhe, sepse kushtet dhe rrethanat e punës janë shumë më të ndërlikuara, andaj kërkon kompetencë, aftësi, planifikim, profesionalitet, efikasitet etj.[6]

Fusha tjetër me rëndësi në jetën morale islame përbëhet në marrëdhëniet afariste të njeriut, përkatësisht me biznesin dhe moralin afarist. Morali afarist është i theksuar në burimet normative islame, në Kur'an dhe Sunnet. Për më tepër, etika islame në tërësi është e konci-puar si etikë afariste. Koncepti tipik islam i moralit vjen në shprehje

[6] Ebu'l-A'la El-Mewdudi, Nidham'ul-hajati fi'l-islam, Rijad, 1404 h./1984, fq. 61-73.

në të gjitha ato ajete kur'anore në të cilat Zoti i madhëruar flet për drejtësinë, matjen e drejtë në litër dhe në kandar, në mosabuzimin e pasurisë së bonjakut, mbi verifikimin e informatave, mbi tregtimin e moralshëm, mbi distribuimin e moralshëm, mbi zekatin, mbi tregtinë, mbi kamatën, etj.

Koncepti i këtillë afarist i etikës islame buron nga konceptimi islam aktivist dhe dinamik të botës dhe jetës së njeriut në këtë botë.

Islami nuk është fe e fatalizmit naiv dhe determinizmit, që kërkon nga muslimani t'i dorëzohet fatit pa punë dhe pa angazhim. Janë të shumta ajetet kur'anore dhe hadithet e Muhammedit a. s. që flasin kundër konceptimit të tillë të islamit.[7]

Për të kuptuarit islam të moralit afarist me rëndësi bazore është e drejta e çdo njeriut në integritetin e jetës, pasurisë dhe dinjitetit njerëzor. Në Këshillën lamtumirëse Muhammedi a. s ka thënë:

"O ju njerëz, me të vërtetë gjaku dhe, pasuria juaj janë të shenjta për ju … Ruajeni, respektojeni dhe nderojeni vlerën e personalitetit dhe dinjitetit njerëzor …" [8]

Të gjithë njerëzit kanë për detyrë të bëhen të drejtë dhe kanë të drejtë në kushte të drejta për jetën dhe punën e tyre në shoqëri. Allahu i lartësuar thotë: ***"Bëhuni të drejtë, sepse drejtësia është më afër devotshmërisë."*** *(El-Maideh, 8).*

Në fushën e moralit afarist islam është me rëndësi themelore edhe kjo: e drejta për aftësim për punë, e drejta për punë, e drejta në pronë private.

Të gjithë pjesëmarrësit në punë – punëdhënësit, punëmarrësit, partnerët afaristë – janë të obligueshëm të jenë të ndershëm dhe ta flasin të vërtetën në afarizëm, drejtë dhe me kohë të paguhen punëtorët, me nderë të kryhen punët dhe të zbatohen obligimet afariste dhe të punës,

[7] Ekmeludin Ihsanoglu, Poslovna etika u multireligijskom kontekstu: imovinske transakcije u islamu, në: Grup autorësh, Zapad i Islam ka dijalogu, Sarajevë, 2001, fq. 86.

[8] Hutbeja lamtumirëse e Muhammedit a.s., Prizren, 1422 h./2001, fq. 4; Kasim Bukvic, Moralni aspekt privredjivanja u zajednici muslimana, në: Etika u islamu, Zbornik Radova III Simpozija zagrebacke dzamije 1410/1990, Zagreb, 1991, fq. 165.

të respektohen marrëveshjet, kontratat, ligjet dhe rregullat tjera që kanë të bëjnë me punën dhe raportet e punës etj.

Sipas të kuptuarit islam interesi, profiti afarist, nuk bën dhe nuk mund të jetë synimi më i lartë që nuk është limituar me kurrfarë parime morale.[9]

Në fushën e njoftimeve dhe të marketingut, si elemente të rëndësishme të afarizmit modern, duhet të respektohet parimi bazor moral që të flitet e vërteta.[10]

Në fushën e raporteve të përbashkëta është e nevojshme shkrimi i kontratës dhe roli i dëshmitarit.[11]

Në fushën e etikës afariste duhet respektuar parimin e formimit të arsyeshëm të çmimit, pa makinacione dhe pa mashtrime.[12]

2. Morali politik

Ndonëse togfjalëshi *morali politik* në disa qarqe është i kontestueshëm për arsye se një numër i madh i njerëzve konsideron se *politika* dhe *morali* nuk shkojnë së bashku, sepse fjala *politikë* para së gjithash asocon aftësinë e manipulimit me njerëzit[13], megjithatë konsiderojmë se politika, ekonomia, morali dhe vlerat tjera mund dhe pa tjetër duhet të bashkëveprojnë.

Togfjalëshit *morali politik* mund t'i bëhet vërejtje edhe në kuptimin terminologjiko-logjik, sepse ndoshta do të ishte më e drejtë të flasim *për politikën morale* (ose *jomorale*), respektivisht për politikën dhe moralin.

[9] Ekmeludin Ihsanoglu, Poslovna etika ..., op. cit., fq. 96; Shih kaptinën përfundimtare të këtij libri.

[10] Ekmeludin Ihsanoglu, Poslovna etika..., op. cit., fq. 94.

[11] Ekmeludin Ihsanoglu, Poslovna etika ..., op. cit., fq. 97.

[12] Dzevad Hodzic, Uvod u islamsku etiku, Sarajevë, 1999, fq. 137-140.
Shih hadithet e Muhammedit a.s. rreth formimit të çmimeve: Imam En-Nevevij, Rijadu's-salihin, Shkup, 2003, fq. 485, numri i hadithit 1784, 1785, 1786.

[13] Koncepti makiavelist i sundimit e bën politikën kundërshtare të disa parimeve bazore morale, prej nga buron bindja se politika dhe morali nuk mund të koekzitojnë. Sipas: Yusuf Al-Qaradawy, Introduction to Know Islam, Kairo, 1997, fq. 85. Shih: Nikolla Makiavelli, Sundimtari, Prishtinë, 1979 .

Sikur që në historinë e mendimit politik ervoperëndimor identifikohen dy pikëpamje themelore në aspekt të raporteve të moralit dhe politikës, të marrëdhënieve apo jomarrëdhënieve të tyre, ashtu edhe në historinë e etikës islame identifikohen 'dy koncepte' të moralit islam:

- Koncepti i moralitetit që e kanë zhvilluar sufitë, i cili mund të quhet *konceptimi individualistik, introvert i moralit.* Në këtë koncept morali *ndodh.*

- Koncepti i moralitetit që mund ta quajmë *moral shoqëror, përkatësisht politik.* Këtë koncept të moralit do ta gjeni në *Qytetin ideal* të El-Farabiut [14], në *Ahlak-i-Nasiri* të N. Tusit, në *Ahkam'us-sultanijjeh* të El-Maverdit etj. Konceptimi themelor i moralit te të gjithë këta mendimtarë është që morali të kundrohet si një prej formave bazore të shoqëroritetit të njeriut. Kjo do të thotë se morali sendërtohet në jetën politike, në jetën e bashkësisë, në jetën e përbashkët. E mira dhe e keqja kanë implikime shoqërore. Te dijetarët e theksuar muslimanë politika është pjesë e filozofisë morale dhe e kundërta, morali është pjesë e filozofisë politike.[15]

Nëse i bëhet një vështrim këtyre dy koncepteve themelore të moralitetit në historinë e mendimit etikë islam do të konstatojmë se *pak-a-shumë* ka dominuar koncepti i parë, ai individualistik, introvert i moralit, të cilin do ta quanim koncept *apolitik* të moralit. Kjo veçan mund të thuhet për disa shekujt e fundit.[16] Në këtë mënyrë është

[14] Muhamed Mrahorovic, Filozofijska razmedja islamske duhovnosti, Sarajevë, 2001, fq. 11-62.
James Winston Morris, Orijentacije - Islamska misao u svjetskoj civilizaciji, Sarajevë, 2001, fq. 29-63.

[15] Dzevad Hodzic, Uvod u islamsku etiku, Sarajevë, 1999, fq. 141-142.

[16] Është vështirë të ceket një e vetmja vepër për ta njohur periudhën 15 shekullore në aspekt të zhvillimit ideor dhe praktik, por do t'i theksonim disa vepra ku shkurt, qartë dhe kuptueshëm kuptohet ky jo/zhvillim:
1. Fazlur Rahman, Islam, Chicago, 1979.
2. Seyyid Hossin Nasr, Srce islama, Sarajevë, 1423 h./2002.
3. Muhammed Ikbal, Obnova vjerske misli u islamu, botimi II i plotësuar dhe i ndryshuar, Sarajevë, 2001.
4. Ahmed Emin, Fexhr'ul-islam, Duha'l-islam, Dhuhr'ul-islam dhe Jewm'ul-islam, në botime të ndryshme nga botues të ndryshëm.

shpërfillur ajo që në etikën islame është theksuar shumë – përpjekja e përbashkët (d.m.th. politike) për të mirën dhe kundër të keqes:

"Bëhuni bashkësi e njerëzve që do të ftojë në të mirë dhe do të kërkojë që të bëhet mirë, kurse do të pengojë nga e keqja, - ata do ta arrijnë çka të dëshirojnë." (Ali Imran, 104).

"O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hirë të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos e shtyjë urrejtje ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kinie dro Allahun se Allahu di hollësisht për atë që veproni." (El-Maideh, 8).

Këto dy ajete imponojnë domethënien se morali në islam duhet të kuptohet si politikisht i orientuar.

Na aspekti i etikës islame, morali dhe politika shumëfish janë të ndërthurura: edhe morali edhe politika janë të orientuara kah vlerat, në të dyja kategoritë pjesëmarrës janë njerëzit, përgjegjësia politike domosdo nënkupton edhe përgjegjësinë morale, edhe morali edhe politika janë të orientuar kah e mira për të gjithë.[17]

Në botën moderne, në kushtet e globalizimit të jetës politike dhe ekonomike, të fuqisë teknologjike, mediumeve që botën nuk e bën tjetërfare vetëm kuantitativisht por edhe kualitativisht në raport me kohët e vjetra, aspektet morale të jetës politike janë edhe më të rëndësishme. Me rritjen e fuqisë qytetëruese të njeriut (shkencat teknike, industria ushtarake, industria, komunikimi etj.) rritet edhe përgjegjësia morale në jetën politike.[18]

Kjo përgjegjësi është në zgjerim dhe rritje dhe atë në dy drejtime:

- Njeriu në jetën politike është përgjegjës në përmasa të jetës së tërë njerëzisë. Me të drejtë Gadameri pohon se sot të gjitha luftërat janë qytetare;

- Bashkëpërgjegjësia në jetën e sotme në politikë shtrihet në të gjithë njerëzit. Së këndejmi besojmë se edhe nga aspekti i konceptimit islam të moralit politik dhe moralit në politik, sot dhe këtu, në rend të

[17] Ebu'l-A'la El-Mewdudi, Nidham'ul-hajati fi'l-islam, Rijad, 1404 h./1984, fq. 35-46.

[18] Ali Pajaziti, Ese sociologjike, Shkup, 2003, fq. 16-17.

parë është me rëndësi të theksohet kërkesa e cila përbëhet në nevojën dhe apelin që të gjithë njerëzit të merren me politik, që të gjithë njerëzit të bëhen qytetarë politikanë. Kjo është porosia e fjalëve të Muhammedit a.s.:

"Kush nuk interesohet për çështjet e muslimanëve ai nuk është prej tyre."[19]

Ekziston edhe një moment interesant i moralit politik dhe moralit në politik që meriton theksim, e ai është ruajtja e diversitetit në proceset integruese. Përkundër tendencave ideologjike, ekonomike dhe politike të unifikimit të botës të ruhen veçantitë kulturore, qytetëruese, fetare dhe politike. Është i domosdoshëm mesazhi kur'anor:

"O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur e Allahu është shumë i dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë." *(El-Huxhurat, 13).*

Në aspekt të moralit politik është i paevitueshëm anticipimi islam, kur'anor i konceptit të shtetit botëror (profan). Islami nuk është kënaqur as me nocionin etnik as gjeografik të *populllit*, sepse Kur'ani këtë koncept nuk e bazon as në ngjyrën e lëkurës, as në ngjashmëritë e gjuhës dhe të atdheut, por në ngjashmëritë e mendimit, që do të thotë se në krijimin e Bashkësisë nuk është vendimtar *lindja*, që është e rastit, por zgjedhja, përcaktimi personal.[20]

Po ashtu, Kur'ani më shumë e respekton jetën *korrekte*, të drejtë se sa *prejardhjen fisnike*, më shumë respekton ngjashmërinë e *weltanschauungut* në *besim* se sa interesin *individual, familjar*, më shumë respekton përkushtimin *idesë* se sa *afërsisë dhe bashkëqytetarisë* e rastit:

"Nuhu e luti Zotin e vet, duke i thënë: 'O Zoti im, djali im është i familjes sime, e premtimi Yt është i saktë, ndërsa Ti je më i drejti i të drejtëve! Tha: 'O Nuh, ai (djali) nuk ishte nga familja jote, ai ishte

[19] "Men lem jehtemm bi emri'l-muslimin, fe lejse minhum". Ekzistojnë edhe versione tjera të këtij hadithi.

[20] Muhammed Hamidullah, Muhammed a. s., pjesa 2, Zagreb, 1997, fq. 138.

punëkeq, e ti mos më kërko Mua atë që nuk di, Unë të këshilloj që të mos bëhersh nga injorantët!". (Hud, 45-46).

"O ju që besuat, mos e tradhtoni Allahun dhe të dërguarin, e ashtu të tradhtroni amanetet tuaja, derisa e dini sa e keqe është kjo. Dhe, dine mirë se pasuria e juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm një sprovë, dhe se te Allahu është shpërblimi i madh". (El-Enfal, 27-28). (Ali Imran,103-104).[21]

Moment tjetër me rëndësi në jetën politike është në atë që politika, në këtë apo në atë mënyrë, është lufta për pushtet, fuqi. Politika merret me pushtet. Ajo synon ta praktikojë pushtetin. Politika merret me lirinë. Pushteti merret me sigurimin e lirive dhe të drejtave, por edhe me kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Etika islame kërkon qëndrim kritik ndaj pushtetit, kurse asnjë pushtet nuk dëshiron kritikën. Lojaliteti pushtetit dhe pushtetarit (që preferon edhe Imam El-Gazaliu[22]) me pretekst që të luftohet anarkia, shpesh në historinë islame është mbrojtur edhe ajo që nuk ka guxuar të mbrohet. Kjo ka ndikuar që në historinë islame të krijohet një botëkuptim devijant kundrejt moralit politik dhe kulturës morale.[23]

3. Morali seksual

Mbi seksualitetin si një prej dimensioneve bazore të jetës njerëzore në literaturën tonë bashkëkohore islame flitet rrallë, pakë dhe sipërfaqësisht. Por, edhe kur flitet, qëndrimi i folësit është negativ, sepse vazhdimisht flitet nga këndi çka nuk duhet të jetë e pranishme në seksualitetin islam, çka nuk lejohet në seksualitetin islam, çka gjykohet në seksualitetin islam, çka qortohet në seksualitetin islam e të tjera dhe nuk flitet nga këndi afirmativ i problemit. Ky qëndrim dominues shtron disa pyetje dhe disa dilema, sikur: a mund të flitet afirmativisht për seksualitetin në islam, dhe a kemi njerëz që këtë do ta bënin në

[21] Gjerësisht lexo: Muhammed Hamidullah, Muhammed a. s., pjesa 2, Zagreb, 1997, fq. 138-143.

[22] El-Gazali, Savjeti vlastima, Sarajevë, 1421 h./2001, fq. 37 etj.

[23] Dzevad Hodzic, Uvod u islamsku etiku, Sarajevë, 1999, fq. 143. Krhs.: Yusuf Al-Qaradawy, Introduction to Know Islam, Kairo, 1997, fq. 85-87.

mënyrën më të mirë, pa i thyer standardet tradicionale, por, nga ana tjetër të arrihet efekti te dëgjuesi e lexuesi në prezantimin e problemit. Përgjigja në pyetjen e parë është se në islam mund të flitet pozitivisht për seksualitetin, kurse në pyetjen e dytë mendoj se nuk kemi kuadro që këtë do ta bënin më së miri, si shkak i mosnjohjes kompetente të teorisë dhe praktikës islame – të Sunnetit.

Shkaqet për këtë gjendje janë të shumta, por ato duhet kërkuar kryesisht në dy rafshe:

- Arsyet dhe shkaqet mund të gjenden në mentalitetin e kultivuar me shekuj për turpin dhe intimitetin islam, për spontanitetin dhe shpirtëroritetin si momente me rëndësi në seksualitet; pastaj në dëshirën që seksualiteti islam mos të profanizohet e vullgarizohet me përditshmëri, por t'i ruajë dimensionet e kësaj bote, por edhe të asaj bote;

- Arsyet dhe shkaqet duhet kërkuar, u pajtuam në këtë çështje apo jo, edhe në ndikimin kristian që është bërë tek muslimanët gjatë shekujve dhe në koekzistim me ta, që seksualiteti të shihet si veprim që në esencë është i gabueshëm, i ulët, animal. Andaj, edhe rekomandimi islam që para aktit seksual të marrim abdest, të falim dy rekat namaz ose ta lusim Allahun po hasë në konfuzion dhe dilemë te muslimanët, se si mund të shkojnë së bashku këto dy kategori: seksi dhe lutja.

Në raportin e lutjes, namazit dhe të seksualitetit në islam mund të themi se këto kanë raporte të ngushta ndërmjet veti dhe këto raporte nuk janë armiqësore. Seksualiteti në burimet islame ka dimension të lartë, hyjnor, frymor. Në të vjen në shprehje principi dhe ligji universal mbi të cilat Zoti krijon dashurinë, tërheqshmërinë, mëshirën, unitetin, ekzistencën etj.[24]

Ja disa ajete kur'anore:

[24] Morali seksual islam rrënjësisht dallon nga morali i kishës kristiane, por edhe nga morali perëndimor i perceptuar kohëve të fundit. Islami nuk e pranon koncpetin e seksit të lirë, islami nuk mëson zbrapsjen e instinktit seksual, por mëson plotësimin e nevojave të tij në mënyrë të përgjegjshme. Islami nuk e konsideron as nuk e barazon seksin me mëkat apo si veprim të keq, islami nuk e konsideron martesën si të keqen më të vogël prej dy të këqijave, islami e refuzon kallugjerinë dhe celibatin, islamin martesën e konsideron si ndihmesë për ngritjen shpirtërore, e jo pengesë. Gjerësisht shih: www.muslimanskizivot.org/sex_moral_islama.htm.

"Natën e agjërimit u është lejuar afrimi te gratë tuaja, ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato. … " (El-Bekare, 187).

"Dhe Ne krijuam prej çdo sendi dy lloje (mashkull e femër) që ju të përkujtoni." *(Edh-Dharijat, 49).*

"Ai është Ai që ju krijoi prej një vete, e prej saj, krijoi palën e saj për t'u qetësuar pranë saj, kur e mbuloi ai *(mashkulli)* ***atë*** *(gruan),…" (El-A'raf, 189).*

"Dhe nga faktet e Tij është që për të mirën tuaj, Ai keijoi nga vetë lloji juaj palën *(gratë),* ***ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë."*** *(Err-Rrum, 21).*

Në islam "*seksualiteti është krijim dhe lindje. Ky është afirmim dhe komplementaritet. Rruga e përsosurisë kalon nëpërmjet qetësisë seksuale. Erosi e lidh sjelljen e tërësishme të njerëzisë, çdo etapë në përvojën njerëzore, çdo rafshë të realitetit dhe imagjinares … Erosi është ajo që dominon me tërë Univerzumin. Seksualiteti është diversitet në unitet… Misioni i shenjtë i seksualitetit është: rekomandimi i jetës, shumëzimi i ekzistencës. …."*[25]

Meqë në këtë botë seksualiteti esencialisht ka dimension shoqëror, ai në islam përcaktohet edhe si fushë e jetës morale të njeriut. Këta mund të përmblidhen në:

- Jeta seksuale është e lejuar vetëm në bashkësinë martesore, e rregulluar me kontratë valide bashkëshortore;

- Jeta seksuale në martesë është pjesë përbërëse e dashurisë reciproke të mashkullit dhe femrës;

- Në nevojat seksuale mashkuli dhe femra janë të barabartë;

- Jeta seksuale ka funksionin e lindjes, d.m.th. zgjatjen dhe shumëzimin e jetës;

- Jeta seksuale ka funksion legal edhe në kënaqësinë reciproke;

- Bashkëshortët janë të detyruar të ruajnë intimitetin e jetës së tyre seksuale;

[25] Abd al-Wahhab Bouhdiba, Seksualiteti në islam, Gjilan, 2001, fq. 12-13.

- Marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore karakterizohen si kurvëri, janë rreptësisht të ndaluara dhe në fe konsiderohen mëkat i rëndë;

- Qortohet çdo gjë që mund të çojë kah kurvëria;

- Janë të lejueshme vetëm marrëdhëniet seksuale ndërmjet gjinive të ndryshme (heterogjene);

- Homoseksualizmi dhe lezbeizmi është rreptësisht i ndaluar dhe kualifikohet si marrëdhënie seksuale kundërnatyrore;

- Ndalohen marrëdhëniet seksuale gjatë periudhës së menstruacioneve të femrës;

- Ndalohet çdo abuzim seksual, perversione seksual dhe pornografia.

Në botën aktuale, e cila gjendet nën dominimin agresiv profan, sekularist dhe vullgaro-liberal të qytetërimit modern perëndimor, dimensioni frymor dhe moral i seksualitetit radikalisht është rrezikuar. Për më tepër, seksualiteti dhe dashuria në erën e pozitivizmit është redukuar në 'kimi'. Seksualiteti është banalizuar dhe deerotizuar.

Një autor këtë e ka thënë si vijon: *"Heqja e tisit, lakuriqësia pakashumë e masovizuar, promiskuiteti seksual, përzieshmëria, plesi, bioskopi, erotizmi publik, prostituimi në rrugë publike, të gjitha këto ndërrojnë natyrën dhe domethënien e marrëdhënieve reciproke. Ndër palët bashkëshortore gjithnjë e më shumë hyn shkathtësia e teknologjisë, e cila fuqishëm e ndihmuar me magjinë e mediumeve publike, copëton atë harmoni esenciale pa të cilën dashuria shndërrohet në manipulim fizik, kurse erotizmi në pornografi."* [26]

Me çlirimin nga autoriteti, me luftën për lirinë individuale, me redukimin e seksualitetit në princip ekskluziv hedonistik, njeriu modern sot gjendet para humnerave: familjet e rrënuara, apatia e jetës seksuale, dhuna seksuale, zbrazëtira shpirtërore, kriminaliteti, sëmundjet, krizat shpirtërore dhe fizike të seksualitetit.

[26] Abd al-Wahhab Bouhdiba, Seksualiteti në islam, Gjilan, 2001, fq. 244. Krhs.: Ibrahim Amini, Etika bashkëshortore, Tetovë, 2000.

Në situatën aq kritike dhe moralisht aq të varfër të jetës dhe botës moderne vijnë në shprehje vlerat tradicioanale / religjioze morale dhe koncepti islam i jetës seksuale.

4. Morali medicinal

Medicina dhe praktika mjekësore paraqet fushë të veçantë në të cilën në mënyrë specifike ndeshemi me disa pyetje dhe me disa dilema morale. Meqë medicina me preventivën dhe mjekimin e sëmundjeve, përkatësisht me kurrimin dhe përparimin e shëndetit, më së drejtpërdrejti merret me jetën e njeriut; ajo vetëvetiu është veprimtari njerëzore e bazuar dhe e orientuar moralisht. Teoria dhe praktika medicinale në esencë janë manifestim të atyre përpjekjeve njerëzore që kanë vlerë dhe dëmethënie morale. T'i ndihmohet njeriut ta ruaj, ta përparojë dhe ta përmirësojë jetën dhe shëndetin e tij – ky është akt i pakontestueshëm moral. Në këtë aspekt flasim për etikën mjekësore me të gjitha aspektet morale të raporteve të shkencës së medicinës, praktikës medicinale, mjekëve dhe shoqërisë në përgjithësi kundrejt jetës, shëndetit, sëmundjeve, të sëmurëve, pacientëve, familjeve të tyre dhe të gjithë atyre që janë të implikuar me kategoritë e mësipërme.

Fakti se mendimi islam në periudhën klasike të historisë së saj ka arritur famë të lartë në medicinë ndoshta sikur në asnjë fushë tjetër flet edhe për synimet më burimore morale të frymës islame.[27] Mirëpo, me zhvillimin e shkencës moderne, të medicinës, të biogjenetikës dhe të teknologjisë vijmë në situatë të re, para dilemave të reja dhe para situatave delikate [28], të cilave duhet dhënë përgjigje. Ju përkujtojmë se pararendësit klasikë muslimanë qenë shumë të kujdeshëm në aspekt të trajtimit të trupit të njeriut.

Një ndër këto probleme është çështja e *eutanazisë* – vdekjes së mëshirshme, në të cilën shkenca mundëson që disa pacientë artificiali-

[27] Shih për aspektin teorik dhe praktik të medicinës së Pejgamberit a.s., për këshillat, rekomandimet dhe ndalesat: Ibn-Kajjim El-Dzevzi, Poslanikova medicina, Sarajevë, 1422 h./2001.

[28] Abdul Fadl Muhsin Ibrahim, Biomedicina - Islamski pogledi, Sarajevë, 2001/1422 h., fq. 5-40.

sht të mbahen në jetë, ndonëse jeta e tyre varet vetëm nga kyqja apo shkyqja e aparaturës. Nuk është e qartë cila është më morale: të mbahet në jetë pacienti në mënyrë artificiale apo pacienti t'i lihet fatit të tij, caktimit të tij. A guxojmë t'i absolutizojmë dhe gjeneralizojmë diagnozat apo parashikimet e mjekëve, kur kihet parasysh shpresa që duhet pasur deri në Caktimin e Zotit. Nuk lejohet të mbytet / vritet dikush me kërkesë të tij, me kërkesë të familjes së tij apo nga mëshira për të, qoftë nisma vjen nga mjekët apo nga familja e pacientit.[29] Për të gjetur përgjigje përkatëse në pyetje të ngjashme është me rëndësi të kemi parasysh se jeta, shëndeti dhe sëmundja janë nga Zoti dhe se njeriu nuk ka të drejtë autonome të vendosë mbi jetën e vet, sikur as për jetën e tjetrit. Po ashtu, duhet të kihet parasysh se nga pacienti nuk duhet çuar duart, por duhet dhënë maksimumin në mjekimin e tij.[30]

Në medicinën bashkëkohore dhe praktikën medicinale një çështje tjetër është me rëndësi të madhe, e ajo është raportet reciproke të mjekut, pacientit dhe të afërmëve të tyre. Shpesh pacienti gjendet në aso pozite shëndetësore ku ai vetë nuk mund të marrë vendime. Këtë duhet ta bëjë prindi i pacientit dhe kjo metodë quhet *paternaliste*. Në rastin tjetër këtë vendim duhet ta merrë vetë pacienti dhe ky vendim quhet *individualist*. Dhe në rastin e tretë, pacienti, familja dhe mjekët duhet të bashkëpunojnë në marrjen e vendimit, dhe kjo quhet *reciproke apo kolegiale*.[31] Kjo metodë nga aspekti islam do të ishte më e pranueshme, dhe atë:

- Vendimet që duhet marrë në fushë të medicinës kërkojnë njohjen e lamisë. Vetëm ekspertët e lamisë mund të marrim vendime të kualifikuara.

- Vendimet në rastet delikate nuk janë vetëm vendime medicinale, së këndejmi në marrjen e këtyre vendimeve duhet të marrë pjesë edhe

[29] Temës së *Eutanazisë* i kemi kushtuar një temë të veçantë në librin tonë në dorëshkrim "Islami dhe kriza e identitetit", që pritet të botohet në LOGOS-A, Shkup ose: www.zeriislam.com.

[30] Malik Badri, AIDS / SIDA i kriza modernog svijeta u svijetlu islama, Sarajevë, 1423 h./2002.

[31] Dzevad Hodzic, Uvod u islamsku etiku, Sarajevë, 1999, fq. 148-149. Abdul Fadl Muhsin Ibrahim, Biomedicina - Islamski pogledi, Sarajevë, 2001/1422 h., fq.37-38.

pacienti dhe në shumë raste edhe familja. Familja merrë pjesë në marrjen e vendimeve sidomos në rastet kur pacienti është i mitur.

Në etikën medicinale me rëndësi është edhe problemi vijues: a t'i kumtohet pacientit e vërteta rreth shëndetit të tij, veçan kur kemi të bëjmë me sëmundjet vdekjeprurëse, me sëmundjet e pashërueshme, me sëmundjet vështirë të shërueshme. Nëse vendoset t'i kumtohet, atëherë sa, si dhe në çfarë forme t'i kumtohet natyra e sëmundjes?!

Sipas etikës islame, pacienti ka të drejtë të dijë për sëmundjen e tij, për natyrën e sëmundjes, për intenzitetin e sëmundjes së tij, por kjo t'i thuhet në mënyrë të përshtatshme, qartë, miqësisht, me dhembje e jo brutalisht, ftohtë dhe vrazhdë, pikërisht në frymën e ajeteve kur'anore:

"Ata janë që për hirë të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hirë të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim." *(El-Insan, 8-9).*

Por, nëse ai nuk dëshiron të njoftohet, duhet respektuar dëshirën e tij. Pacientin nuk duhet ngarkuar me informata të panevojshme dhe nuk duhet biseduar me të me gjuhë medicinale.[32]

Ekzistojnë edhe shumë pyetje tjera që meritojnë përgjigje, sikur transplantimi i pjesëve të trupit, klonimi, aborti i embrionit e tjera.

Sot ekzistojnë dy tendenca: njëra lejon eksperimentimin me gjallesat tjera por edhe me njeriun, nëse kjo është në interes të rritjes së dijes dhe tjetra e cila përpiqet që tendecën ta kufizojë në vëllimin e eksperimentit shkencor dhe medicinal mbi njeriun me disa rregulla morale, siç është e drejta e njeriut të vendosë mbi trupin, organizmin dhe gjymtyrët e tij, e drejta në dinjitet, liri, privatësi etj. [33]

Është porosi e përgjithshme e etikës islame se dituria dhe teknologjia nuk bën të shfrytëzohen kundër njeriut, kundër natyrës së tij. Përkundrazi, qasje e drejtë çështjeve bashkëkohore nga domeni i me-

[32] Abdul Fadl Muhsin Ibrahim, Biomedicina - Islamski pogledi, Sarajevë, 2001/1422 h. fq. 37

[33] Shih: Valentin Pozaic, Moral u bioetici, Etika u islamu, Zbornik Radova III Simpozija Zagrebacke dzamije 1410/1990, Zagreb, 1991, fq. 205-214.

dicinës, ku nuk kemi argumente direkte nga burimet sheriatike, është studimi i këtyre çështjeve në frymë të sheriatit, të synimeve të tij, të parimeve të tij të përgjithshme. I tërë ky angazhim duhet të bëhet me qëllim që të fitojmë kënaqësinë e Tij, shpërblimin e Tij dhe të drohemi nga ndëshkimi i Tij.[34]

5. Morali ekologjik

Ekologjia është shkencë e cila më mënyrë interdisiplinare merret me hulumtimin e raporteve të njeriut por edhe të qenieve të tjera ndaj natyrës. Ndërgjegjja ekologjike e njeriut dhe ekologjia, në kuptimin figurativ, janë të pranishme në jetën e njeriut në këtë botë qysh nga fillimi i historisë.

Në *kulturat arkaike* njeriun e gjejmë në bashkëpunim të plotë me natyrën si një organizëm të madh;

Në *kulturat e larta* sjellja e njeriut ndaj natyrës sillet në bazë të diturisë dhe teknikës, që megjithatë i ngjasojnë natyrës;

Në *traditat shpirtërore lindore* natyra përjetohet në vertikalen metafizike të manifestimit hyjnor;

Në *qytetërimin modern* në mbështetje të bazave të shkencës moderne me teknikën që më nuk ngjason as në njeriun as në natyrën njeriu sillet në mënyrë rrënuese ndaj natyrës sikur ndaj objektit të thjeshtë.

Sot në botë kriza ekologjike konsiderohet si një prej problemeve më të mëdha para të cilës ndodhen njerëzia, natyra dhe jeta. Ndër karakteristikat më të rëndësishme të krizës ekologjike para së cilës gjendet njeriu është e natyrës planetare. Ajo i përket jetës së tërë njerëzisë dhe tërë planetës. Mirëpo, për kërcënimet e tmerrshme të krizës ekologjike di megjithatë numër i kufizuar njerëzish. Atë e shkaktojnë vendet më të fuqishme dhe më të pasura në botë. Shpesh njeriu i ballafaquar me seriozitetin e krizës ekologjike, vjen para dilemës se a ka fare rrugëdalje!

[34] Asim Kurjak, Eticki aspekti zivota i zdravlja nerodjenih, Etika u islamu, Zbornik Radova III Simpozija Zagrebacke dzamije 1410/1990, Zagreb, 1991, fq. 215-223.

Ka edhe asosh që thonë se paradigma ekonomike e shekullit XX do të zëvendësohet me paradigmën ekologjike në jetën ekologjike të shekullit XXI.

Burimet e krizës ekologjike janë të ndryshme, por ato para së gjithash duhet kërkuar në zhvillimin e diturisë moderne të privuar nga pyetja e kuptimit dhe vlerës. Në bazë të diturisë së këtillë të liruar nga përgjegjësia morale dhe nga ideali i urtësisë vjen deri te rritja e tmerrshme e fuqisë teknologjike të njeriut. Kjo fuqi pakontrollueshëm përplaset në naturë në shoqërinë industriale të konstituar në dituri, teknik dhe ekonominë kapitaliste.

Kalimi i racionalitetit perndimor nga dituria antike në atë moderne është përgatitur në mesjetë, në të cilën kontribut të madh ka dhënë Nikolla Kuzanski. Ai me sukses bëri përgatitjen e absolutizimit të subjektivitetit dekartezian. Me Dekartin fillon nënshtrimi i pamëshirshëm i natyrës si objekt bashkëkohësisë absolute të njeriut si subjekt. Kurse Vittorio Hoesle pohon se "çelësi për të kuptuarit e shkretërimit bashkëkohor të natyrës është mësimi kartezian mbi natyrën."[35]

Për etikën ekologjike islame me rëndësi të madhe është të kuptuarit islam të Natyrës. Kurse Natyra, sipas burimeve islame, është vend i veprimit të emrave dhe atributeve hyjnore. Natyra është libër i Zotit i hapur njeriut në mënyrë analitike. Në faqet e saj Zoti i shkruan shenjat (ajetet) e veta. Në traditën islame jeton mendimi mbi Natyrën si Kur'an që heshtë dhe mbi Kur'anin si Natyrë që fletë. Natyra është gjithnjë e gjallë. Ajo e lavdëron krijuesin e saj: ***"… po secili noton në një galaksion."*** (… we kul-lun fi felekin jesbehune, Jasin, 40).

Për etikën ekologjike islame është me rëndësi vitale fakti se në islam nuk ekziston ndarja në botën sakrale dhe profane. E tërë bora është e përshkuar me Shenjtëri.

Sipas mësimit islam njeriu është halif në tokë: *"Unë po krijoj në tokë një zëvendës"* (El-Bekareh, 30). Zoti ia ka nënshtruar çdo gjë që është në tokë dhe qiell: *"Dhe për ju nënshtroi natën dhe ditën dhe diellin dhe hënën. Edhe yjët janë të nënshtruar me urdhërin e Tij. …"*

[35] Sipas: Dzevad Hodzic, Uvod u islamsku etiku, Sarajevë, 1999, fq. 152.

(En-Nahl, 12). Kjo duhet të kuptohet si përgjegjësi e madhe e njeriut dhe që së bashku: natyra dhe njeriu ta falënderojnë Zotin. Njeriu nuk është zotëri i saj, por ruajtës dhe kultivues i saj.

Këto përgjegjësi, këto detyrime ndaj natyrës islami i rregullon me ligj, nëpërmjet fikhut detyrimet morale sanksionohen dhe bëhen të shenjta. Kjo nënkupton edhe angazhimin politik. Lufta politike për vetëdije ekologjike dhe politikë ekologjike legjitimizohet.

Nexhat Ibrahimi

CONTEMPORARY ISSUES OF ISLAMIC ETHICS

(Summary)

Every generation has certain responsibilities to which its fortune and misfortune, hope and despair, joy and misery, wealth and poverty, success and failure, is tied with. Life in the present days reminds us that we live in an era, in which tribal, regional, national, religious and other borders loose their meaning. World events preoccupy us more than ever. The explosion in the atomic power plant in Chernobyl in the end of the 20th century, the destruction of the twin towers in New York on September 11, 2001, the wars in Kosova and Bosnia, in Afghanistan, Iraq, Palestine etc. show that man at the beginning of the XXI century is faced with brutal egoism, a destructive civilization which knows how to kill people and to exploit nature.

Confronted with this situation, Islamic ethics gains importance in dealing with these problems.

القضية المعاصرة للخلق الاسلامى

(خلاصة البحث)

كل وقت و كل جيل له مسئوليته الذى يرتبط به مفتاح حظه أو سوء حظه امله او حزنه سعادته او تعاسته, ثروته او فقره, نجاحه او فشله. ان ظروف المعيشة فى الوقت الحالى تجعلنا نفهم باننا نعيش فى عصر العولمة التى ليس فيها اى معنى للحدود القبلية و القومية و الدنيية. نحن على علم باننا كبشر نحن على علاقات مستمرة بمشاكل كثيرة. الاحداث التى من حولنا تؤثر فينا كأفراد و جماعات. الكارثة التى حدثت بمحطة تشرنوبيل لتوليد القوة الذرية فى نهاية القرن العشرين و تدمير مبنى مركز التجارة العالمى بمدينة نيويورك فى ١١ سبتمبر ٢٠٠١, الحرب فى بوسنه و كوسوفا, ثم بعد ذلك الحرب فى افغانستان و العراق و فلسطين كلها تدل على أن الانسان فى بداية القرن الواحد و عشرين امام انانية شرسة و امام مدنية مدمرة تعرف كيف تقتل الانسان و تلوث و توسئ استخدام الطبيعة.

امام هذه التحديات الكبيرة الاخلاق الاسلامية تكسب اهمية قصوى فى كيفية تفادى هذه المشاكل.

KULTURË

Ajni Sinani & Mimoza Sinani

KULTURA DHE CIVILIZIMI

"Edhe para jush, kanë kaluar popuj e ligje, por ecni nëpër botë dhe vëreni, çfarë përfundimi kanë pasur përgënjeshtarët." *(Ali-Imran, 137)*

Pikërisht kur përhapja e Uesternizimit po merr përmasa gjithnjë e më të mëdha, qytetërimi islam po tërheq vëmendjen e një numri gjithnjë e më të madh njerëzish, të cilët po bëhen gjithnjë e më tepër të vetëdijshëm për natyrën e gjallë të traditës islame, si një fuqi kozmike dhe një forcë aktive, që vazhdon të veprojë edhe sot e kësaj dite në realitetin e kësaj bote, dhe për lidhjen e saj me problemet bashkëkohore.

Islami - edhe pse i goditur qenësisht prej krizave, dhe, edhe pse mendohej se u përkiste thesareve të qytetërimeve, që tashmë konsideroheshin si pellgje ezoterike dhe mistike të kulturave të vdekura, - nuk u varros, përkundrazi, ai po përjeton një rilindje dhe rigjallërim. Madje, krizat u paraqitën në shoqërinë industriale moderne.[1]

Pavarësisht nga përpjekjet për modernizimin në përmasa botërore të stilit jetësor perëndimor, në qytetërimin islam u shënua një zgjim dhe orientim drejt përkufizimit të vetvetes. Kjo shkaktoi dyshime serioze, se:

[1] Murad Hofmman, Islami si alternativë, Shkup, 2000, f. 18.

- ose ishte e gabuar formula e identifikimit të modernizimit me qytetërimin perëndimor, si model final;

- ose se ekzistojnë esenca të qytetërimeve që sigurojnë ruajtjen e vitalitetit të tyre.[2]

Lënda kulturore, me të cilën gjallojnë dhe rriten intelekti dhe bota emocionale e njeriut "perëndimor" (d.m.th. të hemisferës veriore), me të vërtetë është bërë tejet e njësuar. Mirëpo, frytet e përfitimeve, që janë pjekur falë kësaj arritjeje, me sa duket kërcënohen drejtpërdrejt nga një valë antiuniversaliste.[3]

Sot, revolucionet më të fuqishme të Botës së tretë, janë ato islamike, të Lindjes së Mesme. Ato drejtohen kundër Veriut dhe hedhin poshtë vlerat perëndimore, mbi të cilat mbështetet sistemi ndërkombëtar.[4]

Bota Islame, e cila në nëntor 1980 ka hyrë në shekullin XV, me të gjitha dimensionet e përvojave të veta, gjendet në vlugun e një transformimi shumë të gjerë.... Zgjimi islam, me anë të dinamikave të reja që solli me vete, është duke e detyruar Botën Islame të pësojë ndryshime.[5]

Në vend që të shihej dinamika e brendshme, që pellgun e qytetërimit islam e kahëzoi nga rigjallërimi, në plan të parë dolën përpjekjet për trajtimin e këtij zgjimi nga fokusi politik dhe strategjik. Kështu, studimet e orientalistëve, që kishin të bënin me burimet historike të një qytetërimi që konsiderohej i tejshkuar dhe i harruar, ia lëshuan vendin studimit të faqes politike të Islamit, që përfaqësonte rizgjimin kulturor të një qytetërimi të gjallë dhe dinamik.[6]

[2] Ahmet Davutogllu, Vetëperceptimet e qytetërimeve, Prishtinë, 2002, f. 15
[3] Gashpar Miklosh Tomash, Ferenc Feher – Agnesh Heler, Fiolozofia dhe tranzicioni, Ese të zgjedhura, Tiranë, (pa vit botimi) f. 223.
[4] Joshua S. Goldstein, Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Tiranë, 2003, f. 534
[5] Voll. J. O.Islam: Continuity and Change in the Modern World, Boulder Westieë, 1928, f, 347, sipas A. Davutogllu, Vetëperceptimet e Qytetërimeve, f. 20
[6] A. Davutogllu, po aty, f. 17.

Vitet e fundit, shumica e lëvizjeve radikale për ndryshim, kanë kërkuar më shumë të pohojnë vlerat të vjetra dhe të humbura, sesa të formulojnë vlera të reja.[7]

Historia nuk mund të kuptohet duke e përhapur në mënyrë abstrakte ndikimin e "sistemit qendror të vlerave". Ndërkaq, orvatjet për t`u imponuar teoritë perëndimore qytetërimeve të tjera, nxjerrin në pah nevojën e studimit të çdo qytetërimi, sipas parametrave të veta të vlerave.

Nëse është i vërtetë pohimi se, qytetërimet joperëndimore, në fillim të shekullit të njëzetë, po jepnin shpirt nën hegjemoninë e qytetërimit perëndimor, kurse nga fundi i shekullit njëzet përjetuan një gjallërim, atëherë lind pyetja themelore, në lidhje me elementin bazë, që e mundësuan rezistencën e këtyre qytetërimeve autentike: Cila është forca që, krahas globalizimit të qytetërimit perëndimor, ka vënë në lëvizje pellgjet e qytetërimeve joperëndimore?[8]

Para se t'u japim përgjigje këtyre pyetjeve, po bëjmë disa trajtime paraprake.

Dallimi ndërmjet Kulturës dhe Civilizimit

Civilizimet[9] e hershme lindën në luginat e lumenjve të mëdhenj të Lindjes së Mesme e të Largët.

[7] Laërence C. Mayer, Politikat Krahasuese. Kombet dhe teoritë në një botë që ndryshon, Tiranë, 2003, f. 453

[8] A. Davutogllu, po aty, f. 27

[9] Fjala 'civilizim', fillesën e saj e ka te fjala latine: 'civis, civilis'-qytetar. Edhe fjala 'urban', 'urbanizim, që përdoret në kontekstin e civilizimit, e ka burimin tek fjala latine 'urbs'- qytet, (shih Mikel Ndreca, Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, Prishtinë, 1986, f. 116 dhe f. 721), kurse në gjuhën arabe fjala 'hadare' – civilizim rrjedh nga fjala 'hadere', që do të thotë: të qenët prezent, të marrët pjesë, të ekzistuarit, të kultiviuarit e tokës nga popullata e përhershme, jetë (qytetare) me banim të vazhdueshëm, jetë e ngulitur, civilizim etj.
Fjala tjetër arabe 'medenije' rrjedh nga fjala 'medene', që do të thotë themeloj, muros, ndërtoj (qytete), nga e cila rrjedh edhe fjala 'el medine' – qyteti, (shih: Teufik Muftiç, Arapsko-Bosanski Rijeçnik, Sarajevë, 1997, f. 304 dhe f.1394).
Fjala arabe 'hadare'- 'civilizim' është e së njëjtës trajtë sikurse edhe fjala 'temeddun', që do të thotë "të kaluarit ose të organizuarit e jetës në 'medine'- qytet në kuptimin e

Civilizimet e para u shfaqën në procesin e organizimit të shoqërisë, me struktura të përcaktuara sociale, ekonomike, shpirtërore, politike dhe ushtarake. Ato shprehnin forma të organizuara, që përbënin një shndërrim tërësor të gjendjes së mëparshme.[10]

Ndër faktorët që ndikojnë në ngritjen e një civilizimi, pa dyshim janë jeta e qetë, begatia, siguria, besimi, kultura, dëshira për një jetë më të mirë materiale, ekonomike etj.[11]

Sipas Ibn Haldunit, ndërtimi dhe planifikimi i vendbanimeve është qëllimi i civilizimit tek shpie mirëqenia dhe bollëku.[12]

Që njerëzit të mund të kontribuojnë në ngritjen e civilizimit, kërkohet që ata të kenë energji dhe vullnet. Për t'u arritur kjo, kërkohet që njerëzit të kenë besim, besim ndaj shoqërisë në të cilën jeton njeriu, besim në filozofinë e saj, besim në ligjet e saj dhe besim në forcat e veta shpirtërore.[13]

Në shekullin XVIII, mendimtarët francezë, duke e trajtuar në një kuptim më të gjerë, civilizimin e përcaktuan si kundërshti ndaj konceptit të 'barbarizmit' dhe të ekzistencës së 'shoqërive' barbare. Për ta, shoqëria e civilizuar dallohej nga shoqëria barbare, ngaqë ishte e përqendruar, e urbanizuar[14] dhe e arsimuar. Në këtë përcaktim shfaqej dallimi ndërmjet 'të civilizuarve' dhe të 'pacivilizuarve'. Nga Franca, fjala 'civilizim' u përhap me shpejtësi anembanë Evropës.[15]

fjalës latine 'civis', ose greke 'polis', (sipas: Nerkez Smailagiç, Klasicna Kultura Islama, II, Zagreb, 1976, f. 255).

[10] Ilira N. Sulo & Llambro Filo, Ngritja dhe rënia e civilizimeve, Tiranë, 2002, f, 6.

[11] Ibn Halduni bën dallimin ndërmjet badawe-s', jetë (nomade) e thjeshtë, trimërore, e ashpër dhe e forcës së theksuar, dhe 'hadare-s', jetë e qytetërimit urban, në të cilën, ato cilësi, pushojnë gradualisht nga dëshira për qetësi, siguri, komoditet, luks dhe kënaqësi (shih: Nerkez Smailagiç, po aty, f.259).

[12] Daniel Buçan, Realistiçki Racionalizam Ibn Halduna, Ibn Haldun iz Mukkadime, Zagreb, 1976, f. 93.

[13] Kenneth Clark, Qytetërimi, Tiranë, (pa vit botimi), f. 27.

[14] Qëllim i shoqërisë nomade është plotësimi i nevojave elementare, ndërkaq shoqëria urbane, përveç këtyre nevojave natyrore dhe elementare, ka aspirata më të mëdha. që ajo të jetojë e organizuar. Pra, vetëm njerëzit që jetojnë në një shoqëri të organizuar, që banojnë dhe vendosen për një kohë të gjatë në një vend, që kanë një ndjenjë qëndrueshmërie, mund të mendojnë dhe të punojnë që atë vend t'ua përshtatin nevojave të tyre.

[15] Ilira N. Sulo, &Llambro Filo, Ngritja dhe rënia e civilizimeve, f. 6

Mbi këtë çështje janë kundërshtuar pikëpamjet e studiuesve gjermanë, që bënin dallime dhe veçonin 'kulturën' dhe 'civilizimin'.

Njerëzit, në pak çështje të tjera kanë bërë një rrëmujë aq të madhe nocionesh, si në çështjen e kulturës e të civilizimit.

Si kultura, ashtu dhe qytetërimi, nuk janë fenomene që ekzistojnë në natyrë para veprave të njeriut. Lindja dhe formimi i tyre nuk mund të trajtohen si rezultat i kapaciteteve të lindura të njeriut, apo si rezultat automatik i fantazisë gjenetike të tij. Pra, kultura dhe qytetërimi, nuk janë fenomene që njeriu i gjen të gatshme në natyrë ose në strukturën e vet biologjike. Njeriu, kulturën dhe qytetërimin, i formon në fushën e mundësive të veta, në sajë të preferimeve të tij.[16]

Antropologët dhe sociologët amerikanë e anglezë, termin "kulturë" e përdorin kur flasin për të gjitha shoqëritë, si shoqëritë primitive ashtu edhe të qytetëruara. Ata, duke mos bërë klasifikime, pohojnë se të gjitha shoqëritë e kanë kulturën e vet. Termin "qytetërim" e përdorin në lidhje me shoqëritë që janë ngritur në një nivel të caktuar, të cilat kanë kulturë të shkruar, të cilat kanë përparuar në fushë të shkencës, teknologjisë dhe sistemit të vet organizativ.

Të gjitha shoqëritë njerëzore, si ato "të civilizuara" ashtu edhe ato "primitive", kanë kulturën e vet dhe nuk ekziston bashkësi njerëzore pa kulturë.[17]

Në Gjermani, pas një pështjellimi të vazhdueshëm, iu dha përparësi kulturës ndaj civilizimit. Civilizimi, për studiuesit gjermanë, nuk është më shumë se masa e arritjeve teknike e praktike e mënyrave të veprimit me natyrën. Ndërkaq, kultura, sipas tyre, është e kundërta, është tërësia e parimeve, vlerave, idealeve, dijeve dhe shprehje e shpirtit.[18]

Shumë studiues civilizimit i japin një kuptim të dyfishtë në aspektin e vlerave, si të vlerave materiale ashtu edhe të atyre morale. Për disa të tjerë, civilizimi s'është tjetër veçse arritje dhe përparim i veprimit teknik e praktik mbi natyrën.

[16] Jillmaz Ozakpinar, Kultura dhe qytetërimi, Shkup, 2003, f. 9
[17] Jillmaz Ozakpinar, po aty, f. 37 & f. 50
[18] Ilira N. Sulo & Llambro Filo, po aty f. 8.

Sipas përkufizimit që bën Izetbegoviç, i cili përkrah mendimin e studiuesve gjermanë, kultura dhe civilizimi[19]kanë atë raport, sikur qiellorja dhe tokësorja, sikurse shpirti dhe trupi, ideja dhe materia. Në vazhdim do të sjellim përkufizimin dhe dallimin, që bën ai midis tyre:

Civilizimi është vazhdim i jetës zoologjike, njëdimensionale, këmbim i materies ndërmjet njeriut dhe natyrës. Ai është vazhdim i elementeve natyrore, mekanike, pra të pavetëdijshme e të pakuptimta të ekzistencës sonë. Aq sa ai, vetvetiu, s'është as i mirë as i keq. Njeriu detyrohet ta krijojë civilizimin sikur detyrohet të marrë frymë a ushqim.[20]

[19] Në këtë tabelë po japim dallimin që bën A. Izetbegoviç midis kulturës dhe civilizimit, në librin e tij "Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit", Shkup, 2000/1421, f. 72-75

Kultura	Civilizimi
Kultura është veprim i religjionit mbi njeriun, ose veprim i njeriut mbi vetveten.	Civilizimi është veprim i intelektit në natyrë, në botën e jashtme.
Kultura është "arti të jesh njeri".	Civilizimi është mjeshtëri për të funksionuar, për të prodhuar, për të drejtuar, për t'i përsosur sendet.
Kultura është " krijim i vazhdueshëm i vetes ", antiteza njeriu-sendi.	Civilizimi është ndryshim i pandërprerë i botës.
Kultura është ndjenjë e vazhdueshme e zgjedhjes, manifestim i lirisë njerëzore.	Civilizimi është vazhdim i zhvillimit teknik, e jo shpirtëror. Ai është shprehje e domosdoshmërisë sonë, e jolirisë sonë.

Kultura (këtu qëndron karakteri i saj religjioz) synon të zvogëlojë numrin e nevojave njerëzore, ose së paku, të zvogëlojë shkallën e përmbushjes së tyre, dhe në këtë mënyrë, të zmadhojë lirinë e brendshme të njeriut.	Civilizimi ka tendencë të intensifikojë këmbimin e materieve, ndërmjet njeriut dhe natyrës, të stimulojë jetesën e jashtme në dëm të së brendshmes. "Prodho të fitosh, fito të shpenzosh"- ky parim është në natyrën e civilizimit.
Bartës i kulturës është njeriu.	Bartëse e civilizimit është shoqëria.
Caku i kulturës është pushteti mbi veten, përmes edukimit.	Caku i civilizimit është pushteti mbi natyrën, përmes shkencës.
Kulturës i përket njeriu, filozofia, arti, poezia, morali, besimet.	Civilizimit i përket shteti, shkenca, qytetet, teknika.

[20] Alija Izetbegoviç, Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, f. 73.

Kultura[21]. - Besimet religjioze, drama, poezia, vallet, folklori, urtia popullore, mitologjia, kodekset morale e estetike të shoqërisë, elementet e jetës politike e juridike, që afirmojnë vlerën dhe lirinë e personalitetit, toleranca, filozofia, teatri, galeritë, muzetë, bibliotekat - ky është filli i pakëputur i kulturës njerëzore, akti i parë i së cilës u zhvillua "në qiell" ndërmjet Zotit dhe njeriut.[22]

Ndërkaq, disa kuptimin e përgjithshëm të civilizimit e japin si shprehje të tërësisë së faktorëve të ekzistencës dhe të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, në procesin e arritjeve progresive. Madje, ata civilizimin e trajtojnë edhe përmes karakteristikave të identitetit etnik, gjuhës së folur e të shkruar, zakoneve, mënyrës së sjelljes, mënyrës së jetesës, besimit fetar të popullsisë, vlerave krijuese ideale, kulturore e materiale etj.[23]

Pavarësisht nga ndarja mjaft interesante të bëra më lart, ne jemi përcaktuar për një ndarje tjetër, të bërë nga Ozakpinar, e cila do të jepet më poshtë.

Morris Dobre dhe Oswald Spengler mendojnë se kultura është struktura primare e shoqërisë njerëzore. Spengleri themeloi shkollën e tij të 'kulturalizmit' dhe besonte se jeta shoqërore varet drejtpërdrejt nga kultura.

[21] Fjala kulturë rrjedh nga fjala latine 'cultura', që do të thotë 'lërim dhe mbjellje e tokës'. Me këtë domethënie, kjo fjalë është përdorur në kohën e grekëve dhe romakëve. Ndërkaq, në kohën e Renesansës, me të, filluan të përfshiheshin krijimtaritë artistike dhe letrare. Fjala kulturë në gjuhën arabe përkthehet me fjalën thekafe ose me fjalën hadare. E njëjta gjë ndodh edhe me fjalën civilizim. Sociologët dhe antropologët arabë, fjalën kulturë e kanë përkthyer me fjalën hadare, kurse fjalën civilizim me fjalën medenije. Përkthimi i këtyre termave në gj. arabe shpeshherë shoqërohet me termat e përkthyer. Kur me fjalën thekafe ata e përkthejnë fjalën 'kulturë', atëherë në kllapa vendosin fjalën 'culture', ose, nëse me këtë fjalë nënkuptojnë 'civilizimin', atëherë në kllapa vendosin fjalën 'civilization'. Të njëjtën gjë e bëjnë edhe me fjalën hadare, (shih: Nasr Muhammed Arif, El-Hadaretu-Eth-Thekafetu-El –Medenijjeh, Riad, 1995/1415, f. 19). Me kalimin e kohës, fjala kulturë përfshiu krijimtarinë e gjithanshme në gjuhë, në art, në letërsi, në shkencë dhe në tërë jetën shpirtërore. (Shih: Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Prishtinë, 1981, f. 909).

[22] Alija Izetbegoviç, po aty, f. 73.

[23] Ilira N. Sulo & Llambro Filo, po aty, f. 7.

"Teza kryesore e Spenglerit është se çdo kulturë është organizëm specifik, i cili nuk ka kontakt me kulturat që i kanë paraprirë, ose që do të vijnë. Në fakt, sipas mendimit të tij, çdo kulturë ka mënyrën e saj vetjake specifike, të shikimit të gjërave, që është e paarritshme për njerëzit, të cilët i përkasin kulturës së dytë. Nga dëshira që ta dëshmojë këtë tezë, ai grumbullon një numër të madh faktesh dhe shpjegimesh, që të dëftojë se fryma e kulturës evropiane është krejtësisht antiklasike. Dhe kjo frymë antiklasike e kulturës evropiane i përket frymës plotësisht specifike të Evropës."[24]

Kur fjala 'kulturë' fitoi vlerën që meritonte, ajo u bë një element mjaft i ndjeshëm, dhe, për pasojë, u bë objekt i studimeve të shkencave sociologjike, saqë në qarqet akademike të shkencave të historisë, u krijuan dy degë të posaçme: antropologjia kulturore dhe historia e evolucionit kulturor.[25]

Aime Çezire beson se civilizimi nuk mund të monopolizohet, pra se ekziston vetëm një civilizim, i cili paraqet një mori investimesh dhe përvojash njerëzore, në periudha të ndryshme kohore. Ndërsa kultura, në anën tjetër, përmban karakteristika, me se dallohet një popull prej një populli tjetër. Kështu, Aime Çezire mendon se kultura është aspekti etnik i civilizimit, kurse civilizimi është aspekti i përgjithshëm i kulturës.[26]

Ndërkaq, Ozakpinar mendon se pretendimi që kultura është kombëtare kurse qytetërimi ndërkombëtar, është një çështje që kërkon kushtëzim. Qytetërimi është i përbashkët te kombet që ndajnë të njëjtin sistem të besimit dhe moralit.[27]

Kultura përmbledh manifestimet e vetëdijeve të ndryshme, siç janë: filozofike, letrare, artistike, religjioze etj. Këto kanë luajtur rolin zotërues në formimin e një kulture, edhe pse vetëvetëdija (self-consciousness apo self-awareness) më e fortë, çdoherë ka luajtur rolin zotërues në formimin e një kulture. Për shembull, në kulturën greke

[24] Muhammed Ikball, Obnova Vjerske Misli u Islamu, Sarajevë, 1979, f. 107.

[25] Dr.Ali Sheriati, Kultura dhe ideologjia, Tetovë, 1992, f. 113

[26] Ali Sheriati, Kultura dhe ideologjia, f. 116

[27] J. Ozakpinar, po aty, f. 64

zotëronte pikëpamja filozofike, në atë romake pikëpamja politike, në atë arabe (semite) ajo teozofike, në atë kineze ajo artistike, kurse në kohën tonë pikëpamja teknike i tejkalon të gjitha të tjerat.[28]

E theksojmë edhe një herë, se njerëzit, në pak çështje të tjera, kanë bërë një rrëmujë aq të madhe nocionesh, si në çështjen e kulturës e të civilizimit.

A është kultura vetëm shpirtërore apo mund të ndahet në kulturë lëndore dhe shpirtërore? Vallë, kultura shkakton qytetërimin, apo qytetërimi shkakton lindjen e kulturave me tipare të ndryshme? Nëse qytetërimi përbëhet më tepër nga elementet materiale, kurse kultura nga ato shpirtërore, si është e mundur që kultura të konsiderohet stil i përcjelljes së qytetërimit në një shoqëri?

Social-antropologët dhe sociologët e kohës aktuale, bëjnë dallim midis shoqërive që cilësohen "primitive", dhe atyre që cilësohen si përfaqësuese të një "qytetërimi" të caktuar. Kur hulumtohet materiali i historianëve, antropologëve dhe sociologëve, lidhur me qytetërimin, vërehen disa pika të përbashkëta:

1. Shteti i organizuar me kufij të caktuar;

2. Lindja e klasave shoqërore dhe e punëtorëve në sfera të ndryshme, si bujqësia, tregtia, zejtaria dhe prodhimi industrial;

3. Përdorimi i shkrimit, lindja e arteve të bukura dhe veprave ideore.

Radhitja e këtyre pikave[29], që i hasim në shkallë të ndryshme në çdo qytetërim, nuk e ndriçon çështjen e lindjes së qytetërimit. Kush ua

[28] Ali Sheriati, po aty, f. 128

[29] Këtë ka aluduar edhe Ibn Halduni në veprën e tij të famshme, Mukkadime, kur thotë: "Kur të popullohet më shumë qyteti dhe kur të rritet numri i banorëve, atëhere, me rritjen e punëve, rritet edhe numri i materialit dhe artizanateve… " Gjendja e jetës qytetare, sipas Ibn Haldunit, është e lidhur ngushtë me shkallën e prodhimit dhe ndarjes së punës. Sa më i madh dhe më i populluar të jetë qyteti, aq më shumë ka punë, manufaktura (prodhimi i tekstilit), mjeshtëri (zanate) dhe arte e çdo gjë që e bën qytetin më të zhvilluar dhe më të pasur. Kur, për shkak të pakësimit të numrit të popullatës, fillojnë të dobësohen këto aktivitete, fillon të bjerë edhe qyteti. Nga kjo shihet se Ibn Halduni, esencën e dallimit ndërmjet qytetit dhe fshatit e sheh në mënyrën e prodhimit, divergjencën e prodhimit, pasurinë e ndarjes së punës dhe çdo gjë që del si rezultat i gjithë kësaj, e jo vetëm në numrin e banorëve. (Shih: Daniel Buçan, Realistiçki racionalizam Ibn Halduna, Ibn Haldun iz Mukadimme, Zagreb, 1976, f. 97 dhe 142).

jep qytetërimeve identitetet e ndryshme? Cili është burimi i këtyre pikave të përbashkëta? Kjo është çështje e projeksionimit të filleve të procesit të lindjes së çdo qytetërimi me identitetin e vet specifik.[30]

Profesori autoritativ Jillmaz Ozakpinar ofron një teori të vetën origjinale, duke paraqitur një ndarje dhe përkufizim tepër të qartë e të kapshëm të kulturës e qytetërimit dhe shmang plotësisht konfuzionin e përkufizimeve dhe klasifikimeve të dhëna nga një numër i madh studiuesish perëndimorë.

Sipas J. Ozakpinarit 'Tek të gjitha qytetërimet ekziston një besim[31] dhe një sistem moral i lidhur me atë besim. Themeli shpirtëror i qytetërimit është besimi, kurse themeli shoqëror, sistemi moral i lidhur me atë besim. Ata njerëz që e ndiejnë vetëdijen dhe sigurinë e të qenit të bashkuar mbi këtë themel, duke krijuar organizimin shte-tëror dhe strukturën ekonomike që do ta jetësojë atë besim dhe sistem moral, krijojnë vepra të mëdha kulturore'.

Burim i qytetërimit është besimi, i cili është në nivel intelektual të së vetëdijshmes, abstraktes dhe racionales, që i mundëson njeriut t'i ndriçojë marrëdhëniet me natyrën, jetën e përtejetësoren dhe t'i ofrojë atij një sistem moralo-etik.

Pra, qytetërim quhet sistemi i besimit dhe moralit, i cili në kuadër të një kornize shpirtërore, gjeneron elementet kulturore.

Në themelin e qytetërimeve qëndron besimi, i cili në vetvete është një projeksion kognitiv-intelektual.

Qytetërimi është një sistem besimi dhe morali, që shkakton lindjen e veprave të kulturës, që ua cakton atyre qëllimin, drejtimin dhe karakteristikat. Veprat e kulturës reflektojnë sistemin e besimit dhe moralit të qytetërimit ku kanë lindur.[32]

[30] J. Ozakpinar, po aty, f.52-53

[31] Pa dyshim, rëndësia e besimit në ngritjen e civilizimit, është e pazëvendësueshme. Këtë fakt, e theksojnë të gjithë autorët islamë, duke theksuar se besimi, çfarëdo qoftë ai, është vendimtar për një civilizim. (Për këtë shih: Ebul Ala el Mewdudi, el Hadaretul Islamijeh, ususuha ve mebadiuha, Darul Hilafe, Aleksandri, f. 92).

[32] J. Ozakpinar, po aty, shih f. 54, f. 56, f. 58, f. 60

Nga momenti kur njerëzimi ka hedhur hapat në skenën e jetës dhe ka vendosur themelet e civilizimit, zëri i fesë ka arritur fuqishëm nga thellësitë e brendshme të tij.[33]

Qytetërimi është burim dhe përcaktues i kulturës. Qytetërimi e nxit kulturën të përparojë. Besimi, i cili nuk mund të krijojë qytetërim, kulturën e lë në gjendje primitive. Kualiteti krijues i një qytetërimi ka të bëjë me "drejtësinë dhe saktësinë" e besimit.

Sistemi i besimit dhe moralit, paraqesin shpirtin lindës të qytetërimit dhe, që ky qytetërim të jetësohet, ka nevojë për organizim politik dhe srukturim ekonomik. Pra, shtylla qendrore e qytetërimit është sistemi i besimit dhe moralit, kurse shtylla mbështetëse, - organizimi politik dhe strukturimi ekonomik. Kur fillon të lëkundet sistemi i besimit e i moralit dhe të humbasë kuptimin në shpirtin e individit, ndodh rrënimi i qytetërimit.[34] Çdo produkt njerëzor, qoftë me përmbajtje emocionale, qoftë me përmbajtje diturore, është kulturë.

Dallimi ndërmjet kulturës së një fisi primitv dhe kulturave në kuadër të qytetërimeve të vjetra mijëravjeçare, si ai i Mesopotamisë, Egjiptit, Indisë dhe Greqisë antike, është dallim mendor-intelektual, që manifestohet në faktin, se në kulturat primitive ekziston besimi, i cili shkakton reagim përplot ndjenja dhe emocione, kurse në kulturat civilizuese hasim besimin që ka arritur në projeksionin abstrakt dhe racional. [35]

Në kulturë, sikurse bëjnë pjesë gjërat që mund të perceptohen konkretisht e me strukturë materiale, po ashtu bëjnë pjesë edhe formacionet relativisht abstrakte. Një vepër arkitektonike religjioze, si një vepër kulturore, sado që e ka strukturën e vet materiale, prapëseprapë, para se të shndërrohet në një strukturë materiale, është një projeksion i mendjes së njeriut, një mendim abstrakt dhe imagjinativ, që paraqet realizimin material të një projeksioni mendor jashtë mendjes, në planin e përkapur. Përderisa edhe produktet teknologjike lindin nga pro-

[33].Sejjid Muxhteba Musavi Llari, Islami dhe Civilizimi Perëndimor, Gjilan, 2004, f. 83.
[34] J.Ozakpinar, po aty, f. 68-69
[35] J. Ozakpinar, po aty, f. 56

jeksionet e mendjes, vijmë në përfundimin se edhe ato, në esencë, ngërthejnë një dimension shpirtëror.

Produkti teknologjik, si një vepër kulturore, buron nga një kapacitet mendor, i cili, sipas kësaj, bart një kualitet shpirtëror. Ky produkt mund të përvetësohet, por kapaciteti teknologjik (që është kualitet mendor në rrafsh abstrakt, që lind në fund të një procesi të gjatë zhvillimi), nuk mund të përvetësohet. Për këtë arsye, ndarja formaliste e veprave kulturore në materiale dhe shpirtërore, është një ndarje që shkakton paqartësi dhe nuk e reflekton esencën e kulturës. Të gjitha veprat e kulturës në bazë janë shpirtërore, por në aspektin teorik mund të thuhet se disa prej tyre janë konkrete, e disa abstrakte.[36]

Historia e civilizimeve është edhe histori e huazimeve reciproke të vazhdueshme gjatë shekujve, ku secili civilizim ka ruajtur karakterin e vet origjinal.[37]

Ndërveprimet e civilizimeve janë në aspektin 'ndikues' e 'përftues' ndaj njëri-tjetrit dhe nga njëri-tjetri, pa zëvendësuar në mënyrë rrënjësore njërin apo tjetrin. Shumë nga këto veprime shpjegohen me 'teorinë e huazimeve'. Sipas kësaj teorie, civilizimet huazojnë nga njëri-tjetri, madje mund të asimilojnë aspekte të veçanta në mënyrë reciproke. Por, në përgjithësi, këto kanë ndodhur për të forcuar e garantuar paprekshmërinë e vlerave themelore, origjinale të tyre.[38]

Figurativisht, raportet midis qytetërimeve do të mund t'i paramendonim si rrathët e simbolit të lojërave olimpike, ku secili prej tyre paraqitet si tërësi në vete, por që i kanë segmentet e puqjeve mes tyre, pra të përvojave të përkthyeshme ose edhe të përbashkëta.[39]

Tërësia kulturore e një qytetërimi të vetëdijshëm dhe të sigurt në vetvete, mund të marrë dhe të homogjenizojë çdo element kulturor, për të cilin ka nevojë dhe e pëlqen, me kusht që ky element kulturor të mos e kundërshtojë sistemin përkatës të besimit dhe moralit.

[36] J. Ozakpinar, po aty, f. 61-63
[37] Ilira N. Sulo & Llambro Filo, po aty, f. 9
[38] Ilira N. Sulo & Llambro Filo, po aty, f. 28
[39] Dialogu mes Civilizimeve, Shkup, 2003, f. 75

Shkrirja e kulturave primitive ka të bëjë me mosekzistimin e një kornize të vetëdijshme dhe racionale, e cila do të siguronte rezistencën e tyre. Tronditja e qytetërimeve ka të bëjë me shoqërinë, e cila bëhet skeptike lidhur me vlerën e qytetërimit të vet.[40]

Kjo do të shprehej, me një thënie të bukur artistikisht, kështu: Shtylla e botës, që e mban qiellin për të mos rënë, është një shtyllë prej qelqi, që formohet nga bashkimi i stalagtiteve të urtisë qiellore, që zbresin nga lart, dhe i stalagmiteve të marrëzive tokësore, që ngjiten nga poshtë. Në çastin kur stupiditetet lartësohen aq shumë, saqë stalagtitet dhe stalagmitet bashkohen, kristali i qelqtë copëtohet dhe qielli rrënohet mbi botë, duke sjellë shkatërrimin e qytetërimit.

Pra, sistemi i besimit dhe i moralit, - kjo është esenca embrionale e formimit të çdo qytetërimi, dhe sa më i shëndetshëm e vital të jetë ai, aq më të mëdha janë mundësitë për jetëgjatësinë dhe ripërtëritjen e qytetërimit, që bazohet në atë sistem besimi dhe morali.

Përplasja e civilizimeve

Samuel P. Huntington publikoi tezat e veta rreth "luftës së kulturave": `Shkaku më i rëndësishëm për konflikt, shkruan ai, do të jetë i natyrës kulturore` ose më qartë "lufta e ardhshme botërore, nëse ndodh, do të jetë një luftë ndërmjet kulturave". Huntingtoni përmend shtatë a tetë kultura me versione të ndryshme, dy nga të cilat janë ajo islame dhe krishtere.[41]

Samuel Huntington, thesaret e qytetërimeve të tjera i vlerëson në një kategori të vetme, përballë Perëndimit, duke "prodhuar" teori të konfliktit.

Dallimet më të rëndësishme në botën pas Luftës së Ftohtë, - pohon S.Huntington - nuk janë ideologjike, po kulturore, që ekspozojnë veçanërisht identitetin, duke theksuar sidomos përkatësinë identike të lidhur me prejardhjen, me fenë, gjuhën, vlerat morale etike, zakonet,

[40] J. Ozakpinar, po aty, f. 66, f. 64

[41] Christian Hoffman, I shtrirë nga të gjitha anët, Tetovë, 2003, f. 126.

institucionet, historinë e jetuar, dhe që shoqërohen me përplasje, që marrin trajtën e përplasjeve të civilizimeve.[42]

Teza e Huntingtonit paraqet mënyrën e përcaktimit të politikës perëndimore, kundrejt botës, dhe kjo doli në shesh, në kohën kur Perëndimi filloi t'i mohojë qytetërimet.[43]

Ai luftën e trajton si kategori të amshueshme, që nuk ndërrohet, porse ndërrohen vetëm pretekstet që e nxisin atë. Tani, sipas tij, ka ardhur koha për pretekste të reja – ato qytetëruese, të bazuara në religjion. Ai religjionin e vë në funksion të përcaktuesit të identitetit të qytetërimeve[44], por nuk hamendet që në mënyrë implicite ta cilësojë edhe si shkaktar të konfliktit.[45]

Bota bashkëkohore është pluraliste, sa i përket religjionit. Islami vjen në fund të ciklit të shpalljeve, prandaj është edhe kthim në të vërtetën primordiale ademite, parësore, që ka ekzistuar gjithnjë në fillim të çdo shpalljeje. Për këtë arsye dimensionet ezoterike të Islamit janë të ruajtura më mirë sesa në religjionet e tjera.[46]

Islami nuk është një fe e re, e cila u shfaq me predikimin e Muhammedit (a.s.). Më saktë, Islami ka dy histori: ajo para dhe ajo pas Muhammedit (a.s.). Historia e Islamit, pas Muhammedit (a.s.) (historia e Islamit, në kuptimin e ngushtë), s'mund të kuptohet krejtësisht

[42] Ilira N. Sulo & Llambro Filo, po aty, f. 31.

[43] Dialogu mes civilizimeve, Shkup, f. 26

[44] Ne e përkrahim mendimin se religjioni është përcaktues i identitetit të qytetërimeve, por kurrsesi të jetë shkaktar i konfliktit. Mendimin tonë e bazojmë në bindjen e njërit prej dijetarëve më të shquar të plejadës së shkencëtarëve më të spikatur botërorë, Sejjid Husein Nasr, i cili ka shkruar me dhjetëra vepra dhe me qindra artikuj shkencorë. Sipas Nasrit, 'Çdo qytetërim është bazuar në idenë hyjnore. Nuk ka qytetërim që nuk është ndërtuar nga religjioni. Qytetërimi është një bashkim që reflekton parimet hyjnore. Mbi çdo qytetërim qëndron ideja, e cila nuk e bart historinë, por e përcakton atë. Dialogu mes civilizimeve, Shkup, (shih: S. H. Nasr f. 22 & f. 25).
Çdo religjion, që vjen nga Qielli, ka krijuar civilizimin e vet. Sot ekzistojnë një mori civilizimesh aktive, në të cilat e vërteta e religjionit reflektohet mu si religjion. Kështu, kemi civilizimin krishterë, civilizimin budist, civilizimin hinduist, etj. Edhe, manifestimet e ndryshme të civilizimit islam, janë të lidhura në mënyrë integrale me Islamin, si religjion. Sejid Husein Nasr, Islami tradicional dhe problemi i shkencës moderne, Gjilan, 1996, f. 16-17.

[45] Dialogu mes civilizimeve, S. H. Nasr, f. 35.

[46] Dialogu mes civilizimeve, shih S. H. Nasr, f. 28.

pa parahistorinë e Islamit dhe, veçanërisht, pa pjesën e fundit të saj, që përfshin periudhën e Judaizmit dhe të Krishterimit.[47]

Kur'ani vërteton unitetin transhendental të religjionit. Kjo është arsyeja që, gjatë gjithë historisë së njerëzimit, qytetërimet kanë bashkëjetuar, kanë përvetësuar dhe këmbyer vlera kulturore, nëpërmjet bashkëveprimit dhe integrimit me njëri-tjetrin. Historikisht, qytetërimet nuk janë përplasur, por kanë trashëguar njëri-tjetrin dhe kanë shërbyer si urë lidhjeje dhe afrimi midis popujve. Shkaku i përplasjeve dhe luftërave nuk kanë qenë asnjëherë kulturat dhe qytetërimet, por grupe dhe qarqe të caktuara politike e ushtarake revanshiste. Parimi i dialogut është themeli më i rëndësishëm i bashkëjetesës në botën pluraliste të religjioneve të ndryshme. Të gjitha civilizimet mbështeten në ide të përbashkëta: se ekziston diçka që quhet e vërtetë; se e vërteta e shpëton njerëzimin; se njeriu është i krijuar nga diçka që i tejkalon njerëzit; se ekzistojnë disa vlera, që nuk mund të ndryshohen dhe janë absolute; se ekzistojnë disa refleksione të caktuara të bukurisë dhe mirësisë, të cilat janë të pëhershme dhe burojnë jashtë kësaj bote.[48]

Poeti i madh Muhamed Ikball për Islamin shprehet:

Edhe pse dielli lind në lindje
Dhe dëfton trimërisht shkëlqimin e vet, pa tis,
Ai bëhet flakë e dritë nga zjarri i brendshëm vetëm kur
U ikën verigave të Lindjes e të Perëndimit;
I dehur nga shkëlqimi ai shfaqet në lindjen e vet
Që t'i pushtojë të gjitha horizontet;
Qenia e tij s'i përket as Lindjes, as Perëndimit,
Edhe pse nga lindja është.

Muhammed Ikball, Xhavid-Namë.

[47] Alija Izetbegoviq, Islami ndërmjet Lindjes e Perëndimit, f. 217.
[48] Dialogu mes civilizimeve, shih S.H.Nasr f. 28-29.

Kontributi i qytetërimit islam

Në vazhdim do të shohim kontributin e pamohueshëm të civilizimit islam (që ngërthen pazbërthyeshmërisht edhe kulturën islame) dhe ndikimin e tij në qytetërimin perëndimor, si dhe perspektivat që u afron e ardhmja këtyre dy civilizimeve, në bazë të sistemit të besimit dhe të moralit mbi të cilat ngrihen të dyja.

Por këtu duhet të përmendim se shpirti prometejan dhe titanesk, që tregohet aq qartë në pjesën më të madhe të artit të renesancës, qëndron diametralisht kundër shpirtit të Islamit, i cili mbështetet në përulje ndaj Zotit. Vërtet, shkenca dhe kultura islame qenë faktorë për ngritjen e renesancës në Perëndim, por elementet u shkëputën nga kuptimi dhe rëndësia e tyre e plotë.

Qytetërimet - hindus, kinez dhe japonez janë, të mbledhura në rajone të caktuara gjeografike dhe, në panoramën aktuale, zënë vend si sisteme të besimit e mënyra jetese, pa pretendime universale. Në panoramën aktuale, na bien në sy dy qytetërime që shënojnë ngritje: qytetërimi islam dhe ai perëndimor.[49]

Nëse lexon libra që përshkruajnë historinë e kombeve, lexuesi në historinë e kombeve perëndimore do të hasë përshkrime në detaje e me ngjyra të gjalla, sa kohë qëpër pjesët e tjera të botës do të gjejë vetëm një kundrim sipërfaqësor, duke iu nënshtruar kështu iluzionit se "e tërë bota është krijuar vetëm për Perëndimin dhe civilizimin e tij, ndërsa civilizimet e tjera kanë qenë të përcaktuara vetëm për të formuar një kornizë të përshtatshme për tërë atë famë perëndimore dhe, për pasojë, në shpirtin e popujve joevropianë, krijohet ndjenja e inferioritetit ndaj kulturës dhe mundësive të tyre personale."[50]

Evropianët kanë pohuar deri vonë se qytetërimi i sotëm ka lindur drejtpërdrejt nga qytetërimi i vjetër grek. Qytetërimi grek është më i vonshmi nga qytetërimet e lashta, si: kaldeas, asiras, midias, indas, egjiptas etj. Qytetërimi perëndimor, në mendjen e individëve të qytetërimeve të tjera, mbjell tezën se ai është qytetërimi i vetëm që rrethon

[49] J. Ozakpinar, po aty, f. 129.
[50] Muhammed Asad, Islami në udhëkryq, f. 73.

dhe përfshin edhe të kaluarën edhe të ardhmen. Kjo paradigmë, e përhapur me përmasa botërore edhe në librat shkollorë, bëri që qytetërimi perëndimor të admirohet si një e vërtetë absolute.[51]

Historiani i njohur Jacques Le Goff, midis të tjerash, shkruan: "Bota, në çdo epokë, ka vetëm një zemër në harmoni, me të cilën, jeton pjesa tjetër e universit. E ngritur mbi ekzogjezën orosiane të ëndrrës së Danielit, vazhdimësia e perandorive, nga babilonasit tek medeasit dhe tek persët, pastaj tek maqedonasit dhe pas tyre tek grekët dhe romakët, përbën parimin që udhëheq filozofinë mesjetare të historisë. Ajo, vepron në nivel të dyfishtë: në atë të forcës dhe në atë të qytetërimit. Mbartja e pushtetit, translatio imperii, është mbi të gjitha një mbartje e diturisë dhe e kulturës, translatio studii... Ajo theksson ngujimin e qytetërimit të krishterë, duke hedhur tej qytetërimet bashkëkohore, bizantine, muslimane, aziatike."[52]

Koncepti i historisë, që ka filluar me historinë greke dhe atë ariane, të cilat qytetërimi perëndimor i konsideron si rrënjë të veta, dhe që ka vazhduar me Romën dhe feudalizmin e që ka arritur në epokën moderne përmes Renesancës dhe Reformacionit, bëri që të gjithë librat e mendimit filozofik, ekonomik dhe politik, të shkruhen duke marrë për busull konceptin perëndimor. Në këtë mënyrë, individët e pellgjeve të qytetërimeve kineze, indiane dhe islame, vendosen brenda kornizave të konceptit perëndimor, me kushtëzimin se qytetërimet e tyre, nuk i kanë dhënë kurrfarë kontributi historisë së njerëzimit.[53]

Orientalistja e njohur gjermane, Zigrid Honke, në librin e saj të njohur `Dielli arab lind mbi Perëndim; me një objektivitet të thellë, tregon kontributin e jashtëzakonshëm të civilizimit islam. Kjo gjermane, pranon gjithashtu fshehjen e faktit, për rëndësinë dhe mundin civilizues të arabëve, nga ana e shkencëtarëve evropianë, duke thënë: "Megjithë rëndësinë dhe kontributin e arabëve, kush lexon njëqind libra historike, në nëntëdhjetë e tetë prej tyre nuk gjen të jetë përmendur ndonjë emër arab." Ajo gjithashtu shkruan: "Pika e shikimit të

[51] A.Davutogllu, po aty, f. 57.
[52] Jacques Le goff, Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar, Tiranë, 1997, f. 211
[53] A.Davutogllu, po aty, f. 57

shekujve të mesjetës ende nuk ka vdekur; edhe sot e kësaj dite ekzistojnë një grup njerëzish, me horizonte të kufizuara, larg nga toleranca fetare, i cili ndërton penda dhe pengesa përballë dritës"[54].

Është e papranueshme, që të pajtohemi me faktin se në periudhën 10-shekullore, në mes qytetërimit grek, që është më i vonshmi i atyre qytetërimeve të lashta, dhe qytetërimit të sotëm evropian, rruzulli tokësor të ketë mbetur i zhveshur dhe pa qytetërim. Përkundrazi, kjo periudhë ka qenë e stolisur me qytetërimin më të plotë dhe më të përsosur, që është QYTETËRIMI ISLAM.[55]

Qytetërimi islam është fryt dhe prodhim pikërisht i fesë islame, sepse ky qytetërim është paraqitur bashkë me paraqitjen e fesë islame. Ngado ka arritur feja islame, ka arritur edhe ai qytetërim; çdo popull që pranoi fenë islame, në gjirin e tij u fut edhe ai qytetërim.[56]

Islami ishte dhe mbeti një fuqi kozmike, që arriti ta nxjerrë botën nga errësira në dritë, sistem shoqëror që rregulloi të gjitha aspektet e jetës së njeriut dhe fuqinë e tij krijuese e orientoi nga të mirat dhe mirëqenia. Ai ishte dhe mbeti një forcë aktive, që vepron edhe sot, në realitetin e kësaj bote.[57]

Me shfaqjen e Islamit, nisën të viheshin themelet e një civilizimi të ri. Drita islame filloi të ndriçonte viset e ndryshme të botës. Filloi një jetë e re.[58]

John W. Draper thotë: 'Islami, gjatë gjithë kohës, pasoi shkencën fizike. Ndërkaq, krishterimi pagan, jo vetëm që e hodhi poshtë këtë shkencë, por shprehu përbuzje të thellë dhe urrejtje ndaj saj. Mjekët

[54] Prof.Hani el-Mubarek & Dr.Sheuki Ebu halil, Roli i Civilizimit Arabo- Islam në Renesansën Evropiane, Shkup, 1999, f. 24 & f. 26.
[55] Sami Frashëri, Qytetërimi Islam, Shkup, 2002, f. 26, 27.
[56] Sami Frashëri, po aty, f. 35.
[57] Muhammed Kutub, Sa jemi muslimanë, Shkup, 1999, f. 126.
[58] Me pranimin e Islamit, i cili fton që të besohet All-llahu, Krijuesi i qiejve dhe i tokës, që të punohet mirë dhe të shmanget e keqja, që të kërkohet dhe të merret dija, kudo që të gjendet dhe sado larg që të jetë, madje vargjet e para të shpallura në Kur'an bënin thirrje për dije, - gjithë këto bënë që shoqëria arabe, nga një shoqëri e paorganizuar dhe e përçarë, të bëhej pishtar që reflektonte dritë dhe dije në botë.(Shih: Dr.Mustafa esh Shukah, Mealimul Hadaretil Islamijeh, Darul Ilm, Bejrut, 1987, f. 38).

shiheshin, nga Kisha, me sy jo të mirë dhe njerëzit i konsideronin të pafe.'[59]

Muslimanët e parë, falë asaj fryme të hapur, për se thërret Kur'ani në çdo faqe të tij, janë përpjekur të përkthejnë, të përshtatin dhe të integrojnë kontributet më të vlefshme të Indisë, Bizantit, Greqisë, Iranit, prej matematikës e gjer tek mjekësia. Ata e dinin që thesarin shkencor, ta diskutonin me themel që t'i jepnin kuptim të ri, në perspektivë të fesë islame, dhe kështu muslimanët u bënë jo vetëm bartës të diturisë së vjetër të gjithmbarshme, por krijues të një kulture, e cila gjatë shumë shekujve u bë pishtar i tërë botës. [60]

Muhammed Ikball thotë: "Pika e parë e rëndësishme, që duhet pasur parasysh, në aspekt të frymës së kulturës islame, është që ai ka fiksuar, në aspektin e njohjes, shikimin e vet tek konkretja, përfundimtarja. Është e qartë, pos kësaj, se prejardhja e metodës së eksperimentimit dhe kundrimit, në Islam, nuk është borxh ndaj kompromisit me mendimin grek, por rezultat i luftës së gjatë intelektuale me të."[61]

Autori i veprës 'Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar', historiani i njohur Jacques Le Goff, jo për shkak të simpatisë, po për shkak të objektivitetit, veç të tjerash, shkruan: "Në kulmin e Kryqëzatave, shkenca arabe derdhet mbi Krishterimin dhe, nëse ajo nuk e shqetësoi, të paktën e ushqeu atë që ne e quajmë Rilindja e shekullit XII. Ajo që arabët u dhanë dijetarëve të krishterë, thënë të vërtetën, është para se gjithash shkenca greke, e grumbulluar në bibliotekat orientale dhe e vënë në qarkullim nga dijetarët muslimanë, të cilët e përhapën deri në skaj të Islamit perëndimor, në Spanjë (Andaluzi)".[62]

John Davenport, dijetar i shquar, thotë: 'Duhet të pranojmë se e tërë dija në fushën e fizikës, astronomisë, filozofisë, matematikës, që u përhap në Evropë, duke filluar nga shek. X, buron nga shkollat arabe.

[59] Robert L. Gulick, Jr. Muhammedi Edukator, f. 95.
[60] Rozhe Garodi, Gjallërimi Islamik, Gjakovë, 1991, f. 68
[61] Muhammed Ikball, Obnova Vjerske Misli u Islamu, f. 100.
[62] Jacques Le Goff, Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar, Tiranë, 1998, f. 181.

Madje, saracenët (muslimanët) e Spanjës, mund të konsiderohen si etër të filozofisë evropiane.'[63]

Bertrand Rasel, filozof i famshëm anglez, thotë: 'Fraza, shekujt e errët të Mesjetës, ndërmjet shek. 7-10, ka të bëjë vetëm me Evropën. Në atë kohë, prej Indisë deri në Spanjë, shkëlqente qytetërimi Islam. Prandaj, është pasaktë të flitet vetëm mbi qytetërimin e Evropës.'[64]

Sami Frashëri thotë: "Evropianët, pasi nuk kishin fare njohuri mbi qytetërimin e lashtë grek, vazhdonin të mësonin në shkollat e porsahapura të Andaluzisë. Bile aty, ata mësuan edhe emrat e dijetarëve të vjetër grekë, si dhe shumë vepra të tyre të humbura i morën nga përkthimet që gjendeshin në gjuhën arabe.[65]

Kurse, Asad, shprehet: "Para syve të verbuar të dijetarëve e mendimtarëve evropianë, u paraqit një civilizim tjetër- i rafinuar, progresiv, përplot jetë, pasionant dhe me posedim të pasurive kulturore, të cilat Evropa i kishte harruar prej kohësh. Ajo që bënë arabët, ishte më tepër se ringjallje e diturisë së lashtë greke. Ata kanë krijuar një botë plotësisht të re shkencore të tyre, vetjake, dhe hapën rrugët deri atëherë të panjohura të hulumtimit dhe të filozofisë."[66]

Klarku, profesori i historisë së artit, është i detyruar të pohojë, se:

"Teposhtëza e qytetërimit mund të ketë zgjatur shumë kohë, por nga mesi i shekullit të shtatë u shfaq një forcë e re, që kishte besim, energji dhe vullnet për të ngadhënjyer, si edhe një kulturë alternative - Islami. Fuqia e Islamit fshihej në thjeshtësinë e tij. Kisha e hershme e krishterë, e pat shkapërdarë fuqinë e vet, në zënkat dhe grindjet teologjike, që vazhduan për tre shekuj me një duf dhe me sajesa të pabesueshme. Por, Muhammedi a.s., profeti i Islamit, predikonte një doktrinë më të thjeshtë, e cila u pranua menjëherë dhe pasuesve të saj, u dha atë ndjenjë solidariteti të pathyeshëm, që u pat prirë dikur legjioneve romake. Brenda një kohe çuditërisht të shkurtër - rreth pesëdhjetë vjet

[63] Mevdudi, Të Kuptuarit e drejtë të Islamit, Shkup, 1994, f. 51.
[64] Dr. Fadlurrahman Ensar, Personaliteti dhe karakteri i Pejgamberit të Zotit, Takvimi, Prishtinë, 1993, f. 43.
[65] Sami Frashëri, Qytetërimi Islam, f. 37.
[66] Muhammed Asad, Islami në udhëkryq, f. 42.

– bota klasike, u nënshtrua. Vetëm eshtrat e saj të zbardhura, zbuloheshin në sfondin e qiellit mesdhetar."[67]

Këtë e thekson edhe Joshua S. Goldstein, kur thotë: "Kur Evropa ndodhej në 'periudhën e errësirës', qytetërimi arab (islam A.S.), ishte në periudhën e tij të artë. Ai thekson se 'Perandoria e madhe arabe e periudhës së viteve 600-1200 luajti një rol të veçantë. I gjithë rajoni i Lindjes së Mesme ka qenë i bashkuar nën këtë perandori, e cila lindi dhe u përhap së bashku me fenë islame.'[68]

M. Hofmman thotë: "Muslimanët arritën rezultate epokale në të gjitha fushat e artit dhe shkencës, duke inkuadruar matematikën, optikën, botanikën, kirurgjinë, oftalmologjinë, higjienën, leksikografinë, historinë, sociologjinë. Në këto dhe në lëmenj të tjerë, civilizimi islam, la në hije civilizimin perëndimor, prej shekullit të nëntë deri në shekullin katërmbëdhjetë. Në këtë kohë kemi personalitetet më të shquara të kohës, sikurse janë: Razi (Rhases), Biruni, Ibn Rushdi (Averroes), Ibn Sina (Avicena), Ibn Halduni, Ibn Batura, Havarizmi etj." [69]

Në të vërtetë, trashëgimia greke, e përzier me trashëgiminë arabo-islame, është ajo që arriti në Evropë dhe e ndihmoi atë të dilte prej injorancës së saj të errët të mesjetës, në atë që njihet si kohë e Renesancës.

Ekzistojnë me dhjetëra e dhjetëra libra të studiuesve të ndryshëm islamë, të cilët, venë në pah me argumente dhe fakte të pamohueshme, ndikimin e civilizimit islam, rrezet e para të të cilit filluan prej gadishullit Arabik dhe që, pas pak kohësh, "u shndërruan në diej që shndritën hapësira të gjera, nga pjesa lindore e rruzullit tokësor e deri në pjesën perëndimore, duke përfshirë popuj të civilizimeve të ndryshme, një civilizim ky, minaret e të cilit u ngritën mbi shkencë, filozofi, letërsi, art..."[70]

[67] Keneth Clark, po aty, f. 29.
[68] Joshua S. Goldstein, Marrëdheniet Ndërkombëtare, f. 39, 40.
[69] Murad Hofmman, Islami si alternativë, f. 15.
[70] Prof. Hani el- Mubarek & Dr.Sheuki Ebu Halil, Roli i Civilizimit Arabo – Islam në Renesansën Evropiane, f. 16.

4. Qytetërimi perëndimor dhe karakteri i tij monopolist

Qytetërimi perëndimor ngërthen në vete hipotezën: "Qytetërimi ka vetëm një rrjedhë – atë në të cilën jemi duke ecur ne – dhe, të tjerët ose janë të varur prej saj, ose janë të gjykuar të humbin në rërën e shkretëtirës."[71]

Përfundimi i Luftës së ftohtë, i konsideruar si triumf i Perëndimit, krijoi idenë e një bote tashmë unike, që ka pranuar vlerat dhe institucionet perëndimore të qeverisjes së demokracisë liberale dhe të ekonomisë së tregut. Siç është folur, gjatë viteve 1960, për "fundin e ideologjisë", u shpejtua të pohohet për "fundin e historisë", në kuptimin e fundit të evolucionit ideologjik të njerëzimit dhe të universalizimit të demokracisë liberale perëndimore, si forcë e vetme vendimtare e qeverisjes njerëzore.[72]

Arnold Toynbee, në veprën e tij "A Study of Histori" (Studim i Historisë), botuar më 1930, pohoi se nga njëzet e gjashtë qytetërimet me ndikim në historinë njerëzore, gjashtëmbëdhjetë prej tyre (ai egjiptian, i Andeve, kinez, minoa, sumeras, maja, indian, hitit, sirian, helen, babilonas, meksikan, arab, jukatanas, spartan dhe ai osman) kanë vdekur, kurse pjesa tjetër e qytetërimeve (qytetërimi kristian i Lindjes së Afërme, islam, kristian rus, hindu, kinez i Lindjes së Largët, japonez, polinezian, eskim dhe ai nomad), mundohen t'a ruajnë ekzistencën e vet, karshi kërcënimeve të qytetërimit perëndimor me shfarosje dhe asimilim.[73]

Ky klasifikim dhe konstatim, thekson mbisundimin e qytetërimit perëndimor dhe karakterin e tij monopolist, eliminues.

Janë tri pikëpamje, sipas Amaresë, që kanë ndikuar dhe kanë degraduar mendimin e civilizimit perëndimor, drejt idesë së përplasjes:

1. Hegelizmi, në filozofinë e historisë… e cila bazohet në faktin se koha bashkëkohore është kopjim i kohës së hershme, përmes përpla-

[71] Toynbee, A.J., A Study of History, Oxford Univerrrsity Press, New York, 1965, vëll.1, f. 55. Citimi është marrë prej: Ahmet Davutogllu, Vetëperceptimet e qytetërimeve, f. 10.
[72] Ilira N. Sulo & Llambro Filo, po aty, f. 29
[73] A. Davutogllu, po aty, f. 14

sjeve me komponentet e saj, duke i fshirë dhe duke zënë vendin e tyre.

2. Darvinizmi, në filozofinë e lindjes dhe të zhvillimit të specieve, e cila mbështetet në parimin e luftës për mbijetesë, ku organizmat më të dobët zhduken gradualisht dhe mbijetojnë më të fortët (sipas kësaj teorie, të drejtën për të mbijetuar e kanë më të fortët, e jo më të drejtët A.S.)

3. Lufta e klasave, qoftë në marksizëm-komunizëm, apo në liberalizmin perëndimor, sipas së cilës, filozofia e përplasjes mbështetet në lidhjet dhe raportet që kanë shtresat e ndryshme shoqërore. Sipas kësaj teorie, shtresa e re e lindur përplaset me shtresën e vjetër, që ta mposhtë, ta zhdukë dhe ta trashëgojë, duke i shfrytëzuar, e vetme, të gjitha frytet, favoret dhe pushtetet… borgjezia në liberalizëm, kurse proletariati tek marksistët.[74]

Janë këto tri teori, që kanë ndihmuar karakterizimin e identitetit pe-rëndimor, me këto nuanca të filozofisë së përplasjes, duke ndikuar në vdekjen e ndërgjegjes perëndimore, gjatë përplasjeve me civilizimet joperëndimore. Meqenëse ai është më i forti, është edhe më i dobishmi. Prandaj përplasja e tij kundër civilizimeve të dobëta, baza trashëguese e popujve të ngratë, është 'ligji shkencor' dhe 'misioni fisnik' që duhet ta bëjë njeriu i bardhë, sipas të cilit duhet të bëhet zhdukja e së kaluarës, trashëgimisë dhe institucioneve të dobëta e vendosja e shembullit civilizues perëndimor 'të fortë… më të fortë' në gjithë botën, nëpërmjet zbatimit të nduarnduarshëm 'të filozofisë së përplasjes'.[75]

Qytetërimi arian thuri bazat e një sistemi përjashtues. Kjo traditë antike përjashtuese, një koncept që përfaqëson përjashtimin kategorik të thesareve të tjera të qytetërimit, për shekuj me radhë, ka luajtur një rol të rëndësishëm në mendimin perëndimor, një përjashtueshmëri që bazohet në bindjen,se të gjitha virtytet njerëzore i takojnë vetëm një

[74] Muhammed Amare, el Hadarat el Alemije, tedafu-un, em sira-un, Kairo, 1998, f. 7.
[75] Muhammed Amare, po aty, f. 7.

qytetërimi dhe se ky 'qytetërim' i veçantë zotëron të drejtën absolute, për t'i përcaktuar kufijtë e njerëzimit, si dhe ardhmërinë.[76]

"Perëndimi, me gjithë vështirësitë, veten e konsideron si ofrues të modelit unikal, i domosdoshëm për të gjitha kombet e tjera. Ato kultura që nuk duan ta imitojnë, Perëndimi i kërcënon me margjinalizim. Kjo ishte porosia e njëmendtë e Francis Fukuyamas, një amerikan me origjinë japoneze, kur në vitin 1991, pas kolapsit të Bashkimit Sovjetik, proklamoi "Fundin e Historisë". Kjo nënkuptonte se i ashtuquajturi "projekt i modernizimit", i njohur si "mënyra amerikane e jetës", ose si "Mekdonalizim", është kulmi i civilizimit i pakapërcyeshëm për të gjitha kohët. Për njerëzit e tillë, bota e së ardhmes do të jetë e ndarë vetëm në Perëndimin e përparuar gjithnjë dhe në pjesën tjetër të botës.[77]

Shembull par exellance të një përjashtueshmërie të tillë të qytetërimit, kemi ndarjen kategorike të Huntingtonit West-Rest (Perëndimi dhe të tjerët) . Sipas këtij përjashtimi kategorik, 'të tjerët' paraqesin një variabël pasiv, 'Perëndimi' - një variabël absolut aktiv. Koncepti 'të tjerët' përfshin tërësinë e bashkësive, kombeve, feve dhe qytetërimeve të ndryshme. Domethënë, nuk është një përjashtim njëdimensional, po universal. Një përfytyrim i tillë përjashtues përgatit bazat e teorisë së shpëtimit, për të cilën Mathewsi[78] dhe amerikani me origjinë çifute, Huntington[79], kanë folur haptas, kurse Fukuyama[80] e prek në formë të aluzionit: Pellgjet e qytetërimeve të tjera duhet t'u japin fund përpjekjeve dhe pretendimeve për vazhdimësinë e qenies së vet dhe duhet t'u përshtaten parametrave bazë të qytetërimit perë-ndimor. Ky perceptim përjashtues universal, shihet edhe në tezën e Rudyard Kiplingut, 'të misionit të njeriut të bardhë', dhe të ndarjes kategorike 'Perëndimi dhe të tjerët', që paraqet kontinuitetin e mendësisë së Kiplingut dhe Huntingtonit.

[76] Shih A. Davutogllu, po aty, f. 37
[77] Ekmeledin Ihsanoglu, Zapad i Islam ka Dijalogu, Sarajevo, 2001, shih Ambasador Murad W. Hofmann, Muslimani izmedu Okcidenta i Orienta, f. 123.
[78] Young Islam on Trek: A Study in the Clash of Civilizations, Londër, 1926.
[79] The Clash of Civilizations and the Remaking of World Order, Simon and Schuster, New York, 1996.
[80] The End of History and the Last Man, The free Press, New York, 1992

As pushtimi antik arian, as ekspansioni imperialist, as globalizmi nuk i japin hapësirë sintezës qytetërimore ose pluralizmit. Përkundrazi, kemi një mentalitet, që i përjashton pellgjet autentike të qytetërimit, që është fryt i një qytetërimi monolist, hegjemonist dhe forcëcentrist, që bazohet në superioritetin e shoqërive që ndajnë ngjyrën, gjuhën, racën dhe qytetërimin e njëjtë.[81]

Historia njeh raste të qytetërimeve, ku ndryshimet e mënyrës së jetesës dhe mundësitë e formave kulturore për riprodhimin e vet, zhvilloheshin nën patronazhin politik të qytetërimit zotërues, duke u ngritur mbi të drejtat për koekzistencën krah për krahu dhe horizontale, të kulturave të ndryshme, dhe jo mbi rregullat e një stili jetësor hierarkik. Shembull i një qytetërimi të tillë është pellgu qytetërimor eklektik i formuar nën pushtetin politik të Lekës së Madh si dhe Qytetërimi Islam. Por, qytetërimi islam dallon nga ai i kohës së Lekës së Madh, sepse botëkuptimi i tij bazohet në një sistem besimi, me një konzistencë të brendshme të lartë, duke ruajtur fushën e jetës, ku thesaret e ndryshme kulturore të vendeve të ndryshme, të futura nën ombrellën politike, do të mund ta ripërtërinin vetveten." Këtë tipar integrues, internacionalizues, të qytetërimit islam, Toynbee e quan "Shteti islam universal". Si rrjedhojë e këtij tipari të qytetërimit islam, për herë të parë në histori, pellgjet e mbyllura të qytetërimeve i janë hapur njëritjetrit; 'globalizmi' i kohës së Aleksandrit të Madh, i ba-zuar në njohje të ndërsjellë afatshkurtër, u transformua në 'globalizëm' kompleks të bazuar në interaksion afatgjatë. [82]

"Pushtimet e Lekës së Madh, për herë të parë bashkuan të gjitha territoret e Mesdheut Lindor, në një fabrikë të përkryer politike. Për fat të keq, kjo fabrikë, me gjithë përparësinë e gjuhës dhe kulturës greke, pati një themel të pasigurt politik, dhe me vdekjen e Aleksandrit pësoi rënie të menjëhershme."[83]

Ndërkaq, Perandorisë Islame të halifëve, i janë dashur përafërsisht një mijë vjet të rrënimit të ngadalshëm. Mësimi religjioz i Kur`anit

[81] A. Davutogllu, po aty, f. 37-39
[82] A. Davutogllu, po aty, f. 42, f. 43
[83] Ferdinand Schevill, BALLKANI, Historia dhe Qytetërimi, Tiranë, 2002, f. 13

ishte ai që i jepte bazë solide dhe që përbënte hallkën e çeliktë, rreth asaj strukture madhështore shoqërore.[84]

Qytetërimi islam nuk bazohej në bindjen se një racë, fis ose grup social është e zgjedhur ose superiore, dhe u krijoi mundësi bashkësive të ndryshme fetare, që në kuadër të statutit të posaçëm juridik, të ripërtërinin stilin e tyre të jetës.[85]

"Të gjitha ato fise ballkanike, mbi të cilat ai (Bizanti) kishte sunduar e mbi të cilat tani mbretëronin sulltanët, ruajtën – falë ortodoksisë së tyre – përvojën e kulturës, të artit, së fundi të qytetërimit, që i detyroheshin Perandorisë greke. Politika e sulltanit, e zhdërvjellët dhe përgjithësisht zemërgjerë, e lejoi këtë mbijetesë duke u lënë të drejtën të praktikonin besimin fetar, në të cilin i kishte kthyer Bizanti, duke pranuar për ta një patriark, duke respektuar hierarkinë e kishës..."[86]

Brenda kufijve të qytetërimit islam kanë jetuar popuj të besimeve të ndryshme. Domosdoshmëria e koekzistencës i hapi rrugë lindjes së një atmosfere tolerance. Si ata që kishin pranuar Islamin, ashtu edhe grupet e besimeve të tjera, ruajtën kontinuitetin e qenies së vet. Pushteti nuk ndërhynte asnjëherë në ritualet fetare të qytetarëve jomuslimanë.

Në këtë periudhë, në prani të halifit Me'mun, zhvilloheshin debate fetare dhe filozofike, ku merrnin pjesë katolikët, adhuruesit e zjarrit, sabiinjtë dhe apologjetët islamë.[87]

Fryma kozmopolite mbizotëroi që në fillim të halifateve.Toleranca e zbatuar në to mundësonte harmoninë e ideve. Kështu, në Bagdad ishin të mirëpritura arritjet e shkencës dhe të filizofisë të Greqisë së lashtë e të Indisë. Në arabisht u përkthyen veprat e Aristotelit, Euklidit, Ptolemeut, Arkimedit etj. Kjo ndodhi në kohën kur në Evropë ishte shpërfillur së tepërmi zhvillimi i arsimit. Përkthimet e bëra, dhanë një ndihmesë shumë të madhe në ringjalljen e kulturës së Perëndimit. Ndërkaq muslimanët realizuan shumë vepra origjinale në shkencë. Pe-

[84] Muhammed Asad, Islami në udhëkryq, f. 37
[85] Shih A. Davutogllu, po aty, f. 43
[86] Ogyst Baji, Epopeja e një qytetërimi të magjishëm. Perandoria e Bizantit, Tiranë, (pa vit botimi) f. 275 & 276.
[87] A. Davutogllu, po aty, f. 45.

riudha midis viteve 900 e 1100, quhet “epoka e artë e dijeve muslimane”.

Në “Civilization Past & Present “ arrihet në përfundimin: “Arritjet e muslimanëve, në fushën intelektuale dhe artistike, mund t`u atribuohen jo vetëm arabëve, por edhe popujve të tjerë që e përqafuan Islamin. U përfitua shumë nga aftësia e Islamit për të absorbuar kulturat e tjera, si dhe prej gjenive të vetë popujve islamikë.”[88]

“Islami ishte një nga fetë më të efektshme në heqjen e pengesave të shkaktuara nga larmia e nacionaliteteve dhe racave. Feja e re mund të përqafohej nga popujt e ngjyrave e të kulturave të ndryshme. Pa dyshim, për shtrirjen e Islamit ndihmoi shumë tipari egalitar i tij.[89]

- vijon -

Ajni Sinani & Mimoza Sinani

CULTURE AND CIVILIZATION

(Summary)

“Indeed there have been examples before you; so travel in the earth and see what was the end of the deniers.” (Al Imran, 137)

As the spread of western civilization is gaining momentum, Islamic civilization is drawing the attention of more and more people, who are becoming aware of the lively nature of Islamic tradition, as a cosmic power and active force, which continues to affect the reality of this world.

Islam - despite of being hit by a crises and thought to belong to civilizations, which are now considered as pools of esoteric and mystic cultures, which are now extinct - did not die. On the contrary, it is experiencing a revival. Moreover, a crises is affecting modern industrial societies.

Alongside the efforts for the modernization of western lifestyle, in the Islamic civilization efforts for the definition of oneself are made

[88] Ilira N. Sulo & Llambro Filo, f. 141.
[89] Ilira N. Sulo & Llambro Filo, f. 145.

عيني سناني و مموزا سناني

الثقافة و الحضارة

(خلاصة البحث)

" قد خلت من قبلكم سنن فسيروا فى الارض فانظروا كيف كان عاقبة المكذبين" (٣ : ١٣٧)

انه فى الوقت الذى يتم فيه انتشار الثقافة الغربية بصورة سريعة, الحضارة الاسلامية تجذب انتباه عدد كبير من الناس و الذين يفهمون يوما بعد يوم المحتوى الانسانى و الحى لتلك الحضارة كقوة عالمية تستطيع ان تتفاعل تحت كل الظروف حتى يومنا هذا و بامكانها التغلب على جميع المشاكل فى الوقت الحاضر. بالرغم من ان الاسلام يواجه ازمات مختلفة نظرا لانه كان يحتوى على حضارات متنوعة و التى تنتمى الى ثقافات ميتة الا انه لم يدفن بل على العكس هو يعيش نهضة كبيرة والازمة انتقلت الى المجتمعات الصناعية المتحضرة.

PORTRETE

Abdullah Nasih Ulvan

SALAHUDIN EL-EJUBI
HERO I BETEJËS SË HITTINIT DHE ÇLIRUES I JERUSALEMIT NGA KRYQTARËT

FAMILJA DHE EDUKIMI I SALAHUDINIT

Prejardhja familjare

Salahudini rrjedh prej një familjeje fisnike që sundoi Egjiptin dhe Sirinë e Madhe (që përfshin Sirinë, Libanin dhe Palestinën e sotme). E gjithë kjo quhej Shteti Ejubij. Origjina e familjes rrjedh prej fisit më fisnik kurd, err-Rrawadia[1] nga Haziani, që ishte një prej fiseve më të mëdha kurde. Disa historianë vënë në dukje përmendin se prejardhja e Salahudinit është nga Mudari i Adnanit. Pa dyshim, ata kanë dashur të gjurmojnë prejardhjen e çdo karakteri të madh të arabëve. Sigurisht kjo nuk përputhet me metodologjinë e hulumtimit dhe me të vërtetën. Ata mendonin që virtytet dhe ndershmëria janë të kufizuara vetëm për arabët, dhe se joarabët nuk mund të krijonin kulturë apo lavdi.

[1] Ky fis jetoi në një fshat qw quhej Devin në Azerbajxhan, në të cilin lindi Ejub ibn Shadhi, babai i Salahudinit.

Nëse lexojmë historinë dhe hulumtojmë personalitetet tona të mëdha, do të kuptojmë se shumica e atyre që luajtën një rol të madh në themelimin e kulturës dhe civilizimit, kanë qenë joarabë. Por duke u dhënë të gjithëve karaktere arabe, historianët e tillë kanë nxitur fanatizmin e padrejtë dhe diskriminim, që nuk janë të lejuara sipas parimeve islame. All-llahu xh.sh. thotë:

"S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër…". *(el-Huxhurat: 10)*

"…s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur *(nga të këqijat)****…"*** *(el-Huxhurat, 13)*

Cilit mesazh, pas këtij, do t'i besoni?

Salahudini është biri i kurdit Nexhmudin Ejub ibn Shadhi ibn Mervan. Do të flasim për jetën e hershme të familjes së tij dhe veprat më të rëndësishme të saj.

Lindja

Sulltan Jusuf Salahudin kishte lindur më 532 sipas hixhretit (1137) në kështjellën e një fshati antik të quajtur Tikrit afër Bagdadit. Mbretërit persianë kishin ndërtuar kështjellën mbi lumin Tigër shumë kohë para së të bëhej deponi e municionit dhe të shërbente si postë mbikëqyrëse. Muslimanët e pushtuan Tikritin në vitin 16 sipas hixhretit, gjatë sundimit të halifes Umer ibn Hattab.[2]

Pastaj ai ra nën sundimin e udhëheqësve të ndryshëm muslimanë. Kur selxhukët turq erdhën në fuqi, Nexhmud-din Ejub ibn Shadhi, babai i Salahudinit, takoi figurën kryesore në policinë selxhuke në Bagdad, që quhej Muxhahid-din Bahruz. Ai e caktoi Ejubin si komandant të kështjellës së Tikritit, së bashku me vëllanë e tij Shirkuh Eseduddin si ndihmës. Kështu të dy vëllezërit u shpërngulën prej fshatit Devin të Azerbajxhanit në Irak. Ata ishin prej fisit Ravadian dhe erdhën në Tikrit që të punonin në policinë e Bahruzit.

Çuditërisht, Salahudini lindi në kohën kur Muxhahid-din Bahruz dëboi Nexhmud-din Ejubin dhe vëllanë e tij Shirkuh, sepse ky i fundit

[2] Muxhem el-Buldan, vëll. 2, fq. 491

kishte vrarë njërin prej rojave të kështjellës, pasi ai e kishte akuzuar një grua si të shthurur. Shirkuh e vrau atë në momentin kur gruaja kërkoi ndihmën e tij. Në fillim, Muxhahidi ishte në dyshim nëse t'i dëbonte apo t'i lejonte të qëndronin aty. Pastaj, vendosi t'i dëbonte duke u frikësuar se familja e rojës do të hakmerrej. Ai u tregoi për frikën që kishte dhe i kështilloi të largoheshin natën. Ata morën familjet e tyre dhe të porsalindurin Jusuf Salahudin dhe u nisën për në Mosul.

Ibn Halikan në librin e tij "Wefejat el-A'jan" thekson se Ejubi u bë aq pesimist për të porsalindurin, duke besuar se fatkeqësia ishte paralajmëruar në të qarët e tij qysh në nisje, saqë mendoi ta vriste. Por dikush e paralajmëroi: "Zotëri, mos u bëj pesimist për të porsalindurin, pasi ai nuk di asgjë. Ky është caktim hyjnor. Ku e di, ndoshta ai do të jetë një mbret i famshëm dhe një figurë e madhe në të ardhmen? Kështu, kujdesu për të, sepse ai nuk e kupton pesimizmin tënd". Këto fjalë patën ndikim tek Ejubi, dhe më vonë i erdhi arsyeja dhe mori rrugën e drejtë të Islamit.

Rinia e hershme

Ejubi dhe Shirkuh u shpërngulën nga Bagdadi në Mosul dhe shkuan te Imadud-din Zanki, sundues i Mosulit. Ai i mirëpriti dhe u dha dhurata, sepse ata e kishin shpëtuar nga vrasja a rënia rob i luftës derisa ai ishte duke luftuar kundër selxhukëve, në kohën kur Bahruzi ishte sundues i Bagdadit. Më herët e përmendëm se Ejubi dhe vëllai i tij ishin caktuar komandantë të Tikritit dhe kështjellës së tij. Kur Imadudin Zanki ishte mundur nga sunduesi selxhuk, ishte tërhequr me trupat e tij dhe kishte kaluar përmes Tikritit. Kështu kishte rënë në duart e Nexhmud-dinit. Nexhmud-dini kishte dy mundësi: ta vraste ose ta burgoste. Megjithatë, ai e liroi dhe e ndihmoi të shkonte në Mosul. Dhe Imad-dudini nuk ia harroi këtë të mirë.

Kur të dy vëllezërit arritën në Mosul, siç e përmendëm më lart, atyre bujarisht u dhanë tokë që të jetonin.

Familja jetoi mirë nën kujdesin e Imadud-dinit. Gjithashtu ai i caktoi dy vëllezërit si komandantë të ushtrisë. Kur Imadud-dini pushtoi

Ba'lebekun (534 hixhrij), Nexhmud-dinin e caktoi si sundues të tij. Ky emërim dëshmoi sigurinë dhe besimin e Imadud-dinit në Nexhmud-dinin.

Salahudini kaloi një pjesë të fëmijërisë së tij në Ba'labek, ku jetoi ditët më të lumtura të jetës. Mësoi kalorësinë, ushtroi për luftë e xhihad, dhe praktikoi politikën dhe administrimin. Poeti thotë:

Fëmijët janë edukuar sipas mënyrave
të edukimit që babai i mësonte të ndiqte.

Pasi që djali i Imadud-dinit, Nurud-dini, pushtoi Damaskun më 1154 miladi, Salahudini kaloi një pjesë të jetës së tij në Damask, ku trimëria dhe fuqia e tij ishin të përsosura. Ai gëzonte një pozitë dhe respekt të lartë tek djali i sunduesit të Damaskut. U bë i njohur për qetësinë, sjelljen dhe devotshmërinë e tij. Gjithashtu digjej nga zelli për Islamin dhe muslimanët.

Në kohën e Nurud-dinit u caktua si komandant i policisë së Damaskut. Ia doli me sukses ta kryente detyrën e re, duke e pastruar Damaskun nga kriminelët e plaçkitësit, dhe aty krijoi një stabilitet dhe siguri. Njerëzit jetuan në siguri e qetësi gjatë administrimit të tij. Hasan ibn Numejr, i njohur me nofkën Arkala, gëzohej për shërbimin dhe suksesin e Jusuf Salahud-dinit, ashtu siç ka thënë në poemë:

O robërit e Sirisë, mendoni kohën tuaj,
pastaj do t'ju këshilloj me fjalët e mia.
Jusufi ka ardhur tek ju, emri i të cilit
është si emri i profetit Jusuf, i mprehtë dhe i pashëm.
Ai ishte që priste duart e grave dhe ky është
që ua pren duart plaçkitësve.

Koha që e kaloi në Egjipt ishte më e rëndësishmja në formimin e përvojës së tij heroike dhe ushtarake. Shavir es-Sa'di u ngrit kundër halifit fatimi el-Adid në Kajro më 558 hixhrij, dhe kërkoi ndihmë në Damask nga Nurud-din Mahmud. Ai pranoi ta ndihmonte. I siguroi një ushtri të udhëhequr nga Asadud-din Shirku, i cili e mori edhe nipin e tij Salahudinin - me vete. Salahudini tregoi shkathtësi të mëdha dhe aftësi ushtarake në artet e luftës dhe për pasojë, ata triumfuan kundër armiqve dhe i bashkuan Egjiptin mbretërisë së Nurud-din Mah-

mudit më 564 hixhrij. Kjo do të sqarohet në detaje në kapitullin pasues.

Me pak fjalë, në jetën e hershme të tij dhe në dekadat e dytë e të tretë të rinisë së tij, Salahudini ishte edukuar me virtyte të mira dhe cilësi fisnike. Ai tregoi shkathtësi ushtarake, zakone të rrënjosura thellë, zell islam dhe guxim letrar e financiar në marrëdhëniet me mbretërit dhe princat. Kjo formoi unitetin e tij, karakterin e shkëlqyer që ndërroi drejtimin e historisë.

Edukimi

Më lart e përmendëm se Salahud-dini kaloi pjesën e jetës së tij të hershme në Ba'labek. Natyrisht, edukimi i tij bëhej prej një vendi në një vend tjetër. Mësoi të lexonte e të shkruante, mësoi përmendsh Kur'anin dhe rregullat e gjuhës arabe ashtu siç mësonin fëmijët e fisnikëve muslimanë.

Autori i *"Tabakat esh-Shaf'ije" thekson* se Salahud-dini mësoi hadithin prej el-Hafish es-Selefi, ibn Avf, en-Naisaburi dhe Abdullah ibn Berrit. Ai ishte avokat, recitues i Kur'anit dhe një poet entuziast.

Historianët pajtohen që shumica e dijetarëve vinin prej Lindjes dhe Perëndimit, prej Samerkandit dhe Kordovës, që të mësonin në xhamitë dhe shkollat e Damaskut. Sigurisht, Salahud-dini mësoi prej shumicës së tyre, veçanërisht prej Abdullah ibn ebi Asrunit, që ligjëronte në Xhaminë e Umevinjve. Atë e kishte sjellë Nurud-dini, i cili ndërtoi shkolla në Damask dhe në shumicën e qyteteve të Sirisë[3], që të mësonin njerëzit dhe të përhapej dituria. Ebi Asruni arriti pozitë të lartë sa u bë kryegjykatës i Damaskut. Salahud-dini e respektonte këtë dijetar dhe kujdesej për të, veçanërisht kur ky e humbi të parët.

Salahud-dini ishte shumë i shkathët në kalërim, hedhje të shtizës, gjueti dhe artet ushtarake, sepse ambienti në të cilin jetoi, shquhej në këto fusha. Për këtë arsye ai arriti përvojë dhe mund të udhëhiqte

[3] Kudo në libër, Siria dhe Siria e Madhe i referohen hapësirës që sot përfshin Libanin, Palestinën, Jordanin dhe Sirinë. Në atë kohë njihej si Sham, por Shami sot nënkupton vetëm Damaskun.

ushtarë e të zgjidhte me mençuri probleme në luftëra. Përveç kësaj, ai i kishte karakteristikat themelore që të bëhej një luftëtar i madh: talentin, intelegjencën, trashëgimin, ambientin, përgatitjen dhe edukimin. Është rrallë të gjenden karakteristika të tilla tek një person.

Karakteristikat e tjera që e bënin këtë personalitet të madh, ishin zemra e tij e patundur dhe mendja e tij e qetë kur të tjerët humbnin zemrën dhe arsyen. Për shembull, gjatë pushtimit të Sirisë, i ishte treguar se vëllai i tij Taxhmuluk kishte vdekur; pastaj mësoi për vdekjen e vëllait të tij el-Melik el-Muzafar pas disfatës së Akrës. Ky i fundit ishte një prej inxhinierëve më të mirë për fortifikimin, mbrojtjen dhe organizimin e kështjellës. Mirëpo, lajmet e këqija nuk ndikonin tek ai në beteja.

Me pak fjalë, nga shikimi i shpejtë që i bëmë jetës së hershme të Salahud-dinit, kuptojmë se ai ishte një burrështet i shkathët, një udhëheqës me përvojë, një luftëtar i ushtruar dhe një dijetar i zgjuar. Kjo ishte sikur fati që kërkonte një hero në betejën e Hitinit, i cili, duke goditur tmerrësisht zemrat e kryqtarëve, do të bëhej i njohur në Lindje e në Perëndim, të jetë shembull i mirë për gjeneratat e ardhshme, dhe të shënohej në mesin e personaliteteve të mëdha në histori. Është e pamundshme për nënat të lindin dikë si Salahud-dini, me zellin dhe trimërinë e tij, për mbrojtjen e Islamit dhe të vendeve të Profetëve. Poeti thotë:

Këta ishin baballarët e mi të mirë, pastaj më sjell
baballarë si ata
Kur ne. O Xherir, jemi mbledhur përsëri në takim.

FILLIMI I SUNDIMIT TË SALAHUD-DINIT

Egjipti gjatë sundimit të Fatiminjve

Para shfaqjes së Salahudinit, Egjipti ishte shkatërruar nga kryengritjet dhe luftërat e brendshme në mes grupeve të ndryshme të memlukëve, turqve, sudanezëve dhe marokenëve.[4] Vdekjet nga mungesa e ushqimit dhe epidemitë e ndryshme ishin shumë dhe dobësuan fuqinë e njerëzve. Bëheshin komplote ndaj vezirëve dhe halifëve në mënyra të ndryshme.

Halifi fatimi kishte humbur fuqinë që të kontrollonte vendin. Fuqia ishte në duart e ndonjërit prej ministrave a të ndonjë komandanti fitues. U bënë shumë masakra dhe beteja për shkak të grindjeve që ekzistonin brenda ministrave në halifatin Fatimi. Stabiliteti ishte arritur kur Tala'i ibn Ruzik fitoi postin e ministrit më 549 hixhri. Kaosi shpërtheu përsëri pas vrasjes së tij dhe djali i tij, Ruzik ibn Tala'i e mori pushtetin më 558 hixhri.

Që të dy: Nurud-dini dhe Mbreti kryqtar, Almariku i Jerusalemit (i njohur në gjuhën arabe si el-Amuri) i kushtonin një vëmendje të veçantë Egjiptit. Secili mundohej ta pushtonte atë në mënyrë që të rriste fuqinë dhe mbretërinë e vet, por frikësoheshin prej njëri-tjetrit. Konfliktet e brendshme që ekzistonin mes ministrave të Egjiptit, u bë shkak për ndërhyrjen e të dyve - Nurud-dinit dhe Almarikut në policinë egjiptiane.

[4] Memlukët ishin robër të bardhë që ishin zënë në luftëra të ndryshme apo ishin blerë në tregjet e robërve në Azinë e Vogël, Persi, Azinë Qendrore, dhe ndonjë vend tjetër. Kryesisht përgatiteshin si luftëtarë dhe nuk përziheshin me njerëz të zakonshëm, por ruanin karakteristikat e tyre.

Kryengritja e Shavir as'Sa'dit

Në kohën kur Ruzik ibn Tala'i ishte ministër në halifatin Fatimi, Shavir ibn Muxhahid es-Sa'di, që sundonte Egjptin e Epërm, u ngrit kundër tij. Ai ishte në gjendje ta mundte dhe ta vriste Ruzikun, dhe më 558 hixhri (1163 miladi) zuri vendin e tij si ministër i halifit fatimi - el-Adidit

Kur Shavir es-Sa'di dhe djemtë e tij u korruptuan, Durgam ibn Amir el-Lahami, njëri prej komandantëve, u caktua nga halifi fatimi që ta largonte atë. Halifi u ngrit kundër Shavirit, duke e detyruar që të ikte. Durgami zëvendësoi Shavir es-Sa'din, i cili shkoi në Damask që të kërkonte ndihmën e Nurud-din Mahmudit. I premtoi se do të paguante shpenzimet e ekspeditës në Egjipt dhe se do të paguante një haraç vjetor prej 1/3 e të ardhurave të Egjiptit. Në fillim, Nurud-dini ngurroi t'i ndihmonte. Erdhën lajme se mbreti Almarik i Jerusalemit kishte sulmuar Jerusalemin dhe kishte mposhtur Durgamin, i cili pastaj kishte lidhur aleancë me Almarikun dhe i paguante haraç, duke u frikësuar se Shaviri do të bënte aleancë me Nurud-dinin kundër tij. Nurud-dini dërgoi me të Asadud-dinin, i cili mori me vete nipin e tij Salahud-dinin. Asadud-dini mposhti Durgamin, dhe Shaviri u bë përsëri vezir.

Megjithatë, Shavir nuk i zbatonte premtimet dhënë Nurud-dinit. Madje, bëri edhe aleancë të fshehtë me mbretin e Jerusalemit. Asadud-dini dhe Salahud-dini u detyruan të luftonin kundër Shavirit, i cili kërkoi ndihmë nga mbreti i Jerusalemit. Ushtria siriane rezistoi kundër ushtrisë egjiptiane dhe kryqtare prej Ramazanit deri në Dhul-Hixhe të vitit 559 hixri (1164 miladij). Nurud-dini shfrytëzoi rastin kur mbreti i Jerusalemit ishte i zënë me Egjiptin dhe pushtoi këshjellat e Haramit dhe të Panaisit. Për pasojë, mbreti i Jerusalemit Almarik u frikësua për mbretërinë e tij dhe u detyrua të lidhte armëpushim me Asadudin Shrikun me kusht që të dy palët të largoheshin nga Egjipti.

Me këtë përfundoi edhe periudha e parë e luftimeve mes Nurud-dinit dhe kryqtarëve (të njohur si evropianë) për Egjiptin.

Periudha e dytë e luftimeve për Egjiptin

Asadudini përfitoi nga shkuarja në Egjipt. Ai e hulumtoi dhe e studio atë tërësisht dhe u bind se Egjipti ishte vendi përmes të cilit mund t'i mposhte kryqtarët. Prandaj ia lehtësoi çështjen Nurudinit dhe kërkoi nga ai t'i premtonte që ta pushtonte. Nurudini iu përgjigj kërkesës së tij dhe i siguroi një ekspeditë të dytë të udhëhequr nga Shirkuh dhe Salahudini më 562 hixhri. Kur veziri Shavir, dëgjoi se një ushtri siriane ishte drejtuar për Egjipt, kërkoi ndihmë nga aleatët kryqtarë, të cilët u pajtuan ta ndihmonin.

Të dy ushtritë u ndeshën në Munia në Egjiptin e Epërm. Ushtria siriane fitoi mbi armiqtë e saj në vitin 563 hixhri. Kjo betejë tregoi trimërinë dhe fuqinë e Salahudinit.

Ushtria siriane pastaj u drejtua nga veriu dhe pushtoi Aleksandrinë pa rezistencë. Asadudini e caktoi nipin e tij, Salahudinin, si sundues të Aleksandrisë. Ishte hera e parë që Salahudini bëhej sundues, dhe kështu i jepej mundësia të shfaqte talentin, shkathësitë, heroizmin dhe mençurinë e tij. Sapo Asadudini kishte shkuar në Fustat dhe Kajro, kryqtarët, të ndihmuar nga bizantinët, sulmuan Aleksandrinë dhe e bllokuan atë nga deti dhe toka. Njerëzit e rrethuar në Aleksandri ishin shumë afër dorëzimit, kurse Salahudini ishte në gjendje t'u bënte rezistencë armiqve derisa t'i bashkohej axha i tij. Si rezultat i kësaj periudhe ishte që të dy palët nënshkruan armëpushim, sipas të cilit që të dyja largoheshin nga Egjipti.

Periudha e fundit e luftimeve në Egjipt

Mbreti i Jerusalemit Almarik prishi armëpushimin dhe nuk e largoi gjithë ushtrinë nga Egjipti, me qëllim që ta pushtonte atë pasi të largohej ushtria siriane. Përgatiti një ekspeditë, pushtoi qytetin e Bulbejsit, vrau shumë njerëz, dhe pastaj u drejtua nga Fustati që ta pushtonte. Kur veziri Shavir e kuptoi se kryqtarët do ta pushtonin Fustatin,

lëshoi flakën kundër tij për 54 ditë. Kryqtarët pastaj u drejtuan nga Kajro dhe e bllokuan atë. Shaviri bisedoi me kryqtarët derisa arriti ushtria siriane që e kishte thirrur.

Nurudini shfrytëzoi rastin të pushtonte Egjiptin. Prandaj, për të tretën herë dërgoi një ekspeditë tjetër të udhëhequr nga Shirkuh dhe Salahudini. Kur arritën në Egjipt dhe iu bashkuan ushrisë egjiptiane, kryqtarët u larguan pa luftuar.

Kur Shirkuh hyri në Kajro, njerëzit e mirëpritën dhe panë në të shenja të mira. Halifi fatimi, el-Adidi, e uli afër vetes dhe ishte zemërgjerë me të. Më vonë ndodhi një komplot kundër Shavir es-Sa'di dhe ai u vra në vitin 564 hixhri. Asadudin Shirkuh e zëvendësoi atë si vezir i halifit fatimi, por kjo zgjati vetëm dy muaj, sepse ai vdiq në vitin 564 hixhri.

Analizë dhe komentim

Nga gjendjet e lartpërmendura me axhën e tij dhe betejat, përfundojmë se Salahudini kishte një karakter të rrallë që ndërthurej me trimëri, mençuri, përmes gjykimeve dhe politikës, dhe përvojës në artet e luftës. Kjo kishte bërë që ai që prej moshës së re të ishte një personalitet i vetëm dhe një personalitet i madh në histori. Pa dyshim, betejat në të cilat mori pjesë, rritën përvojën e tij, besimin dhe sigurinë, dhe treguan heroizmin e tij të rrallë që dominoi në histori. Në kapitullin tjetër do të shpjegojmë si ishte në gjendje t'i bashkonte vendet arabe politikisht dhe të formonte një front islam. Ky ishte një prej faktorëve kryesorë për fitoren ndaj kryqtarëve në betejën e Hitinit. Kjo fitore, që historia e përmend ende, do të jetë shembull për gjeneratat e ardhshme për të arritur sukses.

SALAHUDINI NË EGJIPT

Kur Asadudin Shirkuh vdiq pas dy muajsh sundimi, Salahudini mbajti tri ditë zi. Halifi fatimi el-Adid zgjodhi pastaj Jusuf Salahudinin vezir të tij, pavarësisht nga mosha e tij e re dhe pavarësisht nga prania e gjeneralëve të moshuar e personaliteteve të mëdha në atë kohë në Egjipt. Historianët përmendin se arsyet për këtë zgjedhje ishin që halifi fatimi shpresonte të kishte kontroll mbi të dhe ai do t'u bindej shenjave dhe thirrjeve të tij, ngase ishte i ri. Por fati deshi diçka tjetër, si do ta shpjegojmë më vonë.

Salahudini ishte tridhjetedyvjeçar kur u emërua vezir, dhe ai kishte marrë një përvojë të madhe në betejën e Nurudinit dhe xhaxhait të tij, Shirkuh, ishin arsyet kryesore për superioritetin e tij.

Salahudini u përpoq të kënaqte popullin e Egjiptit, duke u dhënë më shumë para dhe duke i trajtuar mirë që të mos bashkëpunonin me princat egjiptianë kundër tij. Si rezultat, ata e donin dhe u bënë më të afërt me të.

Gjithashtu, fitoret kundër evropianëve dhe çlirimi i Dimjetës, Gazës dhe Akabës prej tyre, ndikoi në rritjen e famës së tij. Ai i çliroi këto qytete dhe portin e Akabës, që ishte hyrje për Detin e Kuq, përmes të cilit egjiptasit shkonin në Mekë për haxh. Kjo fitore e madhe dhe mbrojtja e rrugës së haxhinjve ishin faktorët kryesorë për dashurinë dhe besimin mes tij dhe egjiptianëve. Si pasojë, ata u larguan nga sekti shii dhe iu bashkuan sektit suni, të cilit i përkiste edhe Salahudini, me qëllim që të luftonin kundër armiqve të All-llahut dhe të tyre.

Fundi i kompoteve të brendshme

Më herët e përmendëm se Salahudini arriti pozitë në moshë të re, prandaj njerëzit që punonin nën përkrahjen e shtetit Fatimi e kishin zili, duke e konsideruar si të huaj dhe si uzurpues të të drejtave të tyre. Prandaj u orvatën të shtonin fuqinë e fatimijve me çdo çmim. Ata ko-

mplotuan dhe intriguan kundër tij që të shpëtonin nga qëllimet e vezirit të ri.

Komplotet më të njohura janë ato të Nexhahut, njeri i besuar i halifit; Imarah el-Jemenit; dhe Kanz Davlahut.

Komploti i Nexhahut

Në vitin 564 hixhri, një njeri me ndikim në pallatin e halifit të fundit fatimi, el-Adid, bashkëpunoi me një grup të egjiptianëve që të bashkohej me evropianët kundër Salahudinit.

Nexhahu u dërgoi një letër kryqtarëve me të cilën kërkonte që të lëviznin në Egjipt. Ai planifikonte që, kur të arrinin ata dhe Salahudini t'i luftonte ata, ai do ta sulmonte nga prapa atë, dhe në këtë mënyrë Salahudini do të ndodhej në mes dy ushtrive. Pasi e shkroi letrën, e futi brenda një këpuce dhe ia dha atë një njeriu që t'ua dërgonte evropianëve. Por këpuca ra në duart e njërit nga ithtarët e Salahudinit, i cili ia dorëzoi atij. Salahudini e kuptoi të vërtetën, por e fshehu atë nga pasuesit e tij dhe shtyu dënimin e Nexhahut nga frika se pasuesit dhe përkrahësit e këtij të fundit mund të ngriheshin kundër tij. Ai e shtyu këtë dhe priste çastin e duhur.

Njëherë, kur Nexhahu shkoi në pallatin e tij jashtë Kajros, Salahudini dërgoi një grup të ushtarëve që ta vrisnin atë. Si pasojë, ushtria e halifit prej 50.000 ushtarësh, e përbërë nga sudanezët, u zotua se do të hakmerrej kundër Salahudinit. Beteja mes ushtarëve su-danezë të halifit dhe ushtrisë së Salahudinit zgjati dy ditë. Salahudini i mundi ata dhe kështu shpëtoi nga Nexhahu dhe ushtarët sudanezë që u ngritën kundër tij.

Jo vetëm sudanezët bënë komplot kundër tij, por gjithashtu edhe princat fatiminj ndezën flakën e zjarrit të luftës dhe grindjeve brenda shtetit.

Komploti i Imara el-Jemeni

Nga komplotet e mëdha kundër Salahudinit, ishte edhe ajo e përgatitur nga kronisti i mirënjohur Imara el-Jemen. Ai mblodhi një grup të madh të përkrahësve në Kajro, me qëllim që të emëronte njërin nga djemtë e el-Adidit, duke shpresuar të merrte sundimin fatimij dhe të dëbonte Salahudinin, dhe me nxitim u dërgoi një letër evropianëve që të bashkëpunonin me ta për të larguar Salahudinin nga sundimi. Shumë njerëz keqdashës dhe urrejtës iu bashkuan Imarait, që të shpëtonin prej tij.

Njëri prej këtyre komplotistëve, i quajtur Zejnudin ibn Naxha, i tradhtoi ata tek Salahudini, duke kërkuar nga ai shpërblim. Salahudini i arrestoi të gjithë dhe i vrau ata, që të jepte shembull për të gjithë ata që bënin komplote kundër vendit. Komploti ndodhi në vitin 569 hixhri.

Komploti i Kanz ed-Devlait

Një komplot tjetër ndodhi në Asvan dhe Kuz në vitin 570 hixhri. Makrizi shkroi për këtë komplot në librin e tij "*es-Suluk li-Ma'rifat Deval el-Muluk*":

Në vitin 570 hixhri, Kanz ed-Devla, sundues i Asvanit, mblodhi arabët dhe sudanezët. Ata marshuan drejt Kajros, me qëllim që të rimerrnin sundimin fatimi. Ai shpenzoi para të shumta që të arrinte këtë qëllim. Grupi tjetër iu bashkua atij dhe vrau dhjetë princa nga pasuesit e Salahudinit. Një njeri i quajtur Kijas ibn Shad, nga fshati Tud, sulmoi Kusin dhe plaçkiti pasurinë e tij. Salahudini përgatiti një ushtri të madhe të udhëhequr nga vëllau i tij el-Melik el-Adil, që ta luftonte këtë njeri. El-Melik el-Adil vrau Kijas ibn Shadin dhe shpërndau ushtarët e tij, pastaj shkoi në Tud që të luftonte kundër Kanz ed-Devlait, i cili iku pas një beteje ku u vranë shumica e ushtarëve të tij. Ai pastaj u vra më 6 Sefer. El-Melik el-Adil u kthye në Kajro më 18 Sefer.

Kështu, Salahudini shkatërroi komplotet dhe shpëtoi nga të padrejtët, agresorët, komplotistët dhe intrigantët. Kjo tregon mençurinë e tij dhe interesin për çështjet e nënshtetasve.

Fjalët e Mutanabit u kushtohen karakteristikave të tij:

Mundimet gjithnjë vijnë tek ata që kanë
durim t'i përballojnë
Ashtu si cilësitë e mira që gjenden
te njerëzit e ndershëm.
Një gjë e vogël duket e madhe në sytë
e një njeriu të vogël
Ashtu si një gjë e madhe duket e vogël
sytë e një personaliteti të madh.

Zhdukja e kompoteve të jashtme

Kur u bë Salahudini vezir i Egjiptit, evropianët filluan të vëzhgonin aktivitetet e tij me kujdes dhe pritnin lajmet e tij pa durim. Ata frikësoheshin shumë që njerëzit të bashkonin zemrat e tyre me të dhe të çlironin Tokën e Shenjtë. Ata u përgatitën dhe pritnin rastin e volitshëm që ta eliminonin.

Përpjekja e parë ishte sulmi mbi Dimjat. Kur Salahudini kishte vendosur sundimin e tij, evropianëtt në Levant u ndien të rrezikuar. Prandaj shkruan letra në Spanjë dhe Sicili me qëllim që të nxitnin trazirë dhe t'u kujtonte frikën për Jerusalemin. Gjithashtu dërguan një grup klerikësh e murgjish t'i nxitnin njerëzit për kryengritje dhe t'u sigurone atyre para, njerëz dhe armë.

Më vonë, ushtarët e tyre bllokuan Dimjatin në vitin 564 hixhri. Salahudini dërgoi në Dimjat, përmes Nilit, një ushtri të pajisur me municion dhe armë. Ai kërkoi ndihmën e Nurudinit që t'i ndiqte evropianët. Nurudini iu përgjigj duke dërguar një numër të ekspeditave në Egjipt dhe duke shkuar vetë me ushtarët e tij në principatat kryqtare në Levant dhe Palestinë. Kur evropianët mësuan për ekspeditat që ishin nisur për Egjipt dhe se Nurudini kishte hyrë në vendet e tyre, ata u tërhoqën të zhgënjyer, duke qëndruar 50 ditë në Dimjat.

Pesë vjet më vonë, më 569 hixhri, evropianët nga Sicilia sulmuan Aleksandrinë. Flota e tyre arriti në bregdet me 15 mijë kuaj, 30 mijë luftëtarë, kalorës e këmbësorë, të pajisur me armë, katapulta e barka. Kur arritën në breg, ata vranë shtatë ushtarë muslimanë, fundosën disa anije të muslimanëve dhe u vunë zjarrin 300 tendave. Pastaj vazhduan për Aleksandri.

Në atë kohë, Salahudini ishte në qytetin e Fakusit. Kur kuptoi në ditën e tretë se Aleksandria ishte rrethuar, përgatiti një ushtri të madhe, të pajisur me armë dhe municione. Përleshja zgjati deri vonë në mbërmje në ditën e katërt. Salahudini arriti t'i mundte ata, të fundoste anijet e tyre, të mbyste shumë prej tyre,dhe të merrte bagazhet e armët e tyre si plaçkë. Kështu heroi theu bllokimin e tyre dhe shpërndau trupat e tyre. Ushtarët e mbetur u kthyen të zhgënjyer në vendet e tyre.

Shkurtimisht, Salahudini shpëtoi Egjiptin dy herë nga pushtimi i evropianëve dhe shkatërroi komplotet e tyre. Kjo tregon se Salahudini ishte si një shpatë në qafë të kryqtarëve dhe si një luan që mbronte Islamin dhe muslimanët.

Predikimi në emër të Halifit abasi

Pasi Salahudini eliminoi komplotet e brendshme e të jashtme dhe u forcua mjaft, ai vendosi të merrte hapa të tjerë në rrugën për pavarësi.

Duke parë se egjiptianët e tepronin në ndjekjen e familjes së Muhamedit a.s., d.m.th. i takonin sektit shii, ai filloi t'i thërriste në sektin suni, të cilin e ndjekin shumica e muslimanëve në botë. Prandaj themeloi dy shkolla të mëdha, shkollën "Nasarije" dhe shkollën "Kamilije", në mënyrë që njerëzit të pasonin sektin e drejtë. Ndryshimi i dëshirës ishte i lehtë, kështu që Nurudini e nxiti që hytben e xhumasë ta mbante në emrin e Halifit abasi në vend të atij fatimi (kjo pati efekt në rrëzimin e halifit fatimi). Nuk ishte vetëm Nurudini që nxiti këtë ndryshim, por e tërë Bota Islame u pajtua me këtë. Imadi, hatibi (ai që mban hytben) i Salahudinit, iu drejtua atij duke thënë:

Ktheje halifatin tek abasitët
Dhe lëre gënjeshtarin derisa të vdesë.
Mos hezito të prishësh gjithë
komplotet sapo t'i kuptosh.

Salahudini mendoi që duhej të priste kohën e duhur për të ndryshuar predikimin, derisa të përfundonte thirrjen në sektin suni dhe t'i tërhiqte egjiptianët në të.

Kur halifi fatimi u sëmur, Nurudini insistoi dhe Salahudini mblodhi këshilltarët e tij për të marrë mendimet e tyre. Në mbledhje, një dijetar joarab - el-Amir el-Alim (princi dijetar), kërkoi prej tij ta merrte detyrën. Ai shkoi në xhami dhe mbajti predikimin e së premtes në emër të halifit abasi në vend të halifit fatimi. Salahudini urdhëroi ithtarët e tij që ta fshihnin këtë nga halifi fatimi. Ai tha: "Nëse shërohet, do ta kuptojë këtë. Por, nëse vdes, nuk duhet t'ia themi lajmet e këqija". Predikimi në emër të halifit abasi ishte pranuar qetësisht nga njerëzit, pa luftë, ashtu siç e përmend ibn el-Ethiri në Historinë e tij. El-Adid vdiq në vitin 567 hixhri (1171 miladi), dhe me vdekjen e tij mbaroi edhe koha e fatiminjve.

Pas vdekjes së el-Adidit, Salahudini bëhet sundues i Egjiptit. Ai mbajti zi për tri ditë dhe u kujdes e nderoi familjen e el-Adidit.

Marrëdhëniet me Nurudinin

Pas vdekjes së halifit fatimi, Salahudini shtoi përpjekjet e tij që të përmirësonte marrëdhëniet me Nurudinin, që ky i fundit të mos mendonte që Salahudini donte të merrte fuqinë. Ai mbajti marrëdhëniet e forta të mëparshme, që ishin vënë në kohën e axhës së tij Shirkuh, dhe nuk i harroi të mirat e Nurudinit ndaj tij në rini.

Pak kohë më vonë, urdhëroi që predikimi i së premtes të mbahej në emër të Nurudinit në vend të halifit fatimi. Gjithashtu preu monedha në emër të tij dhe i dhuroi dhurata të çmueshme nga thesari i pallatit. Ai i ishte mirënjohës Nurudinit për veprimet e mëparshme dhe tregoi besnikëri ndaj tij.

Gjatë kohës që sundoi Egjiptin, disa tradhtarë nga komandantët e ushtrisë nuk iu bindën dhe refuzuan të jetonin në Egjipt. Ata krijuan disa mosmarrëveshje mes Salahudinit e Nurudinit dhe ndezën flakën e armiqësisë e urrejtjes.

Ata patën sukses në disa nga përpjekjet e tyre të ulëta që të shkaktonin disa çrregullime dhe konflikte. Megjithëkëtë, njerëz të mençur i kuptuan këto përpjekje dhe i këshilluan kundër armiqësisë mes dy palëve. I vetmi fitues i dallimeve dhe konflikteve ishte armiku përgjues. Pak kohë më vonë, besimi dhe sinqeriteti mes dy palëve u kthye ashtu siç ishte më parë. Salahudini mbeti besnik dhe nën sundimin e Nurudinit, deri në vdekjen e këtij të fundit, në vitin 569 hixhri (1173 miladi).

Nga arritjet e Salahudinit në Egjipt dhe komplotet kundër tij, lexuesit mund të njohin karakterin dhe përvojën politike të tij, qëndrueshmërinë e tij dhe organizimin e çështjeve.

Në këtë periudhë, Salahudini ishte në gjendje të largonte të gjitha pengesat që ndeshte dhe për një kohë të shkurtër të bëhej sundues i muslimanëve në Lindje dhe një luftëtar i aftë në betejat e çlirimit. Fati hyjnor e zgjodhi atë që të largonte pengesat që u dilnin muslimanëve gjatë pushtimit të kryqtarëve në kohë të ndryshme. Në kapitullin e ardhshëm do të shpjegojmë se si Salahudini i bashkoi vendet muslimane nën sundimin e tij dhe i mundi evropianët në betejën vendimtare të Hitinit, dhe si riktheu lavdinë e Islamit e të muslimanëve.

"…kjo është dhuratë e All-llahut që ia jep atij që do. All-llahu është dhurues i madh, i dijshëm". *(el-Maide, 54).*

Në numrin tjetër:
Salahudini në Siri

Abdullah Nasih Ulvan

SALAHUDIN EL-EJUBI HERO OF THE BATTLE OF HITTIN AND LIBERATOR OF JERUSALEM FROM THE CRUSADERS (532-589 H/1137-1193)

(Summary)

The family and education of Salahudin
Family origin

Salahudin comes from a noble family that ruled Egypt and Syria (Syria, Lebanon and Palestine). All this was called the Ejubij state. His family's origin is from the most noble of Kurdish tribes, err-Rrawadia from Hazian, one of the greatest Kurdish tribes. Some historians claim that the origin of Salahudin is from the Mudar of Adnan. Without doubt they are trying to explore the origin of every great Arab personality. Surely, this does not coincide with scientific methodology and the truth. They thought that virtue and honesty are limited only to Arabs and that non-Arabs could not create culture and fame.

صلاح الدين الايوبى بطل معركة حطين و محرر القدس من الصلبيين

٥٣٢ –٥٨٩ هـ / ١١٣٧ – ١١٩٣

(خلاصة البحث)

اسرته و تربيته:

ينتسب صلاح الدين الى عائلة كريمة كانت تحكم مصر و سوريا الكبرى (سوريا و لبنان و فلسطين). كل هذه الدولة كانت تسمى الدولة الايوبية. و هو ينتمى الى قبيلة كريمة كردية الروادعا من الحازئان و التى كانت تعتبر من اكبر قبائل الاكراد. و بعض المؤرخين يذكرون بان صلاح الدين ينتمى الى مدد بعدتان.

KUMTESA

Dr. Ismail Bardhi

TEMAT DHE DILEMAT E ARSIMIT FETAR*

Tryeza e rrumbullakët *"Gjendja dhe perspektivat e sistemit arsimor fetar në suazat e Bashkësisë Fetare Islame"* është një tubim i parë i këtij lloji brenda Bashkësisë Fetare Islame, ndërsa Fakulteti i Shkencave Islame i Shkupit kishte nderin t'i rrekej detyrës së organizimit dhe përgatitjes së saj.

Tematika e kësaj tryeze shkencore, siç mund të shihet edhe nga titulli, është e ndërlidhur me çështjen e arsimit fetar të të gjitha niveleve, i cili mund të thuhet se ballafaqohet me probleme të ngjashme që e prekin edhe arsimin në përgjithësi. Prandaj, kur flasim për çështjet aktuale të teologjisë bashkëkohore që kanë të bëjnë me arsimin, spontanisht na imponohet edhe tematika tjetër që mund të titullohet si çështjet aktuale të arsimit bashkëkohor universtar. Le t'i kemi që të dyja këto tematika parasysh në mënyrë të vazhdueshme krahasuese dhe përplotësuese (komparative dhe komplementare). Le të jetë kjo tryezë jona më tepër se vetëm një tubim tradicional i kokave të asrimuara dhe le të mendojë e zbërthejë, të provokojë e udhëzojë përzgjidhje të caktuara të paktën teologjike brenda korpusit tonë fetar.

* Fjala hyrëse në Tryezën e Rrumbullakët: "Gjendja dhe perspektivat e sistemit arsimor fetar në suazat e Bashkësisë Islame" e mbajtur në Shkup më 17 maj 2004.

Ndërsa, si njëra ashtu edhe tjetra, kërkojnë vendin e tyre të justifikimit dhe veprimit në vend dhe në botë, ndonëse njëkohësisht bashkohen dhe polarizohen. Le të jetë kjo tryezë një rast i mirë që të përsiatim rreth dy çështjeve thelbësore të teologjisë:

- E para, sa është në të vërtetë sot teologjia aktuale si për pjesëtarët e Bashkësisë Fetare Islame ashtu, edhe për anëtarët e shoqërisë civile? Me fjalë të tjera, a po shndërrohen dalëngadalë teologët në intelektualë dhe mendimtarë "të tepërt", të cilët, si brenda bashkësisë fetare ashtu edhe në shoqëri, duhet të flasin vetëm kur pyeten për diçka, ndërsa në të gjitha rastet e tjera të mos e shqetësojnë as publikun fetar e as atë shoqëror?

- E dyta, sa përpiqen teologët, mbi të gjitha ata muslimanë, të jenë jo vetëm në nivel të detyrës dhe përgjegjësisë së tyre teologjike, por edhe të kërkuar dhe të pyetur nga besimtarët e tyre dhe nga vetë shoqëria? "Kaluan" kohët kur teologët pritnin të thirreshin nëpër medie, e "erdhën", kohët në të cilat teologët duhet të imponohen në aspektin pozitiv agresiv nëpër mediume, respektivisht në publikun shoqëror. Të mos harojmë se publiku fetar është publik i kufizuar dhe nuk i përfshin të gjitha kategoritë e muslimanëve dhe të gjitha profilet e qytetarëve.

Le të jemi kritikë. A nuk janë, veçanërisht profesorët e teologjisë, paksa të tepërt, sidomos në qarqet fetare? Në çfarë mase udhëheqja fetare dhe nëpunësit fetarë në terren kanë nevojë për shërbimin intelektual-teologjik te teologëve, profesorëve të tyre? Nga ana tjetër, përse teologët nuk janë shpirti lëvizës i ngjarjeve të ndryshme dhe interpretimeve të tyre, të strategjive institucionale dhe interpretimeve të tyre dhe të jetuarit të dimensionit shoqëror të fesë! Ç'po ndodh me reformat e studimeve teologjike dhe me modernizimin e këtyre studimeve? Sa ndodh në fakultetet teologjike tek ne interdisiplinariteti teologjik, e bashkë me këtë edhe interdisiplinariteti mes shkencës teologjike dhe shkencave të tjera nëpër universitete: në nivelin e lëndëve, në nivelin e programeve të përbashkëta dhe në nivelin e projekteve të përbashkëta interdisiplinare?

Degët shkencore dhe teologjia duhet të ecin paralelisht, sepse e kanë të përbashkët shoqërinë në të cilën veprojnë; e kanë të përbashkët njeriun të cilit dëshirojnë t'i shërbejnë dhe qëllim të përbashkët kanë ardhmërinë, respektivisht mirëqenien e njeriut dhe shoqërisë pjesë përbërëse e së cilës janë. Degët e caktuara teologjike nuk lejohet të bëhen një lloj "getoje teologjike" ose "përtacie shkencore". Interdisiplinariteti dinamik brenda studimeve filozofike-teologjike është presupozim thelbësor për interdisiplinaritetin e suksesshëm të teologjisë me disiplinat e tjera shkencore brenda universiteteve.

Kjo tryezë le të na preokupojë edhe me problematikën e reformimit të shkollimit të lartë tek ne dhe në Evropë. Për arsimin e lartë janë relevante edhe proceset e Bolonjës me elementet e tyre: reformat universitare, reformat e fakulteteve, të akademive të arteve, institucioneve shkencore-kërkimore e pse jo edhe reformat në arsimin fetar.

Reformat aktuale universitare në Maqedoni kanë përparësitë e veta sa edhe negativitetet. Përparësitë e këtyre reformave në proceset integruese evropiane janë: lëvizja më e madhe dhe më aktive e profesorëve dhe studentëve; shkollimi më i shkurtër dhe, për shtetin, më i lirë; rritja e përqindjes së të arsimuarve universitarë në disa vende të Evopës; arsimi i lartë është në shërbim të përparimit të një shteti. Negativitetet e këtyre reformave janë: rreziku që më të avancuarit ta braktisin vendin pak të zhvilluar; vendet e vogla ta braktisin veçoritë e tyre tradicionale, historike, gjeografike e nacionale dhe në mënyrë jokritike të marrin çdo gjë që ofrohet nga jashtë vendit; prodhojnë kuadër final të arsimit të lartë, për të cilin nuk do të ketë mjaft vende pune në tregun brenda shtetit në të cilin janë shkolluar; shkollimi të jetë i mundshëm vetëm për të pasurit e jo edhe për të rrezikuarit nga pikëpamja sociale, fakultetet me numër më të vogël studentësh të humben mes fakulteteve më të forta dhe më atraktive nga aspekti i studimit; që teologjia të lejojë të kthehet në "geto shoqërore". Përveç kësaj, në të gjitha diskutimet rreth reformave të arsimit të lartë, ekziston rreziku i saksonizimit dhe amerikanizimit të sistemit të arsimit të lartë tek ne.

Ç'po ndodh, për shembull, me reformat e FSHI? FSHI dëshiron të përfshihet në proceset reformiste arsimore evropiane dhe dëshiron të

shkojë me hapin e reformave në universitetet në Maqedoni e më gjerë dhe t'i marrë si shembull fakultetet simotra në vend dhe jashtë, edhe pse mëton të ndërtojë modelin e vet specifik, duke mbajtur parasysh rrethanat tona.

Është e vërtetë se duhet vazhduar kësaj rruge, por si është realiteti? Intelegjencia jonë, më lejoni ta quaj "shekullariste", jo vetëm në vendin tonë po në mbarë hapësirat shqiptare, fatkeqësisht nuk është duke i dhënë vendin e duhur teologjisë, dhe kjo vetëm për arsye se teologjia nuk prezantohet siç duhet nga vetë bartësit e saj. Por, a është kjo një mënyrë e drejtë e të gjykuarit? Cilat paradigma i ka si shembull intelektuali ynë kur përsiat dhe mendon rreth teologjisë? A ka të drejtë ai të mendojë që shoqërinë edhe në aspektin kulturor ta prezantojë sipas diktateve? Ku janë racionalja, drejtësia dhe kultura në qëndrimin e intelektualit tonë ndaj teologjisë në përgjithësi e asaj islame në veçanti? Nuk do të ishte mirë që pas nja 20-30 vjetësh të shohim prapa e të themi se kemi qenë gabim dhe kemi pasur paragjykime. Pasuria e teologjisë, e filozofisë së teologjisë, është pasuri e përhershme, pa marrë parasysh naivitetin individual dhe kolektiv.

Dr. Ismail Bardhi

THE TOPICS AND DILEMAS OF RELIGIOUS EDUCATION

(Summary)

The main topic of this round table has to do with the issue of religious education at all levels, which is being confronted with similar problems to those of general education. Thus, when we speak of topical problems of contemporary theology, which have to do with education, we must also deal with the topical problems of contemporary university education. We must always bear the two in mind in a comparative and complementary manner. Let this round table be more than a traditional meeting of wise heads and let it provoke certain solutions within our religious body. Let this round table serve as an opportunity to discuss two fundamental theological issues.

اسماعیل بارذی

الموضوعات و الخیارات

(خلاصة البحث)

ان موضوع هذه المائدة العلمية كما يفهم حتى من عنوانها متعلق بالتعليم الدينى على جميع المستويات و الذى يواجه نفس المشاكل التى يواجه التعليم العام. وعندما نتحدث عن الموضوعات الدينية الحديثة و التى لها علاقة بالتعليم بصورة مباشرة يتحتم علينا ان نتطرق الى التعليم الجامعى. ولتكن هذه الطاولة المستديرة اجتماعا لعدد من المهتمين بالتعليم الاسلامى و لنقم بعمل تحاليل علمية لحالة التعليم و لنستعد لنواجه تحديات المستقبل التى امامنا ولنقم بطرح حلول مناسبة على اقل تقدير فى مجال التعليم الاسلامى.

KUMTESA

Akademik Jashar Rexhepagiq

NEVOJA E STUDIMIT TË ARSIMIT TË LARTË TEK NE DHE DISA SUGJERIME*

Tematika konkrete e tubimit të sotëm shkencor ka një rëndësi të posaçme dhe të shumëfishtë. Vlera e këtij fushëveprimi shkencor shihet në radhë të parë në faktin se tema të tilla janë mjet i fuqishëm motivues për organizimin e gjurmimeve të arsimit islam në të gjitha nivelet e zhvillimit, në veçanti të arsimit të lartë islam.

Nuk është e panjohur se jo vetëm në këto pjesë të Ballkanit, po edhe më gjërë - në suazat e Perandorisë Otomane të atëhershme, janë studiuar fare pak shkollat muslimane, ose si e hasim shpesh në literaturë, shkollat turke. Kështu quheshin mektebet, medresetë, iptidaijet, ruzhdijet e shkolla të tjera duke pasur parasysh se ato shkolla me përqindjen më të madhe u dedikoheshin banorëve muslimanë dhe se, sipas autorëve të tjerë, në këto institucione arsimore dominonte gjuha dhe kultura turke. Disa studiues nga Bosnja pos termit "shkolla muslimane", përdorin edhe këto dy nocione: "sistemi shkollor osman" (p.sh. dr. Ismet Kasumoviq) dhe "shkollat muhamedane". Një përdorim gjithnjë më i shpeshtë është koncepti i shkollimit islam. Fjala është

* Kumtesë e lexuar në Tryezën e Rrumbullakët: "Gjendja dhe perspektivat e sistemit arsimor fetar në suazat e Bashkësisë Islame" e mbajtur në Shkup më 17 maj 2004.

për institucionet e arsimit islam në të kaluarën, p.sh. në periudhën osmane, po edhe sot. Ja pra, vetë terminologjia dhe domethënia e saj meriton një studim të veçantë. Gjurmimi i cilitdo segment të shkollave e të arsimit islam, e në veçanti të atij të lartë, nënkupton së pari të posedojmë shënime relevante dhe të shumëllojshme, si dhe të bëhet analiza e të gjitha aspekteve të arsimit islam në Maqedoni, Shqipëri, Kosovë dhe në trevat fqinje.

Me siguri, kur është fjala për burimet primare e sekondare, se pos literaturës së botuar dhe dorëshkrimeve që janë ruajtur në disa xhami, teqe, biblioteka individuale etj., p.sh. në Kosovë, në Shqipëri, në Bosnjë e Hercegovinë, në Maqedoni etj., - të dhënat për disa medrese dhe shkollat shtetërore turke duhen kërkuar në defterët, vakëfnametë, sallnametë etj., sidomos të atyre në Arkivin e Madh Shtetëror në Stamboll (Istanbul Baskanli Arsivi), Arkivin e Sixhileve Sheriatike (Ser'i Siciller Arsivi), në Arkivin e Drejtorisë së Vakëfit në Ankara (Vakiflar Arsivi Mudurlugu), në Bibliotekën Sulejmanie (Suleymaniye Kutuphanesi) etj.

Qëndrimi i njëanshëm dhe nënçmimi i rolit të mektebeve dhe medreseve aty-këtu përsëritet edhe në ditët tona, e kjo dëshmon se de facto nuk dallohen llojet e ndryshme të këtyre shkollave dhe funksioni i tyre. P.sh. në "Veliki rjecnik hrvatskoga jezika" (autor Vladimir Aniç, Zagreb, 2003), në fq. 738 medresetë shpjegohen si institucione islame ekskluzivisht religjioze. Është e qartë se këto shkolla të rangut të mesëm e të lartë njëkohësisht, janë edhe arsimore e kulturore. Edhe mektebet në fq. 742 u shpjeguan në mënyrë të ngjashme, si "shkollat fillore religjioze". Po kështu përkufizohet mektebi edhe në "Fjalorin Enciklopedik" (hartoi Pasho Baku, Tiranë, 2002) ku, në fq. 461, për këtë shkollë, shkurtazi thuhet: "Shkollë e ulët fetare muslimane", ndërsa, po këtu, për medresetë, në fq. 460 theksohet drejt: "Shkollë e mesme ose e lartë ku përgatiten hoxhallarë e myderrizë". Këtu përgatiten mualimët, kurse muderrizët në medresetë e rangut të lartë dhe në fakultetet gjegjëse. Është interesante që në "Pedagogiqeskaja enciklopedija", 2 (Moskë, 1965) në fq. 780 për medresetë gjejmë disa të dhëna të sakta, kurse vlerësimi i përgjithshëm është jo i saktë. Po këtu u dha

etimologjia e fjalës **medrese** (nga fjala arabe madrasa, nga darasa, që do të thotë me mësue, me studiue, vendi i të mësuarit). Kjo shkollë ka për qëllim të përgatisë hoxhollarë dhe mësues për shkollat fillore muslimane (mektebet), ndërsa tipi i lartë i medreseve ka për detyrë të krijojë gjykatës, teologë islamë, nëpunës të Sheriatit dhe persona të tjerë në shërbim të Islamit. Krahas këtyre shënimeve të sakta, përkufizimi i medresesë është jo i saktë, sepse shpjegohet si shkollë e mesme religjioze (konfesionale). Deri në shek. 19 këto shkolla kanë qenë fetare dhe pjesërisht laike.

Të dy konceptet - medresetë dhe mektebet i kemi shpjeguar më me plotni dhe më saktë në "Pedagoska enciklopedija", 2 (Beograd, Zagreb..., 1989) në fq. 19 dhe 25. Më gjërë për këto shkolla shihni në studimin tonë: Razvoj i obelezja turskih skola na teritoriji danasnje Jugoslavije do 1912 godine, (ANUK, Studime - Studije, 3/1988, fq. 51-69).

Në trevat tona, sipas njohurive të deritashme, më e vjetra është medreseja e lartë e ashtuquajtur **Ishakia**, e Ishak-beut në Shkup, që u themelua rreth vitit 1440. PO ashtu, medreseja e Çaush-beut në Manastir u themelua në shekullin e 15. Medreseja e Gazi Hysrev-beut në Sarajevë gjithashtu është e vjetër (nga viti 1537) dhe u takon medreseve të larta, me program të njëjtë a të ngjashëm me Medresetë në Stamboll, Edrene, Bursa, Pllovdiv, Shkup. Janë të njohura, Medreseja e Ali pashës në Edrene, e Shihabeddin pashës në Pllovdiv, e Mahmud pashës në Stamboll, e Eski Ali pashës në Bursa, e Ishak beut në Shkup, e Gazi Husrev beut në Sarajevë, disa medrese në Anadoll, Egjipt dhe vende të tjera të Perandorisë. Me siguri, medreseja e Ishak beut të Shkupit ka qenë ndër më të vjetrat dhe më të njohurat në Ballkan. Rang të lartë (nga 50 aspri) ka pasur edhe medreseja e Gazi Isa beut të Shkupit e vitit 1448, po ashtu medreseja e Husrev beut në Sarajevë dhe Imaret - medreseja në Beograd e Mehmed beut, që u themelua në gjysmën e parë të shekullit 16. Në Pejë, në fillim të shekullit 16 (më 922/1516), sanxhak beu i Shkodrës, Mehmed bej ndërtoi një medrese dhe një teqe. Në shekullin 16 u dallua edhe medreseja e Mehmed pashës në Prizren (1594), e para shkollë e lartë teologjike dhe

pjesërisht laike në Kosovë. Medresetë e rangut më të lartë në Bosnjë, pos asaj të Gazi Husrev beut, kanë qenë Haxhi Besharet medresa në Sarajevë (fillimi i shek. 17) dhe medreseja e Ahmet beut dhe Mahmud beut në Mostar (nga fillimi i shek. 17). Në fillim të shek. 18 (rreth viteve 1700-1720) filloi punën Medreseja e Konispolit, ndërsa në gjysmën e dytë të shekullit 18 Medreseja e Qafës dhe ajo e Pazarit në Shkodër. Në këtë kohë u formua edhe medreseja e Madhe e Gjakovës.

Në historinë Botërore ose të përgjithshme zakonisht theksohet se universitetet e para të mesjetës u paraqitën në shekullin 12 në Angli (Kembrixh, Oksford), Francë (Paris), Itali (Salerno, Padova etj.). Historianët e arsimit dhe të mendimit pedagogjik harrojnë se para këtyre universiteteve evropiane kanë vepruar universitetet e vjetra arabe, siç është Al-Azhar në Kajro, që u themelua më 972, po ashtu universiteti më i vjetër Karauin në qytetin Fes (në Marok), i themeluar më 859 dhe universitete të tjera islame.

Përfundimi i përgjithshëm do të ishte se koha është që, sidomos në mënyrë ekipore dhe sistematikisht, të studiojmë trashëgiminë tonë të pasur dhe më pak të njohur shpirtërore.

Edhe **disa sugjerime konkrete rreth arsimit të lartë islam.**

1. **Fakultetet e Studimeve Islame Shkupit dhe i Prishtinës** të mbesin të pavarura, por njëkohësisht **në gjirin e universiteteve të Maqedonisë dhe të Prishtinës.** Nuk duhet harruar se universitetet e para evropiane të mesjetës zakonisht kishin katër fakultete të para: të artit, jurik, të mjekësisë dhe fakultetin teologjik. Janë edhe disa arsye, pse këto do të ishin institucione private po njëkohësisht edhe shtetërore (pra nën kujdesin e pushtetit). Ana financiare e tyre do të ishte e siguruar dhe më e volitshme.

2. **Propozimi i dytë** do të ishte që **medresetë tona (në Prishtinë, Shkup, Shkodër, Tiranë etj.) të transformohen gradualisht në akademi pedagogjike islame**, ose paralelisht në këto qendra të themelohen edhe akademitë islame. Sot në Bosnjë e Hercegovinë kemi afro dhjetë akademi pedagogjike islame. Edhe në Novi-Pazar, paralelisht me medresenë e Isa beut, vepron edhe Akademia Pedagogjike Islame. Arsye themelore është se sot edhe imamët dhe mualimët, edhe

nëpunës të tjerë të bashkësive islame, duhet të marrin arsim më të lartë islam. Këto akademi islame pedagogjike **përputhen pjesërisht** me medresetë e larta më të njohura, siç ishin ajo e Ishak beut e Shkupit, e Husrev beut e Sarajevës, e Mehmed pashës e Prizrenit etj.

3. **Lidhur me themelimin e institucioneve kërkimore-arsimore**, pjesërisht atë funksion do ta kishin fakultetet islame, e pos tyre edhe akademitë islame pedagogjike. Dikur pranë medresesë dhe xhamisë së Gazi Husrev beut në Sarajevë, para vitit 1531, është ndërtuar **Hanikahu**, institucion në të cilin perfeksionoheshin dervishët e ardhshëm. Aty banonin dervishët, fakirët (ithtarë të tyre), muridët (fillestarët) etj., për t'u aftësuar në stërvitje teorike dhe ceremoni fetare. Aty mësonin komentimin e Kur'anit, sidomos Tesavufin (qendra për studimin e Tesavufit). Kishin lokale për biseda, për dyluftime me fjalë (mejdani), për ziqër etj. Kishin bibliotekën e pasur dhe përgatiteshin teorikisht e praktikisht. Hanikahu i Sarajevës (nga fjala persiane: **hane** - shtëpia dhe **gah** - vendi, qëndrimi) shkollonte dervishë të aftë; ata pastaj përhapnin arsimin dhe kulturën islame.

Hanikahe kanë pasur edhe qendra të tjera, p.sh. në Shtip në shek. 17 kishin shtatë hanikahe të rendeve të ndryshme. U dalluan edhe hanikahet në Mostar, Uzhicë, Travnik etj.

Sado që do të ishte e dobishme të kemi së paku një hanikah në Kosovë, ku kemi aq shumë teqe të rendeve të ndryshme, shumë dervishëve e po ashtu edhe shehlerëve (një pjese të madhe të tyre) u mungon arsimi i lartë, para së gjithash islam.

4. Një nga temat e parapara për këtë tubim është **arsimimi fetar dhe reforma e tij**. Kjo problematikë kaq serioze meriton studim të veçantë. Lidhur me reformën (do të thotë të ndryshimeve esenciale, para së gjithash të brendshme) e arsimit fetar, do të propozoja që çdo ndryshim të bëhet me kujdes maksimal, me përgatitjen paraprake solide, duke i vënë ndryshimet në disa paralele të një shkolle (medresetë p.sh.) dhe duke i ndjekur ato ndryshime (p.sh. inovacionet në mësim) në mënyrë eksperimentale, e pastaj ato masa të zbatohen në institucione të tjera islame.

5. Përkitazi me ngritjen profesionale e pedagogjike të kuadrit arsimor, do të ishte e dobishme **të organizohen takime të shpeshta të autorëve të arsimit dhe të kulturës islame,** e sidomos të shfrytëzohet përvoja pozitive e tyre në punën edukativo-arsimore. Ishte një praktikë jashtëzakonisht e mirë kur nxënësit e disa shkollave në Kosovë organizonin gara në të lexuar të Kur'anit.

Jashar Rexhepagiq

THE NEED TO STUDY HIGHER EDUCATION IN OUR COUNTRY AND A NUMBER OF SUGGESTIONS REGARDING THIS

(Summary)

The topic of this meeting is of a special importance. Such topics are a powerful tool to motivate the study of Islamic education at all levels of development and in particular higher education.

It is a well-known fact that Muslim schools or Turkish schools (as they are frequently called in literature) in this part of the Balkans as well as further, within the Ottoman Empire, have been studied very little. Such schools were mainly dedicated to Muslims and according to different authors the Turkish language and culture prevailed in them. A number of researchers from Bosnia apart from “Muslim schools” use also the terms “Ottoman educational system” (e.g. Ismet Kasumoviq) and “Muhammedan schools”. The concept of Islamic education is being used more frequently day by day. This concept covers the institutions of Islamic education in the past (e.g. during the Ottoman period) as well as nowadays. The teminology that is used and its meaning deserves a special study. The study of all levels of education and in particular that of higher education implies the need for relevant data as well as the analysis of all aspects of Islamic education in Macedonia, Albania, Kosova and neighboring areas.

آكادميك ياشار رجب آغيش

حاجتنا الى التعليم العالى مع بعض التوصيات

(خلاصة البحث)

ان موضوع اجتماعنا العلمى اليوم له اهمية خاصة و متعددة الفوائد. و اهميته تكمن بالدرجة الاولى ان مثل هذه المواضيع تدفع الى الامام التعليم الاسلامى بصورة عامة والتعليم العالى بصورة خاصة.

KUMTESA

Mr. Qemajl Morina

ANGAZHIMI I BI TË KOSOVËS NË ZHVILLIMIN E ARSIMIT UNIVERSITAR ISLAM NË KUADËR TË FSI-SË TË PRISHTINËS*

Arsimimi konsiderohet një prej shtyllave të sigurisë kombëtare dhe jetës kulturore në vendet e përparuara; nëpërmjet tij përcaktohet niveli i zhvillimit të vendit dhe pozita e tij në mesin e shteteve të tjera të botës. Dihet se përparimi në sistemin arsimor, do të thotë përparim në të gjithë lëmenjtë e jetës.

Tradita e jetës fetaro-arsimore në trojet shqiptare është e vjetër mbi gjashtëshekullore, dhe fillon nga vitet e para të shtrirjes së pushtetit osman në këtë pjesë të Ballkanit, kur krahas përqafimit të fesë islame, fillon edhe procesi i arsimimit dhe përhapjes së kulturës e civilizimit islam, si komponente përbërëse e të pandashme të Islamit si fe dhe qytetërim. Si rezultat i kësaj, në shumë qendra të trojeve shqiptare, ku më shumë e ku më pak, nisën të themeloheshin institucione të karakterit fetaro-arsimor, si: xhami, medrese, biblioteka, teqe etj.. Këto ishin institucione që u shërbenin muslimanëve të këtyre trojeve për

* Kumtesë e lexuar në Tryezën e Rrumbullakët: "Gjendja dhe perspektivat e sistemit arsimor fetar në suazat e Bashkësisë Islame" e mbajtur në Shkup më 17 maj 2004.

të mësuar fenë, mësimet e saj, por edhe shkencat e tjera. Këto institucione për shekuj ruajtën traditën fetare dhe kombëtare të popullit tonë.

Duke filluar prej shekullit gjashtëmbëdhjetë e këndej në Kosovë, në shumë qendra, funksiononin medrese, si Medreseja e Madhe e Gjakovës, Medreseja e Mehmet Pashës e Prizrenit, Medreseja e Pejës, e Vushtrrisë, e më vonë edhe në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë etj. Medrese të vogla kishte edhe në disa fshatra të Kosovës.

Këtu vlen të përmendim se shumë bashkëkombës tanë jo vetëm që kontribuan në rritën dhe zhvillimin e këtyre institucioneve edukativo-arsimore, por një numër i tyre ishin themelues ose në krye të atyre institucioneve. Këtu, sa për ilustrim, po përmendim vetëm disa. Institucioni i Shejhul-Islamit, respektivisht Meshihatit Islam tek osmanlinjtë, ishte autoriteti më i lartë fetar i Perandorisë Osmane që ka një histori 498-vjeçare, për pesë shekuj kishte 131 dijetarë, së paku tre prej tyre kishin arritur të jenë në këtë post tejet të rëndësishëm..

Rektori i parë i Universitetit të Stambollit ka qenë dijetari i madh shqiptar Hoxha Hasan Tahsini, ndërsa autori i himnit të Republikës së Turqisë dhe poeti i madh Mehmet Akif Ersoi, me prejardhje nga fshati Sushicë e Pejës për një dekadë ka qenë profesor i letërsisë turke dhe persiane në Universitetin prestigjioz të Kajros, të cilin e kishte themeluar Fuadi i parë, njëri prej pasardhësve të Mehmet Ali Pashës. As sot nuk mungon kontributi i shqiptarëve në lëmin e islamistikës. Me këtë rast vlen të përmendim tre dijetarë të mirënjohur në përmasa botërore në lëmin e shkencës së hadithit: Muhamed Nasiruddin el-Albanin, Shajb el-Arnautin dhe Abdylkadër Arnautin.

Fakulteti Islam nevojë e kamotshme

Nevoja e themelimit të një institucioni të lartë universitar islam tek shqiptarët ishte e kamotshme, për arsye se shumica dërrmuese i përkasin besimit islam, i cili ka ndikuar në ndërgegjen e besimtarëve shqiptarë, madje jo vetëm në ndërgjegjen e besimtarëve, po në ndërgjegjen e çdo shqiptari. Islami për më shumë se gjashtë shekuj ka lënë gjurmët e tij të pashlyeshme në kulturën tonë shpirtërore dhe

materiale, prandaj, për ta studiuar ashtu si duhet dhe si ai e meriton, lypsej të ekzistonte një institucion i lartë edukativo-arsimor. Për fat të keq tonin, rruga deri te ky institucion ka qenë tejet e gjatë, dhe këtë domosdo arritëm ta realizonim vetëm në kohën tonë. Shkaqet ishin të nduarnduarshme, të cilat nuk është rasti t'i elaborojmë.

Në Shqipëri, pas Luftës së Dytë Botërore ishin bërë hapat e para për një nismë të tillë. Në atë kohë në Tiranë vepronte Medreseja e Lartë, të cilën regjimi komunist e mbylli në vitin 1965. Njëkohësisht u mbyllën edhe të gjitha medresetë e tjera në Shqipëri. Të njëjtin fat e patën edhe medresetë në trojet shqiptare në ish-Jugosllavinë. Edhe në Kososvë, gjendja nuk ishte më e mirë pas riokupimit serb dhe vendosjes së atij regjimi. Aktiviteti islam ishte ngushtuar në përmasa drastike. Të gjitha medresetë u mbyllën, dhe vetëm pas shumë përpjekjeve të vazhdueshme të prijësve fetarë mezi arritën të rihapnin Medresenë e Ulët të Prishtinës, në vitin 1951. Kjo medrese më vonë u ngrit në rangun e medresesë së mesme, nga bankat e së cilës dolën kuadro të shumta për të gjitha trojet ku jetonin shqiptarët, që prej Tivari e deri në Manastir. Kjo ishte medreseja e mesme "Alauddin", e cila ka mbushur 53 vjet të themelimit.

Për maturantët që kryenin medresenë e mesme dhe dëshironin t'i vazhdonin studimet, e vetmja zgjidhje ishte që ata të shkonin jashtë Kosovës në qendrat universitare të Botës Arabe, si në Kajro, Bagdad, Tripoli, Hartum, Damask, Islamabad, Tunis, Aman, Stamboll etj. Maturantët e parë shkuan në ato qendra në vitet e gjashtëdhjetë. Më vonë, me hapjen e Fakultetit Islamik të Sarajevës, një numër i studentëve studiuan atje.

Ndërkohë, me themelimin e Universitetit të Prishtinës në vitin 1970, në kuadër të Fakultetit Filozofik të atëhershëm, në vitin 1973 u themelua Katedra e Orientalistikës, ku një numër i medresantëve do t'i vazhdonin studimet.

Fakulteti Islam u bë realitet

Me ndryshimet sa i përket organizimit dhe kuadrove, që u bënë në Bashkësinë Islame të Kosovës në fund të vitit 1990, lindi ideja për themelimin e Fakultetit të Studimeve Islame të Prishtinës në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës. Mirëpo, themelimi i një institucioni të lartë edukativo-arsimor në ato rrethana të vështira nëpër të cilat po kalonte Kosova, ishte sa një nder po aq ishte edhe përgjegjësi e madhe. Në të njëjtën kohë ky hap përbënte një sfidë të madhe për pushtetin serb, sepse Kosova jo vetëm i ruante me një fanatizëm të madh të gjitha institucionet edukativo-arsimore të të gjitha niveleve me anën e ndërtimit të sistemit paralel, por ajo po themelonte edhe institucione të reja, që ishte një argument i ri se Kosova ishte nisur drejt rrugës së pavarësimit të saj.

Kështu, pas të gjitha përgatitjeve të duhura nga ana e Kryesisë së BI dhe propozimeve të saj, Kuvendi i BI të Kosovës mori vendimin nr. 443/92, më datën 1 gusht 1992, për themelimin e Fakultetit të Studimeve Islame të Prishtinës. Fakulteti filloi punën mësimore-shkencore më 7 dhjetor 1992. Në një solemnitet modest rasti, fjalën e hapjes e mbajti Dr. Rexhep Boja në emër të Kryesisë së BI të Kosovës dhe në të njëjtën kohë ushtrues i detyrës së dekanit, kurse ligjëratën e parë e mbajti veterani i arsimit islam në Kosovë, Haxhi Sherif ef. Ahmeti.

Në vitin e parë akademik 1992/93 qenë regjistruar 30 studentë, prej të cilëve 10 me korrespondencë, nga të gjitha trojet shqiptare. Vitin që shkoi fakulteti kremtoi 10-vjetorin e fillimit të punës. Gjatë këtij viti absolvon gjenerata e nëntë. Numri i përgjithshëm i studentëve në të katër vitet, të rregullt dhe me korrespondencë, është afro 120. Ata vijnë nga të gjitha trojet shqiptare: nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi , Presheva dhe Bujanoci. Meqenëse vitet e fundit në kuadër të medresesë së mesme "Alauddin" dhe paraleleve të saj të ndara në Prizren dhe Gjilan, janë formuar edhe dy paralele të vajzave në Prishtinë dhe Prizren, numri i studenteve është shtuar dukshëm, kë-

shtu që proporcioni në studime është 60% studentë e 40% studente. Numri i kandidatëve që konkurrojnë për studime është më i madh sesa ka mundësi Fakulteti t'i pranojë, prandaj ata i shtrohen provimit pranues. Interesim për t'u pranuar në Fakultet tregon edhe një numër i konsideruar i nxënësve që kanë mbaruar shkolla të tjera të mesme.

Studimet në FSI zgjatin 8 semestra; në të mësohen 23 lëndë, 80% janë lëndë profesionale e 20% lëndë të karakterit të përgjithshëm. Në fakultet përveç gjuhës shqipe, mësohen edhe gjuhët e huaja: gjuha arabe, turke dhe angleze.

Studenti, pas dhënies së të gjitha provimeve sipas Statutit, është i obliguar të përgatit punimin e diplomës dhe atë ta mbrojë para komisionit përkatës. Deri më sot janë diplomuar 35 studentë. Sa i përket shtrirjes gjeografike të tyre, 3 janë nga Maqedonia, 2 nga Mali i Zi, 2 nga Presheva, 1 nga Palestina, ndërsa të tjerët janë nga Kosova. Të diplomuarit janë punësuar në Bashkësinë Islame ose në institucione të tjera. Një numër i konsiderueshëm i tyre vazhdojnë studimet pasuniversitare në Universitetet e Prishtinës, Tetovës, në Siri, Liban , Egjipt etj.

Në Fakultet punojnë 21 pedagogë, 4 doktorë shkence, 5 magjistra, ndërsa të tjerët janë në rrugë e sipër për marrjen e titujve shkencorë.

Prioritete në të ardhmen

Kryesia e BI e Kosovës, është e vetëdijshme se Fakulteti i Studimeve Islame si institucion më i lartë edukativo-arsimor, ka nevojë për një përkrahje më të madhe morale dhe financiare në rrugën drejt zhvillimit dhe pavarësimit të tij si në aspektin organizativ, ashtu edhe në atë financiar. Rrethanat nëpër të cilat kaloi në të kaluarën Kosova në përgjithësi dhe BI në veçanti, nuk mundësuan një gjë të tillë. Mirëpo, ky është një obligim që ka Kryesia e BI ndaj Fakultetit si mbikëqyrëse dhe përgjegjëse e drejtpërdrejtë për punën dhe aktivitetin e tij. Është vështirë të arrihet një përparim e zhvillim i gjithmbarshëm pa një përkrahje të duhur financiare.

Prej prioriteteve të Fakultetit të Studimeve Islame të Prishtinës janë:

- Përgatitja e kuadrove të reja të të gjithë lëmenjve për të cilët ka nevojë fakulteti, sidomos në sferën e lëndëve profesionale;
- Këmbimi i përvojave me fakultetet e tjera, si sjellja e profesorëve vizitorë për mbajtje ligjëratash për kohë të caktuar.
- Përshtatja e planprogrameve sipas nevojave dhe kërkesave të kohës, me qëllim që studentët të jenë në gjendje të ballafaqohen me problemet e shoqërisë ku ata do të veprojnë pas kryerjes së fakultetit dhe t'i dalin në ndihmë asaj;
- Hapja e drejtimit pedagogjik në kuadër të fakultetit si nevojë e domosdoshme për përgatitjen e kuadrove adekuate për mbajtjen e lëndës së edukatës fetare, e cila shpresojmë se në një të ardhme të afërt do të hyjë në planprogramet e shkollave edhe në Kosovë edhe në Shqipëri;
- Ndërtimi i godinës së re të fakultetit, me të gjitha objektet e nevojshme;
- Anëtarësimi i FSI-së në Asociacionin e Universiteteve Islame;
- Përgatitja e projektit për themelimin e Institutit të Studimeve dhe Kërkimeve Islame në kuadër të FSI-së;
- Themelimi i Bibliotekës Qendore të doreshkrimeve Islame;
- Themelimi i Muzeut islam.

Për një plan pak më afatgjatë do të punohet për zgjërimin e fakultetit në një Universitet islam, ku do të mësoheshin dhe studioheshin të gjitha shkencat, sepse Islami asnjëherë nuk ka bërë ndarjen e shkencave në ato fetare dhe jofetare apo shekullare. Sipas Islamit, edhe mjeku që i lehtëson dhembjet një të smuri, por edhe arkitekti që bën planin e një ndërteseje të bukur, edhe veterinari që merret me studimin e kafshëve, edhe bujku që kultivon bimët - të gjithë këta janë në rrugën e Allahut dhe zbatojnë urdhrat e Tij.

Sfidat që na presin

Pyetja që shtrohet para nesh është: Cila do të jetë perspektiva e arsimit fetar në të ardhmen në epokën e globalizmit dhe sfidave të shumta me të cilat ballafaqohemi?

Përgjigjja nuk është fare e lehtë, sidomos për ne që në këto kohë të vështira kemi marrë mbi vete një emanet kaq të rëndë dhe me përgjegjësi shumë të madhe. Ekzistimi i institucioneve edukativo-arsimore, qofshin ato të niveleve më të ulëta, si mejtepet, apo të nivelit të mesëm, si medresetë, dhe atyre më të lartave-fakultetet islame janë garanci e vetme e mbijetesës sonë dhe të brezave të ardhshëm në këto troje me identitetin tonë fetar islam. Prandaj, hapja e Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup është një e arritur shumë e madhe në këtë drejtim. Mbetet që një institucion i këtillë të themelohet sa më parë të jetë e mundur edhe në Tiranë.

Pavarësisht nga vështirësitë e shumta me të cilat ballafaqohemi besoj se nuk duhet të ketë vend për pesimizëm të tepruar, por as për optimizëm pa mbulesë.

Ne kemi potencialin njerëzor; kemi kuadro të reja, që janë të aftë dhe kanë dëshirë e vullnet për punë; kemi edhe mundësi financiare, edhe pse jo ndoshta sa kërkohen; kemi historinë tonë, kemi identitetin tonë. Ajo që na mungon, është organizimi i dobët, moskoordinimi i punëve, na mungon një strategji e përbashkët dhe afatgjatë për arsimin fetar. Shpresoj se kjo tryezë e rrumbullakët do të jetë një nismë e mbarë për ta çuar përpara një segment tejet të rëndësishëm dhe shumë vital të jetës sonë, që është arsimi fetar në suazat e Bashkësisë Fetare, sepse ai nuk ka të bëjë vetëm me ne, por edhe me brezat që do të vijnë. Prandaj, nuk është thënë kot se në këtë botë aq dinamike mund të mbijetojnë vetëm ata që janë në gjendje të ballafaqohen me sfidat.

Mr.Sc. Qemajl Morina

THE EFFORTS OF THE ISLAMIC COMMUNITY OF KOSOVA IN THE DEVELOPMENT OF UNIVERSITY EDUCATION THROUGH THE FACULTY OF ISLAMIC STUDIES IN PRISHTINA

(Summary)

Education is considered one of the pillars of national security and cultural life in developed countries; by it we determine the level of development of a country and its position among other countries. Progress in the educational system means progress in all walks of life.

The tradition of religious education was introduced in the Albanian lands more than six centuries ago and begins in the first years of the Ottoman occupation of this part of the Balkans, during which, along with the embracement of Islam, the process of education and spread of Islamic culture and civilization began. As a result, in many places in Albanian lands began the establishments of institutions of religious and educational character as mosques, madrases, libraries, masjids etc. These were institutions that served the Muslims of these parts to learn the religious teachings and other sciences. These institutions have preserved the religious and national tradition of our people.

كمال مورينا

مساعى المشيخة الاسلامية فى كوسوفا
لتطوير التعليم الاسلامى فى اطار كلية الدراسات الاسلامية
(خلاصة البحث)

لا شك أن التعليم يعتبر احد ركائز الامن القومى والحياة الثقافية فى الدول المتقدمة. و اعتمادا عليه يتم تحديد مستوى تقدم الدولة ومكانتها بين سائر دول العالم, لانه يفهم تلقائيا بان التقدم فى التعليم يعنى التقدم فى سائر مجالات الحياة.

ان تاريخ التعليم الاسلامى فى الاراضى الالبانية ذات جذور قديمة اكثر من ستة قرون والذى يبدأ بقدوم العثمانيين شبه جزيرة البلقان حيث مع بداية اعتناق الدين الاسلامى يبدأ التعليم الاسلامى كركيزة مهمة لانتشار الحضارة والثقافة الاسلامية.

KUMTESA

Akad. Dr. Feti Mehdiu

RELIGIOLINGUISTIKA ISLAME NË KËNGËT POPULLORE SHQIPTARE*

Feja është e vjetër aq sa edhe gjinia njerëzore. Konstatimi i historianëve të kulturës është se mund të gjesh popuj që nuk kanë kinema, nuk kanë teatër, nuk kanë shtëpi kulture… por nuk mund të gjesh popull që nuk ka faltore, ku ata kryejnë ritet e tyre të adhurimit ndaj Zotit. Kurse shkrimtari i njohur francez Bodler, thoshte se nuk ka asgjë në botë më interesante se feja. Kjo dëshmon se elementi fetar jeton në shpirtin e çdo populli dhe është i pranishëm në tërë veprimet e njeriut.

Prandaj krijimtaria popullore: këngët, tregimet, fjalët e urta, lojërat, vallet etj., meritojnë një qasje dhe hulumtim e studim më të thellë dhe analizë të hollësishme, sepse aty gjejmë të shtresuar, përveç historisë së atij populli, etnologjisë etj., edhe bindjen fetare. Folklori shqiptar, me sa di, është studiuar nga disa aspekte, por elementi fetar, për arsye të njohura gjatë një periudhe 50-vjeçare – gjatë sistemit monist 1945-1990 - është injoruar tërësisht, ose është marrë në shqyrtim vetëm kalimthi, kryesisht në kontekst negativ. Elementi fetar është

* Kumtesë e lexuar në Simpoziumin e Dytë Ndërkombëtar: "Qytetërimi Islam në Ballkan", mbajtur në Tiranë 4-7 dhjetor 2003.

shtresuar dhe ngulitur në qytetërimet e tërë botës . Elementi i kulturës dhe qytetërimit islam është i pranishëm tek të gjithë popujt e Ballkanit në forma të ndryshme, sidomos në kulturën materiale[1] dhe në kulturën shpirtërore [2] të popullit shqiptarë.

Dielli, Hëna, yjet…, tek ilirët, p.sh. nuk janë mjet që shpreh ekskluzivisht besimin e ilirëve. Këta trupa qiellor i adhuronin edhe paraardhësit e H. Ibrahimit a.s.[3] Më vonë hasim kryqin dhe format e tij të ndryshme, që paraqesin një shkallë më të zhvilluar të monoteizmit, ngase të gjithë i referohen Krishtit si një subjekt që duhet besuar sipas Besëlidhjes. Aty thuhet: *Zoti juaj jam unë, mos adhuroni tjetër përveç meje*, një sentencë kjo që korrespondon me ajetin e Kur'anit: "Unë jam All-llahu, nuk ka zot tjetër përveç meje, adhuromëni Mua!"

Unë, me këtë shkrim modest, do të bëj një përpjekje për të hapur një shteg, sado të vogël, për një trajtim më të hollësishëm të dy tezave që janë shtruar në planin orientues për këtë Konferencë shkencore shumë të rëndësishme dhe të qëlluar. Ato janë:

Vlera të kulturës dhe qytetërimit islam në krijimtarinë gojore
Vlera të kulturës dhe qytetërimit islam në ligjërimin gjuhësor.

Kultura dhe qytetërimi islam në krijimtarinë gojore , por edhe në ligjërimin gjuhësor në gjuhën shqipe, janë bërë – në situata të caktuara - pjesë e pandashme dhe e pazëvendësueshme me mjete të gjuhës shqipe. Megjithë disa përpjekje, madje qysh në kohën e Hoxhë Vokrr-

[1] Krahaso ndërtime të ndryshme, shtëpia ura, arka, rrethoja shtëpish etj. me se janë dekoruar: Dielli, Hëna, yje të ndryshme, kryqa, minare xhamish, etj.

[2] Krahaso këngë popullore historike, legjendare , epike etj., madje edhe lojëra popullore e rrëfime të ndryshme.

[3] Krahaso në Kur'an, suren 6 (An'am, ajetet: 76-78 "Dhe kur ra nata, ai pa një yll dhe tha: "Ky është Zoti im"!, por pasi perëndoi, ai tha: Nuk i dua ata që perendojnë!" E kur e pa Hënën që po lindte tha: Kjo është Zoti im, e pasi edhe ajo perëndoi, ky tha: "Nëse Zoti im nuk më drejton në rrugë të drejtë, unë me siguri do të jem nga ata që kanë dështuar. Por, kur e pa Diellin si po lind, ai thirri: Ky është Zoti im, ky është më i madh! Mirëpo, pasi edhe ai perendoi, tha: O populli im, unë heq dorë nga politeizmi juaj. Unë po e drejtoj fytyrën time si besimtar i vërtetë nga Ai që ka krijuar qiejt e Tokën, dhe unë nuk jam politeist".

it (S. Najdenit)[4], që emërtimi i pesë kohëve të namazit të zëvendësoh-ej me shprehjet shqipe, si: fal mëngjezin, fal pasdrekën, fal pasdarkën, etj., në folklorin shqiptar kanë mbetur të paprekura.

Ka kohë që jam duke vjelë e veçuar shembuj nga kjo fushë për qëllime të ndryshme. Me këtë rast dëshiroj t'i qasem kësaj çeshtjeje nga këndvështrimi gjuhësor e religjioz, me vështrim të veçantë mbi vlerat e elementit islam. Nuk thellohem këtu, në trajtimin e elementit gjuhësor, i cili si rrjedhojë e pranisë dhe ndikimit të kulturës islame në këto troje, është ngulitur në ligjërimin gjuhësor tek ky popull i Ballkanit – tek shqiptarët, vetëm si mjet teknik, dhe është bërë pjesë e inventarit gjuhësor. Unë do të provoj të veçoj atë pjesë nga ky inventar gjuhësor, e cila shpreh një bindje të ngulitur në ndërgjegjen e këtij populli e që spontanisht shpërthen në krijimet popullore. Këto shpërthime të shprehura me anë të disa fjalëve të caktuara, të cilat janë ekskluzivisht shprehje e bindjes fetare, japin një tablo të elementit fetar të shtresuar në vazhdimësi që prej kohës pagane , krishtere, islame, e deri sot në vetëdijen e këtij populli.

Kam zgjedhur ato njësi leksikore[5], të cilat, nëse i zhveshim nga ngjyra fetare, nuk do të kishin asnjëfarë kuptimi në kontekstin e përdorur. Thënë më qartë, do të paralizohet plotësisht përcjellja e mesazhit tek pala ndërkomunikuese.

Përë këtë studim jam përqendruar te vëllimi i këngëve të botuara në librin: **ZANA POPULLORE**[6] dhe kam veçuar këto njësi leksikore: *All-llah, abdest, aksham, ahiret, ahirzeman, amin, Baki, bil-lahi, bismil-lahi; Din, dua, Dhyl-xhelal; Ezan, ezel, exhel, Err-rrahman, Fe, fetva, Gafurr-rrahim; Gjynah, Hallall, haram, hak, haxhi, hazret , hoxhë, hytbe; Iman, inshallah – ishallah, iqindi, Jaci; Kabull, kadi, kishë, kurban, ; Marshallah, melek, merhum, (merhamet – tek këngët e vjetra qytetare, merhamet në këtë ashik), minare, mulla(molla); Na-*

[4] Hoxhë Voka, Ferrëfenjësa e muslimanëve, Sofje, 1900.

[5] Këto njësi nuk janë të izoluara, ato janë të mishëruara me elemente përcjellëse të gjuhës shqipe, si: fal (sabahin); në (iqindi); n' (aksham); n' (ezel); me ba (bajram); asht (gafurr Rrahman); dajë (zeqatin); p'riza (t'Zotit); me (qitabë); (abdes) me marrë, etj.

[6] Kasem Taipi, ZANA POPULLORE, Shkodër, 1933, f.202.

maz, Perendija, pejgamber, popa; Qafir – qyffar,qerm, qitab; Ramazan, rahmet, rab-bu-l-alemin; rrahman; Sabah, sallat, selam, ; Shehid- shehit, sheriat, shura, sheh Islam; Tealaja; Xhamija, xhenaze, xhennet,; Ylema, ymmeti Muhammed; Zeqat; Zot.

Janë edhe një mori fjalësh të cilat përdoren në këngë të tjera, jashtë këtij botimi,të cilat mund të jenë objekt shqyrtimi me ndonjë rast tjetër, madje edhe në këngët zbavitëse bashkëkohore, si: mëkati, mëkatare, ferri, parajsa,[7] Kur'ani, perria, hyria,etj.

Ndër këto fjalë që kam sjellë këtu, mbizotëron Zot-i, i cili është përmendur më së shpeshti me disa funksione: deklarativ, betim, përbetim, urim, mallkim, lutje etj.. Këtë mund ta marrim si element fetar për të gjitha periudhat e zhvillimt historik të shqiptarëve që prej kohës pagane e deri sot; fjalën pop, e hasim më pak, dhe kjo mund të konsiderohet e shekujve 10 a 11, kur ndahet Krishterimi në dy kisha: Lindore dhe Perëndimore . Të tjerat kanë të bëjnë me përkatësinë islame dhe paraqesin akumulimin e vlerave të qytetërimit Islam, si : abdesti, xhamija, minarja, hytbja,[8] ose të kulturës islame, si: me fal sabahin, bismil-lahi, hallall,[9] madje ka edhe që ngërthejnë të dy këto elemente, edhe qytetërimin edhe kulturën, si zeqati, ezani, haxhija,[10] etj. Për këto mund të themi se në folklorin shqiptar kanë zënë vend prej shekullit 14 e këndej.

Meqë këto fjalë shprehin bindjen fetare, mendoj se mund të flitet për një element të veçantë të gjuhës, i cili mund të emërtohet religiolinguistikë, me gjithë faktin se ka raste kur këto fjalë nuk janë ekskluzivisht në funksion religjioz, ndonjëherë kanë edhe funksion stilistik.

[7] Krahaso; Një bahçe me trandafila – është parajsa e vërtetë;
Ti që digjesh n'mbramje n'aksham – se me ty këndohet Kur'an;
S' du të digjem si në zjarr të ferrit etj.

[8] Këto bëjnë pjesë në vlera të qytetërimit islam, ngase abdesti, xhamia, minarja, hytbeja, nuk mund të merren me mend e as të realizohen pa objektin apo mjetin përkatës.

[9] Këto shprehin thjesht vetëm një veprim të kultit islam, një adhurim të caktuar ose shprehje.

[10] Për të zbatuar këto akte, përveç bindjes se duhet t'i kryejsh këto obligime, duhet të ekzistojnë edhe mjetet teknike, materiale, si edhe mekanizmat e caktuar. Në të kundërtën nuk mund të realizohen.

Këtu do të përmendim disa ilustrime:[11]

Me yryç i dha taborrit - **Allah Allah**[12] tue thirrë
Por a koha **abdes** me marrë
Të shtunën mbraba **n'aksham**
Kena ba luftë deri me mbretin – Ju mos e gjetshi **ahiretin**
Jan fitnet e **ahirzemanit** – Mos u dashim prej **imanit**

Gjallë vatanin s'duem me lëshue
Por due luftën me fillue
Të gjithë përnjiherit: **Aminë** – ia kinë ba

S'na len hasmi **me ba bajram**

Hi – Hyqmi i padishahit – Asht **baki** deri në **kijamet**.

Be – **Bil-lahi** me na fal
Bismil-lah senja me tetë – Me **iman** kush don me dek
Besmil-lah Muji paska ba – Derën e burgit muji e paska çilë

Bini mirë **qafirit** - për hatër të **dinit**
Kush të jetë turk me **dinë e iman** – Nuk do të lamë në Serreq mejhan

Nji **dua** i u bani hallkut – Për me i ardhë dushmanit hakut
Se këta janë **duaxhit** e tu – **Pejgambert** veç së kanë gabu

He – Hidajet me na pështu – Emri yt **Dhyl-xhelalë**

[11] Për ilustrim kemi marrë vargun integral dhe në atë varg kemi theksuar – me të zeza – pjesën për të cilën flitet në kontekstin konkret.

[12] All-llah është emërtim (karakteristik) për Krijuesin e botëve, të Cilin e hasim vetëm në periudhën post-kuranore, do të thotë në shekullin e shtatë, dhe në tekstet shqipe nuk mund të haset para shekullit 15. Për këtë funksion, në gjuhën shqipe përdoren edhe emërtimet Zot dhe Perëndi. Mirëpo dallimi ndërmjet këtyre dy të fundit e të parit qëndron në faktin se këto të dyja kanë numër: zota.. dhe gjini: perendeshë-a; kurse emërtimi All-llah nuk ka as numër as gjini. Kështu është edhe në burimet islame: Kur'an dhe Hadith. Prandaj është i arsyeshëm rekomandimi që të përdoret termi All-llah.
Në këtë kontekst është ekskluzivisht element islam, madje me këtë: All-llahu ekber, hapet edhe çdo namaz. Përveç All-llah në këngët shqipe kemi edhe emrat përshkrues për këtë, si: Dhu-l-xhelali, Bari tealaja, Haku, Gafurr Rrahman, Gafurr Rrahim etj.

Rahmet paqin turqit të tanë – Shpejt e këndoj **hoxha ezanë**

Baftin edhe kyvetin - Qysh **n'ezel** ia ka dhanë **Perendija**

Nën kapuç pushkën ta vuna – Kur **exhelin** s'mund t'a pruna.

Zoti deuletlisë ja dha - **Errahmani rrahimi**

Met Gjin Leka trim si rrëfe – Në saraj jetën dha për **fe**

Sheh islami fetvanë e qiti

The – Thërrasim çka asht **n'iman – Zoti asht gafurr-rrahim**.

Unë e di por kam **gjynah** – At **gjynah** ti lena ne

Ja dha hyqmin Sulltani – **Hallall** ju qoft **imani**

Rrahi teli mbretit memleqetit – **Haram** të qoft o Pashë ylefeja e mbretit

Ha – **Haku** e ka në dorë – Se deuleti na ka lëshu

Dynjaja kuej s'ka me i mbetë – Më sa **hazreti Sylejmanit**

Mori tata mori hore – **Hoxhës** me xhybe çka i lakmove

Mbasi u ba fet'h Misiri – E u këndue **hytbja** gazi

I ndien zanin **haxhi** Idrizit…
Jam **haxhija** qi më kanë thanë…

Bini mirë dushmanit-e - Për hatër **t'imanit- e**
Thrrasim çka asht **n'iman – Zoti asht gafurr Rrahman;**
Kush të jetë turk **ehli iman** – Mos me i ba kaurrit itaat
Me **sheriat** për hatër **t'imanit** –Për me i ardhë hakut Mark Milanit

Urdhno beg e ban qerm – **Ishalla** kur të himë në Pezeren
çonu djem **me fal sabahin** – **Ishalla Zoti** na çil baftin

T' enjten mbrama **n'iqindi** – njikjo punë ka ba vaki
Të marten mbrama **në jaci** – Në Shkodër u zu nizaja

Ju **kabull** ju ba rixhaja – Borç përsëri ju ba **duaja**
Në Mehqeme n'odë të **kadisë** – Shkodra të venë e bani
Ku kam **kishën** qi më kanë çartë
Kurban t'u bajshim gjith si jena – Në **dua** kusur nuk kena

Daut Pasha me dyrbi – **Marshallah** fistanli
Melekët për këtë rrijnë hazër – Edhe **Zoti** ju ep nysret
çka qe mbrendë u ba mahzun – Komandanti **u ba merhumë**
Hypi **hoxha në minare**
Molla Ahmed efendija

Nun – **Namazin** mos me harru – Vuqela-i salihinë

Be – Bytyn na kanë lëshu – Në dorë na ka **Perendija**
Nuk pat faj shumë Rumelija – Ka ba emër **Perendija**
Pejgambert e evlijat – Këta nuk dinë çka a dynjaja

Dymdhet **popa** fjetun ke me i gjetë

Dymdhet letra **qafiri** i ka shkru – Ali Pashës në Guci ja ka çuë
Dy taborre shtat bajrakë – na ka lyp **qafiri** gratë

Ha – Hilaf ashtë për turqni – Me e da **sherjatin qyfari**

Sat- Sahih si thotë **qitabi** – për me i ndejë karshi **qyffarit**
Ti – T'i lutna atij **Qeremit** – Bjerna sulltanin n'insafë

Ylemaja na ka mësue – Me **qitabë** tuj këndue

Me dy javë në **Ramazan** – Na u këndue nji ferman
Tridhet **dit e Ramaznë** – Po të qes **Zotin** qi më ka dhanë

Sul Mustafa moj lale gjetet **rahmet** – Ja merr gjakun moj lale baba i vet

Kaf – Kyvet me pas Sulltani – Kuer don **Rabbu-l-alemini**

He – hidajeti **i rrahmanit** – Dauletin ka m'e madhnu

A don djalë **sabahin me fal**

Kur t'a fal i madhi **Zot sabahin**

Në kala po thërrasin **sallet**

Të gjith Shqypnija **selam** të ka çue – Për vatan çka na thue?

Haxhi Alija shehiti detit – Shpata e yte lule **xhenetit**
Gaza të bojmë e **shehit** të jesim – Sot a dita qi do të desim

Shin - **Sherijatin** qi ka turqnija – Nuk po kqyret në këtë zaman
Turqve ju thanë po del **sherijati** – Si në vakt të **hazreti Muhammedit**

Dervish Pasha rri n'kala – Mbledh Mishlizin ban **shura**
Mebuthanët me xhemijet – **Sheh Islamin** thërrasin shpejt

Iptida u nis nizaja – Sebep ban **Bari tealaja**

Molla Ademi në xhami – Na tradhëtoj ky ylti
Rahmet past Molla Velija

Aman Rusto pashë jetën tane – shumë **xhenazet** Rusto i bane

Shokëve të vet ju nep gajret
Jalla burra në franji
Se shkojmë lule në xhennet

Në Stamboll u mblodh **ylemaja** – Përmbi Nemc u këndu **duaja**
Janë rrethue disa shkodranë – çoj e thirri **ylemanë**

Ndi telallin kah po thërret –
çou **ymmeti Muhammed,**
se ne mbreti po na shet

Shkrepi dielli buzë nji malit – ç'po shndrrisin gurt e kalas
Gani Beg, Gani Beg Toptani – Dajë **zeqatin** fukarasë

Krisi pushka edhe topi – çonu djelm **na ndihmoft Zoti**
Shpata yte mos pushoft – gajretin **Zoti** ta shtoft

Nga shembujt e përmendur, studiuesi i kujdesshëm do të dallojë lehtë fondin leksikor që ngërthen në vete vlera të qytetërimit dhe kulturës islame. Për shembull, ai mund ta dallojë zeqatin si një veprim ekskluzivisht islam, me zbatimin e të cilit lidhen ngushtë vepra të kulturës materiale islame, si xhamia, minarja, abdesti, etj. Zeqati si një obligim material, është edhe adhurim (ibadet), edhe bazë për balancimin financiar të shtetit. Nuk është si tatimet e zakonshme që paguajnë qytetarët e çdo shteti modern. Ky obligim – lloj tatimi specifik – është urdhëruar në librin e shenjtë - Kur'anin dhe është i lidhur ngushtë me një nga shtyllat kryesore të fesë islame, e cila bën pjesë në kulturën shpirtërore islame – që është namazi. (salatun) Shumë herë në Kur'an, menjëherë, sapo urdhërohet falja e namazit, urdhërohet edhe dhënia e zeqatit, por këto janë obligime për ata që i besojnë Kur'anit. Nuk i obligon qytetarët e tjerë që jetojnë në të njëjtin shtet, po që nuk i përkasin fesë islame.

Po ashtu e dallon nocionin Zot, për të cilin këngëtari popullor shpreh bindjen e plotë dhe besimin në gjithëfuqishmërinë e Tij, duke e emërtuar edhe me epitetet: Rrahman, Rrahim, Hak, Bari tealaja, Gafur rrahim, Gafur-rrahman, Dhy-l-xhelal, i Madhi etj., i bindur se vetëm Ai ka mundësi të bëjë gjithçka, prandaj

i l u t e t:
*Banëm **Zot** bilbil mbi dardhë – sa ta shoh Mihanen në këmishë të bardhë;*
*çohi djem me **fal sabahin – ishalla Zoti** na çil baftin;*

e lëvdon dhe e falënderon:

Lum e lum për Zotin të lumin – Na s'kemi kenë e Zoti na ka dhanë;

u r o n :
Kanga qoft si kanë ba motit – E na paçim ndihmën e Zotit,
Shpata yte mos pushoft – gajretin Zoti ta shtoft;
çonu djem na ndihmoft Zoti;

m a l l k o n:
Le Ali Zoti ty vraft,
Ndale gjokun Mujë Zoti të vraft;

b e t o h e t d h e p ë r b e n:
Pashë Zotin Mujë qi të ka dhanë,
Pashë nji Zot jue qi ju ka dhanë;

Tobe m'Zotin në kjesh tuj e marrë,
Be në Zotin nanë qi kam pa ba,

P'rize t' Zotit thujmi Shabanit
Mos i hani paret e kralit etj.

Përveç kësaj, vlerat islame për atdhedashurinë në këto këngë ngrenë moralin e luftëtarit për liri, aq sa ai më tepër e dëshiron vdekjen për liri të atdheut sesa jetën, për shkak se me këtë akt ai, si shehid, fiton Xhennetin:

Haxhi Alija shehit i detit – shpata yte lule xhenetit

Ose
Gajret Sulltan he Zoti mos të frëykt – se bashk me daten në bijm shehëit.

Me anë të këtyre formave, krahas vlerave humanitare, patriotike e etike janë kultivuar edhe vlerat monoteiste dhe janë denoncuar tendencat për të mbjellë idenë e politeizmit, i cili ka provuar, i mbështjellë me maskën e ateizmit,[13] të lëshojë rrënjë te populli shqiptar.

Askund në gjeti nuk i gjemë kaq bukur të bashkuar nocionet: din, iman, ramazan dhe bajram, e të lidhur aq ngushtë me besën, sikur që i kemi te kënga Hasan aga r Cika potureshë:

[13] Kjo i referohet periudhës së sundimit komunist në trojet shqiptare (1945-1990), në të cilën periudhë kishte njerëz që betoheshin " për nder t' partisë; Pasha nderën e partisë; I qofshim falë partisë etj.

Shoqi-shoqit ja kan dhanë ka j'besë
Kan lidh besën bash në din e iman
Ramazanat peng i kan lanë
Dybajramat i kanë lanë dorëzanë
Kur t'i bajna ka pesmëdhet vjet
Bashk n'xherdek të dy kem me fjetë[14]

Ky element i religiolinguistikës përshkon tërë krijimtarinë poetike popullore tek shqiptarët si në këngët kreshnike, historike, lirike, përfshirë këtu edhe këngët më të reja,[15] dhe obligon studiuesit e këtyre fushave që edhe këtij elementi t'i japin vendin e merituar në atë mozaik vlerash që përbëjnë traditën e krijimtarisë gojore në folklorin shqiptar.

[14] Nga repertori i rapsodit popullor Muharem Gashi - Mramor. I shpreh mirënjohjet e mia të sinqerta për bashkëpunim ekspeditiv.

[15] Shih: Mbushe vasho mbushe gjerdanin fishekë – me ja kthy shpinën Kosovës droj **Zoti** po m'vret;
Për **Zot** edhe për atdhe – për këtë tokë e këtë flamur…;
M' ka fal Z o t i për këtë dit – durt e mija këtë flamur me ngrit;
Kosovare t' vraft nji Z o t – dil si dill e dil si han… etj.

Dr.Feti Mehdiu

THE RELIGIOLINGUISTC IN THE ALBANIAN PEOPLE SINGS

(Summary)

In this contribution we are analyzing a problem that is not treated until naw.

In all editions of Albanian folklore, prose or poetry, at the end it is given a kind of dictionary of unknoën word. There, these words come anly as a technical terms (utterance) to complete the utternance.

I will not mention here words (as a technical terms) but I have piched up and separates those words as utterances that are something more than technical utterances, that have in itselves a deepez meaning for a determined field.

There words as a poret of folklore lexicon I have denominated religiolimguistic.

According do my opinion, this denomination is appropriate because the notion: *Zot, melaqe, qitape,zeqatë, sabah, niqah, hallall, dhu-l-xhelal, mashallah, inshallah, iqindi,* ferri, take part in those lexical monits that can not be substituted with words of any other language in the concrete context thre woerds are used attended with. Albanian linguistic elements, such as, *Pasha Zotin, I lumi Zot, Zoti Ju vraft… fal sabahin, jep zeqatin, do t'I lutem dhulxhelalit, hypi hoxha në minare….*

The matrial for this contribution I have piched up from some saurces, especially I was bared in "Zana popllore" edition, volume I, 1933, by Kasem Taipi.

د. فتحى مهدى

فقه اللغة الاسلامي في اللاغاني الشعبية الالبانية

(خلاصة البحث)

اود فى هذه المساهمة أن اتطرق الى موضوع لم يتم مناقشته من قبل. فى كل اعمال الفولكلور الالبانى سواء كانت شعرا او نثرا عادة يأتى فى النهاية. معجم للكلمات المجهولة و هذه الكلمات تأتى كاداة للتعبير. و هنا لا اريد ان اذكر الكلمات كادوات (تكنيكية) و لكننى اخترت الكلمات او التعبيرات التى هى اكثر من تعبيرات تكنيكية و التى لها اكثر من معنى و مدلول عميق فى مجال معين.

AKTUALITETE

Tahar Ben Jelloun

SI IA SHPJEGOVA VAJZËS SIME RACIZMIN

Hyrje

Duke shkuar në protesta me vajzën time, më 22 shkurt 1977, kundër projektligjit Debre[1] mbi hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në Francë, më lindi ideja të shkruaj këtë tekst. Vajza ime dymbëdhjetëvjeçare më shtroi shumë pyetje. Ajo donte të dinte për se protestonim, ç'kuptim kishin disa parulla dhe a ia vlente kjo që parakalonim në rrugë duke protestuar etj.

Kështu filluam të flasim mbi racizmin. Këtë tekst e shkrova duke i kujtuar pyetjet dhe mendimet e saj. Në fillim e lexuam së bashku. M'u desh ta shkruaja përsëri pothuaj tërësisht. T'i ndryshoja fjalët e ndërlikuara dhe t'i shpjegoja nocionet e vështira. Pastaj tekstin e lexuam së bashku me dy shoqet e saj. Reagimet e tyre qenë shumë interesante. Këto reagime i mora parasysh në versionet që i shkrova më pastaj. Që të jetë i qartë, i thjeshtë, objektiv, - këtë tekst e shkrova jo më pak se pesëmbëdhjetë herë.

[1] Ministër i punëve të brendshme në Qeverinë Franceze 1977.

Dëshiroja që të ishte i kuptueshëm për të gjithë, edhe pse se pari u kushtohej fëmijëve të moshës tetë deri katërmbëdhjetë vjeç. Por, mund ta lexojnë edhe prindërit e tyre.

Jam nisur nga parimi se lufta kundër racizmit fillon nga edukata. Fëmijët mund të edukohen, po të rriturit jo. Për këtë arsye këtë tekst e mendova dhe e shkrova me një përkujdesje pedagogjike.

Dëshiroj t'i falënderoj miqtë që patën mirësinë ta lexonin këtë tekst dhe të më njoftonin për vërejtjet e tyre.

Falënderoj po ashtu shoqet e Merjemes, që morën pjesë në përgatitjen e pyetjeve.

- *Më thuaj, baba, ç'është racizmi?*

- Racizmi është një sjellje-dukuri mjaft e përhapur, e përbashkët për të gjitha shoqëritë, e bërë mjerisht rëndom në disa vende, sepse nuk i kushtohet kujdes. Kjo rrjedh nga mosbesimi dhe, madje, nga përbuzja e njerëzve që kanë karakteristika të ndryshme fizike dhe kulturore nga tonat.

- *Kur thua "e përbashkët", ti do të thuash normale?*

- Jo. Një sjellje e rëndomtë nuk do të thotë se është normale.

Në përgjithësi, njeriu është i prirë të mos i besojë dikujt që është i ndryshëm nga ai, për shembull një të huaji-një të panjohuri; kjo është një sjellje aq e vjetër, sa është i vjetër edhe vetë njeriu; ajo është universale. Kjo i godet të gjithë.

- *Nëse i godet kjo të gjithë, a do të mund të bëhesha raciste unë?*

- Së pari, natyra spontane e fëmijës nuk është raciste. Fëmija nuk lind racist . Nëse prindërit ose të afërmit e tij nuk i kanë ngulitur në mendje ide raciste, nuk ka arsye të bëhet racist. Nëse, për shembull, të bindin se ata që e kanë lëkurën të bardhë, janë superiorë ndaj atyre lëkura e të cilëve është e zezë, nëse këtë pohim e merr seriozisht, ti do të mund të kishe sjellje raciste ndaj zezakëve.

- *Ç'do do të thotë të jesh superior?*

- Të jesh superior do të thotë, për shembull, për shkak se e ke lëkurën të bardhë, të besosh se je më intelegjent se dikush tjetër, lëkura e të cilit është e zezë ose e verdhë. Thënë ndryshe, tiparet fizike të tru-

pit të njeriut që na dallojnë nga njëri-tjetri, nuk shkaktojnë kurrfarë pabarazie.

- *Mendon se do të mund të bëhesha raciste?*

- Të bëhesh raciste, është e mundur; çdo gjë varet nga edukata që do ta kesh marrë.

Është më mirë ta dish dhe t'i shmangesh mundësisë që të bëhesh raciste, me fjalë të tjera, të pranosh idenë se çdo fëmijë ose çdo i rritur është në gjendje që një ditë të ketë ndjenjë dhe sjellje mohuese ndaj dikujt që nuk i ka bërë asgjë, vetëm sepse është i ndryshëm nga ai.

Kjo ndodh shpesh. Secili prej nesh, mund të ketë një ditë një gjest, një ndjenjë të keqe. Njeriu që nuk e kemi të afërt, na shqetëson, mendojmë se jemi më i mirë se ai, kemi ndjenjën se jemi qoftë më superior qoftë më inferior ndaj tij, e mohojmë, nuk e duam si fqinj, aq më pak si mik, thjesht sepse është fjala për dikë që është i ndryshëm.

- *I ndryshëm?*

-Ndryshimi (dallimi) është e kundërta e ngjashmërisë, e asaj që është identike. Ndryshimi i parë i dukshëm është gjinia. Burri ndihet ndryshe nga gruaja. Dhe reciprokisht. Kur është fjala për këtë ndryshim, në përgjithësi, ekziston simpatia.

"Prandaj, atë që e quajmë "të ndryshëm" ka ngjyrë tjetër të lëkurës nga ne, flet gjuhë tjetër, përgatit ushqim ndryshe nga ne, ka të tjera zakone, ka tjetër fe, ka mënyrë tjetër të jetës, feston ndryshe etj. Ka ndryshim që duket nga pamjet fizike (trupi, ngjyra e lëkurës, tiparet e fytyrës etj.) dhe pastaj ndryshim në sjellje, mentalitet dhe besim, etj.

- *Pra, racisti nuk i do gjuhët, artin e të gatuarit, ngjyrat, - që nuk janë të tijat?*

- Jo, nuk është krejtësisht ashtu; racisti mund t'i dojë dhe t'i mësojë gjuhët e tjera, sepse i nevojiten për punë ose për pushime, por ai mund të ketë gjykim negativ dhe jo të drejtë mbi popujt që i flasin këto gjuhë. Po ashtu, ai mund të refuzojë që t'ia japë me qira një dhomë një studenti të huaj, për shembull, një vietnamezi, dhe të refuzojë të ushqehet në restorantet aziatike. Racisti është ai që mendon se çdo gjë që është shumë e ndryshme nga ai, ia rrezikon qetësinë.

- *Racisti është ai që e ndien veten të rrezikuar?*

- Po, sepse ka frikë nga ai që nuk i përngjet. Racisti është një njeri që vuan nga kompleksi i inferioritetit ose i superioritetit. Kjo është njësoj, meqë sjellja e tij si në njërin ashtu edhe në rastin tjetër, do të jetë përbuzja-urrejtja.

- *Ai ka frikë?*

- Njeriu ka nevojë të jetë i qetë. Ai nuk e do shumë atë që është rrezik dhe mund ta pengojë në bindjet e tij. Ai është i prirë të mos besojë diçka që është e re. Shpesh kemi shumë frikë nga ajo (diçka) që nuk e njohim.

Në errësirë kemi frikë, sepse nuk shohim se ç'do të mund të na ndodhte kur të gjitha dritat janë të fikura. Ndihemi të pambrojtur përballë të panjohurit. Mendojmë gjëra të tmerrshme. Dhe pa arsye. Kjo nuk është logjike. Nganjëherë, nuk ka asgjë që justifikon frikën, dhe megjithatë kemi frikë. Rezonojmë pa të drejtë, reagojmë sikur të ekzistonte një kërcënim real. Racizmi nuk është diçka e drejtë ose e arsyeshme.

- Nëse racisti është një njeri që ka frikë, shefi i partisë[2] që nuk i do të huajt, duhet të ketë frikë përherë. Prandaj, çdoherë që paraqitet në televizion ai, jam unë që kam frikë!

Ai ulurin, kërcënon gazetarin dhe i bie tavolinës.

- Po, por shefi për të cilin po flet ti, është politikan i njohur për agresivitetin e tij. Racizmi i tij shprehet në mënyrë violente. Ai u komunikon njerëzve të painformuar mirë pohime të rrejshme, që ata të frikësohen. Ai e shfrytëzon nganjëherë frikën reale të njerëzve. Për shembull, ai u thotë se emigrantët vijnë në Francë për t'ua marrë punën francezëve, për t'ua marrë ndihmat familjare dhe për t'u shëruar gratis nëpër spitale.

Kjo nuk është e vërtetë. Emigrantët shpesh kryejnë punë që francezët i refuzojnë. Ata i paguajnë tatimet dhe japin kontributet për sigurimin social; ata kanë të drejtë të shërohen kur të sëmuren. Nëse nesër,

[2] Jean Marie Le Pen, kryetar i Partisë Nacionaliste, i cili vazhdimisht pohon se, nëse arrin në pushtet, do t'i largojë të gjithë të huajt nga Franca.

për fat të keq, i ndjekin të gjithë emigrantët nga Franca, ekonomia e këtij vendi do të shkatërrohej.

- *E kuptova. Racisti frikësohet pa arsye?*

- Ai frikësohet nga i huaji, nga ai të cilin nuk e njeh, sidomos nëse ky i huaj është më i varfër se ai. Ai më pak do t'i besojë një punëtori afrikan sesa një miliarderi amerikan.

Ose, thënë më mirë, kur një "emir" i Arabisë vjen për t'i kaluar pushimet në Bregdetin Axur, ai pritet krahhapur, sepse ai që pritet, nuk është arabi, por njeriu i pasur që ka ardhur për të shpenzuar para.

- *Ç'është i huaji?*

- Fjala i "huaj" do të thotë që vjen nga jashtë, i jashtëm. Kjo fjalë e tregon atë që nuk është i familjes, që nuk i takon klanit, ose grupit; është dikush që vjen nga një vend tjetër, qoftë nga një vend i afërt a i largët, nganjëherë nga një qytet ose nga një fshat tjetër. Kjo ka krijuar fjalën "ksenofobi", që do të thotë "armik i të huajve, i atij që vjen nga vendi i huaj". Sot fjala "etrange" (i huaj) tregon diçka të jashtëzakonshme, diçka shumë të ndryshme nga ajo që jemi mësuar të shohim. Si sinonim ka fjalën "i çuditshëm".

- *Kur shkoj tek shoqja ime në Normandi, unë jam e huaj?*

- Për banorët e vendit, po, pa dyshim, meqë vjen prej tjetër ane, prej Parisit, dhe sepse je marokene. Të kujtohet kur shkuam në Senegal? Pra, për senegalezët ne ishim të huaj.

- *Por, senegalezët nuk kishin frikë nga unë, dhe as unë prej tyre!*

- Po, sepse nëna jote dhe unë të patëm shpjeguar se ti nuk duhej të kishe frikë nga të huajt, qofshin ata të pasur a të varfër, të mëdhenj a të vegjël, të bardhë a të zinj. Mos harro! Gjithmonë jemi të huaj për dikë, do të thotë gjithmonë shikohemi si dikush i çuditshëm nga ai që nuk i takon qytetërimit tonë.

- *Më thuaj, babë, nuk e kam ende të qartë përse racizmi ekziston çdokund nga pak?*

- Në shoqëritë shumë të vjetra, të quajtura primitive, njeriu kishte një sjellje të afërt me atë të kafshës.

Macja nis të shënojë territorin e vet. Nëse një mace ose nje kafshë tjetër tenton t'ia rrëmbejë ushqimin ose t'ia marrë të vegjlit e saj,

macja që e ndien veten në shtëpi të vet, i mbron dhe i pruan të vegjlit e vet me tërë kthetrat. Njeriu është i tillë. Ai dëshiron të ketë shtëpinë e vet, tokën e vet, pasurinë e vet dhe lufton për t'i mbrojtur ato.

Kjo gjë është normale. Racisti, ai mendon se i huaji, cilido që të jetë, do t'ia marrë të mirat-pasurinë. Pra, ai nuk i beson, madje pa menduar, pothuaj nga instinkti. Kafsha lufton vetëm nëse sulmohet. Po, njeriu, nganjëherë, e sulmon të huajin madje pa pasur qëllim që ky (i huaji) t'i marrë çfarëdo qoftë.

- *Dhe ti këtë e konsideron të rëndomtë për të gjitha shoqëritë?*

- Të rëndomtë, mjaft të përhapur, po normale - jo.

Që prej shumë kohësh, njeriu vepron kështu. Më parë është (krijuar)natyra e pastaj kultura. Me fjalë të tjera, ekziston sjellja instinktive, pa reflektuar, pa rezonuar, pastaj ekziston sjellja e arsyeshme, ajo që e kemi fituar nga edukata, nga shkolla, nga arsyeja. Ajo që quhet "kulturë" në kundërshtim me "natyrën". Me kulturë mësohemi të jetojmë së bashku, sidomos mësojmë se nuk jemi të vetëm në botë, se ekzistojnë popuj të tjerë me tradita të tjera, me mënyra të tjera të jetës, që janë po ashtu të vlefshme sikur tonat.

- *Nëse me kulturë do të thuash edukatë, racizmi mund të vijë nga ajo që mësohet…?*

- Njeriu nuk lind racist, ai bëhet racist. Ka edukatë të mirë dhe të keqe. Çdo gjë varet nga ai që edukon, qoftë në shkollë apo në shtëpi.

- *E pra, kafsha që nuk merr kurrfarë edukate, qenka më e mirë se njeriu?!*

- Ta zëmë se kafsha nuk ka ndjenja të paracaktuara. Përkundrazi, njeriu i ka ato që i quajmë paragjykime. Ai i gjykon të tjerët para se t'i njohë. Ai mendon se e di që më parë se kush janë dhe se sa vlejnë. Shpesh, mashtrohet. Frika e tij vjen nga kjo. Dhe, për ta luftuar frikën, njeriu nganjëherë detyrohet të bëjë luftë. Ti e di, kur them se ka frikë, nuk duhet menduar se ai dridhet, përkundrazi frika e tij shkakton agresivitet, ai ndihet i rrezikuar dhe sulmon. Racisti është agresiv.

- *Dhe luftërat u bëkan për shkak të racizmit?*

- Disa, po. Në të vërtetë, ekziston një vullnet për t'ua marrë pasurinë të tjerëve. Racizmi ose feja përdoren për t'i nxitur njerëzit që të

urrehen, të përbuzen, madje edhe kur nuk njihen. Ekziston frika nga i huaji, frika se ma merr shtëpinë time, punën time, gruan time. Injoranca është ajo që e ushqen frikën. Nuk e njoh kush është ky i huaj, edhe ai nuk më njeh se kush jam unë. Shiko, për shembull, fqinjët tanë të ndërtesës. Ata nuk na besonin për një kohë të gjatë, deri në ditën kur i ftuam për të ngrënë një ”kuskus”. Pas këtij çasti, ata kuptuan se ne jetojmë si ata. Në sytë e tyre, ne pushuam të dukemi të rrezikshëm, sa kohë që përpara, kur takoheshim në shkallë, ne mezi i thoshim mirëdita njëri-tjetrit.

- *Pra, për të luftuar kundër racizmit, u dashka të ftojmë njëri-tjetrin!*

- Kjo është një ide e mirë. Të mësohemi të njihemi, të bisedojmë, të përpiqemi të ndajmë të mirën dhe të keqen, të tregojmë se shpesh i kemi të njëjtat brenga-halle, të njëjtat probleme; kjo do të mund të largonte racizmin. Udhëtimi mund të jetë një mënyrë e mirë për t’i njohur të tjerët. Monteni (Montaigne) (1533-1592) i nxiste bashkatdhetarët e tij që të udhëtonin dhe t’i shikonin dallimet.

- Udhëtimi, për atë, ishte mënyra më e mirë “për të krahasuar dhe për të harmonizuar idetë tona me idetë e të tjerëve”.

T’i njohësh të tjerët për t’u njohur më mirë.

- *A ka ekzistuar racizmi përherë?*

- Po, prej se ekziston njeriu, në forma të ndryshme, sipas epokave. Në kohët shumë të vjetra, në epokën e parahistorisë, që një romancier e ka quajtur ”lufta e zjarrit”, njerëzit sulmonin njëri-tjetrin me armë primitive, me çomanga, për një territor, për një kasolle, për një grua, për ushqim etj. Pra, i përforconin kufijtë, i mprehnin armët, nga frika se do të pushtohen.

Njeriu shqetësohet për sigurinë e vet, dhe nganjëherë ndodh që të frikësohet nga fqinji, nga i huaji.

- *Racizëm, do të thotë luftë?*

- Lufëtrat mund të kenë shkaqe të ndryshme, shpesh ekonomike. Por, përveç kësaj, disa luftëra bëhen në emër të të ashtuquajturit superioritet të një grupi ndaj grupit tjetër. Mund të tejkalohet kjo formë

instinktive me arsyen dhe me edukimin. Për ta arritur këtë, duhet të vendosësh që të mos kesh më frikë nga i huaji.

- *Atëherë, ç’mund të bëjmë?*

- Të mësojmë, të edukohemi. Të reflektojmë. Të mundohemi të kuptojmë çdo gjë; të jemi kureshtarë për çdo gjë që i përket njeriut, të kontrollojë instinktet e para të tij, shtytjet e tij.

- *Ç’është instinkti?*

- Instinkti është aktveprim shtytës, që synon drejtë një qëllimi në mënyrë të pareflektuar (pamenduar). Kjo fjalë ka krijuar shprehjen tjetër “aversion” që është akt konkret për të përzënë armikun, për të përzënë dikë jashtë. Aversion do të thotë edhe neveri. Shpreh një ndjenjë shumë negative.

- *Racisti e përzë të huajin jashtë, sepse e urren?*

- Po, ai e përzë edhe nëse nuk është i rrezikuar, thjesht ngase nuk i pëlqen. Dhe, për të justifikuar këtë akt violent (të dhunshëm), ai gjen argumente që i bëjnë punë. Nganjëherë ai i referohet shkencës, por shkenca kurrë nuk e ka justifikuar racizmin. Ai flet për çkado qoftë, sepse mendon se shkenca i sjell dëshmi të forta dhe të pakontestueshme. Racizmi nuk ka asnjë bazë shkencore, edhe pse disa njerëz janë munduar të përdorin shkencën për të justifikuar idetë e tyre diskriminuese.

- *Ç’ka do të thotë kjo fjalë?*

- Kjo fjalë do të thotë të veçosh një grup social ose etnik nga të tjerët duke e trajtuar shumë keq. Kjo do të thotë sikur, për shembull, në një shkollë, drejtoria të vendoste të grumbullonte në një klasë të gjithë nxënësit zezakë, sepse ajo mendon që këta nxënës janë më pak intelegjentë se të tjerët. Fatmirësisht, ky diskriminim nuk ekziston në shkollat franceze. Ky ka ekzistuar në Amerikë dhe në Afrikën e Jugut. Kur një bashkësi etnike ose religjioze e detyrojnë të bashkohet për të jetuar e veçuar, krijohet ajo që quhet geto.

- *Është ky burg?*

- Fjala “ghetto” është emri i një ishulli të vogël pranë Venecies, në Itali. Në vitin 1516 hebrenjtë e Venedikut u dërguan në këtë ishull, të

ndarë nga bashkësitë tjera. Getoja është një lloj burgu. Si do që të jetë, ky është diskriminim.

- *Cilat janë argumentet shkencore mbi racizmin?*

- Nuk ekzistojnë, por racisti mendon ose të bën të mendosh se i huaji i takon një race tjetër, një race që e konsideron si inferiore- të ulët.

Po ai gabon plotësisht, sepse ekziston vetëm një racë dhe kaq, ta quajmë atë gjini njerëzore ose lloj njerëzor, ndryshe nga ai shtazor. Tek kafshët, dallimet janë shumë të mëdha (në mes një qeni të bariut gjerman dhe një teckel), saqë është e pamundur të caktohen racat. Kjo nuk është e mundur për gjininë njerëzore, sepse njeriu me njeriun është i ngjashëm.

- Por, baba, flitet mjaft se dikush është i racës së bardhë, dikush i racës së zezë, ose i racës së verdhë. Këtë na e kanë thënë shpesh në shkollë. Mësuesja madje na tha një ditë se Abdu (Abdou), i cili vjen nga Mali, është i racës së zezë.

- Nëse e ka thënë vërtet mësuesja jote këtë, ajo gabon.

Më vjen keq ta them këtë, e di se ti e do atë, por ajo bën gabim dhe mendoj se ajo vetë nuk e di këtë.

Më dëgjo mirë, bija ime: racat njerëzore nuk ekzistojnë. Ekziston gjinia njerëzore, në të cilën ka mashkuj dhe femra, ka njerëz me ngjyrë, trupmëdhenj ose trupvegjël, me aftësi të ndryshme dhe të dalluara. Dhe pastaj ekzistojnë disa raca shtazësh. Fjala "racë" nuk duhet të përdoret për të treguar se ekziston veçoria njerëzore. Fjala " racë" nuk ka bazë shkencore. Ajo është përdorur për t'i zmadhuar efektet e ndryshme të dukshme, do të thotë ndryshimet fizike. Nuk kemi të drejtë të bazohemi në ndryshimet-dallimet fizike – ngjyra e lëkurës, trupi, vijat e fytyrës, për t'i ndarë njerëzit në mënyrë hiararkike, duke menduar se ekzistojnë njerëz superiorë ndaj njerëzve të tjerë që do t'i futnim në një klasë inferiore. Me fjalë të tjera, nuk kemi të drejtë të besojmë dhe sidomos ta bëjmë dikë të besojë se ngase e kemi lëkurën të bardhë, kemi cilësi më të mëdha në krahasim me një njëri me ngjyrë. Të propozoj që të mos e përdorësh më fjalën "racë ". Ajo është shfrytëzuar aq shumë nga disa njerëz dashakëqij, sa që është më mirë

të zëvendësohet me fjalët "gjini njerëzore". Pra, gjinia njerëzore përbëhet prej grupeve të shumta dhe të ndryshme. Por të gjithë mashkujt dhe të gjitha femrat e planetit që kanë lëkurë trëndafilli, të bardhë, të zezë, gështenje, të verdhë ose tjetër, në venat e tyre kanë gjak të së njëjtës ngjyrë.

- Përse afrikanët e kanë lëkurën të zezë, kurse evropianët të bardhë?

- Pamja zeshkane e fytyrës vjen nga pigmenti i quajtur "melanin". Ky pigment ekziston tek të gjitha qeniet njerëzore. Megjithatë, organizmi e prodhon në sasi më të madhe tek afrikanët sesa tek evropianët ose aziatikët.

- Atëherë shoku im Abdu (Abdou) prodhuaka më shumë…. .

- Melanini, është si ngjyrues.

- Pra, ai prodhon më shumë melanin sesa unë. E di po ashtu se ne të gjithë kemi gjak të kuq, por kur nëna kishte nevojë për gjak, mjeku i kishte thënë se grupi i saj ishte i ndryshëm.

- Po, ekzistojnë disa grupe gjaku; janë katër grupe: A, B, 0 dhe AB. Grupi 0 (zero) është dhënës universal. Grupi AB është marrës universal. Kjo nuk ka të bëjë asgjë me çështjen e superioritetit ose të inferioritetit. Ndyshimet janë në kulturë (gjuha, zakonet, ritet, gatimikuzhina (përgatitja e ushqimit etj.). Të kujtohet, Tami (Tam), shoqja vietnameze e nënës sate, që i dha gjak, e nëna jote është marokene. Ato kanë të njëjtin grup të gjakut. Dhe megjithatë janë me kultura shumë të ndryshme dhe nuk e kanë të njëjtën ngjyrë të lëkurës.

- Pra, nëse një ditë shoku im malien Abdu ka nevojë për gjak, unë do të mund t'i jap?

- Nëse i takon të njëjtit grup të gjakut, po.

- Ç'është racisti?

- Racisti është ai që me pretekstin se nuk ka ngjyrë të njëjtë të lëkurës, as gjuhë të njëjtë, as mënyrë të njëjtë të festave, - mendon se është më i mirë, të themi, superior ndaj atij që është i ndryshëm nga ai, dhe thotë: "raca ime është e bukur dhe e lartë, të tjerat janë të ulëta dhe shtazore".

- Nuk ekziston raca më e mirë?

- Jo. Disa historianë në shekujt XVIII e XIX janë përpjekur të dëshmojnë se ekzistonte një racë e bardhë që do të ishte më e mira në pikëpamje fizike dhe mendore sesa e ashtuquajtura raca e zezë. Në atë kohë, mendoj se njerëzit ishin të ndarë në disa raca. Një historian (Enest Renan, 1823-1892) madje i ka caktuar grupet njerëzore që i takojnë "racës së ulët-inferiore": zezakët e Afrikës, popullsia autoktone e Australisë dhe indianët e Amerikës. Sipas tij, "zezaku" do të ishte ndaj njeriut siç është gomari ndaj kalit", do të thotë "një njeri të cilit do t'i mungonin intelegjenca dhe bukuria"! Por, siç thotë një profesor i mjekësisë, specialist i gjakut, "racat e pastra" në botën shtazore mund të ekzistojnë vetëm në gjendje eksperimentale, në laborator, për shembull, me minj. Ai shton se në mes kinezit, malienit dhe francezit ekzistojnë më shumë ndryshime sociokulturore sesa ndryshime gjenetike.

- Ç'janë ndryshimet-dallimet sociokulturore?

- Ndryshimet sociokulturore janë ato ndryshime që e shquajnë një grup njerëzish nga një tjetër, sipas mënyrës në të cilën njerëzit organizohen në shoqëri (mos harro, çdo grup njerëzish i ka traditat dhe zakonet e veta) dhe atë që krijon si prodhim kultutor (muzika afrikane është e ndryshme nga muzika evropiane). Kultura e njeriut është e ndryshme me atë të grupit tjetër. Është njësoj edhe sa i përket mënyrës së martesës, së fesë, etj.

-Po ç'është gjenetika ?

- Termi "gjenetikë" tregon gjenet, do të thotë elementet shkaktare të faktorit trashëgues në organizmin tonë. Gjeni është njësi trashëguese.

E di se ç'është trashëgimia? Është tërë ajo që prindërit ua përcjellin fëmijëve të tyre: për shembull karakteret fizike dhe psikike. Ngjashmëria fizike dhe disa tipare të karakterit të prindërve që gjenden tek fëmijët e tyre, shpjegohen përmes trashëgimisë.

- Atëherë ne ndryshojmë më shumë për nga edukata jonë sesa për nga gjenet?

- Sidoqoftë, ne të gjithë ndryshojmë nga njëri-tjetri. Thjesht, disa nga ne kanë tipare të përbashkëta trashëguese. Në përgjithësi, ata rigrupohen mes tyre. Formojnë një popullsi që shquhet nga grupi tjetër për mënyrën e jetës. Ekzistojnë disa grupe njerëzish, të cilët ndryshojnë mes tyre për nga ngjyra e lëkurës, për nga sistemi leshtor, nga tiparet e fytyrës dhe gjithashtu nga kultura.

Kur përzihen ata (përmes martesës), lindin fëmijë që quhen "melezë". Në përgjithësi melezët janë të bukur. Përzierja krijon bukuri. Përzierja është mur mbrojtës kundër racizmit.

- Nëse të gjithë jemi të ndryshëm, ngjashmëria nuk ekziston...

- Ç'do qenie njerëzore është unike – e vetme. Në tërë botën nuk ekzistojnë dy qenie njerëzore plotësisht të njëjta. Madje binjakët e vërtetë ndryshojnë. Veçoria e njeriut duhet të ketë identitetin, që e cakton ai vetë. Ai është i veçantë. Do të thotë i pazëvendësueshëm. Sigurisht që një nëpunës mund të zëvendësohej me një tjetër, por riprodhimi i vërtetë i të njëjtit është i pamundur. Secili nga ne mund të thotë: "nuk jam si të tjerët", dhe do të ketë të drejtë. Të thuash "unë jam unikat - i vetëm", kjo nuk do të thotë: të jesh më i miri. Thjesht është për të konstatuar se çdo qenie njerëzore është e vetme-e veçantë. Me fjalë të tjera çdo fytyrë është një mrekulli; e vetme dhe e pangjashme.

- Edhe unë?

- Patjetër. Ti je unikate ashu si është Abdu unikat, ashtu si është Selina unikate. Nuk ekzistojnë mbi tokë dy shenja gishtërinjsh plotësisht identike. Çdo gisht e ka shenjën e vet. Për këtë arsye, në filmat policorë, fillohet nga zbulimi i shenjave të lënë në sende, për të identifikuar personat që gjendeshin në vendin e krimit.

- Por, babë, një ditë në televizion kanë shfaqur një dele që ishtë prodhuar në dy prototipe.

- Ti e ke fjalën për atë që quhet klonim; në fakt për të riprodhuar një send në aq sa prototipe duam, kjo me sendet është e mundur. Ato prodhohen me anë të makinave të cilat riprodhojnë të njëjtin send në

mënyrë identike. Por kjo nuk duhet bërë me kafshët, dhe aq më pak me njerëzit.

- *Ke të drejtë, nuk do të dëshiroja të kem dy Selina (Celine) në klasën time. Vetëm një mjafton.*

- Po e kupton, nëse do të arrinim t'i riprodhonim njerëzit si i bëjmë kopjet, do të kontrollonim botën, do të vendosnim t'i shumëzonim disa ose t'i eliminonim të tjerët. Kjo është e tmerrshme.

- *Kjo më frikëson… Edhe shoqen time më të mirë nuk do të dëshiroja ta kisha kopje!*

- Dhe pastaj, nëse do të lejohej klonimi, disa njerëz të rrezikshëm do të mund ta përdornin për llogari të tyre, për shembull, të marrin pushtetin dhe t'i shtypin të dobëtit. Fatmirësisht, qenia njerëzore është unikale - e vetme dhe nuk riprodhohet në mënyrë identi-ke. Sepse unë nuk jam identik as me fqinjin tim e as me vëllanë tim binjak, sepse ne të gjithë jemi të ndryshëm nga njëri-tjetri. Dhe mund të thuhet e të konstatohet se "pasuria është në ndryshime".

- *Nëse e kam kuptuar mirë, racisti ka frikë nga i huaji, sepse ai është injorant, mendon se ekzistojnë disa raca dhe të veten e konsideron si më të mirën?*

- Po, bija ime. Por kjo nuk është e tëra. Harrove dhunën dhe dëshirën për të nënshtruar të tjerët.

Racisti është njeri që mashtrohet. Racistët janë të bindur se grupi të cilit i takojnë- i cili mund të caktohet për nga feja, vendi, gjuha ose të gjitha këto së bashku-është superior përballë grupit tjetër.

- *Si ia bëjnë që të ndihen superiorë?*

- Duke besuar dhe duke i bërë të tjerët të besojnë se ekzistojnë padrejtësi natyrore, të natyrës fizike ose të natyrës kulturore, të dukshme, gjë që krijojnë ndjenjë superioriteti në krahasim me të tjerët. Kështu disa mbështeten tek feja për të justifikuar sjelljen ose ndjenjën e tyre. Duhet thënë se çdo fe pretendon të jetë më e mira për të gjithë dhe tenton t'i shpallë ata që nuk e ndjekin, se e gabojnë udhën.

- *Ti thua se fetë janë raciste?*

- Jo, fetë nuk janë raciste, por njerëzit nganjëherë i bëjnë (raciste), ata që ushqehen me racizëm. Në vitin 1. 095 papa Urbani II nga qyteti

Klerma Ferra (Clermont Ferrand), filloi luftën kundër muslimanëve, të konsideruar jobesimtarë. Mijëra të krishterë u nisën në vendet e Lindjes për t'i masakruar arabët dhe turqit. Kjo luftë që u bë në emër të Zotit, u quajt "Kryqëzatë" Kryqi, symbol i të krishterëve, kundër gjysmëhënës, simbol i muslimanëve". "Midis shekujve XI e XV, të krishterët e Spanjës i dëbuan të gjithë muslimanët, dhe pastaj çifutët për shkaqe fetare". "Kështu disa gjejnë mbështetje në libra të shenjtë për të justifikuar tendencën e tyre që të mendojnë se janë superiorë ndaj të tjerëve. Luftërat fetare janë të shpeshta.

Por Kur'ani, ashtu sikur Tevrati (Thora) ose Bibla; të gjithë librat e shenjtë janë kundër racizmit. Kur'ani thotë se njerëzit para Zotit janë të barabartë dhe ata ndryshojnë për nga shkolla e besimit të tyre. Në Tevrat shkruan: "Nëse një i huaj vjen të rrijë me ty, mos e keqtrajto fare, ai do të jetë për ty si njëri nga bashkëvendësit e tu dhe do ta duash si vetveten".

Bibla insiston për respektimin e tjetrit, do të thotë, për respektimin e qenies njerëzore, qoftë ai fqinji, vëllai yt ose një i huaj. Në Dhjatën e re thuhet: "Ajo që jua porosis, është të duani njëri-tjetrin, dhe ti do ta duash tjetrin si vetveten". Të gjitha fetë predikojnë paqen në mes njerëzve.

Po nëse nuk besojmë në Zotin? Po e them këtë, sepse nganjëherë e pyes veten nëse ferri, parajsa me të vërtet ekzistojnë…

Nëse nuk besojmë, fetarët na kanë në sy të keq, shumë në sy të keq; për më fanatikët madje bëhemi armiq. Një ditë, kur pati atentate, një gazetar në televizion akuzoi Islamin.

- *Ky është një gazetar racist sipas teje?*

- Jo, ai nuk është racist, ai është injorant dhe i paaftë. Ky gazetar ngatërron Islamin dhe politikën. Janë politikanët ata që e përdorin Islamin në luftrat e tyre. Ata quhen integristë.

- *Ç'janë këta integristë?*

Integristët janë (njerëz) fanatikë. Integristi është njeri që mendon se vetëm ai mund ta mbrojë të Vërtetën. Shpesh fanatizmi dhe feja shkojnë së bashku. Integristët ekzistojnë në pjesën më të madhe të feve. Ata mendojnë së janë të inspiruar nga fryma hyjnore. Ata janë të

verbër dhe të etshëm e bindjet e tyre dëshirojnë t'ua imponojnë të gjithë të tjerëve. Ata janë të rrezikshëm, sepse nuk i japin rëndësi jetës së të tjerëve. Në emër të Zotit të tyre, ata janë të gatshëm të vrasin, madje edhe të vdesin. Shumë manipulohen nga ndonjë udhëheqës. Sigurisht ata janë racistë.

- *Janë sikur ata njerëz që votojnë për Lë Penin (Le Pen)?*

- Lë Peni udhëheq një parti politike të bazuar në racizëm, do të thotë urrejtje e të huajve, emigrantëve, urrejtje e muslimanëve, e izrealitëve, etj.

- *Është parti e urrejtjes!*

- Po, por të gjithë ata që votojnë për Lë Penin, nuk janë ndoshta të gjithë racistë…

Dyshoj… Sepse në Francë do kishte më tepër se katër milionë racistë! Kjo është shumë! I mashtrojnë; ose nuk dëshirojnë të shohin realitetin. Duke votuar për Lë Penin, disa shprehin huti; por ata e gabojnë mënyrën.

- *Më thuaj, baba, si duhet vepruar që njerëzit të mos jenë më racistë?*

- Siç thonte gjenaral Dë Goli (De Gaulle), nevojitet një "program i gjerë". "Shumë më lehtë është të mbjellësh urrejtje sesa të mbjellësh dashuri". Është më lehtë të mos i besosh dikujt, të mos e duash dikë, sesa të duash dikë që nuk e njeh. Gjithmonë kjo tendencë spontane instinkti famoz i cili shprehet me mospranim, me mohim".

- *Ç'është mospranimi, mohimi?*

Është fakti të mbyllësh derën dhe dritaret. Nëse i huaji troket në derë, nuk ia hapim derën.

Nëse ai insiston, ia hapim, por nuk e lejojmë të rrijë; i themi se është më mirë të shkojë tjetërkund, e refuzojmë.

- vijon -

Nga frëngjishtja
Qemajl Selishta

Tahar Ben Jolloun

HOW I EXPLAINED RACISM TO MY DAUGHTER

(Summary)

On 22 February 1977, I took my daughter to protests against the Debre draft-law on the residence of foreigners in France. There, I got the idea to write this text. My twelve-year-old daughter asked me many questions. She wanted to know the reason why we were protesting, what was the meaning of the placards and if our presence made a difference, etc.

This is how we started talking about racism. Recollecting her questions and opinions, I wrote this text. In the beginning, we read it together. I had to write it again almost completely, to change complicated terms and to explain difficult notions. Then we read the text together with her two friends. Their reactions were interesting. I have taken them into consideration in the versions that I have written later.

In order to be clear, concise, objective, I have written this text no less than 15 times.

طاهر بن يلون

كيف شرحت لابنتى التفرقة العنصرية

(خلاصة البحث)

أثناء ذهابى مع ابنتى فى مظاهرة احتجاج بتاريخ ٢٢ فبراير ١٩٧٧م ضد مشروع للقانون "ديبره" بشأن دخول و اقامة الاجانب فى فرنسا جاءتنى الفكرة لكتابة هذه المقالة. ابنتى و عمرها اثناعشر سنة طرحت لى عدة اسئلة و هى كانت تود ان تعلم لماذا نحن نحتج و ما ذا تعنى بعض الشعارات التى كان يحملها بعض المتظاهرين.

و هكذا بدأنا نتكلم عن التفرقة العنصرية, و بناء على اسئلتها و افكارها كتبت هذا النص. و فى بداية قرأناه سويا ثم بعد ذلك اعدت كتابته من جديد تقريبا لكي اغير التعبيرات المعقدة و اشرح معانى للكلمات الصعبة. ثم بعد ذلك قرأنا النص مع زميلتين لها و كان رد فعلهما مهما جدا و قد اعتمدت على ردودهما فى الكتابات للجديدة و حتى يكون هذا النص واضحا و بسيطا يستطيع أن يفهمه اى انسان اضطررت لكتابته ليس أقل من خمس عشرة مرة.

SHOQËRI

Mr. sc. Menduh Bamja

IDEJA E TOLERANCËS FETARE DHE NDIKIMI I SAJ NË SHOQËRI

Problemi i tolerancës fetare është një prej provokimeve më serioze me të cilin ballafaqohet bota bashkëkohëse. Rëndësia e idesë së tolerancës fetare, si parim moral dhe si parim institucional juridik, për botën bashkëkohëse, duke mos përjashtuar edhe ish-RSF të Jugosllavisë, shihet në përleshjet ndëretnike, me elemente të theksuara fetare. Në një pjesë të konsiderueshme të botës, krahas faktorëve të tjerë shoqërorë, besimi dhe bindjet fetare janë burim i mosmarrëveshjeve dhe i zemërngushtësisë. Mostoleranca dhe zemërngushtësia fetare kanë pasoja të rënda në planin politik.

Në emër të bindjeve fetare, kryhen lloje dhe akte të ndryshme agresiviteti fetar dhe të agresivitetit politik.

Toleranca fetare si parim i përgjithshëm qytetar dhe kulturor, paraqet pasojën e luftërave fetare të zhvilluara në truallin e Evropës. Të gjitha luftërat fetare kanë dëshmuar në mënyrë tragjike dhe bindëse pasojat e ekskluzivitetit e të fanatizmit fetar.

Luftërat e zhvilluara fetare, kanë treguar në mënyrë konkrete pamundësinë politike të realizimit të parimit të universalitetit të bidjes së caktuar fetare, dhe jo vetëm ekskluzivitetit fetar, me anë të eliminimit

fizik të kundërshtarit me bindje të tjera fetare. Pas të gjitha luftërave të zhvilluara fetare, palët kundërshtare kanë qenë të bindura për validitetin dhe universalitetin e bindjeve të veta fetare. Kundërshtarët në luftërat e zhvilluara fetare, pa marrë parasysh fuqinë që kanë disponuar, nuk kanë mundur të shkatërrojnë kundërshtarin. Vetëdija se me anë të forcës nuk mund të shkatërrohet kundërshtari, ka qenë një prej kushteve kryesore për krijimin e tolerancës fetare në Evropë.[1]

Toleranca fetare, në thelb, është diçka më pak se liria fetare. Në lirinë fetare është e pranuar e drejta e barabartë për ekzistencë, me domethënie dhe me vlerë të barabartë të çdo qëndrimi dhe bindjeje fetare. Toleranca fetare nënkupton dhe supozon disproporcionin dhe pabarazinë e caktuar, ku pala që është e fortë, e duron palën tjetër në veprimet dhe bindjet, të cilat nuk i pëlqen, duke konstatuar se veprimi i tjetërfarshëm do të shkaktonte më tepër dëm se dobi.[2]

Toleranca në kuptimin bashkëkohës nuk e parashtron çështjen se kush ka të drejtë e kush s'ka; këtë çështje toleranca fetare e lë të hapur dhe në vend të kësaj mundohet të kënaqë nevojat e njeriut për të gëzuar të drejtat themelore individuale, dhe në këtë drejtim ofron përkrahje adekuate.[3]

Toleranca fetare, e kuptuar kështu, vërteton të drejtën e dyfishtë individuale të njeriut, të drejtën për të pasur një bindje individuale pa marrë parasysh se a është objektivisht e vërtetë (reale) kjo bindje apo jo, dhe të drejtën për të jetuar në bazë të asaj bindjeje. E drejta për tolerancë fetare duhet të jetë e drejtë e pacenueshme edhe atëherë kur tërë rrethi jeton me bindje të kundërta.

E drejta për tolerancë fetare mund të kufizohet dhe kufizohet vetëm me të drejtën e të tretit që të jetojë i lirë në pajtim me bindjet e veta.[4]

---

[1] Slobodan Antonic: "Verska sloboda i politicka tolerancija", "Religija i savremeni svet", Centar za marksizam Univerziteta u Beogradu, "BIGZ", Beograd, l987, fq. 53-54.
[2] Vep. e cit. fq. 54, fusnota l.
[3] Ivan Fucak: "Od tolerancije do vjerske slobode", "Obnovljeni zivot", 3/l975, fq 208.
[4] Vep. e cit., fq. 208.

Ideja dhe praktika e tolerancës fetare, edhe pse ka ekzistuar në historinë e besimeve të mëdha qysh nga kohët e lashta, toleranca nuk ka qenë një cilësi përcjellëse e të gjitha besimeve.

Gjatë historisë së njerëzimit, besimi ka qenë sinonim i kompaktësisë së etnosit të caktuar dhe një bazë e dallimit me etnoset e tjera. Çdo besim, duke insistuar për parimet dhe superioritet të vetin ndaj së vërtetës, si dhe karakterit universal, nuk ka kontribuar në drejtim të tolerancës fetare.[5]

Edhe pse në shumicën më të madhe të besimeve të zbulesës (të besimeve të shpalljes - librit) dhe të besimeve të përjetimit mistik, ekzistojnë pa mëdyshje norma obliguese ose tradita gojore për tolerancën fetare, në emër të besimit dhe të bindjeve fetare janë zhvilluar shumë luftëra të përgjakshme. Numri i përgjithshëm i viktimave të luftërave për shkak të besimit, është më i madh se për shkaqet e tjera. Bindjet fetare dhe mostoleranca fetare kanë qenë prej shkaqeve më të shpeshta të diskriminimit racial, politik dhe social të atyre që nuk janë pajtuar me besimin zyrtar.

Pretendimi me ngulm i të gjitha besimeve për përsosmëri dhe për vërtetësi absolute të predikimit e të traditës së caktuar fetare, ka dhënë njëfarë lejeje fetare për mosdurimin, diskriminimin dhe padrejtësinë. Mostoleranca dhe përndjekja e bashkësive të vogla fetare, Reformacioni dhe Kundërreformacioni paraqesin kreun më të errët të krishterimit dhe të qytetërimit në Evropë.

Arsyet për mostolerancë fetare mund të ndahen në dy grupe:

• fetare - morale, dhe

• shoqërore - politike.

Arsyet fetare - morale mund të përmblidhen në këto shkaqe:

- Besimi ndaj të cilit shfaqet mostoleranca, konsiderohet si i rrejshëm dhe i rrezikshëm për integritetin moral të bashkësisë shoqërore në të cilën zotëron besimi tjetër;

[5] Dr. James E. Ëood, Jr.: "Uloga religije u napredjivanju vjerske slobode i svjetskog mira", "Savjest i sloboda",

- besimi i "huaj" konsiderohet si i kundërt me zakonet dhe vlerat morale të shoqërisë së caktuar;

- besimi i "huaj" konsiderohet si kërcnim shkatërrues ndaj sistemit të caktuar politik dhe ndaj sjelljeve të caktuara të "shabllonizuara politike;

- besimi i "huaj" konsiderohet si aleat i kulturës dhe i shoqërisë ku është shpallur zbulesa e saj dhe vënia e shenjës së barazimit me shtetin e huaj.[6]

Si faktor me rëndësi për mostolerancën fetare ka qenë edhe identiteti dhe identifikimi i një populli vetëm me një besim. Renegati fetar gjithmonë është konsideruar si armik i shtetit.

Në këtë drejtim, mostoleranca fetare ka nxitur dukshëm mostolerancën politike, këtë fakt më së miri e ilustrojnë shembujt e Izraelit, Greqisë antike, Spanjës mesjetare etj.

Identifikimi i besimit me organizimin shtetëror besimit i ka siguruar statusin e paprekshmërisë dhe çdo kritikë ndaj besimit është konsideruar si tradhti dhe sulm ndaj themeleve të shtetit. Besimi i huaj kishte qenë rrezik shtetëror, sepse rrezikonte unitetin shtetëror ose superstrukturën ideologjike.

Uniteti i bashkësisë shoqërore me një besim, ka qenë karakteristikë në shumë shtete antike, mesjetare si dhe në shtetet e periudhës moderne. Çdo mospajtim me besimin zyrtar shtetëror shkaktonte mosdurim dhe dëbim.

Pra, toleranca fetare në Greqinë antike nuk ishte e njohur, kurse Romakët tolerancën fetare e kuptonin në mënyrë të gjerë si liri fetare. Në këtë drejtim është ilustrative thënia e Ciceronit: "Sua cuique civitati religio est nostra nobis" ("Çdo shteti i takon besimi i vet, kurse neve yni").

Në Krishterimin e hershëm, nën ndikimin e mbretit Justinian, jokrishterët janë konsideruar si persona pa të drejta. Në mesjetë në suaza të Krishterimit, nën ndikimin e mësimeve të Firmicie Materniusit, nuk mund të flitet për kurrfarë tolerance fetare, për më tepër arsyeto-

[6] Dr. James E Ëood, Jr. : Vep. e cit. fq. 42- 43.

hej përdorimi i dhunës për pagëzimin e jokrishterëve. Sipas pikëpamjeve të Toma Akuinit, shteti ka të drejtë dhe detyrë të zbatojë dhunën ndaj heretikëve "blasphemi in Deum" deri në zbatimin e ekzekutimit (dënimit me vdekje), me arsyetimin se personat me bindje të ndryshme fetare prishin "parimin e bashkësisë në dashuri" ("principum comanunionis in caritate")[7]

Në emër të vërtetësisë dhe uniformitetit, Krishterimi, në aspektin shoqëror e sociologjik, i ka dhënë përkrahje religjionit shtetëror në dëm të të drejtave dhe bindjeve intime të njeriut. Me diskriminin e të drejtave të njeriut shkelen normat elementare etike dhe në mënyrë të rrezikshme degradohet njeriu.

Në Evropë fryma e tolerancës fetare dhe e lirisë së ndërgjegjes, zhvillohet dhe i përfshin bashkësitë e krishtera jokatolike. Fryma e tolerancës fetare do të ndikojë në drejtim të pranimit demokratik të njeriut pa marrë parasysh qëndrimet dhe bindjet personale.

Krishterimi, Katolicizmi dhe Ortodoksia, shumë vonë e kuptojnë dhe e pranojnë se liritë dhe të drejtat themelore fetare nuk janë në

[7] "Përndjekja e çifutëve nuk ka qenë shpikje e nacional-socialistëve dhe nuk ka filluar me "Natën e kristaltë" më 9-l0. ll. l938, në Gjermani. Qysh në vitin l480 në Spanjë Ferdinand Katoliku, themeloi inkuizicionin. Detyra e inkuizicionit ishte që të pastronte katolicizmin nga të gjitha llojet e format e herezisë, e në veçanti nga maronët - çifutët që e kishin pranuar Krishterimin, e të cilët akuzoheshin (dyshoheshin) se nuk kishin ndërprerë lidhjet me besimin e vjetër. Disa vjet më vonë, mjeku i njohur i Madridit, Juan Huarte de San Juan, tentoi që në baza biologjike të argumentonte vetitë njerëzore e morale të çifutëve. Edhe pse atëhere ekzistonin teoritë raciste, të cilat kishin "provuar - vërtetuar" inferioritetin e çifutëve, kërkimet e këtij mjeku katolik paraqesin fillet e teorisë raciste. Mjeku i përmendur ka pohuar se kushtet e jetesës të çifutëve kanë krijuar një lloj "vreri të zi", për shkak të të cilit çifutët janë dinakë dhe të pabesë. Për shkak të kësaj vetie, çifutët janë konsideruar si rrezik për katolikët dhe për shoqëritë e tyre. Pas 450 vjetve teoria e gjakut dhe e trevës, sërish paraqitet në përndjekjet e çifutëve dhe në vënien e bazave të antisemitizmit. Pra, gjaku dhe raca çifute ka qenë rrezik për rrethin katolik, ku-rse në gjysmën e shek. XX ka paraqitur rrezikun për racën ariane. Në fillin çifutët kanë paraqitur rrezik vetëm për fenë krishtere - katolike, kurse më vonë jo vetëm që janë konsideruar si rrezik fizik e shpirtëror për racën gjermane, po edhe për kulturën dhe ekonominë gjermene.
Ivan Krtalić, De rebur "Rerum novarum" (IV), "Nase teme", Zagreb, l988, viti XXXII, nr. 9, fq. 2259-23ll
Ivan Fu~ak: vep. e cit. fq. 211.

kundërshtim me mësimet biblike. Mirëkuptimi dhe toleranca brenda këtyre dy konfesioneve zbatohet shumë vonë dhe si pasojë e ndikimit të faktorëve të jashtëm (idetë reformatore dhe liberale që zhvillohen brenda Protestantizmit kontinental dhe anglez). Feja ortodokse nuk është liruar kurrë nga ekskluziviteti fetar. Ndryshe nga Katolicizmi, feja ortodokse ende nuk mund të pranojë ekzistimin e bindjeve të tjera fetare, jashtë mësimeve të saj dogmatike. Brenda mësimeve të saj fetare nuk ka vend për vizionet pluraliste të shoqërisë. Parimi i lirisë së ndërgjegjes kërkohet vetëm në aspektin e deklarimit të përkatësisë ortodokse brenda konfesioneve të tjera fetare, kurse kultivimi i saj brenda konfesionit ortodoks është i panjohur.

Feja ortodokse nuk ka shqyrtuar dhe as ka valorizuar kuptimet e veta për vlerat e njëmendta të të drejtave dhe të lirive të ndërgjegjes. Ajo nuk i ka definuar kurrë bazat teologjike dhe praktike për afirmimin e vlerave të përcaktimit të lirë të njeriut në çështjet e besimit.

Në krahasim me Krishterimin e mesjetës në Evropë, i cili ka qenë tepër jotolerant ndaj jo të krishterëve, duke ndërmarrë edhe masa drakonike ndaj bashkësive të vogla fetare dhe ndaj individëve, feja islame ka qenë në masë të madhe toleruese ndaj jomyslimanëve. Në veçanti ka treguar tolerancë dhe mirëkuptim ndaj çifutëve dhe ndaj të krishterëve si njerëz të librit (popujve të librit – ehli-kitab).

Islami si fe e shpalljes *par excellence* është fe e tolerancës dhe e mirëkuptimit. Besimi islam bazohet në pluralizëm ideologjik, fetar, racor, të pasurisë, prejardhjes, gjuhës etj.. Pluralizmi islam është antitezë e doktrinës katolike *extra ecclesiam nulla salus* (jashtë kishës nuk ka shpëtim).

Islami është fe e tolerancës dhe e mirëkuptimit ndërmjet njerëzve dhe popujve. Islami nuk ka asgjë të përbashkët me fanatizmin dhe me kufizimin e lirisë personale dhe kolektive të njerëzve. Islami paraqet inkurajimin për drejtësi dhe progres shoqëror. Kryerja e detyrimeve fetare nga myslimani nënkupton humanitetin dhe drejtësinë.

Akuzat nga ana e dashakëqijve për fanatizëm dhe mostolerancë, s'kanë asgjë të përbashkët me Islamin dhe mbështeten në mosnjohjen e parimeve themelore të Kur'anit dhe të praktikës së Profetit. Ajetet e

Kur'anit dëshmojnë epërsinë dhe fuqinë për rregullimin harmonik dhe tolerant të shoqërive dhe të shteteve islamike gjatë historisë, sepse si do të argumentonim ndryshe vlerat kulminante të qytetërimit të bazuar në Islam.[8]

Në Kur'an dhe në Traditën e Profetit nuk gjindet asnjë gjurmë e urrejtjes dhe e mostolerancës ndaj popujve të librit -çifutëve dhe ndaj krishterëve, por ata i njohin si besimtarë në një Zot.

Liria e ndërgjegjes është dhunti e Perëndisë, liria fetare është e drejtë natyrore e patjetërsueshme, e cila nuk mund të dhunohet as nga shoqëria si bashkësi e njerëzve, dhe as nga individët. Prej kësaj, për besimtarin e sinqertë rrjedh obligimi i përhershëm i bashkëjetesës me njerëz të përcaktimit tjetër fetar, zgjedhja e lirë e mënyrës së komunikimit me Zotin është e drejtë e çdo individi e bashkësie të njerëzve.

Për myslimanët urdhrat e Zotit kanë karakter detyrues dhe e ndalojnë çdo njeri në drejtim të detyrimit për pranimin apo ndërrimin e besimit. Kështu, bazat për mirëkuptimin, tolerancën e, mbi të gjitha, në bashkëjetesën fetare i kanë themelet në mësimet e Kur'anit. Këto parime qytetëruese ishin të njohura dymbëdhjetë shekuj para Revolucionit Borgjez Frëng (l789).

Këto parime kuranore paraqesin urdhërrëfimin kryesor për zhvillimin e tërë korpusit të të drejtave dhe lirive të ndërgjegjes në shoqëritë e qytetëruara. Bashkëjetesa, mirëkuptimi dhe toleranca fetare kanë qenë një prej shtyllave kryesore të organizimit shoqëror e shpirtëror të qytetërimit islamik. Këto komponente kanë qenë komponentet më vitale dhe më tërheqëse në përqafimin e Islamit nga popujt e ndryshëm të botës.

Thëniet e parashtruara më lart do t'i ilustrojmë me disa ajete të Kur'anit:

"Sikur të dëshironte Zoti yt, do t'i bënte njerëzit të një feje. Mirëpo ata gjithmonë në besim do të kundërshtohen". (ll:ll8)

[8] Dr. Ahmed Muhamed El Hafi, Toleranca islame, Shtëpia botuese "Dituria Islame" , Prishtinë, viti mungon, fq. l3.

"Po të donte Zoti yt, të gjithë ata që jetojnë në tokë, do të besonin. A do t'i detyrosh ti njerëzit të bëhen besimtarë ?" (l0:99)

"Ti nuk mund të udhëzosh atë që do ti, por Allahu udhëzon kë të dojë" (28:56).

"E vërteta vjen nga Zoti, por ju jeni të lirë të besoni ose të mos besoni".(l8:29).

"Ju mos i shani ata (zota) që u luten (idhujtarët)". (6:l08)

"S'ka dhunë në fe, e Vërteta dallohet nga e pavërteta". (2:256)

Në një letër dërguar guvernatorit të Jemenit, Profeti ndalonte që çifutëve dhe të krishterëve t'u imponohej feje islame.

"Mos e përdor dhunën për t'u imponuar Islamin çifutëve dhe të krishterëve, nëse dëshirojnë t'i mbeten besnik fesë së tyre".

Myslimanët si ngadhënjimtarë mbi shumë popuj dhe në shumë vende të botës kanë pasur qëndrim fisnik ndaj të nënshtruarve. Popujt e nënshtruar gëzonin të drejtën që të praktikonin lirisht besimin dhe ceremonitë e tyre fetare.

Një prej shkaqeve kryesore të suksesit të Islamit në vendet që ishin nën sundimin e Bizantit dhe Persisë, ishte fryma e tolerancës fetare dhe bujaria e pushtuesve të rinj, të cilët nga popujt e nënshtruar konsideroheshin çlirues. Si Perandoria e Bizantit ashtu edhe ajo e Persisë, jo vetëm që nuk e respektonin besimin e popujve të nënshtruar, por ua nënshtronin persekutimeve të rënda. Prandaj myslimanët nuk hasnin në rezistencë serioze. Popujt e nënshtruar të këtyre perandorive ishin të detyruar të adhuronin religjionet shtetërore, nën kërcënimin se do t'u konfiskohej pasuria atyre që nuk e pranonin. Si shembull mund të shërbejë pozita e popujve të nënshtruar të Perandorisë Osmane. Të drejtat dhe liritë fetare kanë qenë të garantuara për të gjithë popujt e nënshtruar, duke përjashtuar politeistët dhe ateistët.

Me ligje përkatëse jomyslimanëve u garantohej barazia me myslimanët, si:

- barazia para kodit penal,
- barazia para kodit civil, por duke u lejuar jomyslimanëve të drejtën e martesës dhe të shkurorëzimit sipas ligjeve të tyre;

- myslimanët dhe jomyslimanët nuk mund të trashëgonin njëritjetrin;
- myslimanët mund të ndajnë ushqimin e të krishterëve e të çifutëve dhe anasjelltas;
- Islami lejon që një mysliman të martohet me një të krishtere ose çifute, pa e detyruar ta ndërrojë fenë e saj;
- Islami ua pranoi liritë fetare të krishterëve dhe çifutëve. Nuk ka ndodhur kurrë gjatë fitoreve të ndryshme myslimane që të rrënohej ndonjë sinagogë a kishë. Asnjë i krishterë a çifut nuk u detyrua kurrë ta ndërronte fenë. Në të gjitha shtetet myslimane u lejua ndërtimi i kishave;
- pronësia dhe pasuria e të krishterëve dhe e çifutëve janë të mbrojtura njësoj si ato të myslimanëve;
- besimtarët janë të lirë të lidhin të gjitha llojet e marrëveshjeve të lejuara me jobesimtarët.[9]

Vetëm në kohën moderne mund të vërehet ideja e tolerancës fetare të bazuara në qytetërimin perëndimor. Kthesë vendimtare në këtë drejtim shënon Revolucioni Borgjez Frëng (l789), ku liria e besimit ngrihet në parim kushtetues (është i njohur fjalimi i H. G. Mirabeuasë, më 22. 8. l789, në Kuvendin e Republikës së Francës).[10]

Deri në atë kohë mund të vërejmë shtrëngimin e pranimit të besimit " zyrtar ", si dhe përdorimin e dhunës fizike me qëllim të ruajtjes së superioritetit në lëmenjtë ku Kisha kishte karakter zyrtar. Në drejtim të ruajtjes së superioritetit, çdo liri e ndërgjegjes etiketohej si marrëzi ("deliramentun" Enciklika e papës Gërguri XVI "Mirai Vos").[11]

Në shtetet bashkëkohore me rregullim demokratik dhe parlamentar, toleranca fetare është shndërruar në institucion shoqëror dhe paraqet një prej supozimeve të rëndësishme të jetës shoqërore. Toleranca fetare jo vetëm që është faktor vendimtar i rregullimit të marrëdhënieve dhe zgjidhjes së suksesshme të çështjeve fetare, por edhe faktor me

[9] Vep. e cit. fq. 33-34
[10] E. G. Rusch, Tolleranz, Zolikon, Zurich, l955, lo, cituar sipas Ivan Fu~ak:: Vep. e cit. fq. 209-2l0.
[11] James E. Wood, Jr.: Vep. e cit. fq. 44.

rëndësi i zgjidhjes së çështjes kombëtare. Në këtë drejtim më së miri flet praktika e Evropës Perëndimore dhe ShBA.

Ndryshe nga ideja e tolerancës fetare, e cila çështjen e besimit e shtron si çështje të ndërgjegjes, në ish-RSF të Jugosllavisë janë zhvilluar procese të cilat kishin për qëllim që një besim dhe një konfesion të shndërrohej në ideologji zyrtare, me tendenca që në mënyrë të theksuar të ndikonte në rregullimin e brendshëm shtetëror. Në këtë drejtim veçanërisht vlen të përmendet aktiviteti i Kishës Ortodokse Serbe, e cila paraqitej si faktor i mbrojtjes dhe si faktor kanalizues i së ashtuquajturës "Çështje serbe në Ballkan". Mostoleranca fetare në ish-RSF të Jugosllavisë paraqitet në formë të fanatizmit dhe të klerikalizmit, gati në tërë sipërfaqen e saj. Si karakteristikë e kësaj mostolerance fetare është zemërngushtësia dhe shkurtpamësia e intelektualëve që nuk ishin të aftë të kuptonin dhe të bashkëjetonin me pikëpamjet e bindjet e ndryshme mbi realitetin, si dhe agresiviteti dhe primitivizmi, me elementet e theksuara të ekskluzivitetit nacional, mandej urrejtja racore e bazuar në atavizëm etj. Fanatizmi fetar në ish-RSF të Jugosllavisë, në shumë segmente të shoqërisë dhe në programet e ndryshme, arriti të operacionalizohej si një teori politike.

Riaktivizimi dhe rivitalizimi i besimit ndiqej nga vala e theksuar e nacionalizmit e shovinizmit dhe mitologjia kuazihistorike, me thirrjen e përbashkët në bazë të gjakut etj.

Ekzistimi i shumë besimeve, i shumë bashkësive konfesionale dhe i shumë traditave të bazuara në shumësinë kombëtare e fetare, në masë të konsiderueshme ndikonte në masën e mostolerancës fetare. Sigurisht mostoleranca fetare, përveç faktorëve të tjerë, fuqimisht imponohej nga mjetet politike. Rol të theksuar ka pasur "revolucioni antiburokratik", me theksimin e misionit të mbrojtjes së krishterimit të popullit serb nga depërtimi i fundamentalizmit islamik shqiptar.

Në realitetin shoqëror të ish-RSF të Jugosllavisë, kishte tendenca të theksuara në suazat qeveritare dhe në suazat e partive të caktuara politike, me orientime ultranacionaliste, si dhe rryma të caktuara në bashkësitë e caktuara fetare, që edhe kisha, si një potencial e si një forcë e veçantë shoqërore, të shndërrohej në një formë specifike të fu-

qisë politike. Tendenca e përgjithshme e këtyre forcave ka qenë që besimi të futej në politikë dhe të konstituohej si faktor politik. Shumica e këtyre forcave karakterizohej nga mostoleranca dhe ato nuk ishin të gatshme për kurrfarë dialogu për pikëpamjet e tjera. Shumë nga këto parti politike dhe bashkësi fetare, në veçanti strukturat udhëheqëse shtetërore, mbështeteshin në motivacionin fetar dhe në angazhimin moral të besimtarëve, përkatësisht të aderuesve të vet. Të gjitha këto forca, edhe pse paraqiteshin në petkun demokratik, kërkesat e veta i artikulonin në përparimin kulturor të kombit, ato forca në thelb ishin retrogarde dhe frymëzoheshin nga terri mesjetar mitologjik.

Pra, toleranca fetare si parim i përgjithshëm qytetar dhe kulturor, paraqet pasojën e luftërave të zhvilluara në truallin e Evropës.

Vetëdija se me anë të forcës nuk mund të shkatërrohet kundërshtari, ka qenë një prej kushteve kryesore për krijimin e tolerancës fetare në Evropë. Toleranca fetare është diçka më pak se liria fetare dhe nënkupton - supozon disproporcionin dhe pabarazinë e caktuar. E drejta për tolerancë fetare mund të kufizohet dhe kufizohet me të drejtën e të tretit që të jetojë i lirë në pajtim me bindjet e veta.

Ideja e tolerancës fetare vërehet gjatë kohës moderne, kur liria e besimit ngrihet në parim kushtetues, fillimisht në Francë pas Revolucionit Borgjez (l789).

Toleranca fetare, në shtetet me sistem demokratik e parlamentar shndërrohet në institucion shoqëror dhe paraqet faktor me rëndësi të zgjidhjes së çështjeve fetare e kombëtare.

Mostoleranca dhe diskriminimi i bazuar në religjion ose në besim, janë të pranishme në shumë hapësira të botës bashkëkohëse. Përpjekjet dhe angazhimi i Bashkësisë Ndërkombëtare dhe i organizatave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut nuk kanë qenë në përputhje me rezultatet e arritura praktike, në këtë fushë. Problem më vete ka qenë edhe implementimi i parimeve në Deklaratën e Përgjithshme për të drejtat e njeriut dhe në Deklaratën për eliminimin e të gjitha formave të mostolerancës dhe të diskriminimit që mbështeten në religjion ose në bindje, në të drejtën pozitive të shteteve të caktuara, dhe zbatimi i tyre në praktikë. Ky fakt paraqet një problem

serioz që kërkon kujdes imediat dhe aksion të përhershëm të Bashkësisë Ndërkombëtare.

Duke shqyrtuar manifestimin e mostolerancës dhe të diskriminimit të bazuar në religjion ose në besim, në shtetet e caktuara të botës, duhet të merret parasysh se këto menifestime, jo vetëm për nga natyra e vetë janë serioze, por janë posaçërisht të rënda, sepse ato nën ndikimin e kushteve dhe rrethanave të caktuara, mund të shndërrohen në shkelje masive të të drejtave dhe të lirive të njeriut, madje në raste të caktuara mund të marrin dimensionin e krimit kundër njerëzimit, ndaj një komuniteti - bashkësie të caktuar të njerëzve, të gjenocidit, si dhe paraqesin kërcënimin ndaj paqes dhe sigurisë në rajone të caktuara të botës.

Manifestimet e mostolerancës dhe diskriminimit në radhë të parë cungojnë ose shkelin të drejtën e të menduarit, të ndërgjegjes, religjionit ose besimit si dhe liritë, siç janë: (a) të drejtën për të falur dhe për tubim në bazë të cilitdo religjion dhe besim, si dhe të drejtën për të mirëmbajtur vendet e ritit dhe të kultit; (b) për të themeluar dhe mirëmbajtur institucionet përkatëse mirëbërëse dhe humanitare; (c) për të bërë, për të siguruar dhe përdorur në mënyrë përkatëse artikujt dhe materialet që kanë të bëjnë me ritet dhe zakonet e një religjioni ose besimi si dhe për të shkruar, botuar dhe përhapur publikime në fushat relevante; (ç) për të predikuar religjionin ose besimin në vendet e përshtatshme për këtë qëllim; (d) për të kërkuar dhe marrë kontribute vullnetare financiare dhe kontribute te tjera nga individët dhe institucionet, si në vend ashtu edhe jashtë vendit; (e) për të trajnuar, shkolluar dhe emëruar ose caktuar sipas radhës udhëheqës fetarë në poste përkatëse, që kërkohen sipas standardeve të cilitdo religjion ose besim; (f) për të festuar ditët e pushimit dhe ditët e ceremonive në përputhje me parimet e rregullat e religjionit ose të besimit të caktuar dhe (h) për të themeluar dhe kultivuar lidhjet me individë dhe konfesione, në vend dhe në nivele ndërkombëtare, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me religjionin ose besimin e caktuar.

Sipas Nënkomisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Mbrojtjen e Minoriteteve të OKB-së, të parashtruar në Rezolutën l985/20,

datë 29. 08. l985[12], manifestimet e mostolerancës dhe të diskriminimit në bazë të religjionit ose të besimit ngushtojnë ose paraqesin shkeljen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, përfshirë të drejtën për jetën, të drejtën për lirinë dhe sigurinë personale, të drejtën e lirisë nga tortura dhe nga dënimi mizor, trajtimin jonjerëzor dhe degradues, të drejtën për dëgjim fer dhe publik nga ndonjë gjykatë e pavarur dhe e paanshme, të drejtën për liri të lëvizjes dhe të drejtën për zgjedhjen e lirë të vendbanimit, të drejtën për tubim dhe bashkim të lirë në shoqata, të drejtën për intimitet dhe të drejtën e minoriteteve për të predikuar dhe ushtruar religjionin ose besimin në mënyrë të papenguar.

Sipas Rezolutës l985/20, në pikën 70 përmendet rasti i ish-RSF të Jugosllavisë, në lidhje me burgosjen e klerikëve dhe të besimtarëve nga tri konfesionet më të mëdha fetare. Ata (klerikët dhe besimtarët e burgosur) zakonisht ngarkoheshin për abuzim të fesë ose të pozitës së tyre fetare për qëllime nacionaliste dhe për provimin e ideve politike. Përvec kësaj, edhe pse me Kushtetutë e me ligje të tjera pozitive garantohej barazia për të gjithë qytetarët, besimtarët nuk mund të anëtarësoheshin në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë efektivisht, kjo do të thotë që besimtarëve u mohohej e drejta për të gjitha postet politike, në çdo nivel të organizimit shoqëror e shtetëror. Veç kësaj, edhe pse paragjykimet kundër besimtarëve zyrtarisht gjykoheshin e konsideroheshin si sektarizëm, në praktikë paragjykimi i këtillë mbisundonte në qarqet zyrtare të çdo niveli të hiearkisë shtetërore.

Në të gjitha shtetet e ish-Evropës Lindore, autoritetet qeveritare në mënyrë sistematike ndalonin praktikimin e zakoneve dhe traditave të pjesëtarëve të konfesionit mysliman. Gjithashtu, në mënyrë sistematike, ndalonin vijimin e shkollave fetare nga ana e fëmijëve të konfesionit mysliman. Praktika myslimane e synetisë (circumcision) jo vetëm

[12] Elemination of all forms of intolerance and discrimination based on religion or belief, Study of the current dimensions of the problems of intolerance and of discrimination on graunds of religion or belief. Raport by Mrs. Elizabeth Odio Benito, Special Rapportuer. Economic and Social Council - Economic Commission for Europe. Sub-Commission on Prevention of Discrimination and Protection of Minoritie. Thirty-minth session. Iten l3 of the provisional agenda. E/CN. 4/Sub. 2/l987/26. 31 August l986, fq. 9 dhe në vazhdim.

që ndalohej, por me ligje penale sanksionohej si vepër penale. Për prindërit e fëmijëve parashihej shqiptimi i dënimit prej tre deri në pesë vjet burgim. Gjithashtu larja e kufomave, një prej rregu-llave dhe zakoneve myslimane, ishte e ndaluar. Këto veprime të autoriteteve shtetërore përbënin shkelje të të drejtave elementare të njeriut në lëmin e së drejtës për ushtrimin e lirë të religjionit dhe të zakoneve fetare.

Sipas Raportit të përmendur të OKB-së, dyzet e katër shtete, në mënyrë eksplicite, në kushtetutat në Raportet e veta ose në ligjet themelore, inkorporonin garantimin e së drejtës e të lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të religjionit ose të besimit. Përveç kësaj, këto të drejta dhe liri, në shtatë kushtetuta të shteteve të caktuara nënkuptoheshin pa i cekur në mënyrë decidive; dy prej këtyre kushtetutave të "pashkruara" (Izraeli dhe Mbretëria e Bashkuar), dy prej këtyre shteteve ndalojnë nxjerrjen e çfarëdo ligji lidhur me themelimin e ndonjë religjioni ose besimi zyrtar, ose ligji që do të ndalonte apo të kufizonte ushtrimin e lirë të religjionit ose të besimit (Australia dhe ShBA). Pesë shtete në kushtetutat e veta pranojnë neutralitetin e shtetit lidhur me religjionin ose besimin (Burundi, Çadi, Madagaskari, Nigeria dhe Turqia). Dymbëdhjetë shtete në kushtetutat apo në ligjet e veta themelore u referohen të tri lirive themelore të përmendura në nenin l të Deklaratës për eliminimin e të gjitha formave të mostolerancës dhe diskriminimit që mbështeten në religjion ose besim: lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe lirinë e besimit; (Republika e Qipros, Franca, Izraeli, Italia, Xhamajka, Mauriciusi, Monako, Nigeria, Katari, Tongo, Trinidadi dhe Tobago dhe Mbretëria e Bashkuar). Një numër i shteteve në kushtetutat apo në ligjet themelore parashohin, në mënyrë të përgjithësuar të drejtën e mendimit të lirë, lirinë e ndërgjegjes dhe të drejtën e religjionit ose besimit. Tridhjetë e nëntë shtete në kushtetutat a në ligjet e veta themelore parashohin të drejtën e religjionit në mënyrë decidive (Argjentina, Barbadosi, Kepi i Gjelbër, Kili, Kolumbia, Republika e Qipros, ish-Çekosllovakia, Ekuadori, Finlanda, ish-Republika Demokratike Gjermane, Republika Federale e Gjermanisë, Guatemala, Hondurasi, Iraku, Izraeli, Italia, Xhamajka, Jordania, Mauriciusi, Meksiko, Holanda, Nigeria, Pakistani, Peruja, Portugalia, Katari,

Ruanda, Ishujt e Solomonit, Spanja, Surinami, Suedia, Republika Arabe e Sirisë, Tailanda, Tonga, Trinidadi dhe Tobago, Turqia, Mbretëria e Bashkuar, Venezuela dhe Zambia). Njëzet e shtatë shtete në kushtetutat a ligjet themelore parashohin lirinë e ndërgjegjes (Bahamet, Bullgaria, ish-RSS e Bellorusisë, Kili, Kolumbia, Republika e Qipros, Republika Dominikane, Finlanda, ish-Republika Demokratike Gjermane, Republika Federale Gjermane, Izraeli, Italia, Xhamajka, Mauriciusi, Nigeria, Partugalia, Katari, Ruanda, Ishujt e Solomonit, Zvicra, Republika Arabe e Sirisë, Tonga, Trinidadi dhe Tobago, Turqia, ish-RSS e Ukrainës, ish-BRSS dhe Mbretëria e Bashkuar). Njëmbëdhjetë shtete në kushtetutat e veta parashohin të drejtën e mendimit të lirë (Barbadosi, Izraeli, Italia, Xhamajka, Mauriciusi, Nigeria, Katari, Spanja, Tonga, Trinidadi dhe Tobago si dhe Mbretëria e Bashkuar). Tetë shtete në kushtetutat a ligjet themelore parashohin të drejtën e besimit (Bullgaria, ish-Republika Demokratike Gjermane, Republika Federale e Gjermanisë, Guatemala, Jordania, Zvicra, Republika Arabe e Sirisë dhe Zambia).

Në dispozitat e kodeve penale të shumë shteteve të botës është sanksionuar parandalimi dhe ndëshkimi i veprave të mostolerancës dhe diskriminimit në bazë të religjionit ose besimit. Në këtë drejtim ekziston një disparitet i madh në definimin e mostolerancës dhe diskriminimit të bazuar në religjion ose besim. Disa kode penale mostolerancën dhe diskriminimin, të bazuar në religjion ose në besim, e kategorizojnë si kundërvajtje, kurse disa si vepër penale, duke siguruar dënime dhe ndëshkime përkatëse për ata që shpallen fajtorë. Në këto shtete mostoleranca dhe diskriminimi në bazë të religjionit ose besimit, konsiderohen si krime, sepse shkelin seriozisht të drejtat dhe liritë themelore të viktimave të pafajshme.

Sa i përket kategorizimit të formave dhe të manifestimit të mostolerancës dhe diskriminimit të bazuar në religjion ose besim, ato janë të shumta si dhe vëlimi i tyre është i madh. Këtu do të përmendim vetëm disa lloje - më karakteristiket të mostolerancës dhe diskriminimit, të cilat janë të ndaluara dhe sanksionohen në kodet penale relevante. Në disa kode penale është sanksionuar përgojimi i religjionit ose i besimit, përgojimi i pjesëtarëve ose udhëheqësve fetarë të konfesioneve të caktuara religjioze, invidualisht ose kolektivisht; përqeshja, përçmimi, përbuzja ose ofendimi në bazë të gjuhës me qëllim të zvogëlimit të numrit të besimtarëve dhe duke shkaktuar ndjenjën armiqësore të urrejtjes ose të keqdashjes ndaj konfesionit të caktuar religjioz ose ndaj bashkësisë të caktuar të besimtarëve, si dhe duke nxitur të tjerët në kryerjen e veprave të këtilla (ish-Çekosllovakia, Danimarka, Franca, Iraku, Jordania, Madagaskari, Mauriciusi, Pakistani, Portugalia, Spanja, Sudani, Suedia, Republika Arabe e Sirisë etj.).

Në disa kode penale ndalohet dhe ndëshkohet përdorimi i forcës, ose kërcënimi me përdorim force kundër personave, grupeve, organizatave me qëllim ose me efekt të detyrimit të tyre për pjesëmarrje ose për pengimin që të marrin pjesë në adhurim ose në ritet e religjionit ose të besimit ose për nxitjen e të tjerëve për akte të këtilla (ish-Çekosllovakia, Finlanda, Izraeli, Italia, Jordania, Mauriciusi, Panamaja, Venezuela etj.) Në disa kode penale sanksionohet pengimi ose shkaktimi i trazirave gjatë faljes dhe kryerjes së riteve religjioze ose riteve të besimit, me anë të akteve të qëllimshme duke ndërhyrë ose duke ndërprerë tubimet e ligjshme religjioze, të ftuara e të caktuara për këto qëllime, ose nxitjen e të tjerëve për kryerjen e akteve të këtilla. Në disa kode penale është sanksionuar refuzimi i ndonjë shërbimi ose mohimi i ndonjë të drejte ndonjë personi ose grupi të njerëzve, bazuar në religjion ose në besimin e tyre, ose në nxitjen e njerëzve të tjerë për kryerjen e akteve të këtilla (Franca, Iraku, Ruanda, Suedia, ish-RS e Ukrainës etj.). Disa kode penale sanksionojnë nëpërkëmbjen e personit dhe të drejtave të qytetarëve, me pretekst të kryerjes së ceremonisë fetare (ish-RS e Ukrainës etj.). Disa kode penale i sanksionojnë si vepër penale këto veprime: trazimi i paqes dhe tolerancës fetare (Finlanda); propagandimin e mosdurimit konfesional ose sektar (Iraku); botimi ose shqiptimi i fjalëve ose materialit tjetër që llogaritet se cenojnë ndjenjat religjioze ose të besimit të personave të tjerë (Izraeli), sulmi ose cenimi i integritetit fizik të klerikut, kryerja e veprave të blasfemisë (përdhosjes së gjërave të shenjta), që ofendojnë sedrën religjioze të mbrojtur me ligjet përkatëse (Spanja); organizimi ose

drejtimi i ndonjë grupi veprimtaria e të cilit, e udhëhequr nën maskën e propagandimit të besimeve fetare ose duke kryer ceremoni e rituale religjioze, janë të dëmshme për shëndetin e qytetarëve ose cenojnë të drejtat e tyre personale, ose vepra të cilat i nxisin qytetarët që të refuzojnë aktivitetet shoqërore ose kryerjen e detyrave qytetare, ose që kërkojnë t'i tërheqin të miturit në këto grupe (ish-BRSS). Në disa shtete, disa dispozita të kodeve penale rrjedhin dhe kanë bazë në ligjet përkatëse fetare dhe në ligjet për bashkësitë fetare.

Mangësia e kodeve të konsiderueshme penale ka qenë se zbatoheshin në mënyrë selektive, përkatësisht zbatoheshin ndaj besimtarëve të një konfesioni të caktuar, me arsyetimin se pjesëtarë të konfesionit të caktuar janë involvuar në ushtrimin e mostolerancës e të dhunës, kështu që në praktikë bëhej diskrimin praktik ndërmjet konfesioneve dhe besimtarëve.

Përfundim

Në këtë punim është paraqitur ideja e tolerancës fetare dhe zhvillimi i saj gjatë historisë në shoqëritë e ndryshme. Ideja e tolerancës fetare në shumicën e besimeve është e pranishme si normë obliguese ose si traditë fetare, por zbatimi i saj në praktikë ka qenë më tepër se modest. Në emër të bindjeve fetare janë zhvilluar luftëra të përgjakshme. Mostoleranca fetare ka qenë një prej shkaqeve më të shpeshta të diskriminimit ndërmjet njerëzve. Në historinë e Qytetërimit Perëndimor toleranca fetare është paraqitur shumë vonë dhe së pari ka përfshirë bashkësitë e vogla fetare. Si normë obliguese e sjelljes shoqërore, toleranca fetare në Qytetërimin Perëndimor paraqitet në shtetet me sistemin parlamentar dhe demokratik. Islami si fe e shpalljes **par excellence** është fe jo vetëm e tolerancës por edhe e bashkëjetesës fetare. Islami nuk ka asgjë të përbashkët me fanatizëm dhe mostolerancë. Islami është fe që garanton lirinë personale dhe kolektive të gjithë njerëzve e të kolektiviteteve të tyre. Islami paraqet inkurajimin për drejtësi dhe progres shoqëror. Kryerja e detyrimeve fetare nga myslimani nënkupton humanitetin dhe drejtësinë. Toleranca fetare është dicka më pak se liria fetare dhe nënkupton – supozon disproporcion dhe pabarazi të caktuar. E drejta për tolerancë fetare mund të kufizohet dhe kufizohet me të drejtën e të tretit që të jetojë i lirë në pajtim me bindjet e veta. Mostoleranca dhe diskriminimi i bazuar në religjion ose besim, janë të pranishme në shumë hapësira të botës bashkëkohëse. Përpjekjet dhe angazhimi i Bashkësisë Ndërkombëtare dhe organizatave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut nuk kanë qenë në përputhje me rezultatet e arritura praktike në këtë fushë.

Mr. sc. Menduh Bamja

THE IDEA OF RELIGIOUS TOLERANCE AND ITS INFLUENCE IN SOCIETY

(Summary)

The issue of religious tolerance is one of the most serious provocations the contemporary world is facing. The importance of the idea of religious tolerance as a moral principle is best seen if we look at the inter-ethnic conflicts throughout the world, which contain in themselves many religious elements. In a considerable part of the world, along with other social factors, faith and religious beliefs are a source of conflict and egoism. Intolerance and religious egoism have serious consequences in the political plan. In the name of religious beliefs, acts of religious and political aggression are committed.

مندوح باميا

فكرة التسامح الدينى و تأثيره فى المجتمع

(خلاصة البحث)

قضية التسامح الدينى هى من اهم التحديات التى تواجه العالم فى الوقت الحاضر. ان اهمية التسامح الدينى كمبدإ اخلاقى و قانونى للعالم المعاصر دون ان نستثنى منها حتى يوغسلافيا السابقة حيث يظهر أن العوامل الدينية لعبت دورا فى الصراع. و يلاحظ أن فى اجزاء مختلفة من العالم الى الجوانب الاجتماعية العوامل الدينية تعدا منبعا من متابع المشاكل و سوء التفاهم بين الناس. ان عدم التسامح والتعصب الدينى لهما تأثير كبير فى المجال السياسى و فى كثير من الاحيان باسم الدين و المعتقدات الدينية ترتكب اعمال شنيعة ضد آناس آخرين.

SHOQËRI

Dr. Sherif Muhamed

FEMRA NË ISLAM PËRBALLË TRADITËS JUDEO-KRISHTERE – (3)
Miti & Realiteti*

14. POLIGAMIA – Martesa me më shumë se një grua

Le t'i rrekemi tani problemit më të rëndësishëm, që është poligamia. Poligamia është një praktikë shumë e vjetër që e hasim në shumë shoqëri njerëzore. Do theksuar se Bibla nuk e kundërshtoi poligaminë, përkundrazi, Dhjata e vjetër dhe shkrimet e rabinëve vazhdimisht deklaroheshin për legalizimin e poligamisë. Sipas tyre, thuhet se mbreti Salamon (Sylejmani a.s.) ka pasur shtatëqind gra me kurorë dhe treqind të tjera pa kurorë (1 Mbretërve, 11:3). Gjithashtu sipas tyre, thuhet se mbreti David (Davudi a.s.) ka pasur shumë gra me kurorë dhe të tjera pa kurorë (Dhjata e vjetër, 2 Samueli 5:13). *Në Dhjatën e Vjetër gjenden disa dispozita se si duhet të ndahet prona e një njeriu i cili djemtë i ka me gra të ndryshme* (Ligji i Përtërirë, 22:7). Kufizimi i vetëm në lidhje me poligaminë është ndalimi (mallkimi) i martesës me motrën e gruas duke ia bërë atë ortake gruas së tij (Levitiku, 18:18).

* *Titulli i origjinalit* Women in Islam, versus Judeo-Christian tradition Myth & Reality

Talmudi këshillon për më së shumti katër gra[51]. Hebrenjtë e Evropës vazhduan të praktikojnë poligaminë deri në shekullin e shtatë. Hebrenjtë orientalë (të Lindjes), praktikonin poligaminë derisa u kthyen në Izrael, ku ajo u ndalua me ligjin civil. Megjithatë, sipas ligjit të tyre fetar, i cili në raste të tilla nuk e njeh ligjin civil, poligamia është e lejuar[52].

Si qëndron çështja me Dhjatën e re?

Ati Eugen Hillman në librin e tij "Rishqyrtimi i poligamisë" thotë: "Askund në Dhjatën e re nuk gjendet ndonjë urdhër i qartë, i cili thotë se martesa duhet të jetë monogame (vetëm me një grua), ose ndonjë urdhër tjetër i qartë për ndalimin e poligamisë"[53]. Përveç kësaj, Jezusi nuk ka folur asgjë kundër poligamisë, megjithëse poligamia praktikohej nga hebrenjtë në shoqërinë e tij. Ati Hillman thekson faktin se Kisha Romake kishte ndaluar poligaminë me qëllim që t'i përshtatej kulturës greko-romake (e cila ligjërisht parashihte vetëm një grua, ndonëse toleronte bashkëjetesën jashtë martesës dhe laviritetin). Ai e citon Shën Augustinin që thoshte: "Në të vërtetë, tani, në kohën tone, në pajtim me zakonet romake, nuk lejohet më tutje të merret edhe një grua e dytë"[54]. Kishat afrikane dhe të krishterët afrikanë ua kujtojnë shpesh vëllezërve të tyre evropianë se ndalesa kishtare mbi poligaminë është një traditë kulturore dhe jo një urdhër i vërtetë krishterë.

Kur'ani e lejon gjithashtu poligaminë, por jo pa kufizime:

"Në qoftë se frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakëve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, tri e me katra. E nëse i frikësoheni padrejtësisë *(ndaj tyre),* ***atëherë vetëm me një…"*** *(En Nisaë, 3)*

51 Swidler, faqet 144-148.
52 Hazleton, faqet 44-45.
53 Eugene Hillman, Polygamy Reconsidered: African Plural Marriage and the Christian Churches (NeW York: Orbis Books, 1975) faqe 140.
54 Ibid., faqe 17.

Kur'ani ndryshe nga Bibla, e ka kufizuar në katër numrin më të madh të grave me kushtin e prerë që ato të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë. Mirëpo, me këtë nuk duhet të kuptohet se Kur'ani i nxit besimtarët të praktikojnë poligaminë apo se poligamia është konsideruar si një ideal (i muslimanëve). Me fjalë të tjera, Kur'ani e ka *"toleruar"* ose *"lejuar" poligaminë dhe asgjë më tepër se kaq,* por pse? Pse është pranuar poligamia? Përgjigjja është e thjeshtë: *Ekzistojnë vende dhe kohë të caktuara në të cilat gjenden faktorë shoqërorë dhe moralë, të cilët e bëjnë poligaminë të domosdoshme.* Ashtu siç tregon edhe ajeti i lartpërmendur, çështja e poligamisë në Islam nuk bën të kuptohet jashtë obligimeve të shoqërisë ndaj fëmijëve bonjakë dhe grave të veja. Meqenëse *Islami është një fe e gjithanshme, e përshtatshme për të gjitha vendet dhe të gjitha kohët, nuk ka mundur t'i injorojë obligimet e këtilla të domosdoshme.*

Në shumicën e shoqërive njerëzore, femrat janë më shumë në numër se meshkujt. **Në ShBA ka më së paku tetë milionë femra më shumë sesa meshkuj**. Në një vend siç është Guinea, krahas çdo njëqind meshkujve gjenden njëqind e njëzet e dy femra. Në Tanzani, krahas 95 meshkujve gjenden 100 femra[55]. E pra, ç'duhet të bëjë shoqëria ndaj këtyre raporteve gjinore të çekuilibruara? Janë menduar zgjidhje të ndryshme: disa e kanë propozuar jetën në beqari, të tjerët e parapëlqejnë vrasjen e fëmijëve femra që në lindje. Ndërkaq të tjerë do të mendojnë se rrugëdalja e vetme është që shoqëria të tolerojë çdo veprim të mundshëm seksual: prostitucionin, seksin jashtë martesës, homoseksualitetin etj.

Për shoqëritë e tjera, sikur janë shumica e shoqërive afrikane sot, zgjidhja më e ndershme është të lejohen martesat në poligami, si një aspekt kulturor dhe institucion i respektuar shoqëror. Çështja që keqkuptohet shpesh në Perendim, është se femrat nëpër kulturat e tjera nuk e shohin gjithsesi poligaminë si një shenjë të poshtërimit të femrës. Për shembull, shumë vajza të reja afrikane, qofshin ato të krishtera a muslimane ose të tjera, parapëlqejnë të martohen me një njeri të

[55] Ibid., faqet 88-93.

martuar, i cili tanimë ka dëshmuar se është një bashkëshort i besueshëm. Shumë nga gratë afrikane, i nxitin burrat e tyre të marrin gruan e dytë, në mënyrë që ato të mos ndihen të vetmuara[56]. Një studim i bërë me më tepër se gjashtë mijë gra të moshës prej 15 deri 59 vjeç, në qytetin e dytë për nga madhësia në Nigeri, ka treguar se 60 për qind e atyre grave do të ishin të lumtura nëse burrat e tyre do të merrnin edhe nga një grua tjetër. Vetëm 23 për qind u shprehën të zemëruara për idenë e bashkëjetesës me një grua tjetër. Shtatëdhjetë e gjashtë për qind e grave nga studimi i bërë në Keni, poligaminë e shohin si një gjë pozitive. Në studimin që është bërë në pjesët rurale të Kenisë, 25 nga 27 gra poligaminë e kanë konsideruar të jetë më e mirë se monogamia. Përshtypjet e këtyre grave nga poligamia mund të jenë të mira dhe me përvojë të dobishme, nëse ato do të bashkëveprojnë me njëra - tjetrën[57].

Poligamia në shumicën e shoqërive afrikane është një institucion (zakon) aq i respektuar sa që disa kishat protestante tashmë po bëhen shumë tolerante ndaj saj. Peshkopi i Kishës Anglikane në Keni kishte deklaruar: "Megjithëse monogamia mund të jetë ideale në pasqyrimin e dashurisë ndërmjet burrit e gruas, kisha duhet ta ketë parasysh se në disa kultura të caktuara poligamia është e pranuar nga shoqëria dhe se të besuarit se poligamia është në kundërshtim me Krishterimin, nuk qëndron më[58]." Pas një studimi të vëmendshëm mbi poligaminë në Afrikë, meshëtari David Gitar nga Kisha Anglikane erdhi në përfundimin se poligamia e praktikuar idealisht, derisa të ekzistojë kujdesi për gratë e lëshuara dhe fëmijët, është më tepër krishtere sesa shkurorëzimi dhe rimartesa[59]. Unë personalisht njoh disa gra afrikane me arsim të lartë, të cilat, megjithëse kanë jetuar në Perëndim për shumë vjet, nuk kanë asgjë kundër poligamisë. Njëra prej tyre jeton në ShBA; ajo

[56] Ibid., faqet 92-97.
[57] Philip L. Kilbride, Plural Marriage For Our Times (Westport, Conn.: Bergin & Garvey, 1994) faqet 108-109.
[58] The Weekly Review, Aug. 1, 1987.
[59] Kilbride, mendimet e paraqitura në faqe 126.

seriozisht e ka këshilluar burrin e saj të merrte gruan e dytë, në mënyrë që ta ndihmonte atë për t'i rritur fëmijët.

Problemi i mosharmonisë ndërmjet raporteve gjinore bëhet vërtet edhe më problematik gjatë kohës së luftërave. Fiset autoktone të indianëve të Amerikës kanë provuar ndryshimin e lartë të raporteve gjinore si shkak i humbjeve të pësuara gjatë luftërave. Femra nga këto fise, e cila në fakt gëzonte një status vërtet të lartë, e pranoi poligaminë si mbrojtjen më të mirë ndaj përmbushjes së kënaqësive përmes veprave të pahijshme. Ardhacakët evropianë, duke mos ofruar kurrfarë alternative tjetër, këtë poligami tek indianët e dënuan si një vepër "jocivilizuese"[60]. Pas Luftës së Dytë Botërore, në Gjermani kishte 7,300.000 femra më shumë sesa meshkuj (3.3 milionë prej tyre ishin gra të veja). Përballë 100 meshkujve të grupmoshës prej 20 deri 30 vjeç, kishte 167 femra të po kësaj grupmoshe[61]. Shumë nga ato femra kishin nevojë për burrë jo vetëm si shoqërues në jetë, po edhe si mbajtës i familjes, në një kohë mjerimi dhe vuajtjeje të pashembullt. Ushtarët e ushtrive aleate shfrytëzonin gjendjen e lëndueshme të këtyre femrave. Shumë vajza të reja dhe gra të veja kishin vënë lidhje dashurie me pjesëtarët e forcave okupuese. Ishin të shumtë ushtarët amerikanë dhe britanezë që kënaqësinë e tyre e paguanin me cigare, çokollata dhe me bukë. Fëmijët ishin tejet të gëzuar për dhuratat që u sillnin këta të huaj. Një çun dhjetëvjeçar, duke dëgjuar nga fëmijët e tjerë për dhuratat e tilla, e dëshiroi me gjithë zemër një anglez për nënën e tij, në mënyrë që ajo të mos mbetej edhe më tutje e uritur [62]. Ne duhet ta pyesim ndërgjegjen tonë në lidhje me këtë çështje: **Ç'është më dinjitoze për femrën? Të jetë një grua e dytë e pranuar dhe e respektuar siç i trajtonin indianët gratë e tyre, apo një lavire e vërtetë, e trajtuar si në situatën me aleatët e "civilizuar"?** Me fjalë

[60] John D'Emilio dhe Estelle B. Freedman, Intimate Matters: A history of Sexuality in America (New York: Harper & Row Publishers, 1988) faqe 87.
[61] Ute Frevert, Women in German History: nga Bourgeois Emancipation to Sexual Liberation (Neë York: Berg Publishers, 1988) faqet 263-264.
[62] Ibid., faqet 257-258.

të tjera, ç'e bën femrën më dinjitoze, udhëzimi kuranor apo teologjia e bazuar në kulturën e Perandorisë Romake?

Është interesant të shënohet se në një konferencë ndërkombëtare të rinisë, mbajtur në Munih në vitin 1948, ishte diskutuar problemi i mosharmonisë së lartë në raportet gjinore në Gjermani. Me të arritur në përfundimin se nuk mund të gjendej ndonjë zgjidhje e pajtueshme, disa pjesëmarrës propozuan si zgjidhje poligaminë. Në fillim reagimi i pjesëmarrësve ishte një përzierje e tronditjes dhe pakënaqësisë. Mirëpo, pas një studimi të vëmendshëm të propozimit, pjesëmarrësit u pajtuan që kjo ishte zgjidhja e vetme e mundshme. Si rrjedhim, poligamia qe përfshirë në raportin përmbledhës të propozimeve nga konferenca[63].

Bota sot posedon armë për shkatërrimin në masë më shumë se kurrnjëherë më pare, prandaj dhe kisha evropiane, herët a vonë, do të jetë e detyruar ta pranojë poligaminë si të vetmen rrugëdalje. Ati Hillman e ka pranuar këtë fakt me mature:

"Është një gjë fare e besueshme se këto teknika gjenocidale (nukleare, biologjike, kimike…) do të sjellin një çekuilibër të vrullshëm ndërmjet gjinive, saqë martesa e shumëfishtë do të bëhet mënyra më e domosdoshme për të mbijetuar…Ndërsa atëherë, përkundër zakonit dhe ligjit të mëparshëm, do të shtohet nevoja natyrore dhe morale për përkrahjen e poligamisë. Në një situatë të tillë, teologët dhe paria kishtare do të paraqesin shpejt arsyet bindëse dhe tekstet biblike për të vërtetuar konceptin e ri mbi martesën[64]."

Deri në kohën tonë, poligamia vazhdon të jetë një zgjidhje e shëndoshë kundër disa sëmundjeve sociale të shoqërisë bashkëkohore. Obligimet shoqërore që ka përmendur Kur'ani, të cilat e shoqërojnë lejimin e poligamisë, janë shumë më të dukshme aktualisht në disa shoqëri perëndimore sesa në Afrikë. Për shembull, sot në ShBA ekziston një krizë e rëndë ndërgjinore në komunitetin zezak. Një nga njëzet meshkuj të rinj zezakë vdes para se të arrijë moshën njëzetenjë

[63] Sabiq, mendimet e paraqitura në faqe 191.
[64] Hillman, mendimet e paraqitura në faqe 12.

vjeçare. Për ata të grupmoshës 20 deri 35 vjeç, vrasja është shkaku kryesor i vdekjes[65]. Përveç kësaj, shumë meshkuj të rinj zezakë janë të papunë, të burgosur ose narkomanë[66]. Si rezultat i këtyre, nga katër femra zezake të moshës 40-vjeçare, një prej tyre nuk ka qenë asnjë-herë e martuar, kurse kjo gjendje tek femrat e bardha është një në dhjetë[67]. Gjithashtu, shumë femra të reja zezake, para moshës 20 vje-çe, ende pa u martuar ,bëhen nëna dhe i shtojnë vetes nevojën që të kujdeset dikush për to. Rezultati përfundimtar i këtyre rrethanave tragjike është shtimi i numrit të femrave të zeza, të cilat janë të angazhuara në atë që quhet "ndarje e burrit"[68]. Kështu, shumë prej femrave zezake të pamartuara e fatkeqe hyjnë në lidhje dashurie me burra të martuar. Gratë gjithashtu shpesh bëhen të pamoralshme, për shkak se femrat e tjera e "ndajnë" burrin e tyre me to. Disa vëzhgues të krizës së quajtur "ndarje e burrave" në komunitetin afro-amerikan, kanë rekomanduar bindshëm për një marrëveshje mbi poligaminë si një përgjigje kalimtare ndaj zvogëlimit të numrit të meshkujve zezakë derisa të mos ndërmerren reforma më të mëdha gjithëpërfshirëse në shoqërinë amerikane[69]. Me marrëveshje për poligaminë, ata mendojnë një formë të poligamisë të lejuar nga komuniteti dhe me të cilën do të pajtoheshin të gjitha grupet pjesëmarrëse, si kundërvënie ndaj ndarjes së zakonshme të fshehtë të burrit, që është një gjë e dëmshme si për gruan, ashtu edhe për komunitetin në përgjithësi. Problemi i ndarjes së burrit në komunitetin afro-amerikan ishte tema e diskutimit të ekspertëve në konferencën që u mbajt më 27 janar 1993 në Universitetin Temple në Filadelfi[70]. Disa nga folësit poligaminë e paraqitën një mjet potencial për të dalë nga kriza. Ata gjithashtu sugjeruan që poligamia të mos ndalohet me ligj, sidomos jo në një shoqëri që toleron prostitucionin dhe dashuriçkat. Komenti i një gruaje nga publiku se afro-amerikanët

[65] Nathan Hare dhe Julie Hare, në librin "Crisis in Black Sexual Politics" (San Francisco: Black Think Tank, 1989) faqe 25.
[66] Ibid., faqe 26.
[67] Kilbride, faqe 94.
[68] Ibid., faqe 95.
[69] Ibid.
[70] Ibid., faqet 95-99.

kanë nevojë të mësojnë nga afrikanët, ku poligamia është praktikuar me përgjegjësi të plotë, shkaktoi brohoritje ngazëllyese nga të pranishmit.

Filip Kilbrid, një antropolog amerikan me traditë katoliko-romake, në librin e tij ngacmues "Martesat plurale (të shumëfishta) për kohën tonë", e propozonte poligaminë si zgjidhje të plotë për disa sëmundje të shoqërisë amerikane. Ai sjell prova se martesa e shumëfishtë mund të shërbejë si një alternativë potenciale ndaj shkurorëzimit në shumë raste, duke parandaluar kështu pasojat e dëmshme tek fëmijët, që mund të vijnë për shkak të shkurorëzimit të prindërve. Ai pohon se në shoqërinë amerikane, për shkak të lidhjeve të shfrenuara jashtëmartesore kanë ndodhur shumë shkurorëzime. Sipas Kilbridit, përfundimi i lidhjeve jashtëmartesore, në martesë poligamike, para se të ndodhë ndarja, është shumë më mirë për fëmijët. "Për fëmijët do të ketë kujdes shumë më të mirë nëse familja shtohet, dhe në të kundërtën vetëm përçarja e shkatërrimi mbetet të shihen si zgjidhje. Veç kësaj, ai këshilloi gjithashtu që edhe grupet e tjera do të përfitojnë prej martesave plurale (poligamisë), siç janë: gratë e moshuara që kanë nevojë për përkujdesje të vazhdueshme dhe afro-amerikanet e përfshira në "ndarjen e burrave"[71].

Në vitin 1987, në anketën e drejtuar nga gazeta e studentëve të Universitetit të Kalifornisë në qytetin Berkeley, janë pyetur studentët nëse pajtohen që të lejohet me ligj që burri të ketë më tepër se një grua, duke pasur parasysh numrin e zvogëluar të meshkujve kandidatë për martesë në Kaliforni. Pothuajse të gjithë studentët që votuan, e miratuan këtë ide. Një studente madje konstatoi se martesa poligamike do t'i përmbushte nevojat e saj emocionale dhe ato fizike dhe do t'i jepte asaj një liri më të madhe sesa martesa monogamike[72]. Në të vërtetë, një argument i njëjtë është përdorur edhe prej një gruaje fundamentaliste mormone (martesa me shumë gra, sipas Krishterimit), komunitet që e praktikonë ende poligaminë në ShBA. Ata besojnë se

[71] Ibid., faqe 118.
[72] Lang, mendimet e paraqitura në faqe 172.

poligamia është një rrugë e përkryer për gruan që të ketë edhe karrierën edhe fëmijët, nëse gratë do t'i ndihmojnë njëra-tjetrës për përkujdesjen ndaj fëmijëve[73].

Duhet të shtohet gjithashtu se poligamia në Islam është një çështje e miratimit të përbashkët. **Askush nuk mund të detyrojë një femër që të martohet me një burrë të martuar.** Përveç kësaj, gruaja e ka të drejtën e kushtëzimit për rastet kur burri nuk duhet të marrë asnjë femër tjetër si grua të dytë[74]. Ç'është e drejta, Bibla ndonjëherë urdhëron që poligamia të praktikohet edhe me forcë. Vejusha që nuk ka fëmijë, duhet të martohet me vëllaun e burrit të saj edhe nëse ai tanimë është i martuar (shih në pjesën: "Gjendja e vështirë e vejushave"), pavarësisht nga pëlqimi i saj. (Zanafilla, 38:8-10)

Duhet të shënohet se sot në shumë shoqëri muslimane të praktikuarit e poligamisë është rralluar, që kur dallimi në mes numrit të të dy gjinive nuk është tepër i madh. Me siguri mund të thuhet se përqindja e martesave poligamike në Botën Islame është shumë më e ulët se përqindja e lidhjeve jashtëmartesore në Perendim. Me fjalë të tjera, **meshkujt sot në Botën Islame janë moralisht shumë më të drejtë në monogami sesa meshkujt në Botën Perëndimore.**

Billy Graham, një i krishterë i shquar evangjelist, e ka pranuar faktin se "Krishterimi nuk mund të rrezikojë (të përfshihet) në lidhje me çështjen e poligamisë. Nëse Krishterimi i ditëve të sotme nuk mund ta bëjë këtë, kjo shkon në dëmin e tij. Islami e ka lejuar poligaminë si zgjidhje kundër sëmundjeve sociale, mirëpo i ka vendosur shkallët e caktuara të lirisë së veprimit për llojin njerëzor vetëm brenda kornizave të përcaktuara saktësisht me ligj. Vendet e krishtera janë duke e shfaqur në mënyrë të famshme monogaminë, por në të vërtetë ato aktualisht praktikojnë poligaminë. Tanimë askush nuk është i pavetëdijshëm për lojën e luajtur me mjeshtëri në shoqëritë perëndimore. Në lidhje me këtë Islami është një fe krejtësisht e ndershme dhe muslimanin e lejon të martohet me gruan e dytë nëse atij i duhet ta bëjë këtë,

[73] Kilbride, faqet 72-73.
[74] Sabiq, faqet 187-188.

por ndalon rreptësisht të gjitha shoqërimet e fshehta në aspektin e dashurisë, dhe kjo me qëllim që t'i mbrojë parimet e pastra morale të bashkësisë"[75].

Është me interes të shënohet se sot në botë në shumë vende jomuslimane si dhe në ato muslimane ekziston poligamia e paligjshme. Në këto vende marrja e gruas së dytë, madje edhe me pëlqimin e lirë të gruas së parë, konsiderohet thyerje e ligjit. Kurse, në anën tjetër, mashtrimi (tradhtia) ndaj gruas, pa dijen a pëlqimin e saj, është përligjur krejtësisht, përderisa ligji është ai që duhet të brengoset për këtë! Cila është ajo mençuri ligjore që fshihet prapa kundërthënieve të këtilla? A mos vallë ligji qenka i përcaktuar për të shpërblyer mash-trimin dhe për të ndëshkuar ndershmërinë? Ekziston pra një paradoks i pazbërthyeshëm në botën tonë "të qytetëruar".

15. Shamia (Mbulesa e kokës)

Më në fund, le të hedhim pak dritë mbi atë që konsiderohet në Perëndim si shenja më e madhe e shtypjes dhe robërimit të femrës, që është shamia apo mbulesa e kokës. A është e vërtetë se në traditën judeo-krishtere nuk ekziston një gjë e tillë sikur mbulesa? Të paraqesim, pra, tani të dhënat e vërteta.

Rabini Dr. Menachem M. Brayer (Profesor i letërsisë biblike në Universitetin Yeshiva) në librin "Femra jehude në letërsinë e rabinëve" thotë se ka qenë zakon i femrave jehude kur dilnin publikisht, të ishin me mbulesë koke, e cila ndonjëherë mbulonte madje tërë fytyrën duke lënë njërin sy të lirë për të parë[76]. Ai citon disa thënie të dikurshme të njohura të rabinëve:

"Nuk është e pëlqyeshme që bijat e Izraelit të lëvizin jashtë me koka të pambuluara." dhe "I mallkuar qoftë ai burrë që lejon t'i shihen

[75] Abdul Rahman Doi, libri i quajtur "Woman in Shari'ah" (London: Ta-Ha Publishers, 1994) faqe 76.
[76] Menachem M. Brayer, The Jeëish Woman in Rabbinic Literature: A Psychosocial Perspective (Hoboken, N.J: Ktav Publishing House, 1986) faqe 239.

flokët gruas së tij....gruaja që nxjerr flokët e saj për vetë-zbukurim, sjell varfëri."

Ligji i rabinëve ndalon recitimin me zë të bekimeve a lutjeve kur janë të pranishme femrat e martuara kokëzbuluara, që atëherë kur mosmbulimi i flokëve të femrës u konsiderua **"lakuriqësi"**[77]. Dr. Brayer gjithashtu përmend se *"Gjatë periudhës së mundimeve (Tannaitic period) mospërfillja e mbulimit të kokës nga gruaja jehude ishte konsideruar një fyerje ndaj modestisë së saj. Kur koka e saj, të ishte e pambuluar, ajo do të gjobitej deri në katërqind zuzimë (monedhë e kohës së atëhershme) për këtë kundërvajtje."* Dr. Brayer gjithashtu shpjegon se mbulesa e femrës jehude nuk konsiderohej gjithmonë si shenjë e modestisë. Ndonjëherë mbulesa simbolizonte për më tepër pozitën e epërsisë dhe luksin sesa modestinë. Mbulesa personifikonte dinjitetin dhe epërsinë e femrës fisnike. Gjithashtu pasqyronte pakalueshmërinë e femrës si pronë e shenjtë e burrit të saj[78].

Mbulesa shprehte vetërespektin e femrës dhe gjendjen sociale të saj. Femra nga shtresa e ulët shpesh do të vinte mbulesë që të linte përshtypjen se i takonte pozitës së lartë. Vetë fakti se mbulesa ka qenë shenjë e fisnikërisë, ishte arsyeja pse lavireve në shoqërinë e vjetër jehude nuk u lejohej të mbulonin flokët e tyre. Megjithëkëtë, laviret shpesh vinin shalla të posaçëm, me qëllim që t'u ngjanin të ndershmeve[79]. Femrat jehude në Evropë vazhduan të vinin mbulesë deri në shekullin XIX kur jeta e tyre u përzie me mjedisin rrethues me kulturë shekullare (laike-jofetare). Shtytjet e jashtme të jetës evropiane në shekullin XIX i joshën shumë prej tyre që të dilnin kokëzbuluara. Disave nga gratë jehude iu duk më i përshtatshëm zëvendësimi i mbulesës së tyre tradicionale me parukë, si një formë tjetër e mbulimit të flokëve. Sot, shumica e grave fetare jehude nuk i mbulojnë flokët e

[77] Ibid., faqet 316-317. Shiqo gjithashtu Swidler, faqet 121-123.
[78] Ibid., faqe 139.
[79] Susan W. Schneider, Jewish and Female (New York: Simon & Schuster, 1984) faqe 237.

tyre përveç kur shkojnë në sinagogë[80]. Disa prej tyre, siç janë ato të sekteve hasidike, përdorin ende paruka[81].

Si qëndron puna me traditën krishtere? Është mirë e ditur se murgeshat katolike mbulonin kokën e tyre që para qindra vitesh, por kjo nuk është e tëra. Shën Pali në Dhjatën e re ka paraqitur disa qëndrime shumë interesante mbi mbulesën:

"Por dua që ta dini se kreu i çdo njeriu është Krisht, edhe kreu i gruas është burrë; edhe kreu i Krishtit është Perëndia. Çdo burrë, kur lutet ose profetizon kokëmbuluar, turpëron kryet e tij. Edhe çdo grua, që lutet ose profetizon kokëzbuluar, turpëron kryet e saj, sepse është njëlloj sikur të ishte e rruar. Sepse, në qoftë se gruaja nuk mbulohet, le t'ia presin flokët; por në qoftë se për gruan është turp të qethet a të rruhet, le të mbulojë kryet. Sepse burri nuk duhet të mbulojë kryet, se është shembëllimi dhe lavdia e Perëndisë, kurse gruaja është lavdia e burrit, sepse burri nuk është nga gruaja, por gruaja nga burri, edhe sepse burri nuk u krijua për gruan por gruaja për burrin. Prandaj gruaja, për shkak të engjëjve, duhet të ketë një shenjë pushteti mbi kryet. (Korintasve, 11:3-10).

Arsyeja kryesore e Shën Palit për mbulimin e femrës ishte se mbulesa paraqet shenjën e autoritetit të burrit, i cili është shëmbëllimi dhe lavdia e Zotit, mbi femrën e cila qe krijuar prej dhe për burrin. Shën Tertuliani në librin e tij të famshëm "Mbi të mbuluarit e virgjëreshave" shkruante: "O ju zonjusha, vini mbulesat kur të dilni jashtë në rrugë, pra ato duhet t'i vini edhe kur jeni në kishë, i vini ato kur jeni në mes të huajve, atëherë vini ato edhe kur jeni mes vëllezërve..." **Ndër rregullat krishtere (kanunore) të kishës katolike sot është një e tillë që kërkon nga femrat të mbulojnë kokën kur të shkojnë në kishë**[82]**.** Te disa kategori dominuese krishtere, siç janë amishët dhe menonitët, gratë e tyre i mbajnë të mbuluara deri në ditët e sotme.

[80] Ibid., faqet 238-239.
[81] Alexandra Wright, tema "Judaism", në librin "Holm and Bowker" faqet 128-129.
[82] Clara M. Henning, "Cannon Law and the Battle of the Sexes" në botim të Rosemary R. Ruether, Religion and Sexism: Shembëlltyra e gruas në traditat hebreje dhe krishtere (Neë York: Simon and Schuster, 1974) faqe 272.

Arsyeja për mbulesën, siç është dhënë nga paria e tyre kishtare, është se **"Të mbuluarit e kokës është simbol i nënshtrimit të gruas ndaj burrit dhe Zotit"**, një logjikë e njëjtë si ajo e futur në praktikë nga Shën Pali në Dhjatën e re[83].

Nga tërë ajo që u evidencua më lart, kuptohet qartë se **Islami nuk e shpiku mbulesën e kokës. Por Islami veçse e vërtetoi atë.** Kur'ani i urdhëron besimtarët meshkuj e femra të ulin sytët e tyre dhe të ruajnë modestinë dhe më pas i urdhëron femrat besimtare të zgjatin mbulesat e tyre të kokës për të mbuluar qafën (krahët) dhe gjokset e tyre:

***"Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet** (prej haramit), **të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, se kjo është më e pastër për ta….. Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të vënë shamitë mbi krahërorin e tyre…"** (En Nur, 30-31).* Kur'ani na e bën fare të qartë se mbulesa është gjë themelore për të qenë femra modeste, por cila është rëndësia e modestisë? Kur'ani është edhe më i qartë për këtë:

***"O ti Pejgamber, thuaju grave të tua, bijave të tua dhe grave të besimtarëve, le t'i vënë shamitë** (mbulojat) **e veta mbi trupin e tyre, sepse kjo është më afër që ato të njihen** (se nuk janë rrugaçe) **e të mos ofendohen".** (El-Ahzabë, 59).*

Kjo është e tërë çështja, modestia është urdhëruar që ta mbrojë femrën nga ngacmimet apo edhe më thjesht, modestia është mbrojtje.

Pra, mbrojtja është qëllimi i vetëm i mbulesës në Islam. Mbulesa islame, në dallim nga mbulesa sipas traditës krishtere, nuk është shenjë e autoritetit të mashkullit mbi femrën, as është shenjë e nënshtrimit të femrës ndaj mashkullit. Mbulesa islame, në dallim nga mbulesa në traditën jehude, nuk është shenjë e salltanatit (luksit) dhe e dallimit të disa grave të ndershme. Mbulesa islame është vetëm shenjë modestie, me qëllim të mbrojtjes së femrës, të të gjitha femrave. Botëkuptimi (filozofia) islam të mëson se më mirë është të jeshë i sigurt

[83] Donald B. Kraybill, The riddle of the Amish Culture (Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1989) faqe 56.

sesa i mjerë. Ç'është e vërteta, shqetësimi në Kur'an për mbrojtjen e femrës dhe nderit të saj është i tillë që mashkulli i cili guxon të ngrejë akuza të rrejshme ndaj femrës së pafajshme, do të ndëshkohet rreptë:

***"Edhe ata të cilët bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, t'i rrihni me nga tetëdhjetë të rëna dhe atyre mos u pranoni dëshminë kurrë më. Të tillët janë të pabesueshëm".** (En-Nur, 4)*

Krahaso tani këtë qëndrim të ashpër kuranor me ndëshkimin tepër të padrejtë mbi dhunimin e femrës sipas Biblës:

"Në rast se një burrë gjen një vajzë të virgjër që nuk është e fejuar, e merr dhe bie në shtrat me të, dhe kapen në flagrancë, burri që është shtrirë me të, do t'i japë babait të vajzës pesëdhjetë sikla argjendi dhe ajo do të bëhet bashkëshortja e tij, sepse e ka çnderuar dhe nuk mund ta përzërë sa të jetë gjallë. (Ligji i Përtërirë, 22:28-30)

Ne këtu duhet të shtrojmë një pyetje të thjeshtë: Kush po ndëshkohet vërtet këtu? Burri i cili paguan gjobën për dhunim, apo vajza e detyruar të martohet me një mashkull i cili e ka dhunuar dhe do të jetojë me të derisa të jetë gjallë ai? Një pyetje tjetër që duhet shtruar gjithashtu është kjo: Çfarë e mbron femrën më tepër, qëndrimet e ashpra kuranore, apo qëndrimet e padrejta të Biblës?

Disa njerëz, posaçërisht në Perëndim, do të përpiqen të tallen me tërë argumentin tonë se modestia është mbrojtje. Argumenti i tyre është se mbrojtja më e mirë është përhapja e edukimit, sjellja civilizuese dhe vetëpërmbajtja. Ne do t'u thoshim: Kjo është e mirë, por nuk mjafton. *Nëse **"civilizimi"** është mbrojtje e mjaftueshme, atëherë pse femra në Amerikën Veriore nuk guxon të lëvizë natën e vetme nëpër rrugë – ose madje as të kalojë nëpër parkingun e zbrazur? Nëse edukimi është zgjidhje, atëherë pse një universitet i respektuar si ai "Queen's", posedon "shërbimin për dërgimin në shtëpi" kryesisht për studentet nëpër kampe? Nëse vetëpërmbajtja është përgjigjja juaj, atëherë pse ka raste të ngacmimeve seksuale nëpër vendet e punës, të cilat raportohen nëpër media të informimit çdo ditë? Më të thjeshtat*

akuza të ngacmimeve seksuale në vitet e fundit përfshijnë: oficerët e marinës, drejtorët, profesorët universitarë, senatorët, prokurorë të gjyqit suprem dhe Presidentin e Shteteve të Bashkuara!

Nuk kam mundur t'u besoj syve kur lexova statistikat në vijim, të shkruara në një broshurë të lëshuar nga Dekani i shërbimit të femrave pranë Universitetit "Queen's":

"Në çdo gjashtë minuta në Kanada sulmohet seksualisht një femër, një në tri femra në Kanada do të jenë të sulmuara seksualisht ndonjëherë në jetën e tyre, një e katërta e femrave janë në rrezik ose bëhet përpjekje të dhunohen, një e teta e femrave do të sulmohen seksualisht gjatë kohës së vijimit të shkollës së mesme ose universitetit. Nga ky studim është zbuluar se 60% e meshkujve në moshën e shkollimit universitar në Kanada thonë se do të kryenin përdhunime nëse do të ishin të sigurt se nuk do të kapeshin nga policia."

Ka diçka krejtësisht të gabueshme në shoqëritë ku jetojmë ne. Patjetër është i nevojshëm një ndryshim rrënjësor në mënyrën e jetës shoqërore dhe në kulturë. Ka tepër nevojë për kulturën e modestisë, modestia në veshje, në të folur dhe sjellje tek të dy gjinitë, meshkuj e femra, sepse, përndryshe, statistikat e zymta do të rriten, madje do të jenë më të këqija nga dita në ditë dhe fatkeqësisht vetë femra do të jetë ajo që do të paguajë çmimin e tërë kësaj. Në të vërtetë, ne të gjithë po vuajmë, por siç kishte thënë K. Gibran: "...për njeriun që i merr goditjet, nuk është njësoj sikur për atë që i numëron ato" [84]. Prandaj, një shoqëri si Franca, e cila i përjashton vajzat e reja nga shkolla për shkak të veshjes së tyre modeste, më në fund, thjesht do ta dëmtojë vetveten.

Sot, një prej ironive më të mëdha në botën tonë është që mbulesa fare e njëjtë e kokës e mbajtur nga murgeshat katolike për arsye të shfaqjes së autoritetit të mashkullit, nderohet si dëshmi e "shenjtërisë", kurse kur femrat muslimane e vënë me qëllim të mbrojtjes së tyre, ato fyhen dhe kjo konsiderohet shtypje.

[84] Khalil Gibran, Thoughts and Meditations (New York: Bantam Books, 1960) faqe 28.

Përfundim

Nga të gjithë jomuslimanët që kanë lexuar versionin e mëhershëm të këtij studimi, ka dalë një pyetje e përgjithshme: A ka femra muslimane në Botën Islame një trajtim të tillë të mrekullueshëm siç përshkruhet këtu? Përgjigjja fatkeqësisht është: Jo. Që atëherë kur kjo pyetje është bërë e pashmangshme në diskutimet e bëra mbi pozitën e femrës në Islam, na është dashur të kërkonim përgjigjen, me qëllim që ta pajisim lexuesin me një pikturë të kompletuar përgjithësisht.

Së pari, do sqaruar se ndryshimet e mëdha ndër shoqëritë muslimane e bëjnë së tepërmi të lehtë përgjithësimin e gjërave. Sot ka një shtrirje (spektër) të gjerë të qëndrimeve ndaj femrës në Botën Islame. Ato qëndrime ndryshojnë prej një shoqërie në tjetrën dhe brenda çdo shoqërie në vete. Megjithatë, janë të dallueshme prirjet që kanë përcaktim përgjithësisht. Pothuajse të gjitha shoqëritë islame në një shkallë a në një tjetër kanë devijuar nga idealet e Islamit sa i përket pozitës së femrës. Këto devijime, për pjesën më të madhe (të muslimanëve) janë paraqitur në një nga dy drejtimet e kundërta. Drejtimi i parë është më konservativ, më i rreptë dhe me synim drejtë traditave, kurse i dyti është më liberal dhe me orientim perëndimor.

Shoqëritë që kanë devijuar në drejtimin e parë, femrën e trajtojnë sipas zakoneve dhe traditave të trashëguara nga të parët e tyre. Traditat e këtilla zakonisht femrën e privojnë nga shumë të drejta të dhuruara nga Islami. Përveç kësaj, femrat trajtohen sipas standardeve që ndryshojnë larg nga ato të zbatuara për meshkuj. Ky diskriminim përshkon jetën e çdo femre: kur ajo lind, pranohet me më pak gëzim sesa një djalë; shkuarja e saj në shkollë pëlqehet më pak; asaj mund t'i mohohet ndonjë gjë nga pjesa e trashëguar familjare; ajo është nën një mbikëqyrje të vazhdueshme, me qëllim që të mos sillet me jomodesti, kurse veprimet jomodeste të vëllezërve të saj janë të toleruara; madje ajo edhe mund të vritet për bindje të caktuara, për se të tjerët që janë meshkuj në familje, zakonisht mburren; ajo ka pak për të thënë për çështjet familjare a interesat e bashkësisë; ajo mund të mos ketë kontroll të plotë mbi pronën e saj dhe dhuratat martesore; dhe përfundimisht

ajo si nënë do t'i preferonte vetes të bënte djem, në mënyrë që të arrinte një pozitë më të lartë në bashkësinë e saj.

Në anën tjetër, ka nga shoqëritë muslimane (apo kategori të caktuara brenda disa shoqërive) që janë kthyer drejt kulturave dhe mënyrës së jetës perëndimore. Ato shoqëri shpesh imitojnë, pa menduar, çfarëdo që marrin nga Perëndimi, dhe zakonisht përfundojnë duke marrë frytet më të këqija të civilizimit perëndimor. Në ato shoqëri, prioriteti tipik modern më i lartë i femrave në jetë, është që të shtojnë bukurinë fizike. Prandaj ajo shpesh është e preokupuar me pamjen e saj fizike, gjatësinë dhe peshën. Ka prirje të kujdeset më tepër për trupin e saj sesa për mendjen, dhe më tepër për sharmin sesa për intelektin. Aftësitë e saj për sharmin, atraktiven dhe joshjen, në ato shoqëri vlerësohen më shumë se sa arritjet në edukime, aktivitetet intelektuale dhe punët sociale. Tek asnjëra nuk mund të pritet të gjendet ndonjë kopje e Kur'anit në çantën e saj. Ç'prej se ajo mbushet me kozmetikë më shumë se e tërë shoqëria e saj ku shkon ajo. Për anën shpirtërore të saj nuk ka vend në shoqërinë e preokupuar me gjërat atraktive. Dhe kështu, ajo do të kalojë jetën e saj më tepër duke u përpjekur të plotësojë anën femërore sesa të përmbushë atë njerëzoren.

Pse u shmangën shoqëritë muslimane prej idealeve të Islamit? Përgjigjja nuk është e lehtë. Një shpjegim i zbërthyeshëm i arsyes pse muslimanët nuk i kanë ndjekur udhëzimet e Kur'anit në lidhje me femrën, do të dilte jashtë shtrirjes së këtij studimi. Duhet të sqarohet, megjithatë, se shoqëritë muslimane deri më tani kanë devijuar nga normat islame në shumë aspekte të jetës së tyre. Ka një boshllëk të gjerë në mes asaj çfarë muslimanët duhet të besojnë dhe çfarë ata tani janë duke praktikuar. Ky boshllëk nuk është ndonjë fenomen i ri. Ka ekzistuar ndër shekuj dhe është zgjeruar ditë pas ditësh. Ky zgjerim i vazhdueshëm i këtij boshllëku ka pasur rrjedhime shkatërruese në Botën Islame, i manifestuar në pothuajse çdo aspekt jetësor: tirania dhe ndarja politike, prapambetja ekonomike, padrejtësitë sociale, ngecja në shkencë, amullia intelektuale, etj. Gjendja joislame e femrës sot në Botën Muslimane është thjesht një shenjë e dobësisë së thellë. Cilado reformë në pozitën e tanishme të femrës muslimane, nuk pritet të dalë

e frytshme, nëse nuk shoqërohet me reforma gjithëpërfshirëse në të gjitha aspektet e jetës së shoqërisë muslimane. Bota Islame ka nevojë për një rilindje, e cila do ta sillte më afër idealeve të Islamit dhe jo ta largonte nga ato. Në përmbledhje të kësaj, nocioni i pozitës së varfër (palakmueshme) të femrës muslimane sot është sepse Islami është keqëkonceptuar tërësisht. Problemet e muslimanëve përgjithësisht nuk janë shkaku i afrisë së tepërt me Islamin, por ato janë kulmi i shkëputjes së gjatë dhe të thellë prej tij.

Do ritheksuar gjithashtu se arsyeja për këtë studim krahasues nuk është në asnjë mënyrë diskreditimi i Judaizmit apo Krishterimit. Pozita e femrës në traditën judeo-krishtere mund të duket gjithashtu brengosëse për standardet tona të shekullit XX/XXI. Sidoqoftë, ajo duhet të vështrohet brenda kontekstit të duhur historik. Me fjalë të tjera, për një vlerësim objektiv të pozitës së femrës në traditën judeo-krishtere duhet të merren në konsideratë rrethanat historike në të cilat kjo traditë është zhvilluar. Nuk ka dyshim se pikëpamjet e rabinëve dhe të priftërinjve sa i përket femrës, kanë qenë të ndikuara nga qëndrimet që mbizotëronin ndaj femrës në shoqëritë e tyre. Vetë Bibla është e shkruar nga autorë të ndryshëm e në kohë të ndryshme. Këta autorë nuk kanë mundur të jenë mospërfillës ndaj vlerave dhe rrugëve jetësore të njerëzve përreth tyre. Për shembull, ligjet mbi tradhtinë bashkëshortore në Dhjatën e vjetër janë aq të njëanshme - kundër femrës, saqë mendja jonë nuk mund t'i përfillë me asnjë shpjegim të arsyeshëm. Sidoqoftë, nëse marrim parasysh faktin se fiset e hershme jehude kanë qenë të pushtuara nga homogjenizmi i tyre gjenetik dhe tmerrësisht të etura për të definuar veten e tyre si një popull i zgjedhur, dhe se tradhtia e grave të tyre do të mund t'i kërcënonte aspiratat e dashura të tyre, - atëherë do t'i kuptonim, por jo gjithsesi edhe t'i pëlqenim arsyet e këtyre paragjykimeve. Gjithashtu, edhe qëndrimi i ashpër i priftërinjve kishtarë kundër femrës nuk do të duhej të ndahej prej kontekstit të kulturës antifemërore greko-romake, në të cilën jetonin ata. Do të ishte një gjë e padrejtë të bënim vlerësime mbi trashëgiminë judeo-krishtere pa e vënë në kornizat e rëndësisë së kontekstit historik.

Në të vërtetë, të kuptuarit e mirëfilltë të kontekstit historik judeo-krishterë është gjithashtu vendimtar për të kuptuar rëndësinë e kontributit të fesë islame për historinë botërore dhe qytetërimin njerëzor. Tradita judeo-krishtere ka qenë e ndikuar dhe e formuar nga ambienti rrethues, kushtet dhe kulturat në të cilat ekzistonte. Gjatë shekullit të shtatë të e.r. ky ndikim pati shtrembëruar pa ndonjë miratim porosinë origjinale hyjnore që i ishte shpallur Musait a.s. dhe Isait a.s.. Pozita e mjerueshme e femrës në botën judeo-krishtere gjatë shekullit të shtatë është pikërisht shembulli i kësaj çështjeje. Prandaj, atje kishte nevojë të madhe për një shpallje të re hyjnore, që do ta udhëzonte njerëzimin në rrugë të drejtë. Kur'ani e ka përshkruar misionin e Lajmëtarit, Muhamedit s.a.v.s., si çlirim për hebrenjtë dhe të krishterët nga barra e rëndë që kishte qenë mbi ta:

***"Që pranojnë të dërguarin** (Muhammedin), **Pejgamberin arab,** (që nuk shkruan as nuk lexon), **të cilin e gjejnë të cilësuar** (të përshkruar me virtytet e tij), **tek ata në Tevrat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet, dhe heq prej tyre barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta".** (El-A'rafë, 157)*

Prandaj, Islami nuk bënë të shikohet si traditë kundërshtare e Hebraizmit apo Krishterimit. Duhet të vështrohet si përfundim, përmbushje dhe përkryerje e shpalljes hyjnore që kishte zbritur edhe më parë.

Në përfundim të këtij studimi, do të doja të jap këshillën vijuese për mbarë bashkësinë muslimane. Deri më tani janë të shumta ato femra muslimane të cilave u janë mohuar të drejtat themelore islame. Gabimet nga e kaluara duhet të përmirësohen. Nëse e bëjmë këtë, kjo nuk është përkrahje ndaj saj por detyrë e cila bie mbi të gjithë muslimanët. Bashkësia muslimane mbarëbotërore duhet të nxjerrë kartën e të drejtave të femrës muslimane të bazuar në urdhrat kuranorë dhe në mësimet e Pejgamberit tonë, Muhamedit s.a.v.s.. Kjo kartë duhet t'ia japë femrës muslimane të gjitha të drejtat e dhuruara nga Krijuesi. Më pas duhet të zhvillohen të gjitha procedurat e nevojshme, me qëllim që të sigurohet zbatimi i duhur i kartës. Kjo kartë qysh tashti është e

vonuar, por më mirë është vonë sesa hiçfare. Nëse muslimanët në mbarë botën nuk i garantojnë të drejtat e plota islame për nënat, gratë, motrat dhe bijat e tyre, atëherë kush do ta bëjë këtë?

Gjithashtu ne duhet të kemi guximin që t'i kundërvihemi së kaluarës sonë dhe t'i refuzojmë hapur traditat dhe zakonet e stërgjyshëve tanë kurdo që ata do t'i kenë shkelur rregullat islame. A nuk i ka kritikuar ashpër Kur'ani arabët paganë për ndjekje të verbër të traditave të stërgjyshëve të tyre? Në anën tjetër, ne duhet të zhvillojmë një qëndrim kritik kundër tërë asaj që marrim nga Perëndimi ose prej ndonjë kulture tjetër. Bashkëveprimi i ndërsjellë dhe të mësuarit nga kulturat e tjera është një përvojë e çmueshme. Kur'ani ka përfillur në mënyrë të përmbledhur këtë bashkëveprim si një ndër arsyet e krijimit: ***"O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam prej një mashkulli e një femre, ju bëmë popuj e fise, që të njiheni ndërmjet vetes…"*** *(El-Huxhurat, 13).* Kjo të le pa fjalë, megjithëkëtë, imitimi i verbër i të tjerëve është shenjë e sigurt e mungesës së shprehjes së vetërespektit.

Këto fjalët e fundit u kushtohen lexuesve hebrenj, të krishterë ose të tjerë. Është për t'u habitur përse feja e cila ka bërë kthesë rrënjësore në statusin e femrës, veçohet dhe ndaj saj shpifet për shtypje ndaj femrës. Ky perceptim mbi Islamin sot është një nga mitet më të përhapura në botë. Ky mit po mbetet i përhershëm ngase ekziston një vrull i pandërprerë antiislam përmes librave të bujshëm, artikujve, përshkrimeve në mjete të informacionit dhe përmes filmave të Holivudit. Rezultati i pashmangshëm i këtyre përshkrimeve mashtruese të pareshtura përbën një keqëkuptim dhe shqetësim ndaj çdo gjëje të lidhur me fenë islame. Ky portretizim negativ i Islamit nëpër mediet botërore, duhet të pushojë, nëse dëshirojmë të jetojmë në një botë të lirë nga të gjitha gjurmët e diskriminimit, armiqësisë dhe keqkuptimeve. Është detyrë e jomuslimanëve ta njëmendësojnë ekzistimin e mospërputhjes së gjerë në mes besimit të muslimanëve e praktikës së tyre dhe ta kuptojnë të vërtetën e thjeshtë se veprimet e muslimanëve nuk e përfaqësojnë gjithsesi fenë islame. Etiketimi i gjendjes së femrave në Botën e sotme Muslimane, duke e shprehur "kjo është Islam", është aq larg nga e vërteta, sikur të etiketohej gjendja e femrave në Perëndi-

min e sotëm me shprehjen "kjo është judeo-krishtere". Muslimanët dhe jomuslimanët nuk duhet të fillojnë procesin e komunikimit dhe bashkëbisedimit me gjykime të këtilla në mendje, por duke i hedhur të gjitha keqkuptimet, dyshimet dhe shqetësimet. Një e ardhme e qetë për familjen njerëzore e ka mëse të nevojshëm një dialog të këtillë.

Islami duhet të pasqyrohet si feja që e ka përmirësuar pa masë pozitën e femrës dhe asaj i ka dhuruar shumë të drejta, të cilat bota bashkëkohore i ka njohur veçse në këtë shekull. Feja islame ka ende aq shumë për t'i ofruar femrës së sotme: dinjitetin, respektin dhe mbrojtjen në çdo aspekt e në të gjitha periudhat e jetës së saj, prej lindjes e deri në vdekje, në plotësim të njohjes së personalitetit, barazisë, dhe mjeteve për përmbushjen e të gjitha nevojave shpirtërore, mendore, fizike dhe emocionale. S'është për t'u habitur që shumica e atyre që pranojnë fenë islame në një vend siç është Britania, janë femra. Në ShBA, femrat që pranojnë fenë islame, kalojnë numrin e meshkujve katër me një[85]. Islami mund t'i ofrojë aq shumë botës sonë, e cila ka tepër nevojë për udhëzim moral dhe udhëheqje. Ambasadori Herman Eilts, në cilësinë e dëshmitarit para Komitetit për Punë të Jashtme në Dhomën e Përfaqësuesve të Kongresit të Shteteve të Bashkuara, më 24 qershor 1985, pati thënë: "Bashkësia e sotme muslimane në botë është afër një miliard njerëz. Kjo paraqet një pamje madhështore. Por ajo që për mua është një gjë madhështore, është se Islami sot është feja monoteiste që po rritet më së tepërmi. Kjo është gjëja që duhet ta marrim parasysh. Ekziston diçka që është në rregull në Islam! Kjo gjë është duke i tërhequr mjaft shumë njerëz."

Po! Ka diçka që është në rregull me fenë islame, dhe tani është koha ta zbulojmë atë. Shpresoj se ky studim është një hap në këtë drejtim.

- fund -

Përktheu nga anglishtja:
Bekim Rrahimi

[85] The Times, 18 Nëntor 1993.

Dr. Sherif Muhamed

WOMEN IN ISLAM IN THE FACE OF THE JUDEO-CHRISTIAN TRADITION (MYTH AND REALITY) – (3)
Adultery and fornication
Polygamy

(Summary)

Polygamy is a very old practice, which can be found in many societies. The Bible did not ban polygamy, on the contrary, the Old Testament and the Rabbi writings were for its legalization. According to it King Solomon had seven hundred wives and three hundred concubines (1 Kings, 11:3). King David also had many wives and concubines (Old Testament, 2 Samuel, 5:13). The Old Testament contains a number of provisions on how to share the property of a man who has sons with different wives (Deuteronomy). The only ban regarding polygamy is "not to take your wife's sister" (Leviticus, 18:18). The Talmud limits the number of wives on 4. The Jews in Europe continued to practice polygamy until the 7-th century. The Jews of the East practiced polygamy until their return to Israel, where it was banned by law. Nonetheless, according to their religious law, which does not recognise civil law, polygamy is allowed.

د. شريف مُحَمَّد

وضع المرأة فى الاسلام بالمقارنة مع اليهودية والمسيحية (٣)

تعدد الزوجات

(خلاصة البحث)

والان سوف نتحدث عن موضوع مهم و هو تعدد الزوجات. و تعدد الزوجات هى عادة قديمة جدا و موجودة فى كثير من المجتمعات. ويجدر بالذكر هنا ان الانجيل لم يعارض تعدد الزوجات بل على العكس من ذلك فان العهد القديم و كتابات كبار رجال الدين تطالب باعطائه صفة شرعية. وطبقا لتلك النصوص فان سليمان عليه السلام كان له سبعمائة زوجة بعقد الزواج وثلاثمائة اخرى بدونه. وكذلك حسب ما قال هؤلاء فان داوودعليه السلام كان لديه عدد كثير من النساء بعقد الزواج و اخرى بدونه.

DORËSHKRIME

Sadik Mehmeti

DORËSHKRIMET ORIENTALE NË BIBLIOTEKËN E KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË SHARR

"…do dëshiroja fort të leçit, mishkrimet, me nj'ato fantastike kaligrafi arabe, që asnjë nga alfabetet rigjide europiane nuk mund t'u afrohet nga bukuria. Po nuk di, dhe jam i dëshpëruar se ndofta nuk do të di kurrë. Megjithëkëto më pëlqen t'i vështrojë e t'i prek me gishtërinj, sepse më duket se kur i prek me gishtërinj këto vepra të artit skulptural, i afrohesh shpirtit të artistit që e punoi".

Mitrush Kuteli
("Vargje mbi gurëvarresh")

Sikurse është thënë dhe herë të tjera, në Kosovë në të kaluarën ka ekzistuar një numër i madh i dorëshkrimeve orientale-islame, shumë të ndryshme për nga përmbajtja, prejardhja dhe vlera shkencore artistike. Mirëpo, në shekujt e kaluar, në rrethanat që jetoi populli ynë, dhe për shkak të neglizhencës e paskujdesjes sonë, një numër i madh i këtyre dorëshkrimeve të çmueshme u dogjën, u zhdukën apo u humbën gjurmët. Prandaj, dorëshkrimet e mbetura, si numër, përfaqësojnë një pjesë fare të vogël të asaj pasurie intelektuale, që ka qarkulluar

gjithandej në vendin tonë, një pjesë vepra origjinale të autorëve shqiptarë.

Nëse nuk merren masa për ruajtjen, tubimin, regjistrimin, katalogimin dhe botimin eventual të tyre, edhe këto dorëshkrime të mbetura do të zhduken dhe, së bashku me to, edhe një pjesë e çmueshme e trashëgimisë sonë kulturore, të cilën me shumë mund e sakrificë e hartuan të parët tanë. Vallë, kur do të mësohemi të ndajmë grurin nga egjra?!

Nuk është e tepërt të përmendim se në shumë qendra të dijes në Perëndim (Vjenë, Londër, Bratislavë etj.), - atje ku më së paku janë hartuar dhe shkruar veprat/dorëshkrimet orientale-islame, - para shumë dekadave, nga institucionet më me renome dhe nga dijetarët më të shquar të fushave përkatëse, janë botuar katalogë përfaqësues shumëvëllimësh të dorëshkrimeve orientale-islame.

Prandaj, nisur nga ky fakt, gjatë hulumtimeve tona në bibliotekën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Sharr (ish-Dragash), në mesin e dhjetëra librave të botuar (të shtypur), kemi gjetur edhe pesë dorëshkrime orientale, relativisht të vjetër, të kopjuar e të shfrytëzuar nga ulematë tanë, përshkrimin ekstenziv të të cilëve po e japim në vazhdim.

Këto pesë dorëshkrime orientale, kujtojmë, do të zënë vend dhe do të pasurojnë katalogët e dorëshkrimeve orientale që do të hartohen dhe botohen patjetër edhe tek ne.

Falënderoj botërisht nëpunësit – kolegët e mi nga KBI - Sharr, të cilët më lanë në dispozicion bibliotekën e këtij këshilli, dhe sidomos për zotimin e tyre se do të angazhohen për mbledhjen dhe regjistrimin e dorëshkrimeve orientale në territorin e këtij këshilli, sepse, këto pesë dorëshkrime, sa ruhen në bibliotekën e KBI- Sharr, sigurisht nuk janë të vetmit në këto anë.

Shfrytëzojmë rastin të ftojmë të gjithë lexuesit e nderuar të revistës *"Edukata Islame"*, që, nëse kanë ndonjë dokument a libër/dorëshkrim në gjuhët orientale, ose ndonjë lëndë tjetër që ka të bëjë me të kaluarën tonë, mundësisht t'ua ofrojnë njerëzve kompetentë për t'i regjistruar, për të shënuar përmbajtjen e tyre, apo, të paktën, për t'i fotografuar a kseroksuar.

Sa aktual tingëllon (sikur të jetë thënë sot) apeli dhe dëshpërimi njëkohësisht i eruditit Hafëz Ali Korça, kur thotë:

"Asnjeri nuk çan kokën
Dokumentet për t'i mbledhur
Sikush nga një rrashtë rrokën
Në xhepa ar për të mbledhur".

1. Vasijjetname-i Birgevi – وصيتنامه بركوى

Dorëshkrimi është në gjuhën turke. Ka format 20x12 cm. Teksti 15x7.5 cm. Teksti ka nga 15 rreshta në faqe. Faqet nuk i ka të shënuara, por janë 101 faqe. Është i vokalizuar. Kopjimi është bërë me mjaft korrektësi me llojin e shkrimit arab *nes'h* të trashë. Është i shkruar nga një dorë. Është i shkruar në letër të bardhë në të verdhë. Ka kustoda. I shkruar me ngjyrë të zezë, kurse i kornizuar me ngjyrë të kuqe. Me ngjyrë të kuqe janë edhe disa shënime të tjera.

Autor i veprës është Takijjuddin Muhamed Pir Ali El-Birgevi (njihet edhe me emrin El-Bergili, El-Bergivi,ose El-Birxhevi) (jetoi midis viteve 929-981/1523-1573).[1] Ka qenë një ndër atoritetet më të dalluara të kohës. Njohuritë e tij në fusha të ndryshme të shprehura në veprat *"Vasijjetname", "El–Vesiletu el–Ahmedijjeh 'ala Tarikati el-Muhammedijjeh*", *"Avamil", "Idhhar",* (të shfrytëzuara si tekste bazë në mektebet dhe medresetë e Perandorisë Osmane), *"Tuhfetul-mustershidin fi bejani medhahibi frikeil-muslimin*", dhe shumë vepra të tjera i kanë siguruar një vend me rëndësi në shkencat islame gjithnjë deri në ditët e sotme. *"Vasijjetnameja*", ose *"Birgevija",* siç njihej kjo vepër sipas autorit, ose *"Ilmi hali i Birgevisë"*, ose *"Risale-i Birgevi"*[2], ka njohur një përdorim shumë të gjerë ndër ulematë tanë, dhe sidomos në shkollat fillore islame - mektebet e vendit tonë.

Teksti, pas besmeles, fillon:

[1] Zejnil Fajić, *Katalog arapskih, turskih, perzijskih rukopisa*, svezak treci, Sarajevë, 1991, fq.352.

[2] Salih Trako, *Serhi Vasiyyetname-i Bergivi sa prevodom na srpskohrvatskom jeziku*, "ANALI" Gazi Husrev-begove biblioteke, knjiga V - VI, Sarajevë, 1978, fq. 117.

الحمد لله الذى هدانا للاسلام و جعلنا من امة مُحَمَّد عليه الصلوة والسلام ... ا ما بعد فهذه وصية الفقير الحقير المعترف بالعجز والتقصير مُحَمَّد ابن پر على عفا عنهما العفو العلى لنفسه ولجميع مكلفين كتبها بتركية ليعم نفعها ...

Nuk dimë se kush e ka bërë kopjimin dhe në cilin vit.

Dorëshkrimi është në gjendje të mirë, por i mungojnë disa faqe. Mbulohet me kopertina të forta.

2. Shurut es-Salat – شروط الصلاة

Risale e shkurtër për namazin dhe rregullat e tij, hartuar nga një autor i panjohur[3]. Është në gjuhën arabe. Është i vokalizuar. Ka format 20x12 cm. Teksti 15x7.5 cm. Ka gjithsej 17 faqe. Është i shkruar me shkrimin arab *nes'h,* mjaft korrekt. Ka disa dua. Është i njëjti kopjues i veprës paraprake – *"Vasijjetnamesë".* Teksti ka nga 15 rreshta në faqe. Ka kustodat. I shkruar në letër të bardhë në të verdhë. Shkrimi me ngjyrë të zezë.

Teksti, pas besmeles, fillon:

الحمد لله رب العلمين والصلاة والسلام على مُحَمَّد اله وصحبه اجمعين .

.. باب شروط الصلاة و هى ستة ...

Nuk dimë se kush e ka bërë kopjimin dhe në cilin vit.

3. Multeka El-Ebhur ملتقى الابحر

Është në gjuhën arabe. I shkruar me shkrimin arab *nes'h.* Formati 22x15 cm. Teksti 16x8.5 cm. Ka nga 19 rreshta në çdo faqe. Nuk ka të shënuar numrin e faqeve, po janë 128 fletë (256 faqe). Letra e bardhë e vrazhdë. I shkruar me ngjyrë të zezë. Disa shënime dhe fillimi i kapitujve (babeve) janë me ngjyrë të kuqe.

[3] Kasim Dobrača, *Katalog arapskih, turskih i perzijskih rukopisa*, svezak prvi, Sarajevo, 1963, fq. 113.
Zejnil Fajić, *Katalog arapskih, turskih i perzijskih rukopisa*, svezak treći, Sarajevo, 1991, fq. 352.

Autor i veprës është Ibrahim b. Muhammed el-Halebi (vdiq më 956/1549). Është një nga shkrimet themelore të fikhut hanefij, i cili në Perandorinë Osmane, e rrjedhimisht edhe tek ne, ka pasur domethënie të burimit autoritativ për njohjen e normave të së drejtës së Sheriatit. Është i bazuar në veprat juridike të periudhës së mëhershme të fushës së jurisprudencës islame (fikhut) si: *"Muhtesar el-Kuduri", "Muhtar", "El-Kenzu", "El-Vekaja"),* dhe është e shkruar në mënyrë të thukët e koncize, me stil të lehtë, andaj ka qenë shumë e popullarizuar dhe është përdorur gjatë si doracak dhe si libër mësimi i fikhut nëpër medrese[4]. Është shumë i njohur ndër ulematë tanë me emrin *"Multekaja"* ose *"Halebi Kebir" – "Halebija e Madhe"*.

Teksti, pas besmeles, fillon:

الحمد لله الذى وفقنا للتفقية فى الدين الذى هوجله المتين ... و حيث اجتمع فيه الكتب المذكورة سميته ملتقى الابحر ليوافق الاسم المسمى ...

Kopjimin e ka bërë Ali b. Hasan El-Iskenderevij (nga Shkodra), më 5 shevval të vitit 1129/1717.

Kopjimin e këtij dorëshkrimi, shkodrani Ali Hasani e kishte bërë nga një kopje shumë e hershme, madje në të gjallë të autorit, të cilën, më 13 rexhep të vitit 923/1517, e kishte kopjuar Sinan b. Mustafa.

و قد تم تبضه بين صلوتين من يوم الثلثاء ثالث عشر رجب المعظم لسنة ثلثة و عشرين و تسعمائة على يد العبد الفقير الى الله الغنى سنان بن مصطافى ... ثم تم كتابة الكتاب بعون الله الملك الوهاب على يد على بن حسن الاسكندروى غفر له يوم يقوم الحساب فى خمس من شوال تسع و عشرين و مائة و الف

Mbulohet me kopertina të trasha dhe është e ruajtur mirë.

[4] Kasim Dobrača, *Katalog arapskih, turskih i perzijskih rukopisa*, svezak drugi, Sarajevo, 1978, fq. 465.

4. Et-Tarikatu el-Muhammedijje – الطريقة المحمدية

Është në gjuhën arabe. Ka format 20.5x14 cm. Teksti 15.5x8 cm. I shkruar me korrektësi me shkrimin arab *nes'h*. Në çdo faqe ka nga 20 rreshta. Faqet i ka të shënuara me numra dhe ka 146 fletë ose 291 faqe. Është i pavokalizuar. I shkruar në letër të bardhë në të verdhë, me shkrimin me ngjyrë të zezë. Në faqen e parë ka *"rumuzatet"* – shkurtesat për transmetuesit e haditheve që përmenden në këtë vepër. Ka shënime në margjina, "rumuzatet" janë me ngjyrë të kuqe. Ka të shënuar përmbajtjen.

Autori i veprës është Muhammed Ali el-Bergivi (929-981/1523-1573)[5]. Vepra bën fjalë për rregullat fetare islame. Ka qenë shumë e njohur ndër ulematë tanë më të hershëm. Ka përjetuar shumë komente. Njihet me emrin *"Et-Tarikatu El-Muhammedijjeh ves-Siretu El-Ahmedijje 'ala Tarikati el-Muhammedijjeh"*, ose *"El–Vesiletu el–Ahmedijjeh 'ala Tarikati el-Muhammedijjeh*", tek ne është e popullarizuar me emrin *"Tarikatu Muhammedijjeh",* sikurse është vënë në dorëshkrimin tonë.

Teksti, pas besmeles, fillon:

الحمد لله الذى جعلنا امة وسطا خير امم والصلاة والسلام على افضل من اوتىالنبوة والحكم ... فاردت ان اصنف الطريقة المحمدية و احببت ان ابين السيرة الاحمدية ...

Kopjimin e ka bërë ditën e enjte, në kohën e drekës, të muajit rebiul-evvel të vitit 1054/1644, Hysejn bin Muhammedi, imam në lagjen Sylejman Subashi, një nga lagjet (e kuartit) Ejjub Ensari (Stamboll).

Fundi i dorëshkrimit:

[5] Kasim Dobrača, *Katalog arapskih, turskih i perzijskih rukopisa*, svezak prvi, Sarajevë, 1963, fq. 268.

قد وقع الفراغ من النسخة الشريفة فى اليوم الخميس فى وقت الضحى
فى شهر ربيع الاول لسنة أربعة و خمسين بعد الالف صانه الله تعلى
عن الافات على عبد الضعيف النجيف الفقير المحتاج الى رحمة ربه الكريم حسين
بن مُحَمَّد الامام فى محلة سليمان صوباش من محلات ابى ايوب الانصارى رحمة ربه
البارى تاريخ سنة ١٠٥٤

Faksimili i faqes së parë të dorëshkrimit
"Et-Tarikatu el-Muhamedijjeh"



Faksimili i faqes së fundit të dorëshkrimit
"Et-Tarikatu el-Muhamedijjeh"

Nuk ka kopertina. Në margjina janë të shënuara disa çështje të ndryshme, dua dhe hadithe të Pejgamberit a.s. Në fund gjendet duaja e Jasinit e shënuar nga Rexhep bin Muhammedi.

5. Sa'atname-i – ساعت نامه

Është në gjuhën turke. Ka format 21x13.5 cm. Teksti 14x9 cm. Është i shkruar me shkrimin arab *nes'h*. Ka nga 18 rreshta në faqe. Është i vokalizuar. Ka kustoda. Nuk e ka të shënuar numrin e faqeve, po ka gjithsej 151 faqe. Teksi është i shkruar me ngjyrë të zezë. Ka shënime edhe me ngjyrë të kuqe. Letra e bardhë në të verdhë. Titulli sipas shënimit të vënë në faqen 1.

Teksti, pas besmeles, fillon:

الحمد لله الذى جعل الاسلام نورا و اشهد ان لا اله الاالله الملك المحمود و اشهد ان مُحَمَّدا عبده و رسوله ... بو كتاب تاليف اولندى ...

مصنف هيبة الله بن ابراهيم ...

Është libërth me përmbajtje shkencore në gjuhën turke, në të cilin janë zgjedhur ajete të ndryshme, hadithe, ngjarje interesante, shënime për krijimin e qiellit dhe Tokës, për vdekjen dhe Ditën e Gjykimit.[6]

Autor i veprës, sikurse shkruan, është Hibetullah b. Ibrahim, biografia e të cilit nuk na është e njohur.

Fundi i dorëshkrimit:

بحرمة سيدالانبياء والمرسلين و الحمد لله ربالعلمين الصيبين الطاهرين اجمعين و كرمه ساعت نامه بونده تمام اولدى ...

Është lënë vakëf nga Ajshe Hatuni. Nuk dimë për kopjuesin dhe as vitin e kopjimit.

Është me kopertina të forta.

[6] Kasim Dobrača, *Katalog arapskih, turskih i perzijskih rukopisa*, svezak prvi, Sarajevë, 1963, fq. 227.

Sadik Mehmeti

ORIENTAL MANUSCRIPTS IN THE LIBRARY OF THE ISLAMIC COMMUNITY COUNCIL IN SHARR

(Summary)

"…I wish I could read the inscriptions, which were made using the fantastic Arab caligraphy, whose beauty is above that of the rigid European alphabets. Yet, I cannot read them, and I am desperate that I will probably never be able to do so. Yet, I enjoy looking at them, fingering them, because, when I do so, it seems to me that I come closer to the soul of the artist that made them".

صادق مُحَمَّد

المخطوطات الشرقية بمكتبة الوقف الاسلامى بمدينة شار

(خلاصة البحث)

حسب ما ذكر من قبل فان عدد المخطوطات الشرقية الاسلامية فى كوسوفا كان كثيرا جدا من حيث محتواها واصلها و قيمتها العلمية و الفنية. و لكن مع الاسف فان فى العصور الماضية لاسباب مختلفة ضاع عدد كبير منها والعدد المتبقى يمثل عددا قليلا من ذلك التراث العظيم الذى تركه اجدادنا و آباءنا.

ORIENTALISTIKA

DO TË PREFEROJA QË NJERËZIT TË MË QUAJNË ARABOLOG

Para pak kohe orientalisti gjerman Hartmut Bobzin kishte vizituar Damaskun, ku kishte mbajtur dy ligjërata në gjuhën arabe.

Të parën në Qendrën Kulturore Arabe me titull:" *Studimet evropiane rreth Kur'anit fisnik në shekullin e gjashtëmbëdhjetë dhe fillimi i studimit të gjuhës arabe në Perëndim."*

Të dytën në Qendrën Kulturore gjermane - Instituti i Gëtes - me titull: *"Fridrih Rokhart - poet dhe përkthyes i letërsive orientale*".

*Dr. Bobzin, cili është koncepti juaj për " orientalizmin", i cili përfshin një fushë të caktuar të njohuriv*e?

- E para, orientalizmi është një koncept i gjerë, aktiviteti i studimeve orientale në Evropë. Ky është koncept i zakonshëm që e kuptoj unë.

- E dyta, kam vërejtur që nga qëndrimi im i parë në Siri, se fjala "orientalist"në vete përmban disa aspekte negative, a nuk është kështu?

- Po. Gjithsesi.

Përmbajtja apo kuptimet e përgjithshme të kësaj fjale patjetër duhet të m'i shpjegosh mua. Kuptimet e fjalës "orientalist" apo "orientalizëm" ashtu si i komenton ato qytetari arab.

Po, është e vërtetë se për sa i përket orientalizmit ekzistojnë koncepte të ndryshme.Për shembull Eduard Seidi thotë: Orientalizmi është fuqia e të njohurit. Por e shohim se Terner në librin e tij "Marksi

dhe fundi i Orientalizmit", orientalizmin e sheh në aspektin se ai "është një mori e lidhjeve të marrëdhënieve ekonomike-shoqërore të marra nga aspekti sociologjik."

- Po, ekzistojnë koncepte të ndryshme rreth orientalizmit, secili sipas lëmit që është i interesuar të studiojë. Por, unë dëshiroj mendimin dhe konceptin tuaj të orientalizmit?

Koncepti im është shumë i thjeshtë. Unë jam studiues dhe hulumtues i gjuhës dhe letërsisë. Unë studioj dhe hulumtoj gjuhët dhe letërsitë orientale, prandaj jam orientalist, do të thotë, ai që kërkon dituri dhe studion në Lindje.

- Kjo do të thotë në aspektin e përgjithshëm?

Po. Kjo është në aspektin e përgjithshëm. Asgjë më tepër e as më pak.

- Studiuesi i orientalizmit Salahud-din el-Munexh-xhid konstaton se orientalizmi gjerman dallohet nga orientalizmat e tjerë për dy gjëra:

E para, Ai nuk ka pasur qëllime kolonizuese apo fetare, sepse Gjermania nuk e kishte kolonizuar asnjë vend arab dhe nuk kishte dërguar misionarët e saj në ato vende.

E dyta, Orientalizmi gjerman nuk shquhet për shpirtin e tij armiqësor kundër civilizimit arab dhe islam, kjo do të thotë se orientalistët gjermanë ishin më afër objektivitetit. Cili është mendimi juaj rreth këtij vlerësimi?

Të fillojmë prej pikës së dytë: Shkolla e orientalizmit gjerman dallohet për animin e saj nga aspekti gjuhësor apo filologjik. Këtë e vërteton fakti se shumica e orientalistëve të vjetër gjermanë si Johan Jakob Rajski në shekullin e tetëmbëdhjetë, ishin përqendruar në hulumtimin e filologjisë klasike. Ai është i njohur edhe sot e kësaj dite si studiues i gjuhës greke si dhe themelues i studimeve të gjuhës arabe bashkëkohore në kuptimin e sotëm të fjalës si të filologjisë dhe të shkencës së filologjisë. Sipas asaj sa e kuptoj unë këtë shkencë, ajo kërkon saktësi dhe paanshmëri e objektivitet. Ne duhet t'i studiojmë

tekstet dhe të shohim se ç'na thonë ato. Natyrisht që secili shkencëtar ka mënyrën e hulumtimit dhe studimit të vet, mirëpo kjo ishte qasja e shumicës së orientalistëve gjermanë në kohët më të hershme, pra tek ata mbizotëronte aspekti filologjik, ashtu si edhe në kohën e sotme. Kjo është e vërtetë.

- Më falni, ky aspekt filologjik ekziston edhe tek një numër i or-e-ntalistëve të tjerë, por ai përshkohet nga një lloj armiqësie, si për shembull orientalizmi anglo-sakson apo ai francez...

Në të ekzistojnë rryma të këtilla, por...

- Cili është dallimi midis tyre?

Dallimi. Nuk është e lehtë për mua të gjykoj për kolegët e mi nga Anglia dhe Franca. Mirëpo, ajo që vërehet që në shikimin e parë, është se orientalizmi anglez, por edhe ai francez, ka qenë përqendruar kryesisht në aspektin historik më shumë se në atë filologjik. Kjo është më se e qartë, edhe pse Eduard Lin (Leen) për shembull, është përpilues i një fjalori shumë të rëndësishëm.

- Në anglisht?

- Po në anglisht. Deri më sot konsiderohet fjalori më i mirë i gjuhës klasike që është përpiluar në një gjuhë joarabe.

- Kjo kishte të bënte me pikën e parë. Ç'mund të na thoni për të dytën që të lidhet me shkaqet ?

- Po ashtu nuk pajtohem tërësisht me ju. Edhe pse ajo që po them, ndoshta nuk i pëlqen lexuesit arab. Gjermania ishte shtet kolonizues, sepse Zanzibari apo ajo që sot quhet Tanzani, ishte për një kohë të shkurtër koloni e Gjermanisë. Në atë kohë u bënë disa përpjekje në Berlin për t'u dalë në ndihmë nëpunësve gjermanë, të cilët ishin të angazhuar në Afrikë apo në Zanzibar dhe Tanzani. Këtë e them duke u mbështetur në faktin se në atë kohë ishte një orientalist me emrin Edvard Zahavi, që është i njohur se ka bërë redaktimin e librit "et-Tabakat el-Kubra" të ibnu Sa'dit , si dhe kishte përpiluar një libër, në të cilin kishte shpjeguar fikhun sipas medhhebit shafii. Përpilimi i këtij

libri kishte për qëllim që nëpunësit gjermanë ta mësimin atë para se të shkonin me shërbim në Tanzani. Mirëpo, siç dihet, kjo periudhë e Gjermanisë si shtet kolonizues ishte shumë e shkurtër. Ajo mori fund me përfundimin e Luftës së Parë Botërore.

- A mund të kuptojmë prej kësaj se ka pasur pretendime, të cilat nuk janë realizuar?

- Me siguri po. Mirëpo, megjithatë, kjo rrymë nuk mundi të mbisundonte ndaj rrymës filologjike që mbizotëronte në Gjermani. Megjithatë, libri i fikhut sipas medhhebit shafii, të cilin e përmendëm pak më parë nuk është i keq. Ai është i dobishëm edhe sot e kësaj dite. Ai është shkruar në gjuhën gjermane. E ne kemi nevojë ta njohim mirë fikhun islam, për shkak të numrit të madh të muslimanëve që jetojnë sot në Gjermani, siç është komuniteti i madh turk.

- Përmendet edhe një orientalist tjetër me emrin Shahat. Kush është ky dijetar?

Ky kishte shkruar po ashtu një libër në fikh, por sipas medhhebit maliki. Si dhe një libër rreth zanafillës së fukhut islam.

- Kohët e fundit janë botuar disa libra rreth orientalistëve evropianë. Në disa prej tyre thuhet se orientalizmi evropian në shekullin nëntëmbëdhjetë ishte mbështetur kryesisht në metodën filologjike të hulumtimit, cilat janë metodat e orientalizmit të sotëm, duke u mbështetur në zhvillimet e mëdha që kanë pësuar metodat e shkencave shoqërore?

Unë mund të flas për universitetin në të cilin ligjëroj. Aty që nga fillimi i themelimit të universitetit, ekziston katedra e gjuhëve orientale. Universiteti është themeluar në vitin 1743. Në fillim është ligjëruar gjuha hebraike për studentët e teologjisë . Prej kësaj katedre pastaj u zgjeruan degë të tjera të gjuhëve orientale në kohën e Rokhartit, dhe ai ishte përgjegjës i kësaj katedre. Ai ligjëronte gjuhën arabe, gjuhën hebraike, gjuhën siriaranite, si dhe gjuhët islamike si gjuhën persiane, gjuhën turke si dhe gjuhën sanskrite. Ai ishte themelues i katedrës së studimeve orientale. Në të njëjtën kohë shohim në Arlingen zgjerim të

gjuhëve të tjera orientale që studioheshin . Ndërsa vitet e fundit shohim një zgjerim edhe më të madh të studimit të civilizimit apo gjeografisë së vendeve të lindjes jashtë katedrës së studimeve orientale. Gjeografia është shndërruar në fakultet të veçantë dhe aty studiohen vendet e Lindjes dhe civilizimi i tyre. Përveç në Universitetin e Arlingenit, gjendet edhe një katedër e ngjashme në Universitetin e Berlinit dhe një në Universitetin e Topingenit.

- Meqenëse ju jeni specializuar në studimet kuranore dhe historikun e tyre në Evropë, cili është vlerësimi juaj për vërejtjet e Noldkes rreth Kur'anit fisnik dhe poezisë arabe të kohës së injorancës?

Nuk ka dyshim se Noldke është njëri prej studiuesve më të mëdhenj në lëmin e studimeve të gjuhëve semite. Ai e studioi Kur'anin në aspektin gjuhësor. Hulumtimet e tij rreth Kur'anit edhe sot e kësaj dite konsiderohen si burim kryesor rreth shkencave të Kur'anit, përfshirë tekstin si tekst... duke përfshirë kiraetet si dhe shkrimin e mus-hafave etj. Mirëpo, pjesën e fundit të veprës së Noldkes e ka shkruar një orientalist tjetër, Dak Feltzer, sepse librin e parë të Noldkes nuk e lexon askush, meqenëse botimi i dytë është botim me rëndësi dhe vetëm një pjesë e pakët e këtij libri ka të bëjë me Noldken.

- Sa i përket poezisë arabe të injorancës?

Besoj se sot kemi vepra të reja rreth poezisë arabe të kohës së injorancës, të cilat si pikënisje kanë veprën e Noldkes.Mirëpo, natyrisht se ka ndryshime. Unë nuk jam i specializuar në poezinë e injorancës, prandaj nuk jam kompetent të jap gjykime të sakta. Prandaj, mjaftohem me këtë përgjigje të përgjithshme.

- Cili është dallimi - sipas mendimit tuaj- në metodologjinë e Rokhartit dhe të Noldkes sa i përket qasjes së tyre të studimeve orientale?

Dallimi është i madh. Por dëshiroj të them se në shumë aspekte Rokharti është personalitet i dalluar. Ai është poet. Jo sepse ai e kuptoi shkencën nga poezia. Nuk është kështu. Ai ishte dijetar i madh. Ai interesohej për tekstet dhe korrigjimin e tyre. Por ai nuk u mor me

redaktimin e teksteve. Ajo që bëri ai, ishte vetëm përkthimi i teksteve të rëndësishme nga të gjitha letërsitë orientale.

- Xheririn, për shembull, e përktheu në poezi?

Po Xheririn. Mekamatet e el-Haririt. Unë kam redaktuar një tekst që e ka lënë Rokharti. Një tekst të shkëlqyeshëm, apo dy tekste. Teksti i parë nga Divani i Safijud-din el-Hilelit dhe në tekstin e dytë - dhe ai sipas mendimit tim - është më i rëndësishëm, Rokharti kishte zgjedhur disa fjalë të urta nga një përmbledhje e fjalëve të urta të el-Mejdanit, të cilat i kishte përkthyer në gjuhën gjermane me të njëjtën mënyrë. Ashtu si i kishte përkthyer Makamatet e el-Haririt.

- Në poezi?

Po. Në poezi, dhe solli shembuj të rinj në gjuhën gjermane. Mirëpo, fatkeqësia është se lexuesi gjerman deri më sot nuk ka pasur rastin të njihet me këto tekste të shkëlqyeshme. Vetëm në këtë vit doli nga shtypi me titull "Një mijë e një fjalë të urta."

- Si e shihni të ardhmen e orientalizmit në Gjermani?

Unë jam optimist. Ekziston një brez i ri i studiuesve. Vërejmë se shumica e studentëve që paraqiten për të mbrojtur punimet e tyre shkencore, e njohin gjuhën arabe shumë më mirë se brezi i vjetër edhe në të folur. Ata kanë një interesim të madh për botën arabe bashkëkohore si dhe për letërsinë e sotme arabe. Unë jam shumë optimist për zhvillimin e orientalistikës në Gjermani.

- Cila është porosia juaj për një këmbim dhe zhvillim më të mirë kulturor në mes Gjermanisë dhe Botës Arabe?

Besoj se këmbimi kulturor midis Gjermanisë dhe Botës Arabe është i mirë. Por, ai mund të zhvillohet edhe më shumë. Ne në Universitetin e Arlingenit pranojmë çdo vit studentë nga universiteti "Ajnu Shems" i Egjiptit, nga Universiteti i Mosulit në Irak, Universiteti i Dhahranit në Arabinë Saudite.Por, shpresojmë që ky bashkëpunim do të zgjerohet edhe më tepër me kalimin e kohës.

Biografia e dr. Hartmut Bobzin:
Ka lindur më 1942.
Profesor në Institutin e Gjuhëve dhe Civilizimeve Orientale pranë Universitetit të Arlingenit .
Specializimi në studimin e shkencave semite.
Merret me studimin e çështjeve gjuhësore të gjuhës arabe.
I është përkushtuar studimit të zanafillës së orientalizmit dhe studimeve arabo-islame në Evropë dhe studimit të veprimtarisë së orientalistit gjerman Fridrih Rokhart.

Veprat
1 - Përdorimi i formave të kohës së foljeve në gjuhën hebraike të vjetër në librin e Ejubit, 1974, (temë e doktoratës).
2 - Studime rreth Kur'anit në shekullin e reformave të Protestanizmit - studime rreth fillimeve të studimeve dhe hulumtimeve arabo-islame në Evropë, 1986, (tema e doktoratës shtetërore). Botimi i saj pritet së shpejti nga Instituti Gjerman për Hulumtime Orientale në Bejrut.
3- Së bashku me Dr. Otto Jastrov është bashkëthemelues i revistës "Studime të Gjuhës Arabe"dhe redaktor i saj që nga viti 1978.
4 - "Një mijë e një fjalë të urta e të vjetra arabe", janë fjalë të urta arabe që janë marrë nga "Përmbledhja e fjalëve të urta "të el-Mejdanit, të përkthyera nga Fridrih Rokhart, redaktuar nga Bobzin,1988.
5 - Poezia e Vasfud-din el-Hilelit e shoqëruar me përkthimin e Fridrih Rokhartit, redaktuar nga Bobzin, 1988.
6- I interesuar shumë për gjuhësinë arabe që nga viti 1977 dhe deri më sot, në këtë lëmi ishte aktiv sidomos gjatë viteve (1977-1980).
7 - Është autor i shtatë punimeve shkencore:
- Gjuhësia arabe e vjetër.
- Teoritë e gramatikanëve arabë.
- Historia e Orientalizmit në Evropë gjatë shekujve gjashtëmbëdhjetë e nëntëmbëdhjetë.
- Lutëri dhe Islami

Përktheu nga arabishtja: ***Q. Morina***
Marrë nga revista **"Risalet el-Xhihad"**
nr.87, prill 1990, Tripoli

I WOULD PREFER TO BE CALLED AN ARABIST

(German orientalist Hartmut Bobzin sees with optimism the development of orientalism in the future)

(Summary)

Recently, Hartmut Bobzin visited Damascus where he held two lectures in Arabic.

The first one in the Arab Cultural Centre titled: "European studies on the Noble Qur'an in the 16th century and the introduction of Arab language in the West".

The second one in the German Cultural Centre - Goethe Institute - titled: "Fridrich Rockhart - poet and translator of oriental literatures".

أفضل ان يسمينى الناس مستعربا

(خلاصة البحث)

زار المستشرق الاستاذ هارتموت بوبتسين دمشق والقى محاضرتين بالعربية:

الأولى: فى المركز الثقافى العربى بتاريخ ١٩٨٨/١٢/١٣ بعنوان: "الدراسات الاوربية حول القرآن الكريم فى القرن السادس عشر, و بداية الدراسات العربية فى الغرب."

و الثانية: فى المركز الثقافى لجمهورية المانيا الاتحادية معهد غوته بدمشق بتاريخ ١٩٨٨/١٢/١٤, بعنوان: "فريدرش روكهرت – شاعر و مترجم الآداب الشرقية".

PËRVJETORE

Dr. Pajazit Nushi

VEPRIMTARIA SHKENCORE E AKADEMIK JASHAR REXHEPAGIQIT DHE ZHVILLIMI I MENDIMIT PSIKOLOGJIIK*

I nderuari Akademik Jashar Rexhepagiq,
Të nderuar dashamirë, miq dhe kolegë të Akadamikut Jashar,
Zonja dhe zotërinj,

Zhvillimi i mendimit shkencor ndër shqiptarët, sidomos i atij në Kosovë, është i lindur me veprimtarinë e mendimtarëve të dalluar në disiplina të shumta shkenore. Ndër këta mendimtarë spikat veprimtaria arsimore, pedagogjike dhe shkencore e Akademik Jashar Rexhepagiqit. Veprimtaria shkencore e Akademik Jashar Rexhepagiqit ka një shtrirje të gjërë. Kjo veprimtari përfshinë disa disiplina të shkencave shoqërore e humaniste dhe komunikon me disiplinat e veçanta biomedicinale duke i kontribuar posaçërisht zhvillimit të mendimit teorik. Veprimtaria gjurmuese e gjërë e tij duke përfshirë edhe metodologjinë e punës kërkimore është dëshmi e veçantë e kësaj shtrirjeje dhe e subtilitetit të angazhimit në fushat e ndërlikuara të veprimtarisë hu-

* Ky artikull është huazuar nga revista "Dija" revistë e Degës së Pedagogjisë me rastin e 75-vjetorit të Akademik Jashar Rexhepagiqit, të mbajtur në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, i cili është edhe anëtar i redaksisë së revistës "Edukata Islame".

lumtuese të ndërlidhur me zhvillim të disiplinave shkencore teorike dhe aplikative. Kuptohet, qendra e angazhimit shkencor të Akademik J. Rexhepagiqit është sistemi i shkencave të pedagogjisë, ku vend të dalluar zë angazhimi në hulumtime të historisë së pedagogjisë. Në disiplinën e historisë së pedagogjisë ka hapur shtigje të reja në hulumtimin e zhvillimit të arsimit dhe të sistemit shkollor të shqiptarëve në territorin e ish-Jugosllavisë. Nëpër këto shtigje kanë ecur shumë studentë të tij, sidomos prof.dr.H. Koliqi, prof.dr. A. Vokrri, prof.dr.Nexhat Abazi, etj. Angazhimi i palodhshëm, sistematik dhe shumëvjeçar i tij ka bërë që Akademik J. Rexhepagiqi të jetë ndër punëtorët shkencorë dhe ndër akademikët më produktiv të Kosovës, që dëshmohet me faktin se ky ka botuar mbi 360 punime, nga të cilat 20 studime monografike dhe tekste shkollore.

I motivuar për nxënie e studim sistematik kolegu i ynë Akademik J. Rexhepagiq pas përfundimit me sukses të provimit të pjekurisë ka gjetur truall të plleshëm studimor në Universitetin e Zagrebit dhe në mjedisin e afirmuar të këtij universiteti. Fakulteti Filozofik i Universitetit të Zagrebit ku u regjistrua maturanti i përfunduar i Gjimnazit të Pejës në vitin 1949 kishte një traditë mësimore dhe shkencore prej 287 vitesh. Zotërimi me sukses i programit të studimeve pedagogjike, kur rreth 1/3 e lëndëve studiuese e përbënin lëndët e psikologjisë, ka qenë ndër faktorët e rëndësishëm të aftësimit të tij të hershëm për hulumtime shkencore, duke përfshirë në rend të parë hulumtimet pedagogjike, sikurse edhe hulumtimet psikologjike. Nga mendja dhe duart e mendimtarëve dhe profesorëve eminentë të këtij universiteti në vitet 50-ta të shekullit njëzet, sikurse ishin Vladimir Filipoviqi, profesor i filozofisë, dr. Dragutin Frankoviq, profesor i pedagogjisë, dr. Ramiro Bujas, profesor i psikologjisë dhe Akademik Zoran Bujas, profesor i psikologjisë, etj. u ngrit personaliteti i formuar profesional e shkencor për pedagogji Profesor J. Rexhepagiq, doktor i shkencave të pedagogjisë më 1965 dhe Akademik i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës nga viti 1978.

Zonja dhe zotërinj,

Profesori dhe Akademiku J. Rexhepagiq u dëshmua si hulumtues i zellshëm me shkallë të lartë të përpikërisë dhe të përgjegjësisë shkencore në përzgjedhje të çështjeve hulumtuese, që kanë të bëjnë me afirmimin e mendimit pedagogjiko-psikologjik në përgjithësi dhe me nxitjen e zhvillimit të mendimit psikologjik në veçanti. Sa i përket zhvillimit të mendimit pedagogjik u fol nga kompetentët. Dua të shtoj se zhvillimi dhe afrimi i këtij mendimi në veprat e Akademik J. Rexhepagiqit ka qenë i ndërlidhur dhe i bazuar edhe në rezultatet e studimeve psikologjike. Kështu, bie fjala, që nga viti 1963 ka botuar vështrimin *"Për disa çështje të raporteve ndërmjet psikologjisë dhe pedagogjisë"*, më 1965 ka shkruar *"Baza psikologjike e marrëdhënieve ndërmjet njerëzv e n'edukimin familjar"*, më 1989 ka kumtuar dhe botuar për temën *"Qasje teorike metodologjike të aspektit psikologjik dhe pedagogjik të hulumtimeve etnologjike në Kosovë"*, më 1997 ka kumtuar dhe ka shkruar *"Pedagogjia dhe psikologjia"*, më 2001 ka botuar kumtesën *"Pasojat pedagogjike dhe psikologjike të agresionit në Kosovë gjatë viteve të nëntëdhjeta"*, etj. Ishte recenzent dhe mentor i Fjalorit të Psikologjisë.

Profesor J. Rexhepagiqi ishte profesor i parë i psikologjisë në studimet e larta të Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë më 1958. Në studimet e shumta të historisë së pedagogjisë, të arsimit dhe të shkollës shqipe dallohet përkujdesja e veçantë e tij për formimin pedagogjiko-psikologjik të arsimtarëve. Studiuesve të zhvillimit të mendimit psikologjik Akademik J. Rexhepagiqi u ka ofruar një mori të dhënash dhe faktesh, sikurse edhe vlerësimesh të posaçme për identifikimin e rrugës dhe faktorëve të zhvillimit të mendimit psikologjik ndër shqiptarët, sidomos ndër shqiptarët e Kosovës. Nga përvoja e plleshme e tij mësojmë se profili i arsimtarit cilësor është formuar në mbështetje të një kulture të gjërë të lëmive të psikologjisë. Ndërkaq, profili i profesorit të pedagogjisë i formuar në studimet universitare të viteve '50-ta të Universitetit të Zagrebit ka pasë në bagazh të dijenive universitare përmbajtje të lëndës Psikologji e Përgjithshme, Psikologji Filozogjike, Psikologji Gjenetike, Psikologji Pedagogjike, Psikopatologji në kuadrin e lëndës Defektologji dhe Psikofiziologji të punës.

Gjashtë lëndë nga sistemi i disiplinave të shkencave të psikologjisë kanë qenë pjesë e planit të studimeve universitare në degën e Pedagogjisë. Më ka ardhur mirë që një akademik me kulturë kaq të lartë psikologjike u caktua anëtar i Komisionit për mbrojtje të doktoraturës së parë nga psikologjia në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Sot ndiej kënaqësi të posaçme kur konstatojë se mendimi psikologjik i mjedisit universitar të Zagrebit ka depërtuar edhe në mjedis të Kosovës me ndërmjetësim të atyreve, të cilët kanë kryer studimet në Universitet të Zagrebit dhe të literaturës psikologjike të botuar në kroatishte. Këtë pjesë të fjalës sime do ta përfundojë me konstatim të përgjithshëm, sipas të cilit mendimit psikologjik të zhvilluar "në mendjen popullore të shqiptarëve" i është bashkuar përmbajtja e dijenive të sistemuara shkollore, që nëpërmes të filozofisë e të pedagogjisë te ne u kultivua në rend të parë për nevoja të arsimit dhe të shkollës shqipe. Mbi themelin e këtyre nevojave dhe të praktikës edukativo arsimore dhe shkencore psikologjia u institucionalizua në departmend të studimeve psikologjike në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës që nga shtatori i vitit 2001.

Zonja dhe zotërinj,

Akademik J. Rexhepagiq ka botuar shqyrtime të rëndësishme teorike që kanë të bëjnë me aplikim të rezultateve psikologjike dhe të metodave kërkimore të psikologjisë në veprimtarinë pedagogjike dhe në orientim dhe këshillim të të rinjve për zgjedhje të profesionit. Të këtilla janë shqyrtimet: *"Individualizmi i mësimit dhe i arsimit në të kaluarën dhe sot, "Sami Frashëri dhe Pedagogjia e Rilindjes Kombëtare", "Rëndësia pedagogjike dhe vlera artistike e krijimtarisë letrare për fëmijët", "Shkolla dhe zgjedhja e profesionit"* etj. Mund të thuhet përgjithësisht se Akademik J. Rexhepagiq studimet e veta i bazon në rezultatet e hulumtimeve psikologjike, duke dëshmuar vazhdimisht sa nevojitet njohja e disiplinave të psikologjisë dhe arsimi e kultura psikologjike në veprimtarinë teorike dhe praktike të secilit intelektual, sidomos për veprimtari cilësore të arsimtarëve të shkollave të të gjitha niveleve dhe të të gjitha tipeve. Në këtë pikëpamje kontributi i tij ka rëndësi të veçantë. Gjurmuesit dhe përpiluesit e historisë së mendimit

psikologjiik në Kosovë e më gjërë duhet konsideruar studimet e tij një prej burimeve të rëndësishme të të dhënave, të fakteve, të pikëpamjeve, të qëndrimeve ndaj psikologjisë dhe ndaj mendimit psikologjik gjatë kohës së veprimtarisë së tij, përkatësisht në gjysmën e dytë të shekullit njëzet dhe në fillim të shekullit njëzetenjë.

Duke përmbyllur fjalën timë më lejoni që në emër të të gjithë Jush Akademik J. Rexhepagiqit t'i urojmë vite të shëndetshme dhe frytdhënëse.

Ju faleminderit

NGA TRADITA

Dr. Feti Mehdiu

HAFIZËT TANË GJATË HISTORISË IV [1]

Nga Tirana, Shkodra dhe Berati

Ideja për të përpiluar një pasqyrë të hafizëve tanë më ka lind kaherë. Ka më shumë se dhjetë vjet që më rrin mbi krye si një barrë të cilën duhet shkarkuar. Të them më sakt, prej atëherë kur e pashë botimin për hafizët e Sarajevës[2] fillova të mendoj për këtë. Këtë mendim ua shfaqa disa miqëve të mi në Tetovë duke i lutur që të bëjnë diçka për hafizët e Tetovës. Pse pikërisht në Tetovë ka disa arsye, por njëra nga ato kryesoret është se Tetova ka numër të madh të hafizëve edhe sot e kësaj dite. Në Tetovë ka pasë një traditë shumë të pasur për këtë lëmi. Aty këndohet Kur'ani (hatme ditore) prej vitit 1940 pa u ndërprerë për asnjë moment, pavarësisht nga rrethanat. Kjo hatme ditore këndohet nga hafizët e Tetovës në Xhaminë e Sahatit.

Koha kalonte dhe asgjë konkrete nuk u bë. Prandaj në vitin 2001 iu përvesha kësaj pune personalisht. Me përkrahjen e miqëve të mi

[1] Në numrat paraprakë të Edukatës Islame janë botuar shenimet për hafizët e Prishtinës, Prizrenit, Gjakovës, Pejës, Preshevës, Gjilanit,etj. Po sjellim shenimet edhe për hafizët e Tiranës, Shkodrës dhe Beratit me shpresë se dashamirët e Kur'anit do të na ndihmojnë të plotësojmë shenimet për tëra rajonet shqiptare.

[2] Hafizi u Sarajevu, Sarajevo, 1986?

Mr. Elez Ismaili dhe Hamdi Ilazi përpilova pyetsorin me shënimet që duhej të grumbulloja për këtë fazë të këtij projekti dhe i angazhova edhe disa shokë të tjerë nga kjo anë që të më ndihmojnë në këtë punë.

Fillova me Tetovën dhe për këtë rajon është kryer dhe është botuar në revistën Studime Orientale nr.2, 2002, Prishtinë, të cilën e boton Shoqata e Orientalistëve të Kosovës. Duke hulumtuar për hafizët e Tetovës kurreshtja nuk më lente të qetë. Vazhdova të vjel shënime edhe për territoret tjera shqiptare. Kam vjelë shënime nga territori i Maqedonisë, Kosovës, Malit të Zi , Sanxhakut dhe Shqipërisë, dhe të gjitha këto do të përmblidhen në kuadër të projektit **Hafizët tanë gjatë historisë.**

Fillimi nuk është i kufizuar, do të fillojë prej atëherë kur ne kemi mundësi të gjejmë shënime për hafizë, porse do ta mbyll me vitin 2005, atëherë kur mendoj se ky projekt do të jetë në fazën e fundit.

Shënimet e grumbulluara do t'i publikoj nëpër revistat tona me lutje që anëtarët e familjeve të hafizëve dhe dashamirë tjerë të Kur'anit të na ndihmojnë t'i plotësojmë mangësitë dhe t'i përfshijmë të gjith hafizët e kohëve të kaluara, tash për tash kemi shenime prej vitit 1667, e që mua, në fazën e parë të punës time, ka mundësi të më mungojnë.

Deri tash, më së paku shënime kam nga territori i Shqipërisë. Përkundër bindjes se aty ka pasë më shumë hafizë, unë kam vjelë shënime nga disa botime të reja si edhe nga revistat e viteve 20-45 të shekullit të kaluar dhe ato shënime, qofshin edhe jo të plota unë vendosa që t'i publikoj në revistën e çmuar PERLA, e cila del në Tiranë dhe e boton fondacioni *Sa'adi Shirazi.* Kam shpresë se edhe nga territori i Shqipërisë do të kem më shumë bashkëpunëtorë dhe ndihmëtar në këtë punë deri tash të paprekur.

Për të gjithë hafizët, përveç shënimeve që i kam paraqitur me këtë pyetsor, unë përpiqem të vjelë edhe të dhëna tjera biografike për jetën dhe veprimtarinë e tyre si edhe nga një fotografi (portret) që do të botohen, në dasht All-llahu, në një vëllim të veçant kur të jepet mundësia.

Me këtë përpjekje të përbashkët besoj se kryejmë një pjesë të borxhit ndaj atyre që kishin vendosur dhe e kishin nxënë tërë Kur'a-

nin përmendësh dhe e përcollën brez pas brezi deri tek ne. Ne duhet të përpiqemi që t'ua përcjellim brezave të ardhshëm ashtu si e meriton Shpallja e fundit e All-llahut.

Aktualisht për territorin e Shqipërisë këto shënime do t'i prezentojmë nën:

Myftinia Shkodër - Tiranë dhe Myftinia e Beratit

Shënimet që i hasni nën kapitullin Shkodër - Tiranë i kemi vjelë nga disa revista si Zani i Naltë, Kultura Islame dhe ndonjë shënim që na kanë afruar dashamirët e Kur' anit, kurse shënimet që i sjellim nën kapitullin Berati i kemi nxjerrë nga libri me titull: HAPSIRA TË KULTURËS ISLAME – BERATI, BERAT, 1999.

Myftinia Shkodër - Tiranë

emri mbiemri	*v.lind.*	*vendi*	*v. hifzit*	*te cili hafiz*	*v.vdek.*
hfz.Abdullah S. Sëmblaku	1892	Bilisht		Ahmet Ajdini	1960
hfz. Abdullah ef. Myftia	1867	Shkodër			
hfz. Abaz Golemi	1870	Shkodër			1925
hfz. Abdulla Neziri		Shkodër			
hfz. Abdullah Bërdica		Shkodër			
hfz. Adem Kazazi		Shkodër			
hfz. Abdylfetah Dragusha		Shkodër			
hfz. Ali Kraja (Tari)	1900				1974
hfz. Ali Korça		Korçë			1957
hfz. Ali Tivari				ZN	
hfz. Aqif		Tiranë			
hfz.Emin Kor[a					
hfz.Esat A.Myftia,	1911	Shkodër			
hfz. Fiqiri N. Skënderaga	1903	D. e madhe			1969
hfz. Halit Bushati		Shkodër			

hfz. Halil Puka		Shkodër			
hfz. Hasan Këlliçi	1793	Shkodër			
hfz.Hajredin Delli		Fillat			1970
hfz.Hajdar Durrësi		F.çelë			
hfz.Hamdi Canga		Tiranë			
hfz.Hasan H. Qytyku	1931	Polis (Elb.)	1956	hfz. Xhemali	
hfz.Ibrahim M.Dalliu	1878	Tiranë			1952
hfz. Ibrahim Kaduku		Shkodër			
hfz.Ibrahim Mitrovica		Mitrovicë			
hfz. Ibrahim Repishti		Shkodër			
hfz.Ismet Xh. Dibra		D. Madhe			
hfz.Isuf Karakaçi					
hfz.Izet Durrësi					
hfz. Jusuf Kelmendi		Shkodër			
hfz.Jusuf Cungu					
hfz.Mahmud Dashi	1880	Tiranë	1915		1960
hfz. Maliq Tanusha	1870	Rekë		ZN.	1928
hfz.Mehmet Blakaj		Pejë			
hfz.Muhamet Gogoli	1895	Tiranë			
hfz.Muhamet Bekteshi,	1887	Shkodër			1962
hf.Muhamed Kastrati		Shkodër			
hfz.Musa A. Basha		Elbasan			
hfz. Musa Dërguti	1867	Shkodër			1961
hfz.Mustafë Dauti	1910	Prilep			
hfz.Mustafa Doraci	1890	Tiranë	1915		1970
hfz.Mustafa ef.		Ajdonat			1910
hfz. Nexhipi				ZN	
hfz.Osman Durrësi	1908	Shkodër			1980
hfz.Qazim Çami	1802	Çamëri			1982
hfz.Qazim Ismaili	1890	Vlorë			

hfz. Refat Haxhiu				ZN	
hfz. Raifi				ZN	
hfz.Sabri Koçi	1921	Librazhdë	1938	hfz.M.K astrati	2004
hfz. Sabri Bushati		Shkodër			
hfz.Sait Çanga					
hfz. Sali Hylja		Shkodër			
hfz. Sulejman S.Durrësi		Shkodër			
hfz.Sulejman Myrtaj	1908	Shkodër			1970
hfz.Shaban K. Saliaj		Tiranë			
hfz.Shefqet Boriçi	1885	Shkodër			1980
hfz. Shefqet Cungu					
hfz.Sherif Langu		Dibër			
hfz.Tahir Hallulli	1880	Tiranë		ZN.hfz. H.Tahiri	1955
hfz. Xhaferi,				**ZN**.	
hfz.Xhemal S.Canga	1913	Shkodër			1979
hfz.Xhemal Mullai Dibra	1881	Dibër	1896		1965
hfz. Xhevdet Zylja	1905	Shkodër			1992
hfz. Ymer Dilja				ZN.	
hfz.Ymer Bakalli im-vaz					

Myftinia e Beratit

Emri e mbiemri	*v.lin.*	*vendi lind*	*v.hfz.*	*te cili hfz.*	*v.vdk*
hfz.Fahredin M. Hoxha	1899	Berat			1941
hfz. Hajri M. Emini	1904	Konispol		në Janinë	1984
hfz.Islam Delibashi	1890	Galinë			1985
hfz.Isuf A. Shehu	1902	Berat			1961
hfz.Lutfi A. Qojle	1871	Berat			1985
hfz.Mehmet I. Bolleke	1917	Berat			1940
hfz.Mehmet Memishi	1870	Berat			
hfz.Mehmet N.Durdia	1903	Berat	1920	hfz M.Memishi	1986
hfz..Muharem D. Qahalliu	1915	Berat	1930		1975
hfz.Mustafa A.Basha	1889	Berat			1962
hfz.Refet D. Peshtani	1880	Berat		m.Demiri	1936
hfz.Riza A. Drenova	1898	Berat	1918	hfz. M. Memishi	1972

RECENSION

“Trajtesa mbi imanin” të autorit Hasan Fehmi efendiu

Libërthi i autorit shkupjan Hasan Fehmi efendiu, me titull *Trajtesa mbi imanin*, (*Logos-A*, 2003), të përkthyer nga osmanishtja, paraqet edhe një ‘provë’ se tokat shqiptare, të populluara me muslimanë, paraqesin gurrë të pashtershme për historinë, kulturën dhe traditën tonë islame, që pason traditën e pasur të Suzi Prizrenit, Mesih Prishtinasit, Isak Çelebiut nga Shkupi, Jahja bej Dukagjinit-nga shekujt XVI-XVII, të bejtexhinjve Muhamet Kuçuku, Ibrahim Nezimi dhe rilindësve si Naim e Sami Frashëri, Rexhep Voka, Tahir Boshnjaku, Dervish Hima - në shekujt XIX-XX dhe shumë të tjerëve gjatë shekujve të kaluar.

Njëherësh, libërthi në fjalë paraqet edhe një dëshmi se krijimet e autorëve muslimanë, ndonëse në masë të madhe të injoruara, madje edhe të shtrembëruara e të falsifikuara nga intelektualë shqiptarë, megjithatë po gjejnë rrugë për të parë dritën e botimit, për t’iu bërë të njohura opinionit mësimdashës. Këtë realitet e ka vërejtur qysh moti profesor Hasan Kaleshi (*Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame, Prizren, 1411/1991)* Muhamet Pirraku *(Zhvillimi i kulturës kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit, Prishtinë, 1989)* dhe së voni Mahmud Hysa *(Alamiada shqiptare, I-II, Shkup, 2001)* dhe vetë autori i këtyre rreshtave në disa shkrime, e autorë të tjerë.

Nga të dhënat që ofrohen, mund të konstatohet se Hasan Fehmi efendiu ishte njohës i disa gjuhëve (shqip, turqisht, arabisht, bullgarisht), që e bënte atë komunikativ me rrethin ku jetonte dhe vepronte. Gjatë karrierës së tij ai kreu me përgjegjësi detyrën e imamit, hatibit dhe mualimit në xhami. Këtë e dëshmon vetë parathënia e libërthit. Ishte personalitet i kohës, tejet i gjallë dhe kreativ po modest, i dashur dhe i afërt me popullin dhe mbi të gjitha i devotshëm.

Hasan Fehmiu kreu disa detyra publike me rëndësi: profesor në medresenë “Atije Hanmi” në Shkup, anëtar i trupit gjykues në Gjykatën e Vilajetit të Kosovës, dhe pas katër vitesh (1904) myfti i Vilajetit të Kosovës. Kreu edhe funksione të tjera me rëndësi fetare dhe shoqërore.

Në rrafshin e fjalës së shkruar, shkroi dy vepra: “Zubdet’ut-ta’-lim” dhe “Risalei imanije”. Këtë të fundit, që e kemi në shqyrtim, Hasan efendiu e shkroi në një kohë të vështirë, kur për Islamin flitej kryesisht negativisht. Osmanlinjtë, nga brenda të shtrënguar nga tendenca shekullariste, kurse nga jashtë nga forcat sllave e evropiane, përjetonin periudhën më të rëndë perandorake. Në rënie ishte çdo sferë e jetës. Në këto rrethana politiko-shoqërore dhe në suaza të aftësive të tij intelektuale dhe të nivelit intelektual e shkencor të kohës së tij, kurse për nevojat e xhematit të tij, ai u përpoq që muslimanëve t’u afronte dhe t’u ofronte thesarin islam, mësimin e tij për nevoja praktike të nxënësve të tij.

Ai, me mençuri dhe akribi, absorboi literaturën klasike islame, që vërehet në çdo pasus, duke ia afruar dhe ofruar besimin islam rrënjëve të tij. Imponon qasja e tij ndaj temës së shkruar. Shkrimi është origjinal, kritik dhe shumështresor. Stili është ekspresiv, kurse metoda skolastike dhe apologjetike, për se ndjek klasikët e ilmu’l-kelamit, si Ebu Hanifen, Imam Maturidiun, Imam Nesefiun e të tjerë. Problemet e rënda doktrinare trajtohen dhe analizohen guximshëm, qartë, me argumente nga Kur’ani, Hadithi dhe autorët klasikë, por pa rrëmujë e hendeqe, që veprës i jep vlerë të lartë shkencore, didaktike dhe metodike. Për disa konstatime, Hasan Fehmi efendiu edhe do të mund të kritikohej, por kjo çështje nuk e humb aspak vlerën e libërthit.

Për lexuesit shqipfolës vepra ka rëndësi të shumëfishtë: *Vlerë fetare-doktrinare-praktike dhe kulturo-historike*, sepse dalja e veprës në dritë në gjuhën shqipe ofron kontribut për njohjen e së kaluarës sonë islame në këto treva; përkthimi dhe botimi i veprës në gjuhën shqipe, gjithashtu, tregon nivelin e zhvillimit të shkencës së akaidit dhe shkencave të afërta me të ndër ne atëbotë, dhe lidh fijet thuajse të këputura ndërmjet brezave të muslimanëve në Ballkan.

I kundruar nga largësia, libërthi shërben si vravashkë, kurse i kundruar nga afërsia, si shtyllë e fuqishme në vlerat e besimit, tashmë një kohë të provokuara nga individë dhe grupe të 'importuar' nga vende e qarqe me mentalitet skizmatik, sektar dhe të dyshimtë të disa qendrave muslimane.

Është e rrugës që kjo vepër të hulumtohet rrënjësisht si në aspektin doktrinar, ashtu edhe në aspektin kulturor-historik, në kontekst të rrethanave politiko-shoqërore dhe fetaro-kulturore, për ta parë Hasan Fehmi efendiun në tërë madhështinë e tij intelektuale si hoxhë, myderriz, myfti, gjyqtar, po edhe si njeri dhe personalitet të kohës.

Në mungesë të studimeve më të hollësishme për autorin dhe rrethanat politike në kohën dhe vendet ku ka vepruar, nuk e shohim të rrugës të lëshohemi në elaborim të hollësishëm. Por, mbetet obligim që në të ardhmen të bëhen hulumtime shumëdimensionale për ndriçimin e së kaluarës për të ndërtuar të ardhmen.

Lexuesi shqipfolës, me botimin e këtij libërthi, do të fisnikërohet dhe pasurohet me dije të rrallë dhe shumë të nevojshme nga thesari musliman. Kjo asocion me faktin që kohët e fundit ka filluar të zgjohet vetëdija për publikimin e dorëshkrimeve a botimeve të vjetra, për opinion të panjohura. Botimi i veprave klasike të Imam En-Nesefiut, Imam El-Maturidiut, të Ebu Hanifes, pastaj të veprave të Sami Frashërit e të tjera, dëfton se ***duke studiuar dhe nderuar të parët, kemi filluar ta nderojmë vetveten dhe ta ndërtojmë të ardhmen.***

Meritë të madhe për këtë sihariq për lexuesit ka përkthyesi zotëri Dhylkarnejn Vardari dhe botuesi tashmë i dëshmuar.

N. Ibrahimi

Recension:

"Muhammedi a.s. dhe Kur'ani "
(Osman Nuri-Haxhiq, Muhammedi a.s. dhe Kur'ani

- Shqyrtim mbi historinë e kulturës islame)

Vepra e autorit boshnjak Osman Nuri Haxhiq, *Muhammedi a.s. dhe Kur'ani - Shqyrtim mbi historinë e kulturës islame*, përgatitur për botim nga SHB *Logos-A*, ka një jetë të gjatë mbi shtatëdhjetë vjet. Për herë të parë u botua në vitin 1931 në Beograd, për të përjetuar tri botime (sa kemi të dhëna) dhe për të mos pushuar të mbetet interesante, aktuale dhe provokative edhe për autorë të Lindjes edhe autorë të Perëndimit.

Osman Nuri Haxhiq, (1869–1937), letrar dhe publicist boshnjak, veprën e vet e shkroi në një kohë të vështirë, kur për Islamin flitej kryesisht negativisht. Në suaza të aftësive të tij intelektuale dhe të nivelit intelektual e shkencor të kohës së tij, Osman Nuri Haxhiq u përpoq që muslimanëve, por edhe jomuslimanëve, t'ua afronte Islamin, mësimin e tij, jetën dhe veprën e Muhammedit a.s. dhe shkurtimisht një trashëgimi të pasur kulturo-historike islame, e cila edhe në ditët tona kontestohet në qarqe e rrafshe të caktuara.

Duke marrë parasysh rrethanat dhe kohën kur është shkruar vepra, Osman Nuri Haxhiq me mençuri ka përdorur literaturën klasike dhe moderne, islame dhe evropiane, që veprës i jep freski e të dhëna herë-herë të panjohura.

Veçan meriton të theksohet qasja ndaj temës. Ajo është origjinale, kritike dhe shumështresore. Problemet e rënda doktrinare dhe ato praktike ndërlidhen ndërmjet tyre pa u hetuar, dhe kjo veprës i jep vlerë shkencore. Për disa qëndrime të tij, Osman Nuri Haxhiq qe kritikuar nga një pjesë e ulemasë tradicionale, mirëpo, këto qëndrime, paksa të diskutueshme, Bashkësia Islame e Sarajevës në botimin e dytë (1968)

e të tretë (1986) i ka korrektuar, kështu që vepra paraqet një vlerë të pakapërcyeshme për shkencën dhe kulturën përgjithësisht.

Për lexuesit shqipfolës vepra ka rëndësi të shumëfishtë, por do t'i cekim vetëm dy: 1) Vlerë kulturo-doktrinare, sepse dalja e veprës në dritë u shërben edhe lexuesve tanë, të cilët në Ballkan ndanin pothuajse një fat historik me popullin boshnjak; 2) Historike-fetare, sepse përkthimi dhe botimi i veprës në gjuhën shqipe zhvillon marrëdhëniet ndërmjet muslimanëve shqiptarë e boshnjakë dhe forcon aleancat natyrore shumëshekullore.

Për shkak se vepra është e pasuruar me Parathënien e dr S. Stanojeviçit nga viti 1931, me Parathënien e botimit të dytë, me parathënien e botimit të tretë dhe me një shkrim biografik mbi Osman Nuri Haxhiqin, nuk e shohim të udhës të thellohemi në elaborim të hollësishëm.

Mendoj se lexuesi shqipfolës nuk do të zhgënjehet kur të lexojë këtë vepër në gjuhën shqipe. Përkundrazi, do të fisnikërohet dhe pasurohet me dije të rrallë nga pasuria e thellë e thesarit musliman. Përkthyesi dhe botuesi për përgatitjen e veprës për botim, meritojnë çdo lëvdatë!

Lëvdatë meriton edhe revista **Edukata Islame**, e cila, hap pas hapi, po 'rritet' në një revistë të mirëfilltë shkencore, duke ofruar shkrime interesante, rubrika të reja (kronikë lajmesh nga kultura, recensione veprash) dhe përkthimin e rezymeve në dy gjuhë të huaja.

N. Ibrahimi

PËRMBAJTJA

Qemajl Morina
Arsimimi.....5
Education
التعليم

Prim.dr.med.sci. Ali Iljazi
Kur'ani Famëmadh mahnit shkencëtarët.....17
The glorious Qur'an fascinates scientists
القرآن الكريم تحدى العلماء

Avni Aliu
Islami është program jete, jo adet.....37
Islam is a life program, not a habitude
الاسلام نظام حياة و ليست عادة

Nexhat Ibrahimi
Çështje bashkëkohore të etikës islame 63
Contemporary issues of Islamic Ethics
القضية المعاصرة للخلق الاسلامى

Ajni Sinani & Mimoza Sinani
Kultura dhe civilizimi 83
Culture and civilization
الثقافة و الحضارة

Abdullah Nasih Ulvan
Salahudin el-Ejubi hero i betejës së Hittinit dhe çlirues i Jerusalemit nga kryqtarët 111
Salahudin el-Ejubi hero of the battle of Hittin and liberator of Jerusalem from the crusaders
صلاح الدين الايوبى بطل معركة حطين و محرر القدس من الصلبيين

Dr. Ismail Bardhi
Temat dhe dilemat e arsimit fetar.....129
The topics and dilemas of religious education
الموضوعات و الخيارات

Akademik Jashar Rexhepagiq
Nevoja e studimit të arsimit të lartë tek ne dhe disa sugjerime .135
The need to study higher education in our country and a number of suggestions regarding this
حاجتنا الى التعليم العالى مع بعض التوصيات

Mr. Qemajl Morina
Angazhimi i BI të Kosovës në zhvillimin e arsimit universitar islam në kuadër të FSI-së të Prishtinës 143
The efforts of the Islamic Community of Kosova in the development of university education through the Faculty of Islamic Studies in Prishtina
مساعى المشيخة الاسلامية فى كوسوفا لتطوير التعليم الاسلامى فى اطار كلية الدراسات الاسلامية

Akad. Dr. Feti Mehdiu
Religiolinguistika islame në kënbët popullore shqiptare.....153
The religiolinguistc in the albanian people sings
فقه اللغة الاسلامي في اللاغاني الشعبية الالبانية

Tahar Ben Jellon
Si ia shpejgova vajzës siame racizmin 167
How i explained racism to my daughter
كيف شرحت لابنتى التفرقة العنصرية

Mr. Sc. Menduh Bamja
Ideja e tolerancës fetare dhe ndikimi i saj në shoqëri.....185
The idea of religious tolerance and its influence in society
فكرة التسامح الدينى و تأثيره فى المجتمع

Dr. Sherif Muhamed
Femra në Islam përballë traditës judeo-krishtere – (3).....205
Women in islam in the face of the judeo-christian tradition - (3)
وضع المرأة في الاسلام بالمقارنة مع اليهودية و المسيحية – (٣)

Sadik Mehmeti
Dorëshkrimet orientale në bibliotekën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Sharr.....229
Oriental manuscripts in the library of the Islamic Community Council in Sharr
المخطوطات الشرقية بمكتبت الوقف الاسلامي بمدينة شار

Do të preferoja që njerëzit të më quajnë arabolog.....239
I would prefer to be called an arabist
أفضل ان يسمينى الناس مستعربا

Dr. Pajazit Nushi
Veprimtaria shkencore e akademik Jashar Rexhepagiqit dhe zhvillimi i mendimit psikologjik.....247

Dr. Feti Mehdiu
Hafizët tanë gjatë historisë - (IV).....253

“Trajtesa mbi imanin” të autorit Hasan Fehmi efendiu.....259